

DOK

Seria e dokumentacioneve e Qendrës
International Projects in Education
Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut

Documentation Series
International Projects in Education
Zurich University of Teacher Education

Për dinamikën e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash

Përvoja dhe perspektiva nga rrjeti Kultura
e parë, e dytë dhe ndërkultura (NEZI)

RAPORT PËR PROJEKTIN

Seria e dokumentacioneve e Qendrës
International Projects in Education
Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut
Vëllimi 1

Botues i këtij vëllimi

Basil Schader, Prof. dr. dr., docent në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Cyrihut, Bashkëdrejtues i projektit
«Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura» për Qendrën IPE të Shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut

Përkthimet shqip – gjermanisht dhe gjermanisht – shqip

Brikena Kadzadej, Prof. dr.; Departamenti i Gjermanistikës, Universiteti i Tiranës

Lektorati i teksteve shqip

Brikena Kadzadej, Prof. dr.; Departamenti i Gjermanistikës, Universiteti i Tiranës

Koncepti dhe kopertina

Nadine Hugi

Layouti dhe radhithja

Barbara Müller

Printimi

Shtypshkronja Printing press, Prishtina

Mbështetja financiare

Rrjeti «Kultura e Parë, e Dytë dhe Ndërkultura» u financua nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Arsimit,
Hulumtim dhe Inovacion (SBFI)

Dorëzimi/Porositja

PH Zürich, Zentrum IPE
LAA M042
Lagerstrasse 9
CH-8090 Zürich
ipe@phzh.ch

© 2016 Zentrum IPE (International Projects in Education) der PH Zürich. <http://www.phzh.ch/ipe>
Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit.

Kjo vepër është e mbrojtur nga të Drejtat e Autorit. Për këtë arsye të drejtat e argumentuara, veçanërisht të përkthimit, të ribotimit, të referimit apo të shumëfishimit dhe të memorizimit në dosjet e përpunimit të të dhënave, mbeten të rezervuara edhe gjatë ripërdorimit vetëm në fragmente. Shumëfishimi i veprës apo i pjesëve të veprës është i lejueshëm edhe në raste të veçanta vetëm në kufijtë e përcaktimeve ligjore të ligjit për të Drejtat e Autorit në versionin në fuqi. Ato parimisht janë të detyruara për dëmshpërblim.

Ky vëllim del në një botim në gjuhën shqipe dhe gjermane.

ISBN Botimi në gjermanisht: 978-3-9524544-8-0

ISBN Botimi në shqip: 978-3-9524544-9-7

Për dinamikën e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash

Përvoja dhe perspektiva nga rrjeti Kultura
e parë, e dytë dhe ndërkultura (NEZI)

BASIL SCHADER

Përmbajtja

FJALË PËRSHËNDETËSE DHE SHOQËRUESE 5

Benedikt Hauser (SBFI): Një projekt, ashtu si i nevojitet Zvicrës 6

Regina B. Bühlmann (EDK): Mbi dinamikën e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash: Roli i mësimit të gjuhës së prejardhjes 7

Wiltrud Weidinger, Rolf Gollob (IPE): Bashkëpunim i qëndrueshëm, falë takimit të drejtpërdrejtë 9

PJESA I

Hyrje: Rrjeti «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura» (NEZI): Qëllimi, kronologjia, efekte (Basil Schader) 11

1 Vështrim i shkurtër 12

2 Pikënisja 13

3 Fokuset dhe objektivat e rrjetit. Përhapja 15

4 Kronologjia e punës në rrjetin «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura» 19

4.1 Vështrim i përgjithshëm 19

4.2 Për përzgjedhjen e pjesëmarrësve të rrjetit 21

4.3 Programet veç e veç të çdo konference 23

5 Arritjet dhe dëshirat e hapura. Bilanci 39

5.1 Shënim paraprak 39

5.2 Metodika e nxjerrjes së rezultateve 40

5.3 Prononcimet lidhur me arritjen e qëllimeve të rrjetit 40

5.4 Një vështrim mbi përgjigjet për pesë pyetjet në artikujt individualë 56

5.5 Një vështrim mbi përgjigjet për tri pyetjet në artikujt e grupeve 71

5.6 Bilanci, pasojat, rekomandimet 80

PJESA II

Përfitimet dhe rrjedhojat e rrjetit:

Referime individuale të pjesëmarrësve **85**

Grupi i Zvicrës (Pjesëmarrësit/et nga Zvicra pa origjinë shqiptare) **86**

Grupi shqiptar i Zvicrës (Pjesëmarrësit/et nga Zvicra me origjinë shqiptare) **107**

Grupi i Shqipërisë (Pjesëmarrësit/et nga Shqipëria) **135**

Grupi i Kosovës (Pjesëmarrësit/et nga Kosova) **150**

Grupi i Maqedonisë (Pjesëmarrësit/et nga Maqedonia) **169**

PJESA III

Përfitimet dhe pasojat e rrjetit:

Referime të koordinuara të të pesë grupeve **189**

Grupi i Zvicrës (Pjesëmarrësit/et nga Zvicra pa origjinë shqiptare) **190**

Grupi shqiptar i Zvicrës (Pjesëmarrësit/et nga Zvicra me origjinë shqiptare) **194**

Grupi i Shqipërisë (Pjesëmarrësit/et nga Shqipëria) **199**

Grupi i Kosovës (Pjesëmarrësit/et nga Kosova) **203**

Grupi i Maqedonisë (Pjesëmarrësit/et nga Maqedonia) **207**

SHTESË **211**

Jetëshkrime të shkurtra të pjesëmarrës/eve të rrjetit **212**

Fjalë përshëndetëse dhe shoqëruese

Një projekt, ashtu si i nevojitet Zvicrës

Benedikt Hauser

SBFI (Sekretariatat Shtetëror Zviceran për Arsim, Kërkim dhe Inovacion)

Ky prezantim i shkurtër i anashkalon me vetëdijë lëvdatat mbi rezultatet shkencore të projektit të kulturës së parë, të dytë dhe të ndërkulturës. Të bësh vetë rolin e vlerësuesit, ose më tej akoma të kryesh vetë vlerësime rreth përmbajtjeve, nuk i shkon administratës. Ajo jo vetëm që duhet të pranojë principin e lirisë së mësimdhënies e kërkimit shkencor, por duhet ta respektojë edhe vetë atë duke u kufizuar tek kujdesi për sigurimin e cilësisë si dhe të kushteve të përgjithshme e mjeteve të nevojshme për këtë.

Detyra e SBFI-së është promovimi i të qenit konkurrues në nivel ndërkombëtar të seksionit të edukimit e hulumtimit në Zvicër. Pyetja shekullore/profane që duhet të shtrojmë është: Cila ka qenë ndihmesa e këtij projekti për këtë qëllim? Çfarë i ka sjellë ai konkretisht Zvicrës?

Më lejoni të them paraprakisht: Treguesit që do të lejonin të matnin efektivitetin e inputit monetar të Konfederatës së Zvicrës me anë të outputit shkencor të punës së kryer këtu, nuk ekzistojnë. Dhe kjo gjë padyshim duhet dhe le të jetë kështu, sepse ekziston sigurisht edhe cilësia e mirë që nuk i nënshtrohet procesit të matjes. Edhe pse nuk mund të vërtetohet me shkrim (e zëza mbi të bardhë), sërish mbetet e pamohueshme, që ky projekt ka kontribuar për hapjen dhe për forcimin e sistemit shkollor të Zvicrës: Ai u ka lejuar shkollave të larta të vendit tonë të zgjerojnë e thellojnë shkëmbimin shkencor ndërkombëtar. Në këtë mënyrë, ai ka kontribuar për përfitimin e njohurive dhe për zhvillimin e çështjeve të reja, që me siguri do të ndihmojnë gjithmonë e më tepër në shmangien e shanseve të padrejta të kushtëzuara nga aspekti kulturor, social dhe ekonomik si dhe për njohjen, adresimin si dhe promovimin e fokusuar të potencialeve të fshehura. Duke konsideruar edhe mungesat që ka në Zvicër për staf të specializuar, mund të themi se këtu bëhet fjalë edhe në aspektin politiko-ekonomik më shumë se kurrë për një urdhërim, injorimin e të cilit shteti ynë nuk është në gjendje ta përballojë më gjatë.

Projekti dhe rezultatet e tij u mundësuan vetëm sepse Zvicra nuk e ndoqi e vetme, por e konceptoi dhe zhvilloi atë së bashku me Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë. Risi ishte veçanërisht qasja e përfshirjes së diasporës shqipfolëse të të tri shteteve në Zvicër si shtyllë mbështetëse në projekt, vlerësimi i përvojave dhe i njohurive të tyre dhe tematizimi i çështjeve që mund të lindin për nxënësit, mësuesit si dhe për prindërit dhe edukatorët, për shkak të emigrimit dhe rikthimit. Mobiliteti ndërkombëtar po zhvillohet gjithmonë e më pak si një proces i vetëm i planifikuar në plan afatgjatë e që përmbushet vetëm në një drejtim. Kapërcimet e përsëritura e të paparashikuara të kufijve do të ndeshen gjithmonë e më shpesh. Teknologjitë e reja të informacionit lejojnë gjithashtu shkëmbimin me kosto të ulët dhe brenda një kohe mjaft të shkurtër edhe midis distan-

cave të largëta. Në këtë mënyrë sigurisht hapen mundësi dhe shanse të reja. Por nga ana tjetër shtohet njëkohësisht edhe kompleksiteti i problemeve që lindin dhe, përta i përket shkollës, edhe pretendimet e larmishme të grupeve të interesit.

Në përfundim duhet theksuar angazhimi i madh i gjithë personave pjesëmarrës në projekt. Mbresëlënëse dhe shembullore ishte aftësia e tyre për t'u entuziazmuar për një ide, për t'u përfshirë dhe për ta transferuar entuziazmin e tyre tek të tjerët, si dhe nuk duhet lënë pa përmendur, kompetenca e lartë e skuadrës drejtuese si për të konceptuar, ashtu edhe për të drejtuar me profesionalizëm këtë projekt ambicioz. Pranimit i kësaj detyre që kërkon shumë njohuri organizative, sens për detyrimet administrative, ndjeshmëri dhe këmbëngulje, nuk është gjithmonë e vetëkuptueshme. Por për suksesin, ajo mbetet përherë e domosdoshme.

Mbi dinamikën e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash: Roli i mësimi të gjuhës së prejardhjes (Mësimi në gjuhën dhe kulturën e prejardhjes, HSU ¹)

Regina B. Bühlmann

Komisionere për çështjet e emigracionit në Sekretarinë e Përgjithshme të Konferencës Zvicerane të Drejtorëve të Arsimit të Kantoneve (EDK)

Me ftesë të drejtuesve të projektit mora pjesë si përfaqësuese e autoriteteve rajonale të arsimit në konferencat e rrjetit ndërkombëtar me fokus kulturën e parë, të dytë dhe ndërkulturën (NEZI).

Bashkëpunimi im filloi me një prezantim të mësimi të MGJP-së në Zvicër në pranverë të vitit 2015 gjatë takimit të Shkollës së Lartë Pedagogjike të kantonit të Cyrihut. Kjo ishte ideale, pasi promovimi i gjuhëve të origjinës të nxënësve me sfond emigranti, përbën edhe një nga qëllimet e Konferencës Zvicerane të Drejtorëve të Arsimit të Kantoneve

¹ HSU: Në vijim do të përdoret shkurtime HSK (Mësimi në gjuhën e kulturën e prejardhjes), pasi në Zvicër përdoret zakonisht ky shkurtime.

(EDK) në kuadrin e strategjisë së tyre për mbështetjen e shumëgjuhësisë.² Kjo konferencë pati në fokus rolin e mësimi të gjuhës e të kulturës së prejardhjes për një orientim më të mirë midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës si dhe për edukimin për një shoqëri demokratike në diasporë.

Mësimi i gjuhës e kulturës së prejardhjes në Zvicër normalisht është nën përgjegjësinë e komuniteteve të ndryshme gjuhësore ose të shteteve të prejardhjes. Ai mbështet shkrimin e këndimin në gjuhën e parë të nxënësve, të cilët në familje flasin një gjuhë të ndryshme nga gjuha që flitet në shkollë dhe, në këtë mënyrë, jep një ndihmesë të rëndësishme për mësimin e gjuhëve të dyta dhe të huaja.

Përveç kësaj, mësimi i gjuhës dhe i kulturës së prejardhjes ndikon pozitivisht edhe mbi formimin e identitetit dhe orientimin e këtyre nxënësve në mjedisin e tyre social.

Në këtë kontekst, kurrikula e zhvilluar nga Kantoni i Cyrihut për gjuhën dhe kulturën e prejardhjes (versioni i përpunuar vitit 2011), është me interes.³ Qysh në konceptimet e tij bëhet e qartë se MGJP-ja duhet të mbështesë nxënësit, midis të tjerash, në trajtimin e koncepteve të ndryshme mbi identitetin dhe për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore dhe duhet të promovojë integrimin e tyre në sistemin shkollor fillor në vend. Për këtë arsye, një qëllim i rëndësishëm i planit mësimor kornizë të MGJP-së së Cyrihut, është një lloj njehsimi dhe harmonizimi i kurrikulave të departamenteve përgjegjëse për MGJP-në me kurrikulën e shkollës fillore të Cyrihut.

Takimi në Cyrih ofroi mundësinë që objektivat e mësimi të gjuhës e kulturës së prejardhjes të demonstroheshin me shembuj të mirë, të ndriçoheshin kushtet e përgjithshme aktuale të MGJP-së dhe për mësuesit e MGJP-së dhe, nisur nga ky sfond, të shtrohet pyetja se si kontribuon ky mësim për promovimin e shumëgjuhësisë dhe për formimin e kompetencave ndërkulturore e sociale të nxënësve në Zvicër dhe se ku janë vendosur eventualisht objektiva më ambicioze nga ç'e lejojnë rrethanat e dhëna. Një plus i madh ishte fakti që diskutimet u ushqyen me inpute nga katër perspektiva të ndryshme (ish shkollarë të MGJP-së, persona përgjegjës për MGJP-në, përfaqësues të Shkollës së Lartë

2 MGJP në dokumentet e EDK-së: Rekomandime të EDK-së për shkollimin e fëmijëve me gjuhë të huaj që prej 1991 (<http://www.edk.ch/dyn/11984.php>); Strategjia kombëtare për zhvillimin e mëtejshëm të mësimi të gjuhëve nga vitit 2004 (<http://www.edk.ch/dyn/11911.php>); Marrëveshja e harmonizimit të vitit 2007 (neni 4 parag. 4): <http://www.edk.ch/dyn/11659.php>; Studime + raporte 34 për koordinimin e mësimi të gjuhëve, 2012 (<http://www.edk.ch/dyn/25876.php>); Studime + raporte 36 për MGJP-në, 2014 (Përzgjedhje e praktikës së mirë: <http://www.edk.ch/dyn/27186.php>); Bazë të dhënash për MGJP-në (Anketim kantonal i aktualizuar çdo vit: <http://www.edk.ch/dyn/19191.php>).

3 Plani mësimor kornizë i MGJP-së së Zyrihut ekziston në gjermanisht si dhe në 20 gjuhë të ndryshme prejardhjeje: http://www.vsa.zh.ch/internet/bildungsdirektion/vsa/de/schulbetrieb_und_unterricht/faecher/sprache/heimatliche_sprache_kultur_hsk.html#subtitle-content-internet-bildungsdirektion-vsa-de-schulbetrieb_und_unterricht-faecher-sprache-heimatliche_sprache_kultur_hsk-jcr-content-contentPar-textimage_4. Orientimi nga plani mësimor kornizë është i detyrueshëm për përgjegjësit e MGJP-së në kantonin e Zyrihut për njohjen kantonale. Në kantonet e tjera orientimi nga plani mësimor kornizë thjesht rekomandohet (Basel-Landschaft, Basel-Stadt, Bern, Freiburg, Glarus, Schaffhausen, St. Gallen, Thurgau und Zug).

Pedagogjike, përfaqësues të autoriteteve arsimore) dhe që këto perspektiva u pasuruan me një reflektim nga jashtë në grupet e diskutimit ndërkombëtar. Gjithashtu me vlera ishte edhe lidhja e drejtpërdrejtë me praktikën që u mundësua me vizitën tek sekuencat mësimore të mësimi të gjuhës dhe kulturës së prejardhjes në ditën para Konferencës.

Rrjeti NEZI ka për qëllim të aktualizojë njohuritë duke i kapërcyer kufijtë e shteteve dhe të promovojë çështjet e ardhshme të kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës të fëmijëve dhe të të rinjve, veçanërisht në formimin e mësuesve. Pjesëmarrja ime si përfaqësuese e autoritetit ndërkantonal të arsimit në takimet e Cyrihut, më dha një ndjesi pozitive, pasi takimi tregoi se çfarë kompetencash të mëdha sjell që tani diaspora shqipfolëse në Zvicër në shkollat e larta, ndër të tjera, në shkollat e larta pedagogjike. Bashkëpunimi midis institucioneve shtetërore të Zvicrës dhe shteteve të emigrantëve përsa i përket mbështetjes së kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës, mbetet një mision afatgjatë.

Mendoj së do të ishte me vlerë që rrjeti NEZI të kultivonte më tej këtë shkëmbim profesional të iniciativës zvicerane, edhe në bashkëpunim me institucionet e formimit të mësuesve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

Bashkëpunim i qëndrueshëm falë takimit të drejtpërdrejtë

Wiltrud Weidinger, Rolf Gollob

Drejtuesit e qendrës IPE të Shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut

Një nga objektivat prioritare të qendrës IPE (International Projects in Education) pranë Shkollës së Lartë Pedagogjike Cyrih, është promovimi i shkëmbimit ndërkombëtar të njohurive dhe ekspertizës si dhe bashkëkonceptimi i përmbajtjeve. Pikërisht ky qëllim na udhëhoqi për konceptimin e rrjetit «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura». Me anë të qasjeve inovative metodike përmbajtësore, ai ka pasur dhe vazhdon të ketë për synim të iniciojë shkëmbimin dhe dialogun shkencor midis ekspertëve në fushën e edukimit për një shoqëri demokratike (EDC, Education for Democratic Citizenship) dhe pedagogjisë së ndërkulturalitetit dhe asaj të orientimit nga socializimi në Zvicër, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni dhe, në kuadrin e projekteve të përshtatshme, të vijojë më tej edhe pas përfundimit të projektit. Si medie dhe platformë e këtij bashkëpunimi shërbyen pesë takimet, të cilat kishin përkatësisht nga një fokus specifik, por që gjithmonë sillnin së bashku të njëjtët specialistë, të cilëve u bashkoheshin edhe specialistët lokalë.

Pa dyshim që rrjeti mbështeti dhe vazhdon të mbështesë përmirësimin e bashkëpunimit dhe komunikimit të instancave shqiptare dhe të ekspertëve nga Kosova, Shqipëria

dhe Maqedonia, në kuadrin e një projekti të përbashkët. SBFI (Sekretariati i Shtetit për Arsimin, Hulumtimin dhe Inovacionin) si institut financues, pati për detyrë në përputhje me misionin bazë të tij, që midis të tjerash edhe me anë të këtij projekti të mbështeste në nivel ndërkombëtar aftësinë konkurruese të sistemit arsimor e hulumtues të Zvicrës me anë të një shoqërimi suportues dhe financimi të domosdoshëm.

Krahas inputeve të bazuara teorike e shkencore, vizitave dhe diskutimeve, një vend mjaft të rëndësishëm tek rrjeti «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura» zunë edhe takimet autentike me të përfshirët dhe të prekurit nga kjo tematikë. Në funksion të një njohjeje reciproke të thelluar dhe autenticitetit më të lartë, ishin për shembull vizitat mësimore që u kryen në shtete të ndryshme, të cilat çuan në njohjen më mirë të sistemeve përkatëse të arsimit dhe problematikave të tyre. Kjo qasje mundësoi takimin e drejtpërdrejtë të specialistëve të arsimit të të gjitha niveleve dhe profesioneve dhe bëri të qartë se në fund të fundit, vendimtare për rëndësinë praktike të iniciativave arsimore, është ajo që ndodh brenda ndërtesave dhe klasave të shkollës.

Rrjeti dha një ndihmesë të rëndësishëm për Shkollën e Lartë Pedagogjike të Cyrihut, shkollat e larta dhe grupimet profesionale që bashkëvepruan në Zvicër për promovimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm midis ekspertëve zviceranë dhe atyre me prejardhje shqiptare. Në këtë aspekt projekti kontribuoi për zgjerimin e rrjeteve zvicerane të formimit politik, gjë që i përgjigjet një nevojë të domosdoshme.

Si përfaqësues të qendrës IPE pranë Shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut, dëshirojmë të falënderojmë të gjithë ata që intelektualisht, materialisht dhe që me punën e tyre të vendosur përgatitore dhe gjatë takimeve, dhanë ndihmesën e tyre për suksesin e projektit. Muajt në vijim do të tregojnë se sa i qëndrueshëm do të jetë rrjeti dhe për çfarë aktiviteteve të reja janë aftësuar pjesëmarrësit. Pas përvojave të deritanishme të jashtëzakonshme, kemi mjaft besim edhe për këtë fazë (jozyrtare) të realizimit dhe konkretizimit.

Pjesa I

Hyrje

Rrjeti «Kultura e parë, e dytë
dhe ndërkultura» (NEZI):
Qëllimi, kronologjia, efekte

BASIL SCHADER

1 Vështrim i shkurtër¹

Rrjeti «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura»: Lidhur me dinamikën e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash» (shkurtimi: NEZI), i ka nismat e veta tek disa përvoja të një shkalle më të vogël të qendrës IPE (Projekte Ndërkombëtare lidhur me Edukimin) me grupe ekspertësh, dhe më pas i zgjeroi këto përvoja në një kuadër ndërkombëtar. Fokusin përmbajtësor e përbëjnë shkëmbimi dhe trajnimi në dy fusha tematike a) Orientimi midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës (duke iu referuar emigrantëve dhe të kthyerve por edhe përfaqësuesve të minoriteteve etnike e minoriteteve të tjera në zonën shqipfolëse) dhe b) Edukimi për qytetari demokratike (EDC, Education for Democratic Citizenship). Bashkëpunimi ndërkombëtar në rrjet shërben për përfitimin e njohurive të reja lidhur me tematikën e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash dhe rrjedhojat e kësaj për formimin politik. Projekti krijon gjithashtu një lidhje me Këshillin e Evropës dhe Edukimin për Qytetari Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (Education for Democratic Citizenship and Human Rights (EDC/HRE) si një nga tematikat qendrore të Këshillit të Evropës. Prandaj për Zvicrën është mjaft i rëndësishëm bashkëpunimi i ngushtë me fondacionin «Dialog», Platformën Kombëtare për Formimin Politik.

NEZI financohet nga Sekretariati i Shtetit Zvicerian për Arsimin, Hulumtimin dhe Inovacionin (SBFI). Ai u realizua nëpërmjet IPE-së, pranë Shkollës së Lartë Pedagogjike Cyrih. Në stafin drejtues bënin pjesë bashkëdrejtori i IPE-së, Prof. dr. h.c. Rolf Gollob, gjermanisti dhe albanologu Prof. dr. dr. Basil Schader si dhe përfaqësuesja e shkencave politike lic. phil. Shqipe Bajrami, e cila vetë ka një sfond emigracioni shqiptar. Pjesëmarrës të rrjetit janë 32 specialistë në fushën e edukimit për qytetari demokratike, socializim, formimin e mësuesve dhe zhvillimin e shkollës nga pesë prejardhje të ndryshme, përkatësisht një grup nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia dhe dy grupe nga Zvicra nga të cilët njëri me sfond emigrant shqiptar e tjetri jo. Në fazën qendrore të projektit (nëntor 2013 deri nëntor 2015), u realizuan pesë konferenca me fokus të caktuar tematik (shih përshkrimet e detajuara në vijim), nga të cilat dy në Cyrih dhe përkatësisht nga një në Prishtinë, Shkup dhe Tiranë. Për të garantuar vazhdimësinë e projektit, janë planifikuar projekte të ndryshme vijuese për vitin 2016, tek të cilat bashkëpunojnë përkatësisht skuadra të përbëra me përfaqësues nga të paktën dy vende, të cilët do të konkretizojnë konceptimin e punës në rrjet dhe do të shfrytëzojnë burimet dhe potencialet e lidhura me rrjetin.

1 Një pjesë e shpjegimeve të mëposhtme mbështetet në përshkrimin e detajuar të projektit, i cili ua shpërnda pjesëmarrësve para konferencës së parë (korrik 2013).

Ky publikim i paraqitur i referohet periudhës kohore qershor 2011 deri në dhjetor 2015 dhe mund të lexohet edhe si raport përmbyllës i kësaj faze. Projektet vijuese që do të zhvillohen në vitin 2016, do të jenë objekt i raportimeve të veta përfundimtare.

2 Pikënisja

Në qendër të projektit ndodhet diaspora shqipfolëse e Zvicrës dhe vendet e saj të prejdardhjes Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia. Ky fokusim bazohet piksëpari tek rëndësia e madhe dhe unike e emigracionit shqipfolës në Zvicër dhe tek kontaktet e larmishme dhe intensive midis emigrantëve dhe vendeve të tyre të prejdardhjes. Duhet shtuar se Shkolla e Lartë Pedagogjike Cyrih dhe veçanërisht qendra IPE, i ruan prej vitesh lidhjet me diasporën shqiptare dhe vendet e prejdardhjes (projekte për materiale mësimore në Kosovë, edukimi për qytetari demokratike në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni etj.). Kështu që këtu munda të realizohej mjaft mirë lidhja me strukturat funksionale ekzistente.

Dy tematikat përmbajtjesore kryesore të rrjetit, dinamika e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash, formimi demokratik, janë mjaft aktuale si për Zvicrën ashtu edhe për tri vendet e zonës shqipfolëse. Në diasporën shqiptare në Zvicër, ato lidhen me orientimin e fëmijëve dhe të rinjve, të rritur aty në dhe midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës (ndërkultura në kuptimin e një koncepti të përgjithshëm për format e larmishme të identitetit shqiptaro-zviceran), ku një faktor të rëndësishëm përbëjnë përherë konceptet e demokracisë, të së drejtës së fjalës dhe pjesëmarrjes, që në aspektin kulturor ndryshojnë pjesërisht dukshëm nga njëri-tjetri. Në Kosovë, Maqedoni, dhe duke iu referuar shifrave më pak relevante, në Shqipëri këto dy tema lidhen së pari me fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë e rikthyer, të cilët janë rritur në diasporën e Evropës Perëndimore dhe janë të familjarizuar me normat e konceptet e atjeshme lidhur me tematikën e gjithëpërfshirjes, përfytyrimeve rreth demokracisë si formë dominuese, shoqërore dhe jetese dhe pjesëmarrjes dhe që tashmë duhet të orientohen në sistemet pjesërisht të ndryshme të referimit në vendet e tyre të origjinës. Por nga ana tjetër të dyja temat janë mjaft aktuale dhe të rëndësishme edhe duke konsideruar minoritetet e ndryshme etnike dhe fetare në rajonin ku flitet gjuha shqipe (romët, arumunët, minoritetet sllave etj.). Vetëkuptohet që vështirësitë dhe shanset që lidhen me rritjen në dhe midis sistemeve të ndryshme të normave, nuk kanë të bëjnë vetëm me fëmijët dhe të rinjtë e prekur dhe familjet e tyre, por edhe me mësimdhënësit, autoritetet dhe institucionet që janë të angazhuara me ta.

Në të katër vendet pjesëmarrëse në rrjet, sikurse edhe në mësimin e gjuhës së parë të diasporës shqipfolëse (MGJP përkatësisht kurse të kulturës e gjuhës së prejdardhjes), 2 tematikat thelbësore të përmendura të rrjetit janë të njohura për rëndësinë e tyre dhe

sidomos në Zvicër janë kthyer tashmë në objekt të studimeve intensive dhe të masave konkrete. Më specifikisht, në fushën e edukimit për qytetari demokratike (EDC) ekzistojnë edhe projekti gjithëpërfshirës i Këshillit të Evropës «Education for Democratic Citizenship and Human Rights» me persona përgjegjës edhe nga shtetet e Ballkanit me materialet e veta mësimore EDC të cilat u zhvilluan nën kujdesin e IPE-së. Por janë të pakënaqshëm bashkëpunimi, shfrytëzimi i përbashkët i energjive dhe niveli reciprok i informacionit lidhur me zhvillimet, masat, perspektivat midis grupeve të ndryshme (shembull: si Kosova ashtu edhe Shqipëria gjysmë viti më vonë, publikuan standarde mbi materialet mësimore dhe materialet mësimore të diasporës, nuk pati koordinim midis tyre). Me rrjetin lidhet ngushtë shpresa se do të përmirësohet jo vetëm bashkëpunimi dhe shfrytëzimi i energjive midis Zvicrës dhe rajonit shqipfolës, por edhe ai midis partnerëve shqiptarë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Duke iu referuar këtij qëllimi dhe përmbushjes së tij mundësisht të qëndrueshme, u tregua kujdes që në projekt të përfshiheshin veçanërisht edhe profesionistë dhe ekspertë të rinj e të mirëkualifikuar, të cilët do të kultivojnë më tej temat dhe shqetësimet e lidhura me projektin edhe pas vitit 2015.

3 Fokuset dhe objektivat e rrjetit. Përhapja

Rrjeti i kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës ka tri fokuse të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin:

- Gjenerimi dhe thellimi i njohurive të bazuara shkencërisht në formën e shkëmbimit që u referohet përvojave lidhur me temën «Dinamika e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash». Kjo temë ka një rëndësi mjaft të lartë në Zvicër, si një vend emigracioni me një diasporë mjaft të lartë shqipfolëse (pothuajse 240.000 persona), por e njëjta gjë vlen edhe për Kosovën e Maqedoninë (dhe gjithmonë e më tepër edhe në Shqipëri) përballë të rikthyerve të atyshëm, por edhe duke konsideruar strukturën mjaft multietnike dhe pjesërisht edhe multifetare të popullsisë së këtyre shteteve.
- Promovimi i shkëmbimit shkencor dhe të bazuar tek eksperiencia dhe i trajnimit reciprok në fushën e edukimit për qytetari demokratike (EDC). Ky fokus lidhet ngushtë me pikën më sipër, pasi tek sistemet qendrore të referimit e normave, në dhe midis të cilave janë rritur emigrantët e të rikthyerit në diasporë dhe vendet e tyre të origjinës, por edhe përfaqësues të minoriteteve etnike e fetare, luajnë një rol të rëndësishëm konceptet e ndryshme mbi demokracinë, të drejtën e fjalës, përfshirjen në sferën familjare apo shkollore.
- Implementimi dhe testimi i elementeve inovative e promovuese të ndërveprimit dhe format didaktike të konceptimit të konferencave dhe takimeve.

Me këto tematika qendrore lidhen një sërë objektivash:

- **Shkëmbim e transferim njohurish:** Rrjeti i kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës ka për qëllim të mundësojë shkëmbimit e fokusuar tematik të përvojave, teorisve, koncepteve dhe ideve dhe promovimin e dialogut shkencor midis ekspertëve nga fusha e edukimit për një qytetari demokratike (EDC, Education for Democratic Citizenship), pedagogjinë ndërkulturore dhe të orientuar nga socializimi të ardhur nga Zvicra, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Të pesë takimet që u zhvilluan nga nëntori 2013–nëntor 2015, ishin në funksion të këtij qëllimi, sikurse edhe realizimi i projekteve bashkëpunuese në dhjetor 2016.

b Qëndrueshmëria: Rrjeti ka investuar shumë lidhur me qëndrueshmërinë e tij 1.) Duke parashikuar hapësirë të mjaftueshme gjatë takimeve për shkëmbime e njohje reciproke (me qëllimin e ndërtimit të lidhjeve afatgjata) 2.) Duke treguar kujdes që në skuadra të përfaqësohen edhe specialistët e rinj që do të mund t'i përdorin e ruajnë kontaktet e lidhura edhe pas përfundimit të projektit dhe 3.) në periudhën dhjetor-janar 2016 duhen realizuar e, nëse është nevoja, edhe mbështetur projekte bashkëpunimi (Për 2. Duke konsideruar qëllimin e inicimit të bashkëpunimeve midis ekspertëve zviceranë dhe atyre me vendorigjinë shqiptare dhe për t'i bërë të qëndrueshme këto bashkëpunime iu dha mjaft vlerë edhe përfshirjes së qëllimshme në rrjet të brezit të ri akademik.)

c Bashkëpunimi Zvicër – hapësira shqipfolëse: Rrjeti synon të japë një ndihmesë të rëndësishme për lidhjen dhe promovimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm midis ekspertëve zviceranë dhe atyre nga trojet shqiptare. Në të njëjtën kohë ai kontribuon për përforcimin e strukturave të rrjeteve zvicerane të lidhura me formimin politik dhe mbështet kampin për demokraci të krijuar në kuadrin e fondacionit Dialog.

d Bashkëpunim dhe komunikim i përmirësuar brendapërbrenda zonës shqipfolëse: Pa dyshim që rrjeti mbështet përmirësimin e bashkëpunimit të instancave shqiptare dhe ekspertëve nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia në kuadrin e një projekti të përbashkët (kjo duke konsideruar edhe reduktimin e iniciativave boshe dhe të dyfishta). Për ekspertët nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia bashkëpunimi në rrjet ka madje një dobi të dyfishtë: 1.) Njohjen dhe familjarizimin më të mirë me qasjet, rezultatet studimore, çështjet etj. të Evropës Perëndimore (sidomos zvicerane) në kontekstin e EDC-së dhe mbështetja e fëmijëve e të rinjve të rritur në një sistem dykulturash. 2.) Njohjen dhe përpunimin e masave, njohurive, mundësive dhe rezultateve të studimeve nga përkatësisht dy shtetet e tjera të trojeve shqipfolëse.

e Larmia metodike dhe qasjet shumë perspektivshe: Krahësime inputeve të bazuara teorike e shkencore, diskutimeve etj., duhet që për konceptimin e takimeve të testohen edhe forma dhe elemente të tjera metodike dhe efienca e tyre të mund të provohet praktikisht. Këtu përfshihen takimet autentike p.sh. me mësues, nxënës, përfaqësues nga grupet e prekura (p.sh. romët në Kosovë, Secondos/as në Zvicër) dhe specialistë nga fusha e arsimit dhe shkencave sociale, leksione model, diskutime në tryeza të rrumbullakëta, përfshirja e pjesëve të përgatitura paraprakisht në grupet e vogla etj. Qëllimi i konceptimit didaktik inovativ të konferencave është një trajtim shumëperspektivshe dhe i orientuar nga subjekti me karakter autentik i temave dhe problematikave të trajtuara..

f Lidhje me projektin e Këshillit të Evropës «Edukimi për qytetari demokratike dhe të drejtat e njeriut»: Rrjeti synon një lidhje të ngushtë me projektin në fjalë. Këtij qëllimi i shërben integrimi i vetëdijshëm i personave që janë përgjegjës në Zvicër, Kosovë e Shqipëri për projektin e Këshillit të Evropës që u përmend më sipër (Rolf Gollob, Arbër Salihu, Astrit Dautaj).

g Karakteri model i rrjetit: Themelimi i rrjetit dhe përvojat e mbledhura me anë të tij, duhet të kenë një karakter modelues për projekte të mundshme analoge vijuese me grupet dhe shtetet e tjera të emigracionit dhe ky karakter të jetë i shfrytëzueshëm dhe transferueshëm në kuadrin e projekteve të tilla vijuese. Nën këndvështrimin e pozicionimit në kuadrin zviceran të arsimit e kërkimit shkencor mbetet për t'u thënë se rrjeti paraqet në nivel mbarështetëror, një arritje pioniere lidhur me bashkëpunimin me institucionet arsimore të tri shteteve të rajonit shqipfolës si dhe me diasporën shqiptare të shumtë në numër në Zvicër. Nëpërmjet përfshirjes së ekspertëve nga shkolla të ndryshme të larta pedagogjike dhe institucione arsimore, kjo arritje pioniere nuk mbetet një iniciativë e izoluar e Shkollës së Lartë Pedagogjike Cyrih/IPE, por është njëkohësisht e mirëkoruar në nivel kombëtar. Në këtë mënyrë, projekti mund dhe duhet të shërbejë si bazë e bashkëpunimeve të mëtejshme transkantonalet dhe gjithëpërfshirëse për shkollat e larta në një fushë tematike mjaft aktuale.

Se në ç'masë janë përmbushur objektivat, shpjegohet në kapitullin 5.3. Metodika e përdorur për këtë vlerësim trajtohet në kapitullin 5.2.

Mbetet për t'u thënë që tek qëllimet e rrjetit përfshihet natyrisht edhe përhapja e njohurive të fituara. Përsa i përket këtij qëllimi, i cili lidhet ngushtë me ato të përmendurat më sipër, janë parashikuar masat e mëposhtme:

- Publikimi i projektit dhe rezultateve të tij tek faqja e Web-it IPE-së dhe tek mediat e brendshme të Shkollës së Lartë Pedagogjike Cyrih (phInside, phAkzente).
- Disponueshmëri publike dhe aksesueshmëri e arkivit elektronik të NEZI-t (<http://www.phzh.ch/de/ipe/Projekte-und-Mandate/Europaweite-Projekte/Netzwerk-Albanischer-Sprachraum/#>)
- Përhapja e përvojave dhe njohurive të përfituara gjatë takimeve tek një rreth më i madh specialistësh e pedagogësh të ftuar etj, të cilët kanë marrë pjesë në këto konferenca.
- Përpunimi i mëtejshëm i rezultateve dhe çështjeve të trajtuara gjatë takimeve në kuadrin e grupit të punës «Edukimi për qytetari» i Shkollës së Lartë Pedagogjike Cyrih.
- Prezantimi i aktiviteteve dhe rezultateve të rrjetit pranë Drejtorisë së Edukimit, Rinisë dhe Sporteve, departamenti i EDC-së dhe «Higher Education» i Këshillit Evropian nëpërmjet Rolf Gollob.

- Publikimi i projektit dhe rezultateve të tij tek mediat e emigracionit shqiptar në Zvicër (Albsuisse, Albinfo etj.).
- Implementimi i rezultateve të rrjetit tek projektet kombëtare të EDC-së të Këshillit të Evropës.
- Raportime e rekomandime për Ministrinë Kombëtare të Arsimit (në Kosovë, edhe për Ministrinë e Diasporës).

Një media qendrore përbën gjithashtu edhe bashkimi i skuadrës bërthamë të rrjetit prej afro 32 personash. Duke qenë se këtu bashkëpunojnë vetëm persona, të cilët në vendet e tyre kanë funksione ose si studiues, pedagog, nëpunës ministrior ose funksione të tjera të ngjashme, dhe në këtë mënyrë mund të shërbejnë si multiplikatorë, sigurohet që njohuritë dhe kontaktet e fituara në rrjet të bëhen të kapshme dhe të mund të shfrytëzohen për studime. Në funksion të kësaj mund dhe duhet të kontribuojë edhe fakti që rrjeti, që prej themelimit të tij nuk synon vetëm shkëmbimin strikt shkencor, por edhe krijimin e hapësirës dhe rasteve për takime autentike dhe diskutime me ata që kanë të bëjnë me të.

4 Kronologjia e punës në rrjet «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura»

4.1 Vështrim i përgjithshëm

Koha e vërtetë e zgjatjes së projektit sipas kërkesës së miratuar, përfshin kohën që prej 1 qeshorit 2013 deri në 31 dhjetor 2015. Kjo u përgjigjet bazave të përshkruara më poshtë I dhe II. De facto u bë apo do të bashkëngjitet një fazë e tretë (janar deri në 31 dhjetor 2016), në të cilën partnerë të veçantë të projektit (prej të paktën dy vendeve) do të kryejnë projekte pasuese, dhe me këtë do të konkretizojnë mendimet dhe përfundimin e projektit dhe të venë atë në jetë praktikisht. Kjo fazë e tretë u bë e mundur që, duke vepruar me kujdes me buxhetin, të ishin në dispozicion ende mjete financiare, të cilat me miratimin e institucionit financues mund të përdorreshin në mënyrë optimale për këtë qëllim në këtë fazë.

I Faza e planifikimit, e përgatitjes dhe e testit: 1. 6. 2013 deri 31.12.2013

- 1 qeshor afërsisht deri në shtator 2013: Rekrutimi dhe instruktimi i bashkëpunëtorëve të parashikuar në vende të ndryshme. Përgatitja organizative e konferencës së parë, sqarimi i përgjegjësisë në drejtimin e projektit, të përfshirë të tjerë.
- 7 qeshor: Pothuaj si parapërgatitje u zhvillua në Shkollën e Lartë Pedagogjike Cyrih një konferencë me temën: «Gjuha shqipe në diasporë-quo vadis?». Gjuha e konferencës ishte shqipja dhe gjermanishtja. Të ftuar ishin përfaqësues të të gjitha shoqatave të mëdha shqiptare në Zvicër si edhe një ekspert i rëndësishëm nga Shqipëria. Pjesëmarrës të ndryshëm të kësaj konference bashkëpunuan më vonë edhe me NEZI-n.
- Përgatitja e përmbajtjes së konferencës së parë tek të gjithë grupet e vendeve pjesëmarrëse, sipas paracaktimeve të qarta.
- 7–8 nëntor 2013: aktiviteti i hapjes (konferenca nr. 1): Tema «Të rriturit dhe zhvillimi i identitetit në dhe midis sisteme të ndryshme raportesh dhe normash» (vendi: Cyrih).
- Dhjetor 2013: Evoluimi, diskutimi, analiza e arritjes së qëllimit, vendimi përsa i përket procedurës në vijim (Faza e implementimit).

II Faza e implementimit: 1. 1. 2014 – 31. 12. 2015

- Janar 2014 (Fillimi dhjetor 2013): Raporti i ndërmjetmë me analizën për arritjen e qëllimit për fazën 1. Duke marrë parasysh përfundimin e suksesshëm të fazës 1: Paraqitja e kërkesës për financim të fazës 2 (Implementimi)
- Maj 2014 – nëntor 2015: Konferencat nr. 2–5 (Koncepte të përgjithshme për përmbytjen për konferencat në veçanti, shih më poshtë!)
- 8–9 maj 2014: Konferenca 2: Përvojat me konceptet e ndryshme të demokracisë dhe përfshirja në kulturën e parë dhe të dytë, ndikimet në raportin me vendin dhe kulturën e prejardhjes (vendi: Prishtinë)
- 6–7 nëntor 2014: Konferenca 3: Të sjellurit tonë me edukimin demokratik (EDC): Të realizuarat, modelet, perspektivat, të treguarat dhe të munguarat, mundësi, dëshira për përmirësim, rrugët për këtë qëllim.(vendi: Shkup)
- 7–8 maj 2015: Konferenca 4: Ndihmesa e mësimit të gjuhës së prejardhjes gjatë orientimit midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës. (vendi: Cyrih)
- 5–6 nëntor 2015: Konferenca 5: a) Ndihmesa për formimin e mësuesve për EDC-në dhe mbështetja e orientimit të pjesëtarëve të pakicave etnike (duke përfshirë të emigruarit dhe të riemigruarit) midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës b) Përfundimi, perspektivat, diskutimi i projekteve të mundshme pasuese (vendi: Tirana, me një ditë fakultative shtesë/program kulturor në Krujë dhe në Durrës më 7 nëntor 2015)
- Dhjetor 2015–janar 2016: Hartimi i raportit përmbyllës.
- Afërsisht mars–prillit 2016: Redaktimi dhe publikimi i vëllimit të paraqitur të konferencës si raport përmbyllës dhe pjesë përbërëse e IPE-së

III Kryerja e projekteve pasuese për konkretizimin dhe realizimin e mendimit të rrjetit

- (5–6 nëntor 2015: Sqarimi i mundësisë për projekte vijuese në konferencën e Tiranës, koha për dakortësitë e para dhe Brainstormings)
- Deri më 30 janar 2016: Dorëzimi i kërkesave për projektin (sipas formularit sqarues).

- Deri 29 shkurt 2016: Vendim nga ana e drejtimit të projektit, cilat projekte pasojnë dhe, që në masë modeste do të mund të mbështeten financiarisht.
- Fillimi i realizimit në të vërtetë të projekteve pasuese në më të fundit që prej 30 qeshorit
- Deri në 1 tetor 2016: Dorëzimi i një raporti të ndërmjetmë për çdo projekt pasues
- 31.12.2016: Fundi i punës për projektet pasuese
- Deri në 31 mars 2017: Dorëzimi i një raporti përfundimtar duke përfshirë llogaritjen finaciare

4.2 Për përzgjedhjen e pjesëmarrësve të rrjetit

Për anëtarë të përhershëm të mundshëm të rrjetit u përcaktua si fillim nga drejtimi i projektit një katalog me kriteret e aftësimit, i cili do të prezantohet si më poshtë:

- Kualifikime përkatëse sipas qëllimeve dhe përmbajtjeve të rrjetit (kompetenca shkencore apo kompetenca me një vlerë që i referohen përvojës).
- Kapaciteti dhe gatishmëria, për të marrë pjesë në të gjitha konferencat dhe për të marrë përsipër detyrat përkatëse përgatitore (Raporte përvoje apo input sipas programit, ndihma në organizimin e konferencës në vendin e vet).
- Pjesëmarrje e ekujlibruar e grave.
- Marrja parasysh e specialistëve të rinj, të cilët mund të vazhdojnë projektin dhe të ruajnë kontaktet e lidhura në lidhje me të.

Rekrutimi i 16 pjesëmarrësve nga Zvicra u krye nga Zvicra mbi bazën e kontakteve të pasura me institucionet për formimin e mësuesve dhe institucioneve të tjera me tema të ngjashme, po kështu edhe thjesht me përfaqësues të dasporës shqiptare etj. Në Kosovë dhe Shqipëri po ashtu (6 apo 4 pjesëmarrës) kishin gjithashtu kontakte me persona, të cilët nga ana e tyre mund të propozonin pjesëmarrës të tjerë të përshtatshëm nga vendet e tyre. Pak më e vështirë ishte së pari kalimi në Maqedoni, por në fund ia dolëm edhe këtu, për të krijuar një grup prej 6 personash të motivuar dhe me kualifikim të lartë. Si fillim numri prej 29 personave që përbëhej grupi, u rrit në vazhdimësinë e punës me tre persona, të cilët u bashkuan më vonë në të. Jetëshkrime të shkurtra të të gjithë pjesëmarrësve me të dhëna të kualifikimeve profesionale gjenden në fund të vëllimit të paraqitur. Një vështrim mbi emrat ofron lista e mëposhtme:

Grupi i Zvicrës (Pjesëmarrësit/et nga Zvicra pa origjinë shqiptare):

Miriam Aegerter-Jossen, Brigit Allenbach, Regina B. Bühlmann, Kai Felkendorff, Andrea Hänni Hoti, më tej vetëm në konferencën 1 Janine Dahinden, si edhe prej drejtimit të projektit Rolf Gollob dhe Basil Schader.

Grupi shqiptar i Zvicrës (Pjesëmarrësit/et nga Zvicra me origjinë shqiptare):

Ylfete Fanaj, Shpresa Jashari, Rifat Haxhiaj, Driton Kajtazi, Nexhat Maloku, Shukrije Ramadani, Naxhi Selimi si edhe nga drejtimi i projektit Shqipe Bajrami.

Grupi i Shqipërisë (Pjesëmarrësit/et nga Shqipëria):

Astrit Dautaj, Admir Kraja, Nikoleta Mita, Merita Xhumari.

Grupi i Kosovës (Pjesëmarrësit/et nga Kosova):

Arif Demolli, Lulzim Dragidella, Nuhi Gashi, Shqipe Gashi, Melinda Mula, Arbër Salihu.

Grupi i Maqedonisë (Pjesëmarrësit/et nga Maqedonia):

Jonuz Abdullahi, Adelina Marku, Myqereme Rusi, Ali Pajaziti, Afrim Rexhepi, Nadire Rexhepi.

Veç këtyre tek 32 anëtarët e përhershëm morën pjesë si miq dhe specialistë në konferencat e veçanta persona të tjerë nga mjedisi përkatës lokal, kjo gjë në dokortësim midis grupeve organizatore dhe drejtimit të projektit.

4.3 Programet veç e veç të çdo konference

Shënim paraprak

Konferencat e veçanta si rregull bëheshin sipas modelit të mëposhtëm: Shtirirja në dy ditë (në të shumtën të enjten, të premten, kthimi në ditën e tretë). Nisja herët nga mbasdita e ditës së parë, akomodimi në hotel, më pas vizita në shkolla, kontakte me institucione apo autoritete të përfshira etj. Darkë e përbashkët. Gjysmëdita e parë e orientuar fort nga përvoja u drejtohej vetëm pjesëmarrësve të përhershëm të rrjetit. Dita e dytë: Dita e vërtetë e konferencës, në të cilën ishin ftuar edhe miq. Në mëngjes përshëndetje, inpute, referate, diskutime në rrjet etj. Mbasdite pjesërisht edhe workshope apo oferta me orientim takimi. Në më të shumtën në mbrëmjen e dytë por pjesërisht edhe në të parën u vu në dispozicion një ofertë kulturore (Tur në qytet, lexim, vizitë në muzeum etj.). Para konferencave grupet e vendeve morën përkatësisht detyra për t'u përgatitur tematikisht, përfundimet ishin p.sh. për t'u referuar në formën e një prezantimi të shkurtër apo për t'u përdorur në diskutimet e grupeve me vende të përziera. Këto detyra si rregull dërgoheshin së bashku me programin.

Konferencat e veçanta u përgatitën në bashkëpunim me drejtimin e projektit dhe grupin e vendeve, ku i fundit rregullonte përfundimisht gjithçka nga ana organizative (strehimin, vendin e konferencës, restorantet etj.).

Konferenca e fundit (5–7 nëntor 2015 në Tiranë) u shtri me një ditë fakultative kulture dhe takimi, e cila i drejtoi pjesëmarrësit në qytetin muze të Krujës dhe në Durrës.

Vijojnë programet e konferencave në veçanti, plotësojnë çdo «Spotlight».

Programi i konferencës së parë të 7–8 nëntorit 2013 në Cyrih

Temat:

Nisja e projektit. Tema: «Të rriturit dhe zhvillimi i identitetit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash»

Data	7–8 nëntor 2013 (Për shkak të arritjes vonë të aeroplanëve nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia konferenca e mirëfilltë do të zhvillohej vetëm më 8 nëntor)
Koha, vendi	E enjte, 7 nëntor: Darka e përbashkët, 19h, Rest. Rheinfelder Bierhalle E premte, 8 nëntor 08.45 – 18.00; Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut, LAA, salla L020 19.15 Darka e përbashkët; Pizzeria Molino Gjuhët e konferencës: Shqipja dhe gjermanishtja (me përkthim).

Programi i së premtes

08.45 – 09.00	Mbërritja e pjesëmarrësve/eve
09.00 – 09.15	Përshëndetje
09.15 – 09.30	Vështrim mbi programin
09.30 – 11.50	Prezantime të përgatitura me Power Point të 5 grupeve (Zvicranë me/pa pre-jardhje shqiptare, Kosova, Shqipëria, Maqedonia) për temën «Si ta kuptojmë temën 'të rriturit dhe zhvillimi i identitetit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash' për vendin ose kontekstin tonë, cilat grupe janë më së shumti në fokusin e kësaj teme?» (Ora 10.45 – 11.00 Pushim)
11.50 – 12.20	Panel (diskutim) i moderuar në lidhje me prezantimet
12.30 – 13.45	Drekë në menzën e Shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut
13.45 – 14.35	Workshops, pjesa e parë *
14.45 – 15.35	Workshops, pjesa e dytë *
15.40 – 16.10	Input: Disa vërejtje dhe mendime rreth termit «kultura» (Janine Dahinden)
16.10 – 16.30	Pushim
16.30 – 17.15	5 Round Tables (tryeza të rrumbullakta, grupe pune) për tema të ndryshme
17.15 – 17.45	Raporte nga Round Tablet
17.45 – 18.00	Mbyllja e konferencës, perspektiva
18.15 – 19.15	Varianti a): Shëtitje me Rolf Gollob, Varianti b): Koha e lirë

19.15

Darka e përbashkët; Pizzeria Molino, Stauffacherstr. 31, 8004 Zürich

* Workshops (mund të vizitohen 2 prej 3 ofertave):

- 1 Aspirata dhe qëllime të të rinjve shqiptarë në Zvicër në lidhje me edukimin (B. Allenbach)
- 2 Akulturim, adaptim psikosocial dhe sukses mësimor: Krahësim i të rinjve nga familje të emigruara shqiptare, italiane dhe portugeze (A. Haenni Hoti)
- 3 Forum diskutimime shqiptare të brezit të dytë në lidhje me aspekte të zgjedhura të të rriturit në dhe midis dykulturave (Sh. Jashari, Sh. Bajrami, Y. Fanaj)

Spotlight

Në Zvicër shqiptarët përbëjnë grupin më të madh të emigracionit më të ri, me rreth 230'000-250'000 persona. Në krahasim me tërë popullësinë e fortë multietnike të Zvicrës ata paraqesin një pakicë të qartë. Kjo i karakterizon ato në pikëpamje të ndryshme gjuhësore, të identitetit dhe statusit etj.

Në mënyrë mbresëlënëse Adelina Marku nga Maqedonia i përmbledh pikëpamjet e saj lidhur me këtë:

Një ndër risitë e mëdha nga bashkëpunimi me rrjetin NEZI është njohja me jetën e diasporës shqiptare në Zvicër. (...) Mësova shumë mbi organizimin e jetës së diasporës shqiptare, gjë që nuk e kisha ditur më parë, mësova për format dhe rrugën e integritetit të kësaj diaspore në shoqërinë zvicerane, mësova për mënyrat e mbrojtjes dhe të kujdesit të identitetit kulturor të shqiptarëve në Zvicër, mësova për format e integritetit dhe përfaqësimit të shqiptarëve në politikën shoqërore të Zvicrës, mësova për integritetin e gruas shqiptare në shoqërinë zvicerane, për mënyrën e zhvillimit të familjes tradicionale shqiptare atje, por edhe për transformimet që kjo familje përjeton përmes zhvillimeve të reja të teknologjisë së të jetuarit dhe të menduarit, mësova më shumë për konceptin e integritetit vizavi asimilimit, etj. Të gjitha këto i vlerësoj si mësim me rëndësi të jashtëzakonshme jetësore dhe profesionale dhe sfida veten që edhe më shumë të merrem me këto forma organizimi të diasporës shqiptare dhe komunikimin e së njëjtës me shtetëtarë.

Programi i konferencës së dytë me 8–9 maj 2014 në Prishtinë, Kosovë

Tema:
Përvoja me koncepte të ndryshme të demokracisë dhe
të pjesëmarrjes në kulturën e parë dhe të dytë

Data 8–9 maj 2014

Koha, vendi Fillimi: E enjte 8maj, në orën 12.50, në sallën e hotelit AFA. Vendi i konferencës:
Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), kati i 5-ë, Rruga Agim
Ramadani

Programi i së enjtes

12.00 Mbërritja në hotel

13.00 – 13.45 Vendtakimi në sallën e hotelit AFA, shëtitje e shkurtër në qytet në dy grupe

13.45 – 14.55 Dreka në menzën e MASHT-it

14.55 – 15.15 Vështrim i shkurtër në sistemin e arsimit të Republikës së Kosovës që nga viti
1980 (Arbër Salihu)

15.15 – 15.45 Hyrje/input i shkurtër: Shkolla/Objekti shkollor si vend i mundshëm i socializimit
demokratik. Më pas transferimi i dy grupeve në dy shkolla

15.45 – 18.00 Visitë e një shkolle (infrastruktura, funksionimi, organet etj.) Kohë për pyetje dhe
diskutim. Grupi 1: Sh. Naim Frashëri, Gr. 2: Sh. Faik Konica

18.00 – 19.00 MASHT, diskutim i moderuar. Temat: Pyetje në lidhje me vizitat në shkolla / Si ka
ndërtuar Kosova për 10 vite një sistem shkollor funksional? / Mënyra e praktiki-
mit të NGO-s (OJQ-re) të ndryshme etj, të cilat janë aktive në fushën e arsimit /
Mënyra e të sjellurit me riemigrantët, problemet. (Moderimi: Grupi i Kosovës)

19.00 – 20.15 Kohë e lirë (qëndrim në hotel, shëtitje, aperitiv...). (Ata që dëshirojnë mund të
takohen në orën 20.00 para MASHT-it për t'ua treguar rrugën në restorant)

20.15 Darka në restorant «Te Pishat» (Rr. Qamil Hoxha 11, Tel. 044 245 333)

Programi i së premtes

08.40 – 09.00 Takim në hotel, transferim në MASHT

09.00 – 09.15 Fjala përshëndetëse nga ana e MASHT-it, të Ambasadës Zvicerane dhe
të Institucionit Financues SBFi

09.15 – 09.30 Një vështrim për konferencën e fundit; programi dhe kontekstualizimi i
konferencës së dytë.

09.30 – 10.00	Referati i Sami Kurteshit, Avokati i Popullit, Përfaqësues i të Drejtave të Njeriut në Parlamentin Kosovar: Mënyra e praktikimit të demokracisë, sjellja me pakicat, me pjesëmarrjen dhe me të Drejtat e Njeriut në Kosovë; probleme aktuale
10.00 – 10.20	Pyetje dhe diskutim në lidhje me referatin
10.20 – 11.00	Diskutim i pyetjeve të vetëpërgatitura (shih detyrat përkatëse në faqen 3) në 5 grupe sipas vendeve (KOS, AL, MAK, CH, Ch me prejardhje shqiptare)
11.00 – 11.30	Pushim
11.30 – 12.30	5 tryeza të rrumbullakta (grupe pune) të përziera përsa u përket kombësive: - Informacione reciproke mbi rezultatet e diskutimeve të mëparshme - Diskutim i një çështjeje të veçantë për secilin grup (do të shpërndahet) - Përgatitja e një prezantimi të shkurtër (7 min.)
12.30 – 13.15	Prezantimet e shkurtra të grupeve të përziera në plenum (7 min. për prezantim)
13.15 – 14.15	Dreka në menzën e MASHT-it
14.15 – 15.30	Tri hyrje/inputs rreth temës: «Përvoja me koncepte të ndryshme të demokracisë dhe të pjesëmarrjes në kulturën e parë dhe të dytë»: - Osman Osmani (anëtar i komunitetit rom në Kosovë): Përvoja me për-fshirjen e fëmijëve romë në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës - Nuhi Gashi (Përgjegjës në MASHT për mësimin plotësues të gjuhës shqipe në diasporë: Vëzhgime mbi mësimin plotësues shqip në diasporë) - Shpresa Jashari (anëtare e brezit të dytë të shqiptarëve në Zvicër): të rriturit në, me dhe midis koncepteve shqiptare dhe zvicerane të demokracisë dhe të pjesëmarrjes si anëtare e brezit të dytë (si «sekonda») në Zvicër
15.30 – 16.00	Pushim
16.00 – 16.30	Ngritja e katër tryezave të rrumbullakta për diskutim të çështjeve vijuese: - Çfarë mund të bëj unë personalisht në mjedisin dhe fushën e veprimit tim për të forcuar demokracinë dhe pjesëmarrjen? - Si mund të përfitojmë nga rrjetet dhe strukturat ekzistuese dhe në veçanti nga kontaktet e lidhura brenda rrjetit (network-ut) tonë?
16.30 – 16.45	Përfundimi, vështrim nga pas dhe në perspektivë
16.45 – 18.30	Kohë e lirë; oferta fakultative: shëtitje/«vizitë turistike» në Prishtinë (M. Mula, A. Salihu)
18.30 – 20.00	Program kulturor: Filmi «Këpucët e humbura» i regjisores Shota Bukoshi dhe një film i regjisorit Barish Karamuço. Bisedë me eksperte vendase. Vendi: Kafeneja-libraria Dit' e 'Nat, Rr. Fazli Grajqevci
20.00	Darka në restorant Liburnia, Rr. Meto Bajraktari

Spotlight

Në Kosovë, që prej shpalljes së pavarësisë 2008, shqiptarët paraqesin shumicën më të shtypur prej një kohe të gjatë në një shtet eksplisit multietnik. Ata qëndronin dhe qëndrojnë para detyrës së vështirë për të ngritur një sistem politik, një administratë dhe një sistem arsimor që u përgjigjet standarteve demokratike dhe u garanton të gjitha minoriteteve të drejta të përshtatshme. Referatet e Avokatit të Pupullit të Republikës së Kosovës, Sami Kurteshi dhe të një përfaqësuesi të njohur të pakicës rome, Osman Osmani transmetuan përshtypje të rëndësishme dhe autentike në lidhje me këtë, së bashku me inputet e tjera të kësaj konference, gjë që e dëshmojnë edhe opinionet e Shpresa Jasharit nga Zvicra (1) dhe Admir Krajës nga Shqipëria (2).

1 Përsa u përket të dy pikave kyçe «Ndihma në orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci», kam mësuar shumë të reja, veçanërisht në pikën e dytë; këtu mendoj (...) edhe diskutimet joformale në kampusin e universitetit në Prishtinë për mjetet ndikuese të lidhjeve studentore dhe afëritë e tyre (të hamendësuara apo të vërteta?) me partitë politike.

2 Gjatë konferencës në Prishtinë dhe Shkup jam njohur me problemet dhe sfidat e reja të gjithëpërfshirjes dhe bashkëjetesës ndëretnike e ndërfetare. Kështu kam parë nga afër disa shembuj të përparimit në këtë drejtim të prezantuar në disa shkolla. Gjithashtu jam njohur edhe me iniciativa arsimore kombëtare dhe politikbërëse të pushtetit lokal duke pasur në fokus përcjelljen e vlerave të të drejtave të njeriut dhe të edukimit demokratik.

Programi i konferencës së tretë, më 5–7 nëntor 2014, në Shkup/Maqedoni

Tema:

Edukim për qytetari demokratike (EDC): përvoja autentike shkollore;
pika të realizuara dhe të jorealizuara ende në vendet tona

Data	5–7 nëntor 2014 (5 nëntor = dita e udhëtimit)
Koha, vendi	Konferenca fillon të mërkurën, më 5 nëntor, në orën 16.50 në hollin e hotelit SUPER 8, Bulevard Kriste Misirkov 57/3, Skopje/Shkup

Programi e merkurës, 5 nëntor

± 16.00	Grupet e ndryshme mbërrijnë në hotel
16.50 – 17.00	Mbledhja në hollin e hotelit
17.00 – 19.00	Shëtitje nëpër Shkup me 2–3 referate të shkurtra për multikulturalizëm në Shkup, «Shkup 2014», aspekte politike (Ali Pajaziti, Y. Sela, evtl. A. Marku)
19.00	Darka në restorant Tivoli në qendër (te sheshi Aleksandri i Madh) (Pastaj program kulturor fakultativ sipas sugjerimeve të z. Ylber Selës)

E enjte, 6 nëntor

08.30 – 08.50	Mbledhja në hotel, Lëvizje (në këmbë) në Universitetin e Europës Juglindore
08.50 – 09.15	Hapja zyrtare e konferencës në UEJL, sala «amfiteatër». Fjalë përshëndetëse.
09.15 – 09.30	Disa fjalë për konferencat I dhe II dhe për programin dhe qëllimet e konferencës në Shkup në kontekstin e pesë konferencave të rrjetit tonë.
09.30 – 10.00	Input Rolf Gollob: Edukim për qytetari demokratike (EDC, education for democratic citizenship): Një përpjekje evropiane me rrënjë në rajonet e ndryshme. 3 fokuset e EDC-së: Through, About, For (përmes, në lidhje me, për). Shpjegim i detyrave për vizitat nëpër klasa.
10.00 – 10.30	15 min. pushim, pastaj lëvizje (në këmbë) në shkollën Jashar Bej Shkupi (Jane Sandanski), Rr. Duqanxhik.
10.30 – 10.45	Fjalë shpjeguese për shkollën 3-gjuhësore nga drejtori, z. Muzafer Rexhepi
10.45 – 11.30	Vizita 1 nëpër klasa (6 grupe, secili me 4 veta)
11.30 – 12.35	Vizita 2 nëpër klasa (grupet i ndryshojnë klasat)
12.35 – 13.50	Dreka dhe diskutime me mësuesit në qebaptore Destan; pastaj transferim në UEJL

13.50 – 14.30	Vlerësim për vizitat në klasa, në 4 grupe të përziera (UEJL, sala 2.05-2.07)
14.30 – 15.30	Tri inpute (MAK, AL, KOS) në lidhje me temën «Shkolla si vend ku fitohen përvvoja me demokraci dhe ku mësohet demokracia»
15.30 – 16.00	Pushim
16.00 – 16.45	Katër grupe të përziera sipas vendeve: Cilat shance i ka shkolla në vendin tim për të qenë një model për mësimin e demokracisë? Cilat janë pasojat për formimin e mësuesve e të drejtorëve të shkollave? (Pjesëmarrësit e kishin si detyrë të përgatiten për këtë diskutim; shih edhe dokumente në arkivin elektronik)
16.45 – 17.15	Raporte të shkurta nga grupet në plenum
17.15 – 19.00	Shëtitje me dy referate (A. Sereçi: Zhvillimi i Shkupit; A. Trezi: Shtëpia e Nënës Terezë) ose kohë e lirë.
19.00	Darka në restorant Starogradska Kuka, Rr. Pajko-Maalo 14 (Pastaj program kulturor fakultativ sipas sugjerimeve të z. Ylber Selës)
E premte, 7 nëntor	
08.30 – 08.50	Mbledhja në hotel; transferim (me bagazhet!) në UEJL
08.50 – 09.30	Prezantim i teksteve didaktike «Living Democracy» (3 inpute)
09.30 – 09.50	Informim në lidhje me orën mësimi të Rolfit dhe me pikat që duhen vëzhguar
09.50 – 10.20	Pushim, kohë për t'i shikuar tekstet didaktike «Living Democracy»
10.20 – 11.20	Orë mësimi model që e jep Rolfi në lidhje me EDC-në (vjen një klasë në UEJL)
11.20 – 12.00	Vlerësim në grupe, pastaj në plenum
12.00 – 12.30	Mbyllja e konferencës, vështrim nga pas dhe në perspektivë
12.30 – 13.50	Dreka në UEJL (katering)
± 13.50	Delegacioni zviceran duhet të niset për në aeroport (fluturim në orën 15.45)

Spotlight

Në Maqedoni shqiptarët përbëjnë grupin e dytë më të madh krahas sllavo-maqedonësve dhe luajnë një rol të rëndësishëm si partner minoritar në një shtet dypopujsh (e thënë e thjeshtësuar). Nuk mund të flitet në të vërtetë për barazi dhe përsa i përket zënies dhe shfrytëzimit të hapësirës publike, është një peshë e pabarabartë e qartë, siç e ilustronë fjalët e theksuara të Ali Pajazitit për projektin «Shkup 2014», një ristrukturim i historizuar, eklekticist i pjesëve të qendrës së qytetit të Shkupit:

Shkupi përmes këtij delirium tremens dalëngadalë po shndërrohet në qytetin më të shëmtuar të Evropës, shembëlltyrë e kështjës dhe pashijes. Shkupi është shndërruar në Luna Park të përmendoreve, në një histori në miniaturë, në një legoland, në një neverland, pak antikë, pak Romë, pak Paris, pak Vjenë. «Expo 2014» është shndërruar në metaforë të diznifikimit, në hapësirë totale dhe historicizëm, në sintaksë postmoderne, në buffer-zonë, në hapësirë të krijimit të identitetit të ri.

Pas shpjegimeve të bëra, në stilin peripatetik, ec e diskuto, polemizo, u zhvillua një debat shumë i frytshëm lidhur me realitetin e dy Shkupeve, të atij në anën e djathtë të Vardarit (maqedonas), ultraurban dhe të tjetrit, në anën e majtë (shqiptar), karrakatinë, slum. Pjesëmarrësit nga vendet e ndryshme vërenin pamjet e artit neobarok XXI, ndërkohë që mendonin rreth përplasjeve kulturore për të cilat flet Huntingtoni me të tjerë. Berlinizim, qytet i ndarë. Urë në mes, urë klasike, e gurit, e bastarduar me shkrim cirilik mbi një monument osman.

Programi i konferencës së katërt nga 7–9 maj 2014, në Cyrih

Tema:
Ndihmesa e mësimit plotësues shqip në përmirësimin e orientimit midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës

Data 7–9 maj 2015

Koha, vendi Fillim: E enjte, 7 maj, 15.20, në PH Zürich

Programi i së enjtës, 7 maj (vetëm për pjesëmarrësit e rrjetit)

14.45 – 15.20	Takimi i pjesëmarrësve në hotelin Martahaus. Transferimi në PH (Shqipja)
15.20 – 16.10	Takimi i të gjithë pjesëmarrësve në PH, salla LAA L041. Përshëndetje e shkurtër. Informacione themelore mbi mësimin plotësues shqip. Udhëzimi për të vizituar shkollat në vijim.
ca. 16.10	Transferimi në stacionin kryesor, nisja e tri grupeve në tri shkolla.
17.00 – 19.00	Vizita e shkollave në Wallisellen, Volketswil dhe Glattbrugg: 1. Leksioni mbi mësimin plotësues shqip (me impulse vëzhgimi) 2. Leksioni biseda me nxënësit/et (me impulse tematike)
20.00	Takimi për darkë, në restorantin Rheinfeldner Bierhalle, Niederdorfstr. 76 (salla në katin e parë, si herën e fundit).

Programi i së premtes, 8 maj (me mysafirë)

08.30 – 09.00	Hapja zyrtare e konferencës në sallën LAB G013. Përshëndetje nga ana e PH-së, EDK-së SBFI-së.
09.00 – 09.15	Disa fjalë mbi programin dhe kontekstualizimin e konferencës.
09.15 – 09.50	Vlerësim dhe diskutim mbi vizitat e djeshme në shkolla si dhe impulse mbi vëzhgimet dhe diskutimet (4 grupe: dy në LAB G013 dhe dy të tjerat në LAB K012).
09.50 – 10.20	Prezantime të shkurtra dhe diskutim në plenum
10.20 – 10.50	Pushim

10.50 – 12.10	Inpute për rëndësinë e mësimit plotsues shqip nga katër perspektiva kulturore (15–20 min.): a) Perspektiva e kulturës së parë dhe e ndërkulturës: Mësues i mësimit plotësues (Nexhat Maloku) b) Perspektiva ndërkulturore: Diana dhe Melani Alilaj, ish-nxënëse të mësimit plotësues, tani studente të PH-së. c) Perspektiva e kulturës së dytë/Zvicër (Regina Bühlmann) d) Perspektiva «e jashtme» nga vendi i origjinës (Nuhi Gashi)
12.10 – 13.00	Impulse diskutimi për përpunimin e katër inputeve. Diskutime në katër grupe të përziera, pastaj 20 min: prezantim i shkurtër në plenum mbi rezultatet kryesore dhe pyetjet (20 min.)
13.00 – 14.00	Dreka (në menzën e Shkollës së Lartë Pedagogjike)
14.00 – 15.30	Tri workshope, nga të cilat dy mund të vizitohen (secili workshop zgjat 40 min. Njëri nga 14.00–14.40 dhe tjetri nga 14.45–15.25). a) Kur është mësimi plotësues i suksesshëm, deri ku dhe pse? (Anja Giudici) b) Kurrikula e mësimit plotësues e kantonit të Cyrihut si mjet për ta shfrytëzuar mësimin plotësues si ndihmë për orientimin midis kulturës së parë e të dytë (Claudia Ulbrich, Nexhat Maloku) c) Tekstet e reja shkollore për mësimin plotësues shqip (N. Gashi, N. Mehmetaj, B. Schader)
15.30 – 16.00	Pushim
16.00 – 16.15	Diskutim i njohurive/rezultateve dhe i pyetjeve të hapura nga grupet e punës (një moderim i shkurtër në podium nga drejtuesit e grupeve të punëve)
16.15 – 16.20	Fundi i pjesës zyrtare «publike» të konferencës
16.20 – 17.00	Detyra/rendi dhe koha për planifikimet e rrjetit. Zhvillimi i projektit që nga idet e para të projektit për planifikim të mundshëm bilateral në katër grupet e përziera (koncepte dhe ide që mund të zhvillohen në konferencën e Tiranës në nëntor)
17.00 – 17.15	Prezantim i shkurtër i projekteve të parapara
17.15 – 20.00	Kohë e lirë deri në 19.30 Ofertë: - Shëtitje në liqen me anije nga 18.10–19.35 - Shoqërim për shopping
20.00	Darka në restorantin Zeughauskeller, Bahnhofstr. 28a, 8022 Zürich
E shtunë, 9 maj	
Kthimi	

Spotlight

Mësimi i shqipes në diasporë ndryshon në mënyrë radikale nga ai i vendeve të origjinës. Vetëm rreth 10% e fëmijëve dhe e të rinjve me gjuhë mëmë shqipen, të cilët ndjekin mësimin e gjuhës së prejardhjes në Zvicër, disponojnë, si rregull, kompetenca qartësisht të forta në gjuhën e shkollës të vendit të ri sesa gjuhën mëmë. Mësuesit e MGJP-së në shumicën e rasteve janë të papërgatitur për detyrën e tyre me kërkesa të larta dhe duhet të luftojnë me një sërë vështirësish. Vizitat e shkollave dhe bisedat në tri klasat e MGJP-së, lanë mbresa të thella, si e tregojnë edhe thëniet e docentëve zvicerianë të Shkollës së Lartë Pedagogjike Miriam Aegerter (1) dhe Andrea Haenni (2) dhe e studjuesit maqedonas Ali Pajaziti (3):

1 Parja konkrete në mësim për gjuhën dhe kulturën e prejardhjes (MGJK) në të katër konferencat, qe për mua pika kulminante e tërë projektit. Deri tani në leksionet e mia e kam përmendur gjithmonë mësimin e MGJK-së dhe, falë kësaj konference, kisha mundësinë që të përjetoja një herë një mësim konkret dhe të shkëmbehesha me nxënësit si edhe me personelin mësimdhënës të MGJK-së.

2 Shumë informativ për veprimtarinë time si docent dhe studjues, do të ishte edhe vizita e mësimi shqip të MGJK-së në Zvicër dhe veçanërisht bisedat me mësuesit e MGJK-së dhe nxënësit me sfond emigrimi shqiptar. Ata më kanë treguar një herë më shumë se sa e rëndësishme është përkrahja e gjuhëve të para tek fëmijët me sfond emigracioni dhe, duke pasur parasysh zhvillimin e një identiteti bikulturore.

3 Një temë që u diskutua ishte edhe ajo për mësimin plotësues në gjuhën shqipe që organizohet me vetëkontributin e prindërve. Shumë mbresëlënëse ishte takimi me fëmijët e emigrantëve shqiptarë nga Valliseleni, të cilët reflektonin kulturën e parë, të dytë dhe ndërkulturën, të cilët komunikonin me mësuesen e tyre në gjuhën shqipe por me akcent të veçantë, të një shqipeje me nuanca të gjermanishtes dhe që shpesh mbeteshin të paplota për shkak të mungesës së fjalëve nga gjuha shqipe. Interesante ishin edhe këngët që ata i kënduan para nesh, rrëfimet e tyre personale për «atdheun» dhe Zvicrën, për përkatësinë, identitetin etj. Vërtet ishte një vëzhgim me pjesëmarrje të jashtëzakonshme, një laborator i vërtetë i dykulturësisë, i matjes së ndjesisë të këtyre krijesave të njoma që jetojnë me një diadë kulturore: shqiptare dhe zvicerane, albanofonë dhe gjermanofonë. Sa interesante ishin fjalët e Agnesës së vogël, e lindur në Zvicër, shprehur në takimin e 7 majit: «Këtu ku jemi jashtë», apo e një nxënësi tjetër që ka nuanca kontraktore me këto fjalë: «E mësojmë shqipen sepse është gjuha e nanës, kurse në shpi flasim gjermanisht». Këto janë identitetet shumëformëshe, postmoderne, përkundër atyre klasike, njëtrajtëshe, njëvijëshe. Bota e globalizimit ka prodhuar më tepër qarkullim, më tepër kontakte kulturore dhe më tepër mpleksje dhe ngjizje të reja kulturore.

Programi i konferencës së pestë, 5–7 nëntor 2015 në Tiranë (7–8 nëntor -kthimi)

Temat:

- a) Ndihmesa e institucioneve ku formohen mësues përsa i përket edukimit për qytetari demokratike (EDC) dhe përkrahjes së anëtarëve të pakicave (përfshirë emigrantët dhe riemigrantët) në orientimin e tyre midis kultures së parë, të dytë dhe ndërkulturës;
- b) Diskutim rreth botimit përfundimtar dhe rreth projekteve të mundshme në vazhdim. Mbyllja e projektit «Rrjeti kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura».

Data 5–7/8 nëntor 2015

Koha, vendi Fillim: E enjte, 5 nëntor, 17.00, në hotelin Mondial, Rr. Muhamet Gjollësia

Programi i së enjtës, 5 nëntor (vetëm për pjesëmarrësit e rrjetit)

15.15 – 17.00 Mbërritja nga Zvicra. Grupet nga Kosova dhe Maqedonia udhëtojnë në mënyrë individuale.
Transferim në hotelin Mondial; kohë e lire deri në orën 17.00

17.00 – 19.30 Mbledhja e pjesëmarrësve në hollin e hotel Mondial. Shëtitje nëpër Tiranë, ndoshta aperitiv.

19.30 Darka në restorantin Era.

Programi i së premtes, 6 nëntor

Vendi Hotel Mondial

Programi i paraditës (me mysafirë):

Ndihmesa e institucioneve ku formohen mësues përsa i përket edukimit për qytetari demokratike (EDC) dhe përkrahjes në orientimin e tyre midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës

08.30 – 09.00 Hapja zyrtare e konferencës në sallën Dea në katin e parë. Përsëritet nga ana e Universitetit të Tiranës, e Ministrisë së Arsimit dhe e Zvicrës.

09.00 – 09.15 Vështrim mbi programin, kontekstualizim i konferencës

09.15 – 10.30 Pesë inputet e përgatitura nga grupet AL, KOS, MAK, CH alb, CH ch, prej 15 minutash (duke përfshirë përkthimin!) për pikat:

- a) Çfarë është apo do të ishte e nevojshme për formimin e mësuesve në vendin tonë përsa i përket EDC-së dhe përkrahjes së anëtarëve të pakicave (përfshirë emigrantët dhe riemigrantët) në orientimin e tyre midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës?
- b) Çfarë është realizuar te ne (module të detyrueshme dhe fakultative, etj)?

10.30 – 11.00 Pushim

11.00 – 11.30	Dy inpute të shkurtra nga Zvicra (si vend me shumëkulturshmëri kulturore të veçantë dhe me komunitet të madh shqiptar): a) Trajtimi i diversitetit gjuhësor b) Harta EDC (harta për edukimin për qytetari demokratike).
11.30 – 12.30	Faza diskutimi në katër grupe të përziera me pedagogë dhe studentë të Fakultetit të Mësuesisë: Ajo që kemi mësuar/përfutur deri tani dhe si mund ta zbatojmë këtë në vendin tonë? Secili grup bën një poster ose një hand-out me disa teza.
12.30 – 13.00	Prezantim i shkurtër në plenum
13.00	Dreka, Vendi: Hotel Mondial
Programi i pasditës (pa mysafirë): Botimi përfundimtar, pjesa: raportet individuale	
14.00 – 14.15	Prezantimi i konceptit të përgjithshëm të botimit përfundimtar
14.15 – 15.00	4 tryeza të rrumbullakëta, secila në lidhje me njërin nga detyrat e përgatitura 1–4 (shih dokumentin «informacione, detyra»). Secili grup përgatit një prezantim 5-minutash me 3–4 teza
15.00 – 15.30	Prezantimet e 4 grupeve
15.30 – 16.00	Pushim
16.00 – 16.50	Zhvillim i propozimeve/projekteve konkrete nga pjesëmarrësit (në lidhje me pikën 5 të detyrave)
16.50 – 17.30	Prezantim në plenum
17.30 – 19.30	Përgatitje e një skice për projektin, pastaj kohë e lirë
19.30	Darka në restorant Tajvan
Mëvonë:	Aktivitete të lira (grupi i Shqipërisë do të ketë disa sugjerime)
E shtunë, 7 nëntor (08.30–11.30): Botimi përfundimtar; pjesa: Raportet e vendeve; mbyllja e programit	
08.30 – 09.00	Prezantimet e projekteve të para konkrete për bashkëpunim brenda rrjetit
09.00 – 10.00	Diskutim në pesë grupe (AL, KOS, MAK, CH alb, Chch): «Cilat aspekte të punës së NEZI-t ishin veçanërisht të frytshme për grupin apo vendin tonë, çfarë do të mund të bëhej më shumë për t'i thelluar këto aspekte?» Të hartohet koncepti i një teksti përafërsisht 3 faqesh dhe të sqarohet se kush dhe kur mund ta mbarojë këtë tekst dhe t'ua tregojë kolegëve të vendit. Teksti i finalizuar duhet t'i dërgohet zotit Basil deri më 30.11.2015.
10.00 – 10.30	Pushim

10.30 – 12.00	Prezantimet e pesë grupeve, fjalëpërmbyllëse, vështrim mbi perspektivat e rrjetit
12.00 – 13.00	Snack/ushqim i lehtë
13.00	Për ata që kthehen: Mbyllja e konferencës. Kthimi. Për të tjerët : Fillim i programit kulturor (i cili zgjat deri të dielen në orën 13.00).
Programi shtesë kulturor (fakultativ):	
E shtunë, pas orës 13.00	Ekskursion në qytetin muze Krujë; vizitë në Pazarin e Krujës dhe në Muzeun Etnografik. Pastaj me autobus në Durrës, darka, fjetja në hotelin Adriatik.
E diel.	Vizita e Durrësit (Muzeu Arkeologjik etj.). Në orën 12.00 drekë e vogël, pastaj me autobus për në aeroport (grupi i Zvicrës), dhe për grupet përkatëse Kosovë, Maqedoni.

Spotlight

Në Shqipërinë e pavarur «Mëmëdheut të shqiptarëve» popullsia shqipfolëse paraqet tradicionalisht shumicën. Duke u nisur nga situata dhe imazhi i shqiptarëve vihet re një dallim i qartë me Maqedoninë, Kosovën dhe Zvicrën. Këtu ndër të tjera futen tradita letrare, shkencore dhe kulturore, një univeristet i saj (që prej 1957) dhe institucione të tjera në fushën e arsimit dhe të kulturës. Në problemet aktuale dhe detyrat e politikës shqiptare hyjnë historiografia dhe pedagogjia, ballafaqimet me periudhat e socializmit (1944-1990) dhe implementimi i strukturave demokratike dhe udhëzimet në sferat e ndryshme të jetës.

Një vlerë të lartë, e cila ofron bashkëpunim në rrjet «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura» për një vështrim të diferencuar edhe ndaj vendeve të ndryshme të banuara nga shqiptarët, tërheqin ndër të tjera opinionet e Miriam Aegerter (1) Rolf Gollob (2):

1 Nëpërmjet NEZI-it jam bërë më shumë i vetëdijshëm që nuk ka thjesht shqiptarin apo shqiptaren, por që në rrjet shqiptarët dhe shqiptaret bashkëpunojnë, të cilët marrin pozicionime të ndryshme në vendet e tyre të prejardhjes (...) Kontaktet personale me përfaqësuesit e diasporës shqipfolëse në Zvicër si edhe vendet e tyre të prejardhjes Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia i kanë zgjeruar perspektivat e mia. Me interes për t'u thelluar konsideroj aspektin e të ardhmes. Si duket orientimi midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës në të ardhmen? A do të ndryshojë ky nëpërmjet rrymave aktuale të emigracionit? Si do të dukeshin ndihmat adeguate për një orientim midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës?

2 Vetëm stabiliteti si edhe më parë shumë i paqëndrueshëm politik në Kosovë me në të njëjtën kohë statusin e ri të fituar si një shumicë etnike në kundërshtim me situatën e shqiptarëve në Shqipëri apo në Zvicër, ishte për mua shkas për shumë biseda, njohuri të reja dhe thellim plotësues. (...) Çfarë diskursesh do të bëhen midis brezave, por edhe midis vendeve të ndryshme me traditën e tyre të ndryshme politike? Kështu pyetjet në Shqipëri si një vend postkomunist janë ndryshe nga ato të shtetit të ri të Kosovës, në të cilin brenda Serbisë ishte një pakicë e vetme u bë tashmë në shumicë me një pakicë serbe. Si sillen shqiptarët e rinj në Zvicër me çështjen e dyqytetarisë apo me qytetarinë e refuzuar?

5 Arritjet dhe dëshirat e hapura. Bilanci

5.1 Shënim paraprak

Kur bëhet fjalë për të gjykuar atë që është arritur ose jo në kuadrin e punës për dy vite e gjysmë në rrjetin «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura», burim më autentik janë deklaratat e pjesëmarrësve lidhur me këtë çështje. Ato ekzistojnë në formën e përgjigjeve për pyetjet, të cilave pjesëmarrësit u janë përgjigjur në dy konstelacione të ndryshme: Së pari, të gjithë pjesëmarrësit e rrjetit u lutën që të shpreheshin lidhur me pesë pyetjet e mëposhtme individualisht në 2 ose 3 faqe:

1. Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndihmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci», cilat aspekte mund të thelloheshin më tej?
2. Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI nën këndvështrimin e metodikës së planifikimit dhe organizimit të takimeve dhe çfarë mund të përmirësohej (dhe si)?
3. Çfarë përfitova tjetër nga bashkëpunimi tek NEZI dhe çfarë më mungoi?
4. Nëse NEZI do të vazhdonte: Cilat do të ishin dëshirat e mia lidhur me drejtimin e këtij vazhdimi?
5. Nëse NEZI do të vazhdonte: Cilat janë propozimet e mia konkrete dhe cili do të ishte ndihmesa ime për këto projekte?

Së dyti, pjesëmarrësit u lutën në konferencën e fundit që në grupet e tyre sipas shteteve, të mendoheshin lidhur me tri pyetjet e mëposhtme dhe deri në fund të nëntorit 2015 të dorëzonin një raport grupi mbi këtë:

1. Cilat aspekte të punës në NEZI ishin veçanërisht produktive dhe relevante për grupin/vendin tonë?
2. Çfarë mund/duhet të thellohet apo zgjerohet?
3. Si mund të ndodh kjo konkretisht (2–3 ide).

Tekstet e përpiluara individualisht gjenden tek formulimet në origjinal (ose të përkthyer) në pjesën e dytë të këtij publikimi, tekstet e grupeve në pjesën e tretë. Një vështrim të përgjithshëm të ilustruar me citate domethënëse ofrojnë në vijim kapitujt 5.5 dhe 5.5.

Gjithsesi duhet verifikuar se sa janë realizuar objektivat, të cilët në kapitullin 3 a-g janë formuluar si vendimtarë për rrjetin. Lidhur me këtë pjesëmarrësit nuk u përgjigjën në mënyrë të drejtpërdrejtë por në tekstet e tyre me shkrim dallohen pozicionimet e tyre të diferencuara edhe lidhur me këtë temë. Ato paraqesin së fundmi një burim autentik

me vlera të veçanta krahas vlerësimit të bërë nga skuadra drejtuese e projektit. Rezultatet dhe gjetjet përkatëse shtrohen për diskutim në kapitullin 5.3. Në kapitullin 5.2 do t'i paraprijmë me një shpjegim të shkurtër metodologjik në kuptimin e transparencës që lidhet me trajtimin e burimeve.

5.2 Metodika e nxjerrjes së rezultateve

Burimet qendrore për gjykimin e rrjetit si konstrukt dhe instrument i bashkëpunimit dhe për arritjen e objektivave të vendosura në kuadrin e tij, sikurse u pasqyrua më lart, janë raportet me shkrim të pjesëmarrësve, më konkretisht së pari raportet individuale në pjesën e dytë, së dyti raportet e grupeve të vendeve në pjesën e tretë të këtij volumni. Burime të tjera të mundshme, veçanërisht pohime me gojë të pjesëmarrësve, nuk u përfshinë për arsye kapaciteti, edhe një studim i mirëfilltë shoqëruar që do të kishte sjellë rezultatet e veta, nuk u konsiderua për arsye shpenzimesh.

Për trajtimin e këtyre teksteve dhe si mjet për eksplorimin e tyre do të përdorim një qasje hermeneutike të analizës përmbajtësore që në vija të përgjithshme mund t'i atribuohet «grounded theori», por gjithsesi pa ngritur pretendimin e formimit të një teorie të mirëfilltë. Përmes përzgjedhjes dhe bashkimit të pasazheve në origjinale që lidhen me aspekte të përzgjedhura (pikërisht me fushat e synuara të rrjetit dhe me pyetjet të cilave pjesëmarrësit u dhanë përgjigje me shkrim), synohet shumë më tepër arritja e një teksti kompakt i cili u lejon lexuesve që të krijojnë në mënyrë autonome apo, në përputhje edhe me temën e rrjetit, në mënyrë demokratike, një përfytyrim të vetin. Vetëkuptohet që edhe kjo procedurë cilësore-deduktive nuk është krejt e pavarur nga faktorë të mundshëm problematikë, megjithatë duket se ajo i përgjigjet më së tepërmi pretendimit për një ndërtim interaktiv të gjetjeve.

5.3 Prononcimet lidhur me arritjen e qëllimeve të rrjetit (krahaso më sipër kapitullin 3)

Si përfundim e në mënyrë të përmbledhur nga ana e skuadrës drejtuese të projektit mund të thuhet: Të tri fushat tematike përmbajtësore të prekura më sipër (Dinamika e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash, EDC-ja, konceptimi inovativ e promovues i ndërveprimit për takimet) u trajtuan në mënyrë adekuate dhe produktive. Tek tematika e parë fokusi u përqendrua më pak tek modelet e njohuritë teorikë të kërkimit shkencor rreth socializimit, shumë më tepër u fokusua diskutimi i përvojave autentike, sikurse u realizua në kuadrin e vizitave shkollore, diskutimeve me ekspertët etj. Një hapësirë kohore pak më të gjerë zuri përçimi i modeleve dhe koncepteve teorike tek tema e edukimit për një shoqëri demokratike. Ndërkohë, edhe këtu ishin vëzhgimet konkrete e të strukturuar me detyra vëzhgimi të mësimi ose diskutimi i një

«leksioni model» që zhvilloi Rolf Gollob me një klasë në Shkup, ato që sollën një konfrontim intensiv e pasurues me temën. Mjaft mirë u prit larmia e elementëve inovativë e kreativë të konceptimit të takimeve që nxisnin ndërveprimin, sikurse e dëshmon feedback-u që japin pjesëmarrësit.

Lidhur me qëllimet e veçanta të paraqitura në kapitujt e veçantë, në kapitullit 3 nga pika a) në g) rezultojnë gjetjet e mëposhtme (një përmbledhje e shkurtër plotësohet përkatësisht me disa pohime relevante të shprehura nga pjesëmarrësit në tekstet e tyre individuale mbi aspektet përkatëse):

a) Shkëmbim dhe transferim njohurish:

Gjatë pesë takimeve, të shpërndara në një periudhë kohore prej dy vitesh, u përmbush pa diskutim objektivi i shkëmbimit dhe transferimit të njohurive. Siç edhe u shpjegua pak më sipër, veçanërisht tek fokusi tematik «Të rritesh e të orientoresh në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash», rëndësi primare nuk kishte shkëmbimi i modeleve dhe koncepteve më të reja teorike rreth socializimit; në plan të parë u fokusuan më tepër takimet autentike dhe diskutimi mbi përvojat e lidhura me të në konstelacione të ndryshme. Si një plotësues me vlerë i takimeve u provua arkivi elektronik në faqen e webit të IPE-s (<https://www.phzh.ch/de/ipe/Projekte-und-Mandate/Europaweite-Projekte/Netzwerk-Albanischer-Sprachraum/>), ku gjatë çdo takimi mundën të arkivoheshin dokumente dhe informacione të përgjithshme lidhur me temën aktuale të takimit. Një pikë kritike është se kuadri i gjerë tematik i rrjetit dhe sasia e temave dhe aktiviteteve gjatë takimeve të veçanta, bëheshin komplekse kur bëhej fjalë për thellimin e një aspekti të pjesshëm apo e një çështjeje detaji apo për shembull për konceptin e kulturës. Kjo u tematizua edhe nga ana e pjesëmarrësve dhe bëri që nga takimi i tretë të planifikohej më tepër hapësirë për diskutimet në grupet më të vogla dhe ato më të mëdha. Gjithsesi një zgjidhje e efektshme do të ishte e mundur vetëm duke marrë parasysh parametrat e mëposhtme: a) më shumë kohë në dispozicion për takimet (3–5 ditë; e lidhur kjo me një buxhet shumë më të lartë), b) përzgjedhje më e kufizuar dhe më e fokusuar e temave, c) përbërje më homogjene e pjesëmarrësve, p.sh. vetëm ekspertë nga fusha e kërkimit shkencor rreth socializimit ose edukimit për një shoqëri demokratike/EDC. Realizimi i pikës b), fokus tematik më i kufizuar përmbushet fatmirësisht me projektet vijuese të vitit 2016. Vetëkuptohet që tek këto projekte struktura e partnerëve është më homogjene.

Pronocime të pjesëmarrësve lidhur me aspektin «Shkëmbim dhe transferim njohurish»

«Bashkëpunimi në NEZI më mundësoi një shkëmbim të fokusuar përvojash, teorish, konceptesh dhe idesh me personalitete tërheqëse. (...) Nëpërmjet bashkëpunimit në rrjet munda të thelloja temat (...) dhe mora informacione të reja të cilat aktualisht po përpiqem t'i integroj në punën time.»

Miriam Aegerter-Jossen, CH ch

«Rrjeti NEZI, ka dhënë një ndihmesë shumë të frytshëm për mua përse i përket aspektit metodik të organizimit të takimit. Në rend të parë, e theksoj si pozitive, planifikimin e saktë të aktiviteteve në kuadër të takimeve tona fizike, në konferencat e caktuara por edhe në kuadër të punës sonë parapërgatitore dhe paspërgatitore. Personalisht, them se ishte një përvojë shumë e mirë edhe organizimi praktik i një ore mbi mësimin për demo-kraci në një shkollë në Shkup.»

Lulzim Dragidella, KOS

«Projekti NEZI i filluar më 2013, është projekt që na ka ndihmuar të begatojmë edhe më tej njohuritë për kulturën, ndërkulturën, konceptet kulturore e parë, kultura e dytë dhe për edukimin qytetar. Përmes këtij projekti së pari krijuam miq nga trojet shqiptare, nga diaspora shqiptare por edhe nga Zvicra dhe në këtë vazhde bëmë shkëmbim të përvojave për çështjet e lartëshënuara.»

Shqipe Gashi, KOS

«Kjo lloj qasjeje krahasuese ndaj çështjeve të pjesëmarrjes së minoriteteve, është aplikuar tek NEZI, gjë që ofron mundësinë e fokusimit të karakterit strukturor të diskriminimit në vend që të humbasësh në diskutime esencjalizuese rreth «të ndryshmes në aspektin kulturor». Ne si pjesëmarrës të rrjetit mundëm ta shfrytëzojmë pjesërisht këtë shanc, por pjesa tjetër mbeti fatkeqësisht abstrakte.»

Shpresa Jashari, CH alb

«Projekti mundësoi një dialog shkencor ndërkombëtar, mundësoi paraqitjen e këndvështrimeve, njohjen e natyrës së problemeve të orientimit, përfshirjes dhe integritetit të fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë në shoqërinë zvicerane. Dialogu ndërkombëtar më ndihmoi të identifikojë të përbashkëtat dhe dallimet që lidhen me ndërkulturën dhe edukimin qytetar në Shqipëri, Zvicër, Kosovë e Maqedoni.»

Nikoleta Mita, ALB

«(...) Rrjeti NEZI, më ka sjellë bindjen për interkulturalizmin aktiv, bindjen për modelin e kulturës së tretë, me elemente edhe të kulturës së parë (kultura shqiptare –p.sh. mësimi i gjuhës shqipe në shkolla), edhe të kulturës së dytë (gjuha e vendit migrativ- kultura e vendit), që është funksionale ndër shqiptarët e Zvicrës. Më ka sjellë bindjen e mësim-nxënies ndërkulturore, që realizohet kur nxënësit vihen në kontakt me njëri tjetrin (...).»

Afrim Rexhepi, MAK

«Për mendimin tim NEZI është një shembull konkret që tregon se nëpërmjet rrjeteve krijohen energji të reja të cilat padyshim japin një ndihmesë formimi të nevojshëm në institucionet dhe shoqëritë përkatëse. Ky projekt tregon se larmia kulturore e cila sjell sfida të një lloji të ri në fushën e arsimit mund të trajtohet në mënyrë konstruktive (...) Nga gjithë aspektet e skicuara deri tani rezulton se NEZI paraqet një platformë të mirë për thellimin e qasjes së një trajtimi konstruktiv të larmisë kulturore dhe gjuhësore në shkollë dhe shoqëri.»

Naxhi Selimi, CH alb.

b) Vazhdimësia

Lidhur me qëllimin e vazhdimësisë së projektit u morën masa të ndryshme:

- Integrimi i vetëdijshëm edhe i hulumtuesve dhe ekspertëve më të rinj në skuadrën e rrjetit;
- Planifikimi i një kohe dhe rastesh të bollshme për komunikim ndërkombëtar dhe të grupeve si dhe për njohje reciproke më të thelluar dhe lidhjen e kontakteve;
- Planifikimi i një faze shtesë 'informale' për realizimin e projekteve vijuese me pjesëmarrës nga të paktën 2 shtete ose grupe (janar deri dhjetor 2016).

Se sa është realizuar në të vërtetë qëllimi i vijueshmërisë duke pasur parasysh këto parakushte të mira, nuk mund të thuhet ende momentalisht. Prononcimet e mëposhtme si dhe interesi i gjallë për fazën e projektit 2016, lejon të shpresosh në mënyrë të justifikuar lidhur me këtë.

Prononcime të pjesëmarrësve lidhur me aspektin e «Vazhdimësisë»

«Munda të lidhja shoqëri dhe kontakte që mund t'i aktivizoj e që mbeten ekzistente. Nga NEZI është zhvilluar diçka konkrete: më 19 shtator 2014 pjesëmarrësit e NEZI-t nga Zvicra organizuan një koncert me muzikantë nga Prishtina.»

Ylfete Fanaj, CH alb

«Kontaktet e larmishme dhe kontakti i rregullt janë diçka nga e cila mund të ushqehesh më tej (...). Dëshira e përgjithshme është që NEZI të vazhdohet në një lloj forme. Nëpërmjet njohjeve të krijuara ka lindur një bazë besimi dhe është formuar një identifikim me temat e përpunuara bashkërisht. Kështu do të ishte e mundur që të trajtoheshin tema konkrete në mënyrë cilësore ndoshta në grupe të vogla dhe të planifikohen projekte.»

Shqipe Bajrami Grohs, CH alb

«NEZI përbën një synim dhe një platformë të punës së përbashkët në të ardhmen.»

Driton Kajtazi, CH Alb

«Jam e mendimit se ky varg konferencash nevojitet të mos shkëputet, por të vazhdojë duke shtuar nivelin e studimit dhe kërkimit shkencor, por edhe shkëmbimit të përvojave mes shteteve në rajon (Ballkan) dhe Zvicrës, përse jo përmes Ministrive të Arsimit dhe Shkencës si dhe institucioneve të tjera kërkimore-shkencore.»

Adelina Marku, MAK

«Pjesëmarrja në rrjetin NEZI më ka ofruar mundësinë e njohjes me ekspertë të ndryshëm në Rajon dhe më gjerë, të cilat shpresoj të thellohen me forma të ndryshme të bashkëpunimit në të ardhmen.»

Melinda Mula, KOS

«Ishte një bashkëpunim i mbarë dhe unë gjeta në rrjetin NEZI kolegë, profesorë jo vetëm nga Zvicra, por edhe nga Maqedonia dhe Kosova, me të cilët mund të bashkëpunojmë edhe në të ardhmen. Mundësimi i bashkëpunimeve ndërmjet profesorëve të universiteteve të Rajonit ishte një përfitim që unë kam marrë nga rrjeti NEZI edhe sepse kemi shumë pak mundësi në Rajon për shkëmbime eksperiencash të tilla, pa mundësimin e projekteve me mbështetje nga jashtë.»

Merita Xhumari, ALB

c) Bashkëpunimi Zvicër, hapësira shqiptare

Qëllimi i një bashkëpunimi midis ekspertëve zviceranë dhe atyre me prejardhje shqiptare u realizua në mënyrë të padiskutueshme. 5 takimet si dhe hapësirat e planifikuara për kontakte dhe shkëmbim social përtej kufijve, dhanë një ndihmesë të rëndësishme për këtë qëllim edhe pse pikërisht lidhur me mundësitë që u referohen atyre, artikulohej pjesërisht ende dëshira që shkojnë më tej. Se sa do të vazhdojë mbajtja dhe shfrytëzimi i kontakteve të lidhura pas projektit dhe fazës vijuese të projekteve të bashkëpunimit, mbetet për t'u parë. Krahajo për këtë edhe pikën b) më sipër.

Prononcime të pjesëmarrësve lidhur me aspektin «Bashkëpunimi Zvicër – hapësira shqiptare»

«Falë bashkëpunimit në NEZI, munda të zgjeroj rrjetin personal të specialistëve (...). Kështu p.sh. munda të fitoj dy persona që punojnë si pedagogë në degën e certifikatës «Gjermanishtja si gjuhë e dytë dhe ndërkulturaliteti» drejtim të cilin e kam edhe unë.»

Miriam Aegerter-Jossen, CH ch

«Ishte një pasurim i madh për mua të mund të diskutoja me specialistë të vendeve të ndryshme mbi demokracinë, trajtimin e minoriteteve dhe mbi larminë kulturore. (...) Mjaft të rëndësishme për punën time si pedagogë dhe studiuese ishin edhe vizita e mësimi të gjuhës e kulturës së prejardhjes shqiptare në Zvicër e veçanërisht bisedat me mësuesit e MGJP-së dhe me nxënësit me sfond emigracioni shqiptar.»

Andrea Haenni Hoti, CH ch

«Të gjeje të mbledhur së bashku rregullisht ekspertizën e kaq shumë specialistëve të ndryshëm të gjuhës shqipe e gjermane nga fusha e kërkimit shkencor dhe arsimit në fushat e emigracionit dhe gjithëpërfshirjes si dhe mundësia për të shkëmbyer me ta, përbënte një shanc të jashtëzakonshëm sidomos për studiuesit/et dhe aktivistët e rinj, që punojnë në këto rajone (gjuhe) për lidhje kontaktesh dhe për të mësuar gjëra të reja.»

Shpresa Jashari, CH alb

«Falë multiperspektivës së tij ky rrjet në këtë nivel të lartë, ku në qendër janë shqiptarët e Ballkanit Perëndimor dhe të Diasporës, mbetet për mua personalisht, i vetmi projekt prestigjioz, që bashkoi shumë ekspertë nga katër vende. Përvoja ime përgjatë kontaktit shumëvjeçar me vendet gjermanishtfolëse, nuk më ka njohur me projekte të tilla, pasi kur flitet për Ballkanin apo Evropën Juglindore, Shqipëria është anashkaluar shumë shpesh (...).»

Admir Kraja, ALB

«Pra, projekti NEZI na mundësoi që të shohim ballafaqimin e shqiptarëve të Zvicrës, Maqedonisë dhe Kosovës me aspektet e integritit, ndërkulturalitetit dhe diversitetit në kontekst të vlerës dhe antivlerës, përbrenda shteteve ku jetojnë dhe diversitetit pozitiv brenda tyre si komb.»

Shqipe Gashi, KOS

«Një ndër risitë e mëdha nga bashkëpunimi me rrjetin NEZI, është njohja me jetën e diasporës shqiptare në Zvicër. Për mua ky ishte edhe dimension i dytë më i rëndësishëm i këtij bashkëpunimi menjëherë pas informacionit që fitova për format e edukimit qytetar në shoqërinë zvicerane. Mësova shumë mbi organizimin e jetës së diasporës shqiptare, gjë që nuk e kisha ditur më parë (...).»

Adelina Marku, MAK

«Ky bashkëpunim më ka sjellë krijimin e kontakteve me ekspertë të fushave të ndryshme që së bashku të punojmë për të mirën e gjeneratave të ardhshme dhe për krijimin e marrëdhënieve midis shteteve shqipfolëse dhe me diasporën shqiptare në Zvicër. Gjithashtu ky bashkëpunim më ka motivuar që të mendoj në të ardhmen si të kontribuoj më shumë për diasporën shqiptare të Maqedonisë në Zvicër, sepse mendoj se për këtë grup emigrantësh Maqedonia nuk jep haraçin e duhur, sa emigrantët japin për vendlindjen.»

Nadire Rexhepi, MAK

«Më erdhi keq që duhet të niseshim menjëherë pas takimeve dhe që sidomos shkëmbimi me pjesëmarrësit nga ALB, KOS dhe MAK u kufizua vetëm tek koha e konferencës.»

Ylfete Fanaj, CH alb

d) Bashkëpunim e komunikim më i mirë brendapërbrenda anëtarëve të zonave shqipfolëse

Aspekti i komunikimit të shqipfolësve me njëri-tjetrin (midis Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kosovës) preket më rrallë në raportimet e pjesëmarrësve sesa shkëmbimi i partneritetit me Zvicrën, i cili është përjetuar padyshim si inovativ dhe si special. Megjithatë rrjeti ka kontribuar pa dyshim edhe për përmirësimin e shkëmbimit midis pjesëmarrësve nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Ai u ofroi atyre një kuadër të shkëlqyer për një shkëmbim të zhveshur nga konkurrenca e shpeshtë në një tjetër kontekst dhe nga hierarkia klasike, për njohjen e sistemeve të ndryshme arsimore dhe për reflektimin dhe shfrytëzimin përqasës të përvojave përkatësisht të shteteve të tjera.

Prononcime të pjesëmarrësve lidhur me aspektin e një «Komunikimi të përmirësuar në zonën shqipfolëse»

«Komuniteti i pretenduar homogjen shqipfolës dhe specifik arsimor u shpalos në larminë e vet, në pozicionet dhe këndvështrimet të ndryshme.»

Rolf Gollob, CH ch

«Në këndvështrimin tim ky rrjet ka sjellë risi në mënyrën e bashkëpunimit mes shqiptarëve të të tre vendeve duke shkëmbyer jo vetëm ide për bashkëpunime, por edhe duke parë nga afër se si realizohet qoftë mësimi i gjuhës shqipe në secilin vend. Njohja e teksteve, qarkullimi i tyre mes shteteve do të lehtësonte qoftë edhe unifikimin e terminologjisë së gjuhës shqipe, vecanerisht për lëndën e edukatës qytetare dhe demokratike që pasqyron parime të të drejtave universale të shpalluar në dokumente ndërkombëtare të OKB-së.»

Merita Xhumari, ALB

«Përveç tjerash bashkëpunimi me rrjetin na ka sjellë mundësinë që të vështrojmë e krahasojmë edhe diversitetin brenda shoqërisë shqiptare. Duke jetuar në disa shtete Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, por dhe në vendet të tjera mikëpritëse si Zvicra etj. shoqëria shqiptare ka krijuar një profil të shumëfishtë kulturor edhe përbrenda vetë saj. Gjersa në Kosovë ballafaqimi me lirinë, me të kaluarën e afërt, por dhe me sfidat e shtetndërtimit janë preokupimet kryesore, në Shqipëri konsolidimi i demokracisë është synim parësor, ndërsa në Maqedoni aspiratat për barazi nacionale dhe për zhvillim të demokracisë, mbesin shqetësime kryesore. Kjo reflektohet gjithësesi dhe në fushën e arsimit, në shkollë, në preokupimet e jetës së përditshme por dhe në strukturën kulturore. Dimensionin apo profili tjetër janë shqiptarët e diasporës që përveç «dallimeve» që ata bartin me vete nga vendi i origjinës krijojnë edhe një «dallim» tjetër me përvetësimin e kulturës së dytë, të vendit mikpritës. E tërë kjo larushi ka kompleksitetin e vet që reflektohet dhe në marrëdhëniet ndërshtetërore.»

Arbër Salihu, KOS

«Gjithashtu, një dobi të veçantë nga ky rrjet mund të kenë edhe shtetet e Ballkanit, të cilat kishin një përvojë të ndryshme të edukimit në të kaluarën e afërt, për dallim nga ajo që është prezente dhe në zhvillim e sipër me dekada të tëra në demokracitë e Evropës Përndimore.»

Rifat Haxhijaj, CH alb

«Projekte të tilla janë gjithnjë të mirëseardhura dhe të nevojshme, veçanërisht në mjediset ku gërshetohen kultura e parë dhe e dytë dhe ndërkultura. Duhet theksuar këtu edhe nevoja e projekteve të tilla për shtetet në tranzicion, siç janë shtetet e Ballkanit Perëndimor, të cilat ballafaqohen me krizë ekonomike dhe politike, ku është i theksuar emigrimi i popullatës në vendet e Evropës Perëndimore.»

Jonuz Abdullai, MAK

e) Larmia metodike, qasjet shumëperspektivëshe

Qëllimi që të përohen, në dhe me rrjetin NEZI «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura», edhe impulse e sugjerime implicite didaktike e metodike të vendosura pothuajse në nivelin e një metagjuhe, u përmbush pa dyshim mjaft mirë dhe në një mënyrë shumë të frytshme. Me këtë qëllim, skuadra drejtuese e projektit lidhi edhe dëshirën e çlirimit të «monokulturës» metodike të takimeve (ose rrjedhën e lodhshme të referateve të njëpasnjëshme), sikurse ndeshen shpesh dhe t'u mundësonte pjesëmarrësve njohjen dhe përjetimin e formave alternative të lidhura me këtë, të orientuara nga përvoja dhe ndërveprimi. Këtu listoheshin materialet e përgatitura nga grupet e vendeve të ndryshme, diskutimet e strukturuar në formacione të ndryshme, tavolinat e rrumbulla, woks-hop-et por në veçanti edhe vizitat shkollore (me detyrë vëzhgimi të përgatitura enkas për to), diskutimet me mësuesit dhe nxënësit, materialet video, një «model leksioni» me

një klasë shkollë etj. Aspekti i metodikës së takimit dhe konceptimit të qasjeve shumëperspektivëshe trajtohen përkatësisht në përgjigjet e pyetjes së dytë të raporteve individuale të pjesëmarrësve («Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI nën këndvështrimin e metodikës së planifikimit dhe organizimit të takimeve dhe çfarë mund të përmirësohej (dhe si)?»). Ajo për të cilën pjesëmarrësit shprehin shpesh keqardhje ishte koha e kufizuar në dispozicion ose programi i tej mbushur, i cili ndonjëherë lejonte shumë pak hapësirë për diskutime më të thella. Në vijim do të kufizohemi tek një përzgjedhje e shkurtër e prononcimeve lidhur me këtë çështje, të tjerat gjenden në kapitullin 5.4 tek pjesa e trajtimit të përgjigjeve të pyetjes 2 të raportimeve individuale.

Prononcimet e pjesëmarrësve lidhur me aspektin e «metodikës së takimeve»

«Planifikimi dhe organizimi i takimeve ishte mbresëlënë. Siç e përmenda më sipër, drejtuesit e takimeve bënë të mundur një shkëmbim tepër pasurues gjatë, midis dhe pas referimeve dhe ekskursioneve. (...) Përjetimi i bashkimit të një larmie të tillë perspektivash dhe mundësia për të qenë pjesë aktive e tij, kjo që ajo nga e cila përfitova më shumë. Bisedat dhe takimet informale që u zhvilluan ishin po aq të rëndësishme sa vizitat në mësim dhe diskutimet e përbashkëta apo në grupe. Fokuset tematike formonin një kuadër të përshtatshëm brenda të cilit u arrit të analizohej, prezantohej, shkëmbeheshin përvoja dhe madje edhe të debatohej me pasion (...).»

Kai Felkendorff, CH ch

«[Elemente pozitive:] Shumëlarmshëria e vetëmbajtjes së konferencave, puna efektive në grupe dhe komunikimi interaktiv tejet i vlefshëm i pjesëmarrësve jashtë konference, njohja me metodologji të reja të punës dhe efikasiteti dhe cilësia e lartë e mbajtjes së konferencave.»

Shukrije Ramadani, CH Alb

«Në grupin drejtues mësua që t'i besonim gjithmonë e më tepër dinamikës së simpoziumeve të veçanta dhe së bashku me përfaqësuesit lokalë në Prishtinë, Shkup dhe Tiranë të gjenim një balancë midis momenteve të paplanifikuara dhe elementeve të ngjeshura të programit, të planifikonim vizitat e institucioneve, shkollave dhe autoriteteve dhe të gjykonim në mënyrë realiste afatet, por edhe të nxisnim dhe mbështesnim.»

Rolf Gollob, CH ch

«Zgjedhja e ekspertëve nga fushat përkatëse, informimi me kohë lidhur me detyrat në kuadër të konferencave, dërgimi i materialeve, udhëheqja e konferencave, bashkëpjesëmarrja e mysafirëve, vendet e ndryshme të mbajtjes së konferencave, hyrjet tematike, debatet, puna në grupe, përkthimet, shfrytëzimi shumë racional i kohës, kanë bërë që unë të jem me kënaqësi pjesë e vogël e këtij bashkëpunimi, nga i cili kam fituar përvoja të reja sa i përket kësaj fushe.»

Nexhat Maloku, CH alb

«Duke qenë një shembull i mirë i organizimit në rrafsh të ndryshme, nga pikëpamja metodologjike, Konferenca na njohu më tej me përvojat e të tjerëve në organizime të këtilla komplekse, ku komunikime e bashkëpunime, që shquhen për saktësinë, përgjegjësinë e planifikimit dhe të realizimit, respektimin e tjetrit dhe të së ndryshmes, para së gjithash përbëjnë edhe vlera themelore qytetarie demokratike. (...) Natyra lëvizëse e konferencës nëpër disa qendra shqiptare (kryesoret), e vë atë në lidhje më të ngushtë e të përgjegjshme me vetë lëndën, temën, qëllimin, përfshirjen e insitucioneve përkatëse dhe të subjekteve.»

Nuhi Gashi, KOS

«Nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe e realizimit të konferencave kam përfituar shumë, në veçanti sa i përket ndërlidhjes së dijes teorike me atë praktike. Dalja në terren, ka qenë jashtëzakonisht frytdhënëse për mua, në veçanti kontaktet me fëmijët dhe figura të rëndësishme të diasporës që janë veprimtarë të kauzës në një vend ku kulturat e «sekondove» janë ishuj që mundohen ta përballojnë furtunën e ujërave të oqeanit të kulturës vendase.»

Ali Pajaziti, MAK

«Rrjeti NEZI më ka ofruar një formësim të qëndrueshëm të profilit teoriko- shkencor të avancuar dhe një performancë cilësore pragmatike, origjinale të avancuar që ka qasje të formësuar mbi trendet dhe zhvillimet në vend dhe Rajon. Programi ka ndikuar në zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive kritike, analitike dhe humltuese, që mund të aplikohen në vendet prej nga jemi.»

Myqereme Rusi, MAK

Lidhur me problemin e kuadrit kohor të kufizuar:

«Çfarë mund të përmirësohej ndoshta: Diskutime të thella e të përqendruara tek rezultatet lidhur me çështjet qendrore.»

Brigit Allenbach, CH ch

«Ndonjëherë mungonte ndoshta hapësira për diskutime e biseda të thelluara, kështu që në këtë pikë programi i ngjeshur duhej ndoshta përshtatur pak.»

Shqipe Bajrami Grohs, CH alb

«Një ide për një ndryshim në këtë drejtim, në rast të një vazhdimësie të projektit, do të ishte ndoshta që të ketë më shumë kohë në shfrytëzim për debate shtruese, sepse edhe këtu ka dinamika të ndryshme, dallime kulturore mes grupeve, të cilat ndikojnë në rrjedhën e konferencave (dëshira për të folur më gjatë për tema të caktuara).»

Nexhat Maloku, CH alb

«Ndoshta duhet menduar në krijimin e kushteve për analiza me të thella, më shtruese dhe me bazë më kompetente hulumtuese e krahasimtare brenda njësive shqiptare dhe të njësive shqiptare me të tjerat.»

Nuhi Gashi, KOS

«Problem të vogël përbën agjenda e ngarkuar e konferencës, prandaj jam i mendimit që në të ardhmen të organizohen punëtori që do ti paraprijnë konferencës, në këtë rast do të fitojmë në kohë dhe në cilësi të debatit si dhe të rezultateve nga impakti i organizimit të tillë.»

Jonuz Abdullahi, MAK

f) Lidhja me projektin e Këshillit të Evropës «Edukimi për qytetari demokratike dhe të Drejtat e Njeriut»

Tema «Edukimi për qytetari demokratike dhe të Drejtat e Njeriut» përbënte një nga dy çështjet qendrore të rrjetit. Nga ana e personelit kjo u mbështet në mënyrë të atillë që tek pjesëmarrësit e vendeve, bashkë me Rolf Gollob, Astrit Dautaj dhe Arbër Salihu të përfshiheshin minimumi tre persona përgjegjës të vendit në fushën e EDC-së. Tema e EDC/HRE ishte në fokus sidomos gjatë takimit të dytë dhe të tretë (Prishtinë, Shkup), por edhe gjatë konferencave të tjera ajo mbetej një pikë mjaft e rëndësishme e programit. Qasjet shumë perspektivëshe tek ky qark tematik (vizitat shkollore, modeli i leksionit, njohja me materialet, inputet, dhënia dhe diskutimi i informacioneve të përgjithshme dhe dokumentacionit bazë), garantuan që pjesëmarrësit të sensibilizoheshin brenda ku-

adrit të së mundshmes dhe të aktualizoheshin me njohuritë më të fundit. Gjithashtu mbetet e qartë se temat mjaft aktuale të EDC/HRE-së mund dhe duhen bërë objekt i konferencave e trajnimeve të ardhshme, pa pasur asnjë lloj problemi. Siç e vërtetojnë edhe prononcimet e pjesëmarrësve (nga të cilat do të tregojmë një përzgjedhje disi më të gjerë këtu duke konsideruar rëndësinë e temës dhe receptimin e saj), EDC/HRE u perceptuan si përmbajtje të rëndësishme dhe u shpreh qartë e në mënyrë të shumëfishtë dëshira për një thellim të mëtejshëm.

Prononcimet e pjesëmarrësve/seve lidhur me aspektin «Edukimi për qytetari demokratike»

«Rrjeti KPDI (NEZI) më ka dhënë mundësi të thelloj njohuritë praktike për edukimin për qytetari demokratike. Duke qenë për shumë vite përfaqësues, koordinator i Republikës së Kosovës në rrjetin e koordinatorëve të Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe të Drejta të Njeriut, kam pasur rast të dëgjoj, të mësoj, por dhe të jap ndihmesën time në hartimin e politikave evropiane në këtë lëm.»

Arbër Salihu, KOS

«Për sa i përket temës së dytë «edukimi për qytetari demokratike» ka qenë një temë më atraktive për mua dhe më fitimprurëse nga ana profesionale. Unë si mësimdhënëse në gjimnazin e Tetovës çdo ditë ballafaqohem me këtë problematikë dhe më preokupon fakti se si shkollat tona akoma funksionojnë në formën diktatoriale, ku nxënësi respekton rregullat vetëm nga ana e frikës dhe në të shumtën e rasteve janë vetëm pjesë e problemit dhe jo të marrin pjesë në zgjidhjen e tij. Për këtë arsye mendoj se në lidhje me këtë temë duhet të organizohen më shumë konferenca dhe seminare të tilla por edhe workshope nëpër shkolla, ku mund të trajnonim mësues se si të zhvillojnë mësimin në forma më demokratike sikurse e zhvilloi zoti Rolf Gollob një orë mësimore në Konferencën e Tretë që u mbajt në Shkup.»

Nadire Rexhepi, MAK

«U arrit të trajtohej niveli shkollor i formimit të demokracisë, e njëjta gjë vlen edhe për elementet e zhvillimit të materialeve mësimore. Diskursi rreth lidhjes së përfytyrimeve mbi demokracinë dhe emigrimin u zhvillua shumë shkurt. Ky diskurs nuk është zhvilluar ende. Ai është shumë specifik e politik dhe kërkon njohuri bazë teorike politike paraprake, që shkon përtej qasjeve pedagogjike apo psikologjike.»

Rolf Gollob, CH ch

«Në Kosovë arsimi dhe sistemi arsimor synojnë t'i afrohen sistemeve simotra të shteteve përëndimore duke synuar edhe rol të veçantë në edukimin për qytetari demokratike, por ballafaqohet me inrecione e reminishenca të sistemit të kaluar, me konsekuenca edhe më tej të ndjeshme të luftës së fundit, me refuzimin e minoritetit serb për t'u integruar në sistemin arsimor etj.»

Nuhi Gashi, KOS

«Në të ardhmen shpresoj që projekti të fokusohet në njohjen dhe shpërndarjen e përvojave të suksesshme të përgatitjes së mësimdhënësve para shërbimit dhe në shërbim lidhur me temat e EDC/HRE (...) Po ashtu, ky projekt më ka ndihmuar të thelloj njohuritë e mia në fushën e EDC/HRE, të problematikës së integrimit të komuniteteve pakicë, si dhe problematikës së integrimit të atyre që emigrojnë dhe riemigrojnë për të jetuar në kultura të ndryshme nga vendi i origjinës së tyre ose të prindërve të tyre. Propozoj që projekti NEZI të vazhdojë me shtjellimin e problematikës së EDC/HRE, të ndër- dhe multikulturalizimit, duke ngritur çështjen e përgatitjes së mësimdhënësve para dhe në shërbim lidhur me këto tema.»

Melinda Mula, KOS

«Aftësimi i individit për t'u orientuar në larminë e botës së sotme gjithnjë e më globale e të larmishme, dhe për të marrë vendime gjithnjë e më të mirëmenduar, është një ndër synimet kyesore të edukimit për qytetari demokratike. Për këtë arsye, këto çështje nuk mund të shihen të shkëputura, por të ndërlidhura. Marrëdhëniet ndërkulturore përbëjnë ushqimin e përmbajtjes dhe të kontekstit të edukimit për qytetari demokratike, ndërkohë që ky i fundit, mundëson ndërtimin e kompetencave të individit për të marrë vendimet e duhura në komunitetin shumëkulturësh.»

Astrit Dautaj, ALB

«(...) Do të dëshiroja të realizonim një studim rajonal mbi format e përdorura në vendet tona për të realizuar edukimin qytetar, sa ato përcjellin parimet demokratike të shoqëri-ve përparimtare. Studimi të konsistonte në evidentimin e rasteve më të mira të edukimit qytetar në të gjitha ciklet e edukimit, që nga sistemi parashkollor, arsimi i detyrueshëm, dhe arsimi i mesëm për t'i sjellë në një botim të përbashkët të tri vendeve.»

Merita Xhumari, ALB

«Koncepti për demokraci kreative, është në thelb të librit të Rolfit, e që realizohet përmes edukimit dhe arsimimit praktik. E kjo realizohet, nëse shkolla definohet si njëra nga format pragmatike të jetës në shoqëri. Për t'u realizuar një koncept i tillë, është i nevojshëm edukimi për qytetari demokratike, veçanërisht, edukimi demokratik i mësimitdhënësve dhe nxënësve, apo konstruksioni i kurrikulave ndërkulturore, që duke i zhdukur paragjykimet ndaj tjetrit, përgatit gjeneratat e reja për jetë të përbashkët në shoqëritë demokratike.»

Afrim Rexhepi, MAK

«Ajo që më mungoi ishte (...) një diskutim më i detajuar lidhur me çështjen se si duhet organizuar një bashkëpunim ndërkombëtar ballë për ballë gjatë zhvillimit të mëtejshëm konceptual të edukimit për demokraci. (...) Unë personalisht do të dëshiroja pikë së pari një thellim të temave «Përfshirja/përfjashtimi», «Të Drejtat e Njeriut» dhe «Të drejtat e minoriteteve» (...). Do të më pëlqente të punoja në një grup pune për temën «Formimi i të Drejtave të Njeriut». Ndër të tjera më duket interesante dhe produktive analiza e planeve dhe materialeve mësimore, koncepteve ekzistuese dhe/ose leksioneve nën këndvështrimin e çështjeve që janë ende për t'u përcaktuar.»

Kai Felkendorff, CH ch

g) Karakteri i modelit dhe impulseve të rrjetit

Në raportimet individuale të pjesëmarrësve është vështirë të gjenden referenca të qarta lidhur me këtë qëllim (i cili edhe pjesëmarrësve nuk ju është komunikuar kurrë në mënyrë eksplicite). Prandaj për arritjen e qëllimit duhen verifikuar përgjigjet e pyetjeve apo prononcimet e lidhura me objektivat e tjera, veçanërisht a) dhe b), por edhe e). Ato lënë të kuptosh që edhe ky qëllim është përmbushur pothuajse plotësisht, megjithëse në lidhje me kohëzgjatjen e konferencës mbeten pa dyshim ende shumë dëshira të papërmbushura (krahaso këtu edhe prononcimet që vijojnë që lidhen me kapitujt 3-5 të raportimeve individuale). Ju rekomandojmë këtu përmbledhjet e përmendura dhe do të kufizohemi tek tri prononcime që kemi përzgjedhur, në të cilat preket karakteri standard i rrjetit. Fakt mbetet që përvojat e mbledhura me NEZI-n kanë vlera të larta dhe transferueshmëri optimale, kur bëhet fjalë për krijimin e rrjeteve e bashkëpunimeve të ngjashme në kontekste të tjera (p.sh. në hapësirën sllavejugore).

Prononcime të pjesëmarrësve lidhur me aspektin «Karakter i modelit dhe impulseve të rrjetit»

«Për mendimin tim NEZI është një shembull konkret që dëshmon se nëpërmjet rrjeteve krijohen energji të reja, të cilat padyshim japin një ndihmesë të nevojshme në fushën e edukimit për institucionet dhe shoqëritë përkatëse. (...) Përmbledhtazi mund të thuhet se NEZI ka mundësuar takime dhe ka përforcuar dialogun profesional dhe institucional. Shkëmbimi me mjaft vlerë i përvojave si dhe bashkëpunimet që lindën midis specialistëve, japin sigurisht një ndihmesë të nevojshme arsimore e cila duhet ruajtur në rastin e vazhdimit të kësaj nisme. Përvojat e deritanishme tregojnë se sa i rëndësishëm është vazhdimi i këtij dialogu ndërkombëtar midis specialistëve të arsimit dhe garantimi i vazhdimësisë me anë të bashkëpunimeve të mëtejshme dhe projekteve të përbashkëta. Kush investon në projekte të këtij lloji, pasuron arsimin që përbën një nga shtyllat qendrore shoqërore.»

Naxhi Selimi, CH alb

«Nga ana e metodologjisë së planifikimit dhe zbatimit të projektit, bashkëpunimi në rrjetin KPD (NEZI) ka qenë edhe një përvojë e re, e rëndësishme, për mua. (...) Përcaktimi i qartë i bartësve të secilit veprim dhe respektimi në përpikëri i agjendës kohore, si veçori tipike zvicerane, është model që duhet kultivuar në të gjitha vendet tona.»

Arbër Salihu, KOS

«Konferencat e organizuara derimëtani nga ana e rrjetit NEZI, na shërbyen për të përfuar modelin zviceran të këtij dimensionit/modeli të edukimit demokratik që përcjell vlera të shtuara të progresit shoqëror në përgjithësi. Jam e mendimit, se ky varg konferencash nevojitet të mos shpëputet, por të vazhdojë duke shtuar nivelin e studimit dhe kërkimit shkencor, por edhe të shkëmbimit të përvojave mes shteteve në Rajon (Ballkan) dhe Zvicres, përse jo përmes Ministrive të Arsimit dhe Shkencës si dhe institucioneve të tjera kërkimore-shkencore.»

Adelina Marku, MAK

5.4 Një vështrim mbi përgjigjet për pesë pyetjet në artikujt individualë

Në kuadrin e detyrave të zakonshme përgatitore para çdo konference, pjesëmarrësit u lutën në fund të majit 2015 që deri në 1 tetor të jepnin gjykim nga dy deri në tri faqe për pesë çështjet në lidhje me punën në rrjet «kulturën e parë, të dytë dhe ndërkulturën», si edhe për vazhdimin e mundshëm të kësaj pune.

Që ky grumbullim u krye para konferencës së pestë, do të thotë pa mundësinë për të përfshirë përvojat e atjeshme, dukej në këtë pikë e pranueshme dhe plot kuptim, se sa mendimet përkatëse për t'i paraqitur si një kusht të rëndësishëm për punën në Konferencën e Tiranës.

E ngjashme si në kapitullin 5.3 më poshtë për çdo pyetje kompozojmë disa prononcime relevante dhe të sakta nga raportet individuale. Tekstet përbërëse gjenden në pjesën II të publikimit të paraqitur.

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndihmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci». Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Pyetja është dypjesëshe: a) Arritjet dhe fitimi i njohurive nga NEZI, b) Për t'u dëshiruar përsa i përket thellimit. Pjesa më e rëndësishme e pyetjeve i referohet vetëm pjesës së parë të pyetjes. Thëniet për thellime të mundshme, përmirësime dhe dëshira tematike për përmirësimin gjenden kryesisht tek përgjigjet për pyetjet 2, 3 dhe 4. Për t'u shënuar prapëseprapë është që nën shqetësimin e thellimit tashmë në pyetjen 1 shumë herë është tërhequr vëmendja për një kontradiktë të diferencuar me konceptin e kulturës. Për këtë temë Jeanine Dahinden, e cila duhet ta linte më pas rrjetin për shkak të arsyeve të kapacitetit, ka mbajtur në konferencën e parë një referat edhe pse të perceptuar kontrovers. Sidoqoftë ishte tema «kulturë» (apo ndërtimet kultura e parë e dytë dhe ndërkultura) edhe ndryshe me kuptim si të thuash ekzistencial. Mund të ishte diskutuar pa problem shumë më gjerë, se çfarë pasoje do të kishte nën mbrojtjen e kuadrit të ngushtë kohor, heqja dorë nga përmbajtjet e tjera të konferencës. Një dëshirë tjetër për thellim nganjëherë e cekur i përket konkretizimit të shqetësimeve në lidhje me EDC/HRE. Përshlyetjet e praktikës, transmetuar nëpërmjet vizitës në shkolla etj., ofruan një terren të mirë, por jo të mjaftueshëm.

Në përzgjedhjen e mëposhtme të përgjigjeve për pjesën e parë të pyetjes «Çfarë përfito-va nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat përmbajtëso-re...», ne mund t'ju tërheqim vëmendjen në kapitullin 5.3, veçanërisht në prononcimet e prezantuar në qëllimet a), b), g). Ato dëshmojnë një gjykim tejet pozitiv të bashkëpunimit në rrjet. Ne kufizohemi për këtë pjesëpyetje si më poshtë në tri prononcime të shkurtra dhe dokumentojmë hollësisht për këtë gjë përgjigjet për pjesën e dytë të pyetjes. (Cilat aspekte mund të thellohen?)

«Nga pikëpamja socialo-shkencore është problematike lidhja me një koncept kulturor të orientuar shpesh turbullt nga konceptet e mëdha si «kombi», «populli» apo «prejardhja». Koncepte të kulturës hasen jo vetëm në pikën e parë kyçe dhe në emrin e rrjetit tonë, por kanë qenë prezente edhe gjatë konferencave të ndryshme dhe diskutimeve, veçanërisht kur bëhej fjalë për të tematizuar konflikte dhe vështirësi të "Secondoas" edhe të tilla në çështjen e edukimit demokratik, në të përditshmen e jetës së tyre zvicerane. Të marrët në mënyrë më të thelluar me konceptet kulturore të përdorura në kuadrin e konferencave, kanë qenë sipas pikëpamjes sime të dëshirueshme, pjesërisht u lanë disa kërkesa, nga njëra anë për shkak të presionit të kohës dhe, nga ana tjetër, sepse atje ku është e mundur nga vështirimi i praktikantëve të etabluar, duket më pak e rëndësishme dhe tërheqëse.»

Shpresa Jashari, CH alb

«Shkëmbimi intensiv në konferencat tematike ishte shumë pasurues. Punët përgatitore ishin të rëndësishme dhe kanë thelluar bashkëpunimin brenda pjesëmarrësve nga Zvicra. Bashkëpunimi në NEZI mbi këta dy vjet ishte i dobishëm, sepse kështu njihje pjesëmarrësit dhe shkëmbimi ishte i padetyrueshëm. Grupi me përbërje ndërdisiplinore nga katër vende të ndryshme dhe sfondet e ndryshme profesionale më kanë mundësuar këndvështrime të shumta.»

Ylfete Fanay, CH alb

«Për t'i kuptuar këto gjëra, sipas mendimit tim duhet të sqarohet edhe nocioni i kulturës. Të rritesh në kulturën e parë, që do të thotë në një sistem të caktuar të vlerave dhe normave shoqërore, që në shkencë quhet socializimi i parë dhe socializimi i dytë (shoqëria, shkolla, etj.). Pra, kjo do të thotë se/që në këtë përgjithësim vlerash (të individit), rol shumë të rëndësishëm luajnë gjuha, besimi, morali, e drejta, ekonomia etj.»

Lulzim Dragidella, KOS

«Bashkëpunimi në rrjetin NEZI për mua ka qenë një përvojë e mrekullueshme dhe një sfidë e këndshme, sidomos temat kryesore «përkrahja në orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «edukimi për qytetari», tema që më kanë preokupuar përgjatë jetës sime dhe akoma më preokupojnë.»

Nadire Rexhepi, MAK

«Me interes për t'u thelluar e gjej aspektin e të «ardhmes». Si do të jetë në të ardhmen orientimi midis «kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës»? A do të ndyshojë kjo nëpërmjet ndikimit të rrymave aktuale të emigrimit? Si do të dukeshin ndihmat adeguate për një orientim midis gjuhës së parë, të dytë dhe ndërkulturës?»

Miriam Aegerter-Jossen, CH ch

«Bashkëpunimi në një rrjet në të cilin marrin pjesë mbi njëzet e pesë ekspertë të fushave të ndryshme të kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës nga Kosova, Zvicra, Maqedonia dhe Shqipëria është një mundësi e rrallë që bashkërisht të punohet në mënyrë tematike.»

Lulzim Dragidella, KOS

«Ajo që për mua është intriguese, është përkufizimi i kulturës si strukturë postmoderne. Secila kulturë, në esencë, është ndërkulturore. Themeluesi i komunikimit ndërkulturore Edward Hall, përkufizon: «Kultura është proces, që krijohet përmes kontaktit dhe lidhjes me tjetrin» (...).»

Afrim Rexhepi, MAK

«Pikërisht në këtë drejtim mund të bëhet një thellim në këtë fushë, pra çështja është se si të zbatohen konkretisht në punën me të rinjtë e të rejtat këto norma të demokracisë dhe se si të trajtohet tema e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash.. Në fushën e mësimin plotësues në Zvicër, nxënësit shqiptarë mund të përfitojnë shumë nga një trajtim i drejtpërdrejtë në mësimin plotësues të këtyre temave (...).»

Nexhat Maloku, CH alb

«Mendoj se aspektet që mund dhe duhet thelluar janë anët praktike që ka sjellë projekti. Prezantimi i modeleve të suksesshme, është mënyra më e mirë për të kuptuar dhe rritur besimin në vlerat e demokracisë, të tolerancës, diversitetit, si pasuri personale dhe shoqërore, por dhe si mënyrë e të menduarit dhe të jetuarit.»

Arbër Salihu, KOS

Pyetja 2

Cfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe realizimit të konferencave, dhe çfarë dhe si mund të përmirësohet?

Me këtë pyetje është prekur qëllimi i përmendur në kapitullin 3, shumëllojshmëria metodike dhe rrugët me shumëperspektiva gjatë organizimit të konferencave të veçanta. Përgjigjet përkatëse janë komentuar tashmë në kapitullin 5.3 dhe u referuan në mënyrë fragmentare. Ne kufizohemi më pas në disa pak prononcime shtesë për pjesën e parë të kësaj pyetje në vazhdim. (Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe të realizimit të konferencave?) dhe në disa propozime për përmirësimin (Pjesa e dytë e pyetjes: Cfarë mund të përmirësohet dhe si?). Propozimet për përmirësim referohen, siç është parashtruar në kapitullin 5.3, ndër të tjera në më shumë kohë për diskutime që duhen thelluar (p.sh. për konceptin e kulturës, shih më sipër në pyetjen 1), në heqjen në përgjithësi të gjërave të panevojshme të programeve shumë të ngarkuara, në një ritëm më të lartë të konferencës dhe në dëshirën për publikime shkencore në hapsirën e rrjetit. Parimisht nuk ndihet një pakënaqësi askund, më shumë u bëhet e qartë të gjithë pjesëmarrësve që kuadri i ngushtë kohor duhet të çojë në mënyrë të pashmangshme në të tilla ngushtica dhe që në të kundërt, për arsye të mundësive personale dhe finaciare, zor se do të mund të ishte e bëshme, për të përcaktuar p.sh. konferencën në pesë ditë.

«Shkëlqyeshëm m'u duk lidhja e ballafaqimeve teorike dhe pjesëmarrëse me temat e konferencës dhe, siç është përmendur më sipër, zhvendosja nga konferenca në konferencë. Kjo qasje shumëdimensionale e përjetuar me objektet që qëndrojnë në fokus, përveç kësaj ka lejuar për të bërë përvoja të përbashkëta si grupe, për të ndarë përshtypje, për të shfaqur interpretime të ndryshme respektive dhe kështu për t'i bërë ato të diskutueshme.»

Shpresa Jashari, CH alb

«Konferencat e NEZI-t në vende të ndryshme i përjetova shumë pozitive në pikëpamjen organizative dhe metodike. Veçanërisht mirë m'u duk paleti i gjerë metodik: Referatet input, grupet e punës, diskutimet në plenum etj. Veçanërisht edukative, m'u dukën vizitat në shkolla.»

Naxhi Selimi, CH alb

«Për nga aspekti i metodologjisë së punës, kisha mundësi të njihesha së afërmi me mënyrën zvicerane të punës e cila dallon ndjeshëm nga ajo ballkanike, në veçanti në aspektin e menaxhimit të kohës dhe ai organizativ. Gjithashtu praktikën e mirë që kisha mundësi ta shoh gjatë punës në klasë në Shkup me nxënësit shqiptarë nga eksperti zviceran për mua la mbresa të jashtzakonshme dhe ishte e mirëpritur edhe nga punonjësit e arsimit të shkollës fillore që e kishim si pilot.»

Jonuz Abdullai, MAK

«Cfarë ndoshta do të mund të përmirësohej: Diskutime të thelluara dhe të orientuara drejt përfundimit të pyetjeve qendrore.»

Brigit Allenbach, CH ch

«Sugjerimi im ndoshta mund të ishte vetëm për hapësirën kohore të dedikuar për konferenca. Për mendimin tim boshti i funksionimit të rrjetit ka qenë kontakti i drejtpërdrejtë i anëtarëve të tij. Takimet në mes të pjesëmarrësve, njohja me njëri-tjetrin, shkëmbimet e drejtpërdrejtë të ideve dhe përvojave nuk mund të zëvendësohen nga ndërveprimet virtuale. (...) Dy ditë kohë, sa kanë qenë të parapara për një, mendoj se nuk janë të mjaftueshme (...)»

Arbër Salihu, KOS

«Do ta kisha vlerësuar n.q.s në programin zyrtar do të ishte lënë më shumë hapësirë edhe për diskutime të kundërta. Kështu për shembull nuk mund të ndiqej mjaftueshëm diskutimi për konceptin e kulturës që përbënte thelbin e projektit dhe që në takimin e parë na shtensionoi.»

Kai Felkendorff, CH ch

«Pas vizitave të tilla në shkolla pyetsja veten çdo herë nëse kjo mund ta lehtësonte më mirë programin e ngjeshur të konferencës, për të pasur më shumë kohë për shkëmbim me specialistët nga praktika.»

Naxhi Selimi, CH alb

«Pyetjet gjatë takimit ndoshta mund të formuloheshin më precize dhe të fokusuara më fort. Do të ishte e dëshirueshme, që në kuadrin e takimit të rrjetit të mund të fillonin edhe publikime shkencore dhe projekte hulumtimi.»

Andrea Haenni Hoti, CH ch

Pyetja 3

Çfarë tjetër përfitova nga bashkëpunimi në NEZI dhe çfarë më mungoi?

Kjo pyetje e bërë me qëllim shumë hapur ofron pothuaj përmbylltas (para pyetjeve 4 dhe 5 referuar një vazhdimi të projektit) edhe një herë hapsirë për thënie të lira për projektin dhe dëshirave të mbetura hapur në ambjentin e tij. Edhe kjo pyetje është dypjesësh. Përgjigjet për pjesën e parë (Çfarë tjetër përfitova nga bashkëpunimi në NEZI) janë pjesërisht redundant me ato të pyetjes 1 apo theksojnë aspekte plotësuese positive të bashkëpunimit në rrjet. Përmenden pak a shumë vlera e kontakteve të reja (të cilat pjesërisht u përdorën tashmë për një shkëmbim), shtysat në këndvështrimin përmbajtësor apo të lidhura me profesionin apo rëndësia e diskutimeve të shumëanshme dhe interesante, të cilat u shfaqën edhe gjatë kohës së lire në mënyrë spontane dhe të gjalla. Për pikat, të cilat u munguan pjesëmarrësve, llogariten mundësitë për thellimin tematik të përmendura tashmë në pyetjen 1 si edhe hapsira pothuaj e munguar për përgatitje intensive apo për projekte të vogla hulumtimi në kuadrin e rrjetit (të tilla janë parashikuar sigurisht për fazën e thellimit 2016).

Për të ardhur keq është që tek pjesëmarrësit nuk kishte asnjë pjesëtarë të pakicave dhe të mbartësve të vendimeve politike, më tej jepen disa impulse tematike.

«Falë bashkëpunimit në NEZI arrita të ndërtoja një rrjet personal specialistësh dhe të krijoja edhe lidhje të qëndrueshme. Veçanërisht kontakti me personat e diasporës shqipfolëse në Zvicër ishte me mjaft interes për mua. (...) Takimet dhe përjetimet autentike në vendet e ndryshme, këtu duhen përmendur veçanërisht vizitat shkollore që u organizuan për ne, për mendimin tim përbënin pikën kulmore të projektit.»

Miriam Aegerter-Jossen, CH ch

«NEZI ofroi mundësinë për të ndarë me të tjerët përvoja dhe ide. Personalisht, më ka ndihmuar për t'u dhënë përgjigje disa prej hamendësimeve të mia në lidhje me çështje të caktuara të fushës së kulturës, të arsimit, të politikave etj.»

Astrit Dautaj, ALB

«Gjatë këtij projekti kam njohur shumë ekspertë të fushave të ndryshme, si dhe kam forcuar bashkëpunimin me disa prej tyre. Bashkëpunimi me Prof. Rolf Gollob në këtë projekt më ka ndihmuar që ne së bashku me dy trajnerë të tjerë të organizojmë për herë të parë në Kosovë Akademinë për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut. (...)

Gjatë Konferencës kam njohur edhe ekspertë të tjerë, disa prej të cilëve kam arritur t'i angazhoj si trajnerë në udhëheqjen e seminareve të ndryshme.»

Melinda Mula, KOS

«Rrjeti NEZI më ka ofruar një formësim të qëndrueshëm të profilit teoriko-shkencor të avancuar dhe një performancë cilësore pragmatike, origjinale të avancuar që ka qasje të formësuar mbi trendet dhe zhvillimet në vend dhe Rajon.»

Myqereme Rusi, MAK

«Më erdhi keq që tek pjesëmarrësit e përhershëm nuk ishin të përfaqësuar pakicat e Maqedonisë, Kosovës dhe Shqipërisë. Ekzistojnë pa dyshim persona shqipfolës të kualifikuar të këtyre grupeve.»

Shpresa Jashari, CH alb

«Ajo që më ka munguar është mundësia për të parë nëse bëhet fjalë për një aplikim apo rrezatim konkret nga pjesëmarrësit në vendet dhe institucionet ku punojnë. Më ka munguar edhe pjesëmarrja e vendimmarrësve politikë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia, të paktën në hapje apo në mbyllje të takimeve.»

Driton Kajtazi, CH alb

«Mendoj se konferencat do të ishin edhe më të suksesshme nëse do të kishin marrë pjesë edhe njerëzit të cilët janë në sferat e pushtetit në vendet përkatëse e që kanë të bëjnë me këto tema.»

Nexhat Maloku, CH alb

«Diskursi rreth lidhjes së përfytyrimeve mbi demokracinë dhe emigrimin u zhvillua shumë shkurt. Ky diskurs nuk është zhvilluar ende. Ai është shumë specifik e politik dhe kërkon njohuri bazë teorike politike paraprake, që i kapërcejnë qasjet pedagogjike apo psikologjike.»

Rolf Gollob, CH ch

«Përbërja disi heterogjene e profesioneve të pjesëmarrësve, (...) solli shumë përparësi dhe mjaft diskutime tërheqëse shumëperspektivëshe. Për thellimin dhe fokusimin e aspekteve të caktuara do të kishte qenë ndoshta më mirë një përbërje më homogjene e grupit, pasi në këtë mënyrë mund të niseshe në mënyrë më efikase nga parakushte të ngjashme e respektivisht të bazoheshe në to.»

Basil Schader, CH ch

«Bashkëpunimi më mundësoi kontakte me njerëz shumë simpatikë dhe interesantë. Ajo që më mungoi ishte, nga njëra anë vijimi i kundërshtive interesante të prekura në projekt dhe, nga ana tjetër një diskutim më i detajuar lidhur me çështjen se si duhet organizuar një bashkëpunim ndërkombëtar ballë për ballë gjatë zhvillimit të mëtejshëm konceptual të edukimit për demokraci.»

Kai Felkendorff, CH ch

«Duhet tematizuar më tepër fakti se Evropa Juglindore dhe veçanërisht shtetet që dolën nga Jugosllavia sjellin shumë përvoja dhe Know-how me vete. Do të doja të mësoja më shumë rreth mënyrës se si shfaqet përgjithësisht kompetenca e ndryshimit në sistemin arsimor. (...) Veçanërisht lidhur me temën e «demokracisë» ekziston pak rreziku se kushtet zvicerane idealizohen. Kjo është e disfavorshme për shkak se siç del dukshëm edhe nga bashkëpunimi për zhvillim, modeli zviceran ka një histori të gjatë dhe ky proces historik nuk mund të eksportohet si një mall i çfarëdoshëm. Nga ana tjetër, në diskutimin krahasues harrohen shpesh deficitet e demokracisë zvicerane, pikërisht përjashtimi i popullsisë së huaj nga sistemi politik, në rastin e Zvicrës, ata përbëjnë gati çerekun e popullsisë rezidente.»

Brigit Allenbach, CH ch

«Mendoj se do të ishte më mirë nëse distanca kohore e konferencave të ishte më e shkurtër, ndoshta 3–4 muaj. Gjithashtu mendoj se më shume kohë ditore në dispozicion do të ishte më e nevojshme përballë programit të ngjeshur me plot intensitet apo përballë diskutimeve të shumta me një larmi aspekteve dhe përvojash nga 4 shtete.»

Admir Kraja, ALB

Pyetja 4

Nëse NEZI do të vazhdonte: Cilat do të ishin dëshirat e mia lidhur me drejtimin e këtij vazhdimi?

Pyetjet 1 deri në 3 janë me karakter më tepër retrospektiv-vlerësues, ndërsa pyetja 4 dhe 5 kanë të bëjnë me një vazhdim të mundshëm apo përpunim të mëtejshëm të tematikave të trajtuara tek NEZI. Kjo mund të marrë një përgjigje të përgjithshme ose duke iu referuar konkretisht periudhës dhjetor 2015 deri në dhjetor 2016 që është parashikuar në mënyrë eksplicite për projekte më të vogla vijuese. Në pyetjen 4 pjesëmarrësve u kërkohet të shprehen lidhur me drejtimin primar të punës së mëtejshme në një formë që për ta është e logjikshme, në pyetjen 5 pjesëmarrësve u kërkohen propozime dhe përsiatje lidhur me angazhimin e tyre të mundshëm. Përgjigjet e pyetjes 4 mund të klasifikohen në vija të përgjithshme në 3 grupe: i pari dhe më i madhi ka të bëjë me vazhdimin e punës nga pikëpamja organizative dhe tematike. Në mënyrë të shumëfishtë nxitet vazhdimi i punës në grupe më të vogla të fokusuara tematikisht sidomos nga 2 grupet nga Zvicra (krahaso më poshtë 7 prononcimet e para). Një grup tjetër përgjigjesh nxit për fokuse tematike që mund të përqëndroheshin (trajnimi i mësuesve, EDC, pedagogjia e diversitetit etj.). Disa përgjigje të tjera shprehen sidomos lidhur me aspektet organizative: Përfshirja e vendim-marrësve politik dhe OJQ-ve në rrjet, kohëzgjatje më e madhe e konferencave etj.).

Përgjigjet e pyetjes 4 do t'i pasqyrojmë veçanërisht me detaje pasi këtu dhe në pyetjen 5 gjenden dëshira dhe impulse që mund të shërbejnë si pika qendrore reference si për vazhdimin e NEZI-t ashtu edhe për konceptimin e rrjeteve të ngjashmes.

«Sipas pikëpamjes sime, vazhdimi i NEZI-t do të ishte mjaft interesant dhe i dëshirueshëm. (...) Në një hap të dytë mendoj se është edukative formimi i grupeve të vogla me përfaqësues nga shtete të ndryshme, të cilët së bashku do të përpunojnë tema konkrete, do të planifikojnë, realizojnë dhe vlerësojnë projekte. Me interes do më dukej gjithashtu edhe tematizimi i mënyrës së kuptimit të pedagogjisë së ndryshimit dhe përfshirjes së partnerëve të rrjetit në shtetet e ndryshme. (...) Një temë tjetër që mund të thellohet është roli i mësimdhënësve lidhur me orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës.»

Miriam Aegerter-Jossen, CH ch

«Nga pikëpamja organizative, më duket me vend formimi i grupeve më të vogla të punës që do të punojnë në mënyrë të thelluar për temat specifike që janë ende për t'u përkufizuar. Njëri nga dy takimet vjetore mund t'u kushtohet këtyre takimeve të grupeve të punës. Më pas tek takimet e përbashkëta të projektit mund të prezantohen e diskutohen rezultatet e grupeve të punës. (...) Unë personalisht do të dëshiroja pikë së pari një thellim të temave «Përfshirja/përfjashtimi», «Të Drejtat e Njeriut» dhe «Të drejtat e minoriteteve», por jam i hapur dhe për tema të tjera.»

Kai Felkendorff, CH ch

«Duhet formuar grupe të cilat do të përqendrohen në mënyrë më të fokusuar tek temat e veçanta (...). Do të ishte e dëshirueshme përfshirja më intensive e minoriteteve, veçanërisht në Kosovë dhe Maqedoni, në mënyrë që të përmbushet objektivi i projektit. Gjithashtu është e domosdoshme edhe përfshirja më intensive e komuniteteve të gjuhës shqipe dhe e «Secondo-ve» në Zvicër.»

Shqipe Bajrami, CH alb

«Me shpresë se rrjeti NEZI do të ketë vazhdimësi dhe qëndrueshmëri, (...) mendoj se në të ardhmen e afërt do të ishte e arsyeshme të formohen grupe pune në tematikat në vijim: Identiteti dhe ndërkultura / Marrëdhëniet ndërinstitucionale/ndërshtetërore / Raportet fëmijë, prind, shkollë, besimi dhe ndikimi i tij në raportet ndërkulturore / (...).»

Rifat Haxhijaj, CH alb

«Së pari, unë do të dëshiroja që NEZI të institucionalizohej si një "rrjet që jeton", me një mision të përcaktuar qartë dhe me një strukturë organizative (...). Së dyti, do të ishte e dobishme që të përcaktoheshin fushat e veprimtarisë që mund të ishin: Kërkimi, trajnimi, konsulenca, promovimi i praktikave më të mira, publikimi i materialeve burimore. (...) Së treti, përcaktimi i një axhende afatshkurtër dhe afatmesme të veprimtarisë së NEZI-t (...).»

Nikoleta Mita, ALB

«Do të sugjeroja që diskursin shkencor brenda rrjetit mbi kulturën e parë, të dytë dhe ndërkulturën, diskurs ky që i ka rrënjët tek tradita e formimit ndërkulturore, të zgjerohej më tej në drejtimin e pedagogjisë së diversitetit dhe pedagogjisë së gjithëpërfshirjes dhe në këtë mënyrë, të trajtohen qasje teorike aktuale dhe çështje të politikave arsimore.»

Andrea Haenni Hoti, CH ch

«Besoj se duhet menduar sërish nëse takimet duhet të zgjasin më tepër dhe nëse duhen tematizuar më shumë tema konkrete. Gjithashtu mund të mendohet se si të përfshihen në projekt studentë nga shkollat e larta pedagogjike nga Zvicra dhe shtetet e tjera. Lidhur me drejtimin, mendoj se duhet investuar për kualifikimin e mëtijshëm të mësuesve dhe kjo iniciativë të mbështetet konkretisht në Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë nëpërmjet formimit të një rrjeti.»

Ylfete Fanaj, CH alb

«Krahas (...) përfshirjes së grupeve të tjera minoritare, fokusit të intensifikuar tek elementet e strukturës në vend të kulturës si dhe trajtimit të thelluar të konceptit të kulturës si të tillë, për një projekt vijues do të ishte interesant një drejtim me orientim praktik. Ky do të mund të konsistonte në një përfshirje me të gjerë të institucioneve arsimore, respektivisht të nxënësve (...).»

Shpresa Jashari, CH alb

«Unë do të kisha dëshiruar që përveç temave të shumëllojshme duhet t'i përkushtohemi më shumë temës së integritetit dhe riintegritetit dhe t'i qasemi më seriozisht ngaqë riintegrimi është po aq i vështirë si edhe integrimi. (...).»

Shukrije Ramadani, CH alb

«Do të dëshiroja që ky rrjet ta vazhdonte bashkëpunimin për ta shtrirë më tej shkëmbimin e përvojave në kushtet që problemet e emigrimit të shqiptarëve në Evropë kanë marrë përsëri një vëmendje të vëçantë për shkak të rritjes së emigrimit masiv të familjeve nga trojet e Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë. Vazhdimi i shkëmbimit të përvojave në politikën arsimore, mua më është dukur mjaft me interes, përderisa arsimit, gjuhës, kultura janë treguesit kryesorë të identitetit kulturor.»

Merita Xhumari, ALB

«Për vazhdimësinë e projektit NEZI do të propozoja nevojën për përpilimin e një kurrikule mësimore ose madje edhe programi studimor në nivel universitar mbi diasporën shqiptare, duke marrë për bazë analize dhe studimi, jetën e diasporës shqiptare në Zvicër dhe zhvillimin progresiv të këtij komuniteti kulturor e ekonomik atje.»

Adelina Marku, MAK

«Konferencat të jenë së paku dy ditë punë dhe të rishikohet madhësia e grupit.»

Lulzim Dragidella, KOS

«Unë si dëshirë do të prek vetëm një mundësi që rrjeti NEZI të bëjë organizimin e mësuesve shqiptarë që kanë kryer studimet në Zvicër, të vinë në vendet e tyre të prejardhjes dhe të zhvillojnë disa orë mësimore me qëllim të shpërndarjes së përvojave të tyre dhe në këtë mënyrë të kontribuohet në vendet e tyre të prejardhjes.»

Nadire Rexhepi, MAK

«Në rast të një vazhdimësie për mua do të ishte me rëndësi që krahas ekspertëve të marrin pjesë edhe figura politike të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me zbatimin e normave demokratike në sferat e pushtetit e, të cilët kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në «kulturën e demokracisë».»

Nexhat Maloku, CH alb

«Mendoj se zgjerimi i rrjetit NEZI duhet të përfshijë edhe sektorin e OJQ-ve, përkrahësit administrativë nga universitetet dhe Pushteti Vendor si dhe studiues të dalluar në lëmin e multikulturalizmit. Gjithashtu në kuadër të projektit (...) duhet të shihet edhe mundësia e organizimit të shkëmbimit të nxënësve dhe mësimdhënësve të përzier (të etniteteve dhe kulturave të ndryshme) duke vizituar institucionet arsimore, si dhe pranimi i tyre në familjet e vendit pritës.»

Jonuz Abdullahi, MAK

Pyetja 5

Nëse NEZI do të vazhdonte: Cilat janë propozimet e mia konkrete dhe cili do të ishte ndihmesa ime për këto projekte?

Pyetja 5 konkretizon pyetjen paraprake dhe grumbullon të dhëna mbi ndihmesat dhe angazhimet potenciale personale që mund të japin pjesëmarrësit. Përgjigjet mund të klasifikohen në vija të përgjithshme në grupet e mëposhtme: a) Përgjigje që emërtojnë një apo disa tema konkrete si dhe gatishmërinë për t'u përfshirë në përpunimin e tyre (përmenden p.sh. EDC/HRE, integrimi); b) Përgjigje që nxisin një temë të caktuar (p.sh. trajtimi i diversitetit, ndërkulturës në kualifikimin e mësuesve), por pa përmendur mundësitë e angazhimit personal; c) Propozime në kontekstin e shkëmbimit në nivelin e hulumtuesve, studiuesve dhe nxënësve dhe d) Ide lidhur me aspektet organizative. Sikurse edhe tek pyetja 4 do të japim edhe këtu një përzgjedhje veçanërisht të gjerë përgjigjesh, pasi këtu mund të gjenden udhëzime me mjaft vlerë për punën e mëtejshme në NEZI sikurse edhe për konceptimin e rrjeteve të ngjashme.

«Një temë tjetër që mund të thellohet është roli i mësimdhënësve lidhur me orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës. Për shkak se profesionin e mësimdhënies e zgjedhin shumë persona me përvoja personale emigracioni, edhe kjo përbën një temë me perspektivë. Aktualisht në institutin tonë po kryhet një studim lidhur me çështjet e përvojave biografike që lidhen me ndryshimin e përkatësinë si dhe trajtimin e këtyre përvojave tek personat që japin mësim e që kanë (ose jo) «sfond emigrant». Njohuritë e përftuara në këtë projekt mund t'i përçoj në të ardhmen në diskutime e projekte.»

Miriam Aegerter-Jossen, CH ch

«Do të më pëlqente të punoja në një grup pune për temën «Formimi i të Drejtave të Njeriut». Ndër të tjera më duket interesante dhe produktive analiza e planeve dhe materialeve mësimore, koncepteve ekzistuese dhe/ose leksioneve nën këndvështrimin e çështjeve që janë ende për t'u përcaktuar. Nëse do të ketë një vazhdim për temën «Përfshirja/Përjashtimi», atëherë do të isha e gatshme dhe e aftë të ofroja njohuritë e mia specifike mbi sociologjinë dhe pedagogjinë.»

Kai Felkendorff, CH ch

«Siç e përmenda, unë personalisht jam e interesuar për çështjet e kuptimit të demokracisë, sidomos në kontekstin shkollor. Do të më pëlqente që këtë temë ta trajtonim e zgjeronim më tej së bashku me anëtarët e interesuar të rrjetit. Në fokus të interesit mund të vendosej shkolla si nënsistem shoqëror (...).»

Rolf Gollob, CH ch

«Përvojën time profesionale për temën e emigrimit dhe riemigrimit do ta kisha ofruar me dëshirën më të madhe (...). Mirë do të ishte nëse do të formohej një grup pune me profile të ndryshme i cili do t'i përkushtohej kësaj teme dhe do të kisha ofruar edhe anketat e bëra me fëmijë dhe të rritur të cilat të mahnisin me emocionalitetin me të cilin i përshkruajnë ecejaket e veta nëpër shtete dhe kultura.»

Shukrije Ramadani, CH alb

«Në rast të vazhdimit të projektit, ndihmesa ime do ishte në sferën e integritetit të të huajve nga aspekti teorik dhe praktik, duke u bazuar në përvojën time disavjecare në punën me emigrantë dhe në integrimin e tyre në shoqërinë gjermane.»

Lulzim Dragidella, KOS

«Me kënaqësi do të kontribuoja në realizimin e ndonjë studimi të ndërmarrë nga projekti, i cili është në pajtim me kualifikimin dhe shkathtësitë e mia në fushën e EDC/HRE, si dhe të ndër- dhe multikulturalizimit.»

Melinda Mula, KOS

«Propozimi im konkret është të bëhet një hulumtim në të katër vendet e inkuadruara në projekt (...) dhe të shihet se cili është impakti i projekteve të deritanishme dhe cilat janë nevojat për zgjerimin e rrjetit dhe të hulumtimit të këtyre dukurive.(...) Për më tepër duhet parë se cilat shkathtësi u nevojiten pjesëtarëve të kulturës së parë, të dytë dhe ndër-kulturës për integrim e tyre sa më të sukseshëm në shoqërinë zvicerane. (...) Ndhimesën time në këtë projekt në të ardhmen do ta kisha ndarë në disa aspekte. Fillimisht do ta kisha prekur përvojën time profesionale në mësimdhënie dhe njohjen institucionale (...). Për më tepër përvoja ime në hartimin e programeve studimore dhe në akreditimin e tyre institucional besoj se do ta lehtësojë punën e ekipit profesional (...). Gjithashtu angazhimi im do të jetë i fokusuar edhe në gjetjen e përkrahjes institucionale për sigurimin e mjeteve financiare (...).»

Jonuz Abdullahi, MAK

«Çështjet e mëposhtme mund të përpunohen mbi bazën e prioritetit që kanë:

- Si trajtohet diversiteti në shtetet e ndryshme? Si trajtohet veçanërisht larmia kulturore? Si konceptohet kombi (anglisht: ethnic vs. civic) brenda shteteve të ndryshme dhe si e ndikon ky konceptim trajtimin e larmisë kulturore? Çfarë roli luan shkolla këtu?
- Si trajtohen azilkërkuesit në shtete të ndryshme ose çfarë politikash për azil ndjekin shtetet e ndryshme? Si reagon shkolla ndaj nevojave të fëmijëve të refugjatëve dhe familjeve të tyre apo si integrohen fëmijët e refugjatëve?»

Andrea Haenni Hoti, CH ch

«Pikërisht mësimi plotësues është një vend shumë i përshtatshëm për t'i trajtuar këto tema të cilat ishin pjesë e konferencave të deritanishme. Duke qenë në cilësinë e udhëheqësit të Lidhjes së Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë «N. Frashëri» në Zvicër, jam i gatshëm të kontribuoj në realizimin e një vazhdimësie të tillë.»

Nexhat Maloku, CH alb

«NEZI do të përbënte një bazë ideale për vazhdimin me një projekt pasues në sensin e një hulumtimi dhe publikimeve përkatëse të studimit. Për mua si përfaqësuese e shkencave sociale dhe linguistike do të ishte me interes të merrja pjesë në dizajnimin dhe zhvillimin e një projekti të tillë. Në kuptimin e propozimit të sipërpërmendur do të ishte me vend edhe zhvillimi i një projekti shkëmbimi për nxënësit lidhur me temat e rrjetit. Këtu mendoj se mund të bashkëorganizoj një Workshop.»

Shpresa Jashari, CH alb

«Së pari, do të dëshiroja të realizonim një studim rajonal mbi format e përdorura në vendet tona për të realizuar edukimin qytetar (...). Së dyti, të bëhej një vlerësim i teksteve të edukatës qytetare. (...) Së treti, të organizohen trajnime të mësueve të lëndëve të edukatës qytetare dhe unë mund të kontribuoj me përvojën si pedagogë në këtë drejtim.»

Merita Xhumari, ALB

«Duke e pasur parasysh faktin që arsimi shqip në Maqedoni, është në fazën tranzitive të saj, mendoj që projekte hulumtuese të tipit «Transferet dhe modelet e ndërkulturalizmit» apo «Kurrikula për arsim bilingual ndërkulturore», do të nxisnin progresin e koegzistencës pasive të kulturave.»

Afrim Rexhepi, MAK

«Studentë nga vendet pjesëmarrëse mund të marrin pjesë në një modul nën kujdestarinë e bashkëpunëtorëve që vijnë përkatësisht nga dy vende. Në shkollën pedagogjike të Zyrihut kjo mund të organizohet eventalisht në kuadrin e një projekti FE. (...) Shembuj:

- Studentët mund të hartojnë një sërë leksionesh për temën e edukimit për demokraci, nën këndvështrimin e vendeve të tyre të prejardhjes e respektivisht të lidhjeve të tyre ndërkombëtare.
- Studentët mund të kryejnë së bashku një studim të vogël në terren, p.sh. lidhur me temën «Shkolla dhe familja».

Brigit Allenbach, CH ch

«Të hartohet një platformë për institucionalizimin e rrjetit si një organizëm i cili bashkërendon veprimtarinë e profesionistëve që janë të interesuar dhe aktivë në çështje të interkulturalizmit dhe të edukimit qytetar në Zvicër, Kosovë, Maqedoni, Shqipëri. (...) Të ngrihen degët e rrjetit në vendet pjesëmarrëse. Të ngrihet një ekip menaxhimi me përfaqësues nga vendet pjesëmarrëse. Të hartohet axhenda afatshkurtër dhe afatmesme e veprimtarive. Aktivitetet tipike të rrjetit të jenë: Konferenca periodike (...) Trajnime (...) Workshope (...) Promovime të përvojave dhe praktikave më të mira. Konsulenca për qeveritë.(...)»

Nikoleta Mita, ALB

«Me interes do të ishte studimi më specifik i aspekteve të riintegritit të shqiptarëve në atdheun e tyre. Qasja e tyre në jetën shoqërore dhe në sistemin e normave, i cili në shoqëritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor po pëson ndryshime të shpejta për shkak të orientimit drejt familjes evropiane.»

Admir Kraja, ALB

«Trajnimi i mësuesve për edukimin ndërkulturor, me fokus të veçantë, te marrëdhëniet ndërmjet kulturës së parë dhe të dytë.»

Astrit Dautaj, ALB

«Do të ishte me rëndësi të krijohet një Website i veçantë në të cilën ekspertët e «Rrjetit», por edhe profesionistë të tjerë, të mund të publikojnë punimet e tyre, të debatojnë, të jenë një urë lidhëse me publikun e para së gjithash, me njerëzit e fushës arsimore. Kjo faqe e veçantë do të ishte me rëndësi të jetë si shtesë në Website-t zyrtare të ministrive të arsimit të Kosovës, Maqedonisë e Shqipërisë.»

Nexhat Maloku, CH alb

«Unë mendoj që do ishte fitimprurëse nëse organizohen p.sh. javë të këmbimit të nxënësve të cilët jetojnë në Zvicër të kenë mundësinë të ndjekin mësimë disaditore ose javore në vendet e tyre të lindjes.(...) Një tjetër pikë bashkëpunimi do ishte ripërpilimi i planit mësimor kornizë për gjuhën dhe kulturën e atdheut si dhe rishqyrtimi i teksteve shkollore. (...) Për sa i përket temës së dytë «edukimi për qytetari demokratike», mendoj se do të ishte shumë fitimprurëse sidomos këtu në Maqedoni ku kemi një shtet multietnik dhe ku marrëdhëniet ndëretnike janë të përkeqësuar, nëse organizohen orë të përziera që nënkupton bashkimin e nxënësve të etnive të ndryshme në një orë të përbashkët, p.sh. orën e edukatës fizike ta mbajnë së bashku, që ato të kenë rastin e njohjes dhe të bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe njëkohësisht do të mësohen të pranojnë dhe të duan të tjerët që kanë kulturë dhe gjuhë të ndryshme nga ata.»

Nadire Rexhepi, MAK

5.5 Një vështrim mbi përgjigjet për tri pyetjet në artikujt e grupeve

Në konferencën e pestë dhe të fundit (Tiranë, 5–7 nëntor 2015) pjesëmarrësit morën si detyrë në grupet e vendeve të tyre (CH ch, CH alb, ALB, KOS, MAK) të përpilojnë një tekst prej rreth 3 faqesh për pyetjet e mëposhtme:

- Cilat prej aspekteve të punës së NEZI-t ishin veçanërisht për grupin tonë, vendit tonë, produktive dhe relevante?
- Çfarë mund/duhej thelluar apo zgjeruar?
- Si mund të ndodhte kjo konkretisht? (2–3 ide)

Si afat dorëzimi i këtyre teksteve të grupeve ishte dhënë 30 nëntori 2015. Pjesëmarrësit morën një fletë me pyetjet me shkrim dhe rekomandimet për procedurën si edhe një orë kohë për ta diskutuar në grupe gjatë konferencës (më me saktësi: mëngjesin e të shtunës nga ora 09.00–10.00) si edhe të planifikonin ndarjen e punës. Siç u ra dakort, të pestë grupet e referimit u takuan në fillim të dhjetorit.

Ndryshe nga tekstet individuale (shih kapitullin 5.4 dhe pjesën II), fokusi ishte në tekstet e grupeve jo në aspektin e përdorimit personal dhe në dëshirat personale në lidhje me NEZI-n. Ishte kërkuar më shumë një refleksion në fushat e larta të vendeve të veçanta (apo nga perspektiva sipas prejardhjes të perspektivave të ndryshme të grupit zviceran, respektivisht pa origjinë shqiptare). Ngjeshja, abstraksioni dhe transpozicioni i rrafshit individual për secilin grup çoi dukshëm në diskutime tërheqëse dhe produktive. Prononcimet që rezultojnë nga kjo janë si për një punë në vijim në NEZ, edhe për rrjete të ngjashme me plot vlerë dhe me rëndësi.

Si në kapitullin 5.3 dhe 5.4 për secilën prej tri pyetjeve hartohet një përzgjedhje e prononcimeve pregnante. Tekstet e integruara të të pesë grupeve gjenden në fund në pjesën III.

Pyetja 1

Cilat prej aspekteve të punës në NEZI ishin për grupin, vendin tonë veçanërisht produktive dhe relevante?

Një pjesë e përgjigjeve për këto pyetje prek aspekte, të cilat tashmë u theksuan si pozitive në raportet individuale (shih sipër kapitullin 5.4, pyetjet 1–3). Këtu bëhet fjalë shpesh për më shumë pika të rëndësishme, jo të veçanta për vende dhe grupe, kështu pak a shumë:

- Shumëllojshmëria e perspektivave, të cilat u lidhën me sfondet e ndryshme të pjesëmarrësve.
- Zgjatja prej shumë vitesh e rrejtit, i cili përkrahu edhe ngritjen e kontakteve të qëndrueshme.
- Zgjedhja e arritur e fokuseve tematike.
- Kontaktet e shumëanshme autentike me ekspertët, të prekurit, përfaqësuesit e sistemeve të ndryshme shkollore etj.
- Vështrimet në sistemet e ndryshme shkollore dhe problemet e tyre.
- Rasti për t'u marrë me njohuritë dhe zhvillimet në Ballkan dhe në Zvicër, përsa i përket rritjes brenda dhe midis dy kulturave, përkrahjen e gjuhës së parë dhe edukimin demokratik.
- Mundësinë për t'u menduar i thelluar mbi marrëdhëniet brenda shqiptarëve.

- Shqyrtimet e thelluara për çështjet e sjelljes me edukimin demokratik dhe qytetar dhe me diversity management në shkollat multietnike.
- Vlera e kohës së «paplanifikuar» për njohjen reciproke dhe ngritjen e kontakteve.

Në një sërë pyetjesh të tjera futen aspekte, të cilat ishin veçanërisht me rëndësi nga perspektiva e grupeve të vendeve të veçanta, që respektivisht lidhen me fitimin e njohurive të veçanta për grupin përkatës.

- Veçanërisht theksohen nga të dy grupet zvicerane (CH ch und CH alb) kontraditat me mësimim shqip të gjuhës së prejardhjes në Zvicër (HSU) dhe vizitat përkatëse të shkollave dhe bisedat në maj 2015. Tema e MGJP-së është në të vërtetë me një aktualitet të lartë në sistemin arsimor zviceran, i cili në kuadrin e shikimeve të fituara në kuadrin e NEZI-t i përgjigjen një nevojë të gjallë për informacion para së gjithash grupit të CH ch. Grupi CH alb, theksoi, përveç kësaj, gjendjen e keqe se rëndësia e MGJP-së është e pakundërshtueshme për suksesin e shkollës, por që nga ana e sistemeve të arsimit zviceran zor se bëhet diçka për të forcuar pozicionin e MGJP-së dhe integrimin e saj në sistemet shkollore.
- Aspekti arsimimi demokratik (EDC) theksohet nga grupet e ndryshme si i rëndësishëm, kështu veçanërisht nga grupet e Shqipërisë dhe të Maqedonisë, si edhe nga grupi CH alb.
- Grupi i Maqedonisë para së gjithash thekson këtu përfitimin e njohurive, të cilat lidhen me njohjen e koncepteve (të konsideruara si shembull) zvicerane, të EDC-së, të Evropës Perëndimore.
- Grupi nga Shqipëria thekson rëndësinë e aspekteve të ndërkulturalitetit, sjelljen me ndërkulturalitetin dhe përfaqësimin e kësaj teme në planet mësimore. Kjo temë deri tashmë nuk është perceptuar në mënyrë adekuate në Shqipëri si një vend etnik më shumë heterogjen dhe nuk është përfshirë në planet mësimore.
- Në mënyrë të veçantë mbi vlerën e krahasimeve midis sistemeve arsimore të Kosovës, Maqedonisë dhe Shqipërisë, përta i përket sjelljes me heterogjenitetin dhe diversitetin dhe problemet e lidhura me këtë, i ngre grupi i Kosovës. Me këto krahasime lidhen mundësitë për të reflektuar dhe përsosur praktikën vetjake.

Lidhur me shtrirjen e kapshme të referimeve origjinale në pjesën e III kufizohemi në ridhënien e disa pasazheve qendrore.

«Vizita në mësimin shqip të MGJP-së nga pikëpamja jonë paraqiste një Highlight dhe me këtë krijonte një element lidhës, meqënëse të gjithë pjesëmarrësit nga Zvicra tashmë, në një formë apo në një tjetër, qenë marrë me këtë tematikë (...). Tema mësimi i MGJP-së ka gjetur vend në arsimimin dhe kualifikimin e personelit mësimdhënës. Në certifikatat e viteve studimore gjermanishtja si gjuhë e dytë dhe ndërkulturaliteti (CAS DAZIK), e cila ofrohet nga Shkolla e Lartë Pedagogjike Zug në bashkëpunim me Shkollën e Lartë Pedagogjike Luzern, munda të ngulitej tashmë tematika e MGJP-së në përshkrimin aktual. (...)»

Grupi Ch ch

«Temat e trajtuara nga ekipi zviceran kanë ndihmuar për të pasur një pasqyrë më të qartë të zhvillimeve në fushën e ndërkulturës. Veçanërisht çështja e mësimi në gjuhën e pre-jardhjes ishte me interes të dyanshëm dhe, idetë e shkëmbyera për këtë fushë, ishin të rëndësishme për rrjetin në përgjithësi. (...) Është konstatuar shkencërisht se njohuritë e përfituara gjatë këtyre orëve të vijua në gjuhën e tyre të prejardhjes i ndihmojnë fëmijët dhe të rinjtë edhe në mësimin e rregullt, pastaj në kontaktet me farefisën në vendlindje dhe më vonë edhe në fushën e profesionit. (...) Megjithatë, pozitat reale të mësimi plotësues në shkolla nuk zhvillohen aq shpejt, fjala vjen, ashtu siç ndodh me retorikat përkrahëse të përfaqësuesve të arsimit zviceran. Mësimi plotësues nuk ka arritur ende të përfshihet në orarin e mësimi të rregullt në shkollën fillore.»

Grupi Ch alb

«Veprimtaria e rrjetit na ka hapur një dritare të re të shikimit të problemeve që lidhen me kulturën në Shqipëri, me kulturën e emigrantëve, të të riatdhesuarve pasi kanë jetuar për një kohë të gjatë në një vend evropian, na ka ndihmuar t'u japin përgjigje disa prej pyetjeve që lidhen me edukimin ndërkulturor, integrimin, gjithëpërfshirjen, edukimin qytetar, na ka ndihmuar të reflektojmë për programet e përgatitjes dhe kualifikimit të mësuesve dhe për programet në ndihmë të nxënësve të riatdhesuar. Një reflektim tjetër i yni lidhet me përdorimin e qasjes ndërkulturore në programet e mësuesisë. Meqënëse Shqipëria nuk është një vend shumë divers nga përbërja etnike, edukimit ndërkulturor nuk i është kushtuar vëmendje dhe ai nuk është mjaftueshëm i pranishëm në kurrikula.»

Grupi ALB

«Një përjetim i mirë akademik ishte edhe të mësuarit për konceptin e demokracisë qytetare në një shkollë multietnike, organizimi i një mësimdhënësi zviceran për të gjetur «dheun e përbashkët» (common ground) për kategoritë e ndryshme të nxënësve, studentëve që vijnë me sfond të ndryshëm nga vendi i prejardhjes së tyre apo të prindërve të tyre, duke filluar nga Afrika, Ballkani, Azia etj. Element i rëndësishëm që duhet shënuar, është edhe vetëdija dhe përgjegjësia për t'u mobilizuar në drejtim të përgatitjes së kuadrove të hapura ndaj shumëkulturësisë e cila është përbërës i pandashëm i epokës së globalizimit, kur duhet të aplikohet ajo që quhet menaxhimi i diversiteteve (diversity management), kur të gjithë duhet të veprojmë në drejtim të jetësimit të demokracisë së gjallë (living democracy). Në këtë drejtim përvoja zvicerane është shumë e rëndësishme sepse bëhet fjalë për një vend model i demokracisë së drejtpërdrejtë, kur qytetari dhe kërkesat e tij janë në epiqendër të zhvillimeve sociale, ku identitetet shumështrësore janë pjesë integrale e shoqëri-ndërtimit.»

Grupi MAK

«Në rrafshin kurrikular krahasimtar ndërmjet njësive gjeografike dhe sistemeve shkollore po ashtu diverse shqiptare (3 modelet e shteteve ku jetojnë shqiptarët) dhe Zvicrës, rrjeti bëri të ditura vështirësitë me të cilat përballen shkollat e sistemet arsimore në këtë hapësirë, sfidat evidente dhe vullnetin (Kosovë e Shqipëri) apo mungesën e vullnetit të mjaftueshëm (Maqedoni) për kapërcimin e tyre. Projekti NEZI, duke prezantuar përvojat e shkollave zvicerane, do të ndihmojë më shumë në kapjen e funksionimit praktik të shembullit të shkollës demokratike. (...)»

Grupi KOS

Pyetja 2

Çfarë mund/duhej të thellohej apo ngrihej?

Edhe këtu trajtohen pika të ndryshme, të cilat gjenden në raportet individuale (shih sipër kapitullin 5.4). Këtu futen edhe shtysat e mëposhtme:

- Marrje e thelluar me pozicionet aktuale shkencore (debatet për ndërkombëtarizimin, koncepte dhe emërtime të kulturës, multikulturës dhe të ndërkulturës).
- Marrje e thelluar me modelet konkrete dhe shembujt nga praktika (në mënyrën e vizitave në shkolla dhe kontakteve autentike).
- Informacion dhe shkëmbim i modeleve të dala nga praktika.
- Vështrime të thelluara në realizimin e postulateve të edukimit demokratik/EDC.
- Thellimi i dijes mbi vendet e veçanta të prejardhjes.

Disa prej këtyre kërkesave u konkretizuan, përveç kësaj u formuluan kërkesa të reja:

- Dëshirë e dedikuar sipas statusit më të lartë të kompetencës ndërkulturore si element i formimit shkollor dhe i mësuesve.
- Angazhim më i lartë dhe orientim i ri i politikës së arsimit zvicerian në lidhje me kërkesat ndërkulturore si p.sh. integrimi i MGJP-së respektivisht realizimi i vonuar i qëllimeve dhe kërkesave të fiksuara tashmë prej kohësh në disa instrumenta kornizë.
- Ndërkulturaliteti dhe demokratizimi (EDC), i rritur nëpërmjet refleksionit të vetë-sistemit arsimor, të nxitur nga krahasimet në NEZI dhe arritjeve të tij lidhur me veprimin ndaj heterogjenitetit, ndërkulturalitetit dhe edukimit demokratik (EDC), shqyrtimi i kurrkulave ndërkombëtare dhe praktikave nën këtë fokus.
- Transmetimi dhe shkëmbimi i modeleve dhe shembujve best-practice në lidhje me komunikimin me heterogjenitetin dhe plurikulturalitetin, refleksioni dhe përshtatja e këtyre shembujve p.sh. për integrimin e pakicave të romëve në Kosovë.
- Ballafaqimi me rolin e kapërcyer shpesh të nënvleftësuar të gruas dhe nënës shqiptare për pjesën tjetër në fusha të ndryshme të rrjetit.

Kufizohemi këtu në disa citate të pakta duke u referuar, përndryshe, teksteve origjinale në pjesën III..

«Ne në përgjithësi urojmë një ballafaqim të thellë me debatet shkencore aktuale me perspektivë ndërkombëtare, se cilat procese të bërjes ndryshe vështrohen në mënyrë kritike (‘othering’) dhe kapërcen perspektivën kontejnere etnike-kombëtare.

Si diaspora shqiptare në Zvicër ashtu edhe grupet e popullsisë shqiptare në shtetet e ndryshme të Evropës Juglindore janë shembuj parade për heterogjenitetin e «kulturave» apo «pakicave». «Rrënjët» shqiptare janë pikënisje për atë që Steven Vertovec (2007) e ka rishikuar me konceptin e superdiversitetit: (...) Në të përditshmen profesionale si docentë në shkollat e larta dhe ekspertë të arsimit në Zvicër, konstatojmë fatkeqësisht që dija e familjeve shqiptare në Zvicër për vendet e prejardhjes është e kufizuar si tek mësimdhënësit e arsimuar po ashtu edhe tek ata që po arsimohe.»

Grupi CH ch

«Është mendim i përgjithshëm se shkolla [në Zvicër] duhet të bëjë më shumë në zbatimin e mjaft dokumenteve të shkruara në mënyrë që të ketë një qëndrim të përbashkët për sa i përket marrëdhënies që mban shkolla në përgjithësi në fushën e EDC-së dhe të për-krahjes së fëmijëve me sfond emigrimi dhe të pakicave në orientimin e tyre midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës.»

Grupi CH alb

«Në plan të parë do duheshin thelluar shembujt dhe anët praktike të projektit. Mbase, prezantimi i sa më shumë modeleve të suksesshme do të ishte mënyra më e mirë për të kuptuar dhe rritur besimin në vlerat e demokracisë, të tolerancës, të diversitetit kulturor etj., si pasuri personale dhe shoqërore, në një anë, por dhe si mënyrë e të menduarit dhe të jetuarit, në anën tjetër. Do të duhej një fokusim më i përqendruar në njohjen dhe shpërndarjen e përvojave të suksesshme të përgatitjes së mësuesve para shërbimit dhe në shërbim lidhur me temën e këtij projekti (...)

Në rastin e shqiptarëve në Zvicër, duhej hedhur dritë më shumë te brezi i parë dhe i dytë i emigrantëve, ku vërehet një fortifikim kulturor në kode, zakone e konvenca që, duke qenë jo tipike e jo përfaqësuese shqiptare, tashmë në atdheun e origjinës janë kapërcyer dhe nuk paraqesin vlera as identitare, as kulturore, as qytetare.»

Grupi KOS

«Mendojmë se duhen bërë disa hapa për ta avancuar projektin e demokracisë qytetare: Ndryshime në kurrikulat shkollore, lënda e demokracisë qytetare duhet të ndërtohet në bazë të Kartës së Këshillit të Europës për Edukim dhe Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut. Duhet organizuar trajnime të mësimdhënësve të profileve të ndryshme (sociologë, pedagogë, psikologë) nga ekspertë të fushës (...) në bazë të një teksti të avancuar, të përdorur në vende me traditë demokratike si Zvicra dhe të tjera.»

Grupi MAK

Pyetja 3

Si mund të ndodhte kjo gjë konkretisht?

Këto përgjigje dhe propozime u dhanë pjesërisht në lidhje me pyetjen 2 (Çfarë mund dhe duhej të thellohej?); Krahase listën e shqetësimeve përkatëse sipër. Këtu futen edhe shtysa mjaft konkrete si më poshtë:

- Krijimi i programeve për shkëmbim në fushat e docentëve dhe/apo të studentëve. Kjo shtysë gjendet tek grupi (CH ch, CH alb, MAK). Në një drejtim të ngjashëm është shtysa e grupit ALB për të ngritur një shkolle verore për fëmijë dhe të rinj.
- Vazhdimi i aktiviteteve të NEZI-t në kuadrin e grupeve të punës homogjene më të vogla, nga specializmi i pjesëmarrësve në lidhje me pozicionimet konkrete për temat (ky propozim gjendet shumë herë gjatë raporteve individuale në kapitullin 5.4).
- Informacioni reciprok për modelet e provuara si best-practice-Modelle (krahase sipër tek pyetja 2), kështu p.sh. në katalogun e grupit ALB (shih poshtë).

- Studime të përbashkëta dhe hulumtime p.sh. për integrimin e të riatdhesuarve dhe emigrantëve në shoqërinë e shtetit përkatës por edhe për orientimin kulturor dhe për të kuptuarit të thelluar të proceseve ndërkulturore.
- Krijimi i një doracaku për edukimin qytetar, promovim më i gjerë në media.
- Organizimi i kontakteve me nxënësit përtej kufijve etnikë. (Grupi MAK, duke u lidhur me situatën e veçantë në Maqedoni.).

Nga tekstet origjinale në pjesën III u ripapim përgjigje të rëndësishme disave prej këtyre çështjeve:

«Ne jemi menduar që format e ndryshme të partneriteteve të shkollave të larta, programet e shkëmbimit apo udhëtimet për qëllime studimi midis institucioneve dhe organizatave për arsimimin dhe kualifikimin e personelit mësimdhënës në vendet pjesëmarrëse mund të nisin. Meqënëse programet e mobilitetit në kualifikimin e mësuesve po fitojnë rëndësi në rritje, në letërsi veçanërisht programeve të shkëmbimit studentor u jepet një potencial i konsiderueshëm për përkrahjen e kompetencave relevante për profesionin dhe qëndrimin (...). Prandaj është e rëndësishme, që në Shkollat e Larta Pedagogjike të gjenden, përdoren kontenjerë të përshtatshme, me qëllim që të mund të bëhet para- dhe paspërgatitja e qëllimtë e programeve të mobilitetit (në mënyrë ideale të individualizuar).»

Grupi CH ch

«Në këtë drejtim udhëtimet studimore qoftë të studentëve, qoftë të mësuesve zviceranë, të cilët tashmë janë në procesin mësimor, janë shumë të dobishme. Njohja dhe ballafaqimi i drejtpërdrejtë me kulturat e tjera i ndihmon ata për t'i zbatuar në mësimdhënien e tyre çështjet e lartpërmendura.»

Grupi CH alb

«Në rast të vazhdimësisë së punës së NEZI-t, do të ishte e frytshme që të formohen grupe të reja duke u nisur nga profesionet që ushtrojnë, sepse gjatë konferencave, duke u identifikuar me etni, produktiviteti dhe kredibiliteti i rezultatit ishte i ndryshëm.»

Grupi CH alb

«Si një mundësi tjetër për rezultate më të thelluara shihet ruajtja e vazhdimësisë së rrjetit dhe e funksionimit e bashkëveprimit në projekte konkrete (edhe më të vogla), por me detyra konkrete. Në këtë rrafsh, hulumtimi do të mund të ishte një nga detyrat dhe metodologjitë që do të përdorëshin në të ardhmen.»

Grupi KOS

«Propozimet tona konkrete lidhen me ndërmarrjen e projekteve:

- Për transferimin e modeleve të edukimit qytetar bashkëkohor,
- për partneritetin në edukim,
- për ngritjen e një shkolle verore në edukim,
- për trajnimin e mësuesve për edukimin shumëkulturore,
- për përgatitjen e paketës së kompetencave për edukimin ndërkulturore,
- për kërkime të përbashkëta për integrimin e emigrantëve dhe të të riatdhesuarve në shoqëritë e vendeve ku shkojnë e kthehen;
- për publikime për mësimin plotësues në diasporë.»

Grupi ALB

«Do të ishte shumë produktive që të organizoheshin dy fokus-grupe me nxënës të shkollave fillore në RM që mësojnë për edukimin qytetar dhe një grup tjetër me nxënës (nga komuniteti shqiptaro-zviceran) për të konstatuar perceptimet e tyre për veten, identitetin, tjetrin, racën, besimin, nënshtetësinë, qytetin, shkollën, shtetin, barazinë, lirinë, drejtësinë, demokracinë, ligjin, pushtetin etj.»

Grupi MAK

«(...) një doracak për edukimin qytetar, duke e afirmuar këtë koncept përmes fletëpalosjeve, afisheve, bilbordeve, TV video-klipeve etj. Duhet organizuar debate radio-televizive lidhur me këtë subjekt. Në kuadër të lëndës «Edukimi qytetar» duhet organizuar vizita të objekteve fetare (tempujve) të kulturës tjetër, duhet shfrytëzuar rrjetet sociale për eliminimin e distancës etnike dhe fetare. (...) Ka mundësi që të organizohen ekspozita me piktura të nxënësve lidhur me mënyrën se si ata e shohin botën, kulturën e tyre dhe atë të tjetrit kulturor, duhet organizuar vizita studimore të lagjeve të kulturës tjetër, në veçanti ato unikulturale dhe të (vetë)getoizuar.»

Grupi MAK

5.6 Bilanci, pasojat, rekomandimet

Reagimet me shkrim të diferencuara dhe me përmbajtje të pjesëmarrësve, si edhe vlerësimet e drejtimin të projektit, lenë në kuptimin bilancues konkluzione dhe rekomandime në pikëpamje të ndryshme. Mendime përkatëse u paraqitën tashmë pjesërisht në kapitujt 5.3 deri 5.5, ku gjenden edhe përpilimet e ngjeshura të thënieve origjinale (për tekstet përbërëse krahaso pjesa II dhe III e këtij vëllimi). Në vijim ne përmbledhim pikat e rëndësishme në formë mundësisht të mirëkuptueshme dhe i ndajmë ato në tri fusha:

- a) vlerësimi i konceptit dhe mënyrës së punës së NEZI-t,
- b) pasojat dhe rekomandimet për vazhdimet e mundshme të NEZI-t
- c) rekomandime për konceptimin dhe mënyrën e punës, depozituar ngjashëm në rrjete.

Vlerësimi i konceptimit dhe mënyrës së punës së rrjetit «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura»

Nga pajisjet dhe mënyra e punës NEZI vlen si i arritur dhe i sukseshëm, çfarë e dëshmojnë edhe gjykimet e shumta positive të pjesëmarrësve. Që në spektrin e gjykimeve shfaqen edhe përfundime apo postulate pjesërisht kontradiktore, kjo së pari varet me kërkesat e ndryshme, por para së gjithash, edhe me faktin, që në kuadrin e dhënë kohor dhe financiar në mënyrë të pashmangshme nuk mund të realizohet gjithçka në gjerësinë e dëshiruar. Kështu për shembull gjykimi pozitiv i ofertave të shumanshme dhe i aktiviteteve, si të thuash ana positive e dëshirës e programeve më pak të ngarkuara dhe më shumë kohë për diskutime.

Veçanërisht me sukses kanë qenë elementet e mëposhtme:

- Pjesëmarrja shumëkombëtare.
- Fokusi i qartë tematik (apo: dy fokuset).
- Përfshirja e përfaqësuesve të disiplinave të ndryshme, sfondeve të përvojave dhe perspektivave.
- Kryerja e konferencave në vende të ndryshme (CH, AL, KOS, MAK).
- Metodika me qëllim e shumanshme dhe inovative e konferencave (Inputi, tryezat e rrumbullakta, leksionet e demonstruara, vizitat në shkolla etj. etj.).
- Mundësimi i kontakteve origjinale (vizita në shkolla, diskutimet me përfaqësuesit e minoriteteve etj).
- Ndërhyrja e orientuar nga përvoja dhe bashkëveprimi, koha për diskutime në konstelacione të ndryshme.

- Detyrat përgatitore para konferencave të veçanta (p.sh. përgatitja e inputeve të grupeve të vogla për temën e konferencës).
- Program atraktiv për kohën e lirë, e cila lë kohë për takimet dhe njohjet e veçanërive rajonale.
- Arkivi elektronik në Website të Shkollës së Lartë Pedagogjike Cyrih.

Për t'u optimuar do të kishin qënë, në kuadrin e dhënë kohor dhe financiar, aspektet e mëposhtme:

- Fokusim i qartë në një fushë tematike, e cila mund të ishte trajtuar më thellë (p.sh. EDC apo çështjet e orientimit kulturor).
- Dakortësimet dhe sqarimi i nevojave të mëparshme të lidhura eventualisht me pjesëmarrësit (Gjë që do të thoshte një shpenzim i madh për përgatitjen e konferencave).
- Përbërje homogjene e grupit duke pasur parasysh kualifikimet apo fushën profesionale (p.sh. vetëm njerëz me formim mësues).
- Një ndarje më e fortë e pjesëmarrësve në grupet me tema, të cilën eventualisht të kishin punuar në fazat midis konferencave, në fokusin e tyre tematik dhe të ishin lidhur me anë të mediave elektronike (Email, Skype, E-Konferencën).
- Lidhje më e madhe, përsa i përket bazamentit teorik, p.sh. detyra të fiksuara leximi dhe rrethe diskutimesh apo Internetforen me tekstet.
- Shtysa dhe dakortësime në lidhje me hulumtimet dhe publikimet e vogla që prej konferencës së dytë apo të tretë (në vend që prej së pestës).
- Përfshirje eventuale më e madhe e përfaqësuesve të pakicave si anëtarë fiks apo referues.
- Zgjatje eventuale e konferencave të veçanta në një ditë.

Disa dëshira të tjera nuk do të ishin realizuar apo me vështirësi. Vlen për t'u menduar planifikimi i rrjeteve të ngjajshme. Këtu futen:

- Konferenca qartësisht më të gjata dhe apo më të shpeshta (të cilat nga ana e disponibilitetit të pjesëmarrësve do të ishin më të vështira).
- Përfshirja e qarqeve të tjera: mbartësit e vendimeve politike NGO etj (do të thoshte një ritheksim i temave).

b) Pasojat dhe rekomandimet për një vazhdim të mëtejshëm të mundshëm të NEZI-t

Buxheti i mbetur pas konferencës së pestë lejon në çdo këndvështrim vazhdim plot kup-tim të rrjetit në kuadrin e projekteve vijuese (dhjetor 2015 deri dhjetor 2016). Me këtë dëshira e përmendur shumë herë për punë me projekt apo hulumtim, do të ndahej në grupe të vogla homogjene të fokusuara fort tematikisht.

Sqarime gojore për projektet e përshtashme dhe për kriteret dhe modalitetet e dhënies së tyre dhe përzgjedhjes, Rolf Gollob i deklaroi në konferencën përmbyllëse në Tiranë, në mënyrë të ngjashme u shpërndanë dokumenta të detajuara me shkrim dhe formularë hyrjeje. Si kusht qendror paraparak vlen që projektet të realizohen nga të paktën dy grupe (p.sh. MAK dhe ALB apo KOS dhe Ch alb), me qëllim që të vazhdojë konceptin e rrjetit dhe të shfrytëzojë rezervat e lidhura me të. Tashmë në Konferencën e Tiranës pjesëmarrësit kishin kohë dhe rast për të prezantuar dhe diskutuar propozimet e para.

Përzgjedhja e projekteve pasuese të paraqitura dhe miratimi i kontributeve finaciare, bëhet nga drejtimi i projektit të NEZI-t. Tërë drejtimi i kësaj faze kryhet nga Rolf Gollob

c) Rekomandime për konceptimin dhe mënyrën e punës të rrjeteve të ngjashme të ngritura

Projekti i gjerë i realizuar me kulturën e parë, të dytë dhe ndërkulturën paraqet jo vetëm një sukses të brendshëm edhe për veten, por më shumë trasmetohen përvojat dhe njohuritë e fituara këtu si edhe udhëzime me vlerë në konceptimin e rrjeteve të ngjashme. Rrjetet e tilla shumëkombëshe në llojin e NEZI-t i përgjigjen pa diskutim një nevojë të të gjithë partnerëve dhe mund të transmetojnë kontribute relevante për shkëmbimin dhe për zgjerimin e horizontit në fushat e hulumtimit dhe të teorisë. Si shembuj të mundshëm për rrjetet, në të cilat mund të përdoren direkt përvojat e përfituara në NEZI, përmendim një rrjet analog në hapësirën e sllavëve të jugut, një rrjet në lidhje me kërkesat e romëve të shteteve të ndryshme të Ballkanit, apo një rrjet në lidhje me çështjet e formimit të mësuesve. Për të tërhequr vëmendjen këtu janë shtysat e shumanëshme, të cilat u formuluan më sipër në kapitullin 5.4 për pyetjet 4 dhe 5. Në listën pasuese kufizohemi në disa pika, të cilat mund të shërbejnë si udhëzime.

- Parimisht për t'u marrë në ngarkim mund të këshillohen shumica e elementeve të paraqitura sipër si «veçanërisht të ruajtura». Këtu futen sidomos përbërjet shumëkombëshe të pjesëmarrësve, struktura e konferencës, shumanshmëria e metodave të hyrjeve dhe komunikimi i orientuar mirë nga përvoja, takimi dhe ndërveprimi.

- Aspektet e listuara me sipër si «të optimuara» duhet të bashkëmendohen gjatë konceptimit të rrjeteve të ngjashme dhe të integrohen përkatësisht sipas pikave të rëndësishme tematike dhe mundësive finaciare.
- Për t'u këshilluar është sigurisht, në rrjetet e ardhshme në llojin e NEZI-t, që të planifikohet që në fillim një periudhë për projekte vijimi dhe thellimi (si ai që do të zhvillohet tek NEZI në vitin 2016), të buxhetohet dhe t'u komunikohet pjesëmarrësve si perspektivë. Mundshësi e mirë është që projekte përgjegjëse të fillojnë gjatë fazave të konferencave dhe mund të bëhen me afat diçka më të gjatë, siç është rasti me NEZI-n.
- Nëse dalin rekomandime në lidhje me fazën e projekteve vijuese, duhet të gjykohet pas përfundimit të kësaj faze apo pas vënies në dijeni të raporteve përkatëse përmbyllëse.



Pjesa II

Përfitimet dhe rrjedhojat e rrjetit

Referime individuale
të pjesëmarrësve

Grupi i Zvicrës

(Pjesëmarrësit/et nga Zvicra pa origjinë shqiptare)

Miriam Aegerter-Jossen,
Shkolla e Lartë Pedagogjike të kantonit të Cug-ut (Zug)

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndihmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Bashkëpunimi në NEZI më mundësoi një shkëmbim të fokusuar përvojash, teorish, konceptesh dhe idesh me personalitete interesante. Të dyja fokuset përmbajtësore të rrjetit, dinamika e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash si dhe edukimi për demokracinë, janë mjaft aktuale dhe të rëndësishme në punën time të përditshme në Shkollën e Lartë Zug dhe veçanërisht në Institutin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Çështjet e Arsimit. Nëpërmjet bashkëpunimit në rrjet, arrita të thellohesha në tema të caktuara (si p.sh. rëndësia e mësimit në gjuhën e kulturën amtare) dhe u pasurova me njohuri të reja, të cilat aktualisht po përpiqem t'i integroj në punën time. Nëpërmjet NEZI-t u ndërgjegjësova sërish rreth faktit se «shqiptari» apo «shqiptarja» nuk ekzistojnë, por që në rrjet shqiptarët bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, mbajnë qëndrime të ndryshme në vendet e tyre (të prejardhjes), (në Zvicër si minoritet emigrantësh, në Kosovë si shumicë në një shtet që në mënyrë eksplicite mund të quhet i ri e multietik, në Shqipëri si shumica tradicionale dhe në Maqedoni si partnerë (minoritarë) në një shtet dy popujsh). Kontaktet personale me përfaqësuesit e diasporës shqipfolëse në Zvicër si dhe vendet e tyre të prejardhjes Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, zgjeruan më tej perspektivat e mia. Me interes për t'u thelluar më tej, më duket aspekti i së «ardhmes». Cila është e ardhmja e orientimit midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës? A do të ndryshojë ajo për shkak të lëvizjeve aktuale të emigracionit? Çfarë ndihme mund të jepet për një orientim midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës?

Pyetja 2

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI nën këndvështrimin e metodikës së planifikimit dhe organizimit të takimeve dhe çfarë mund të përmirësohej (dhe si)?

Takimet e ndryshme m'u dukën të planifikuara me shumë kujdes, të larmishme dhe me shumë aspekte. M'u duk mjaft pozitiv fakti që takimet u organizuan (bashkërisht) nga grupet e shteteve të veçanta dhe që u mbajtën përkatësisht në këto vende. Falë këtij bashkëveprimi, u mundësuan perspektiva dhe takime autentike. Format e ndryshme të mësimdhënies e mësimnxënies si p.sh. workshopet, tavolinat e rrumbullakëta me përfaqësues nga vende të ndryshme, bordet e diskutimit, referatet e veçanërisht vizitat në shkolla, ishin mjaft domethënëse për mua. Vështrimi konkret në mësimin e gjuhës dhe kulturës së prejardhjes në takimin e katërt, për mua përbënte pikën kulmore të të gjithë projektit. Deri atëherë e kisha përmendur shpesh mësimin e gjuhës dhe kulturës së prejardhjes në orët e mia mësimore dhe, falë këtij takimi, pata rastin të përjetoja personalisht një orë mësimore konkrete dhe të shkëmbeja përvojat e mia me nxënës si dhe mësues të mësimin të gjuhës dhe kulturës së prejardhjes.

Për shkak se gjithmonë kishte shumë material për përkthim, disa seanca të veçanta frontale bëheshin ndonjëherë të lodhshme dhe ishte e vështirë të përqendroheshe për një kohë të gjatë. Më vjen keq që nga rrjeti nuk ka pasur ende asnjë publikim shkencor (deri tani).

Përveç kësaj dua të përmend se e vlerësoj shumë përfshirjen e personave të ndryshëm, si p.sh. përfshirjen e një ish-nxënëseje të mësimin të gjuhës e kulturës së prejardhjes që tani është studente e Shkollës së Lartë Pedagogjike. Krahas përmbajtjeve, takimet ofruan edhe vend për aspektin kulturor e shoqëror si dhe për biseda joformale që për mua personalisht ishin pasuruese.

Pyetja 3

Çfarë tjetër përfitova nga bashkëpunimi në NEZI dhe çfarë më mungoi?

Falë bashkëpunimit në NEZI arrita të ndërtoja një rrjet personal specialistësh dhe të krijoja edhe lidhje të qëndrueshme. Veçanërisht kontakti me personat e diasporës shqipfolëse në Zvicër, ishte me mjaft interes për mua. Në këtë mënyrë arrita p.sh. të fitoj dy persona që punojnë si pedagogë në degën e certifikatës «Gjermanishtja si gjuhë e dytë dhe ndërkulturaliteti» (CAS DaZIK), drejtim të cilin e kam edhe unë. Një person është specialist i Mësimin të Gjuhës e Kulturës së Prejardhjes, tjetri specialist në fushën e gjermanishtes si gjuhë e dytë. Sipas mendimit tim, kontakti personal me personat e shkolla-

ve të tjera të larta (në Zvicër dhe jashtë shtetit), është i një rëndësie të jashtëzakonshme për lidhjen në rrjet dhe zhvillimin e mëtejshëm të mësimin në shkollat e larta, të tematikave të përbashkëta si dhe të bashkëpunimit midis shkollave të ndryshme të larta.

Takimet dhe përjetimet autentike në vende të ndryshme, këtu duhen përmendur veçanërisht vizitat shkollore që u organizuan për ne, përbënin për mua pikën kulmore të projektit. Me interes do të më ishte dukur edhe përfshirja e përkthyesve dhe ndërmjetësuesve ndërkulturore, pasi këta persona kanë një funksion të rëndësishëm ndërli-dhës në fushën e arsimit.

Pyetja 4+5

Dëshira dhe ide për vazhdimin e NEZI-t, propozime konkrete.

Sipas pikëpamjes sime vazhdimi i NEZI-t do të ishte mjaft interesant dhe i dëshirueshëm. Deri tani u arrit krijimi i kontakteve dhe identifikimi i temave të para të përbashkëta me persona të veçantë. Në një hap të dytë mendoj se është edukative formimi i grupeve të vogla me përfaqësues nga shtete të ndryshme, të cilët së bashku do të përpunojnë tema konkrete, do të planifikojnë, realizojnë dhe vlerësojnë projekte.

Me interes do të dukej gjithashtu edhe tematizimi i mënyrës së kuptimit të pedagogjisë së ndryshimit dhe përfshirjes së partnerëve të rrjetit në shtete të ndryshme. Një çështje për t'u trajtuar mund të ishte p.sh. se si duhen trajtuar fëmijët e refugjatëve. Cilat modele janë aplikuar e aplikohen aktualisht dhe sa sukses kanë pasur ato? Çfarë roli luajnë shteti, shkollat e larta, shkollat, mësuesit etj.?

Një temë tjetër që mund të thellohet është roli i mësimeve të lidhura me orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkultures. Për shkak se profesionin e mësimeve të zgjedhin shumë persona me përvoja personale emigracioni, përbën një temë me perspektivë. Aktualisht në institutin tonë po kryhet një studim lidhur me çështjet e përvojave biografike që lidhen me ndryshimin e përkatësinë si dhe trajtimin e këtyre përvojave tek personat që japin mësim e që kanë (ose jo) «sfond emigrant». Njohuritë e përftuara në këtë projekt mund t'i përçojë në të ardhmen në diskutime e projekte.

Qasjet dhe sfidat e bashkëpunimit midis specialistëve të ndryshëm në fushën e arsimit që mbështesin nxënësit për t'u orientuar midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkultures, mund të ishin një tjetër temë që lidhet me diskutimet e NEZI-t. Një çështje brenda kësaj tematike mund të ishte mënyra e bashkëpunimit të specialistëve dhe përdorimit të inputeve të ndryshme. Këtu kam parasysh p.sh. bashkëpunimin midis një personi që jep mësim në fushën e gjuhës e kulturës së prejardhjes dhe një personi që jep mësim në një klasë normale, apo bashkëpunimin midis shkollave të larta pedagogjike dhe praktikës shkollore.

**Brigit Allenbach,
Universiteti i Fraiburgut,
Shkolla e Lartë Pedagogjike Zyrih**

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndhimë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspektet që mund të thelloheshin më tej.

Shkëmbimi kulturor është një bazë e mirë për proceset mësimore, veçanërisht kur krijohet një kuadër që mundëson takime ballpërballë. Në konferencat e NEZI-t kjo gjë u përmbush plotësisht. Me mjaft interes për mua ishte aksesimi në të përditshmen shkollore në vendet e ndryshme të zhvillimit të konferencave si dhe mundësitë e shumta në kuadrin e konferencave të shteteve për të zhvilluar edhe biseda joformale.

Lidhur me dy tematikat kryesore të rrjetit «Dinamika e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash» si dhe «Edukimi për demokracinë», mund të thellohen më tej dy aspektet e mëposhtme:

1. Çfarë roli luajnë ndryshimet kulturore në situatat e përditshme, p.sh. tek bashkëpunimi i shkollës me prindërit, brenda grupeve shoqërore apo tek bashkëpunimi i atyre që japin mësim etj.?
2. Si jetohet demokracia në jetën e përditshme shkollore dhe jashtëshkollore? Si ndryshojnë perspektivat e bashkëpunëtorëve të ndryshëm për demokraci, p.sh. të fëmijëve, të të rinjve, të prindërve, të mësimmshënësve, ekspertëve etj.

Në disiplinën time të etnologjisë, qasja jonë është se kultura nuk është një objekt me karakteristika të veçanta, por rezultat i një procesi dinamik, që krijohet nëpërmjet shkëmbimit midis njerëzve, individëve dhe grupeve. Për këtë arsye nuk mund të ekzistojnë kultura apo shoqëri homogjene dhe të mbyllura. Kërkimi etnologjik studion se si rrjedhin proceset negociuese në jetën e përditshme ose me fjalë të tjera: Organizimin social të ndryshimeve kulturore. Teoria e themeluar nga antropologu social norvegjez Fredrik Barth quhet ndryshe edhe «boundary theory» dhe ka një ndikim shumë të fortë edhe përtej kufijve profesionalë. Kjo mënyrë dinamike e kuptimit të kulturës bën të qartë se takimet ndërkulturore janë të ndërthurura gjithmonë me strukturat shoqërore të pushtetit. Në kundërshtim me këtë, në jetën e përditshme, paradigma e ndryshimeve kulturore as që diskutohet fare. Por në kontekstin e emigrimit një mënyrë e tillë esenciale e të kuptuarit është problematike, pasi ajo, në fund të fundit ua refuzon emigrantëve dhe pasardhësve të tyre njohjen si anëtarë «normalë» të shoqërisë.

Do doja ta ilustru këtë me shembullin e diasporës shqiptare në Zvicër: Në vitin 2014, kur Xherdan Shaqiri e futi Zvicrën në raundin e dytë të kampionatit botëror, gazeta falas 20 Minuta doli me titullin: «Ballkani po bëhet «trendi» fal Nati-Stars.» Edhe Tomas Kesler, komisioneri i mirënjohur i integritetit të qytetit të Bazelit, spekuloi se shqiptarët në Zvicër tashmë do ndihen si njëherë e një kohë italianët: «Përshtypja që mbetet është se Shaqiri nuk është i vetmi që përpiqet në profesionin e vet, por edhe shumë nga bashkëkombësit e tij të panjohur. (...) sikurse edhe italianët në fund të viteve 1970. Dikur ata mbaheshin si heronj të grave, përtacë dhe kriminelë. Pas marrjes së titullit Kampion Bote në vitin 1982 krejt papritur Italia u bë trendi.»

Edhe pse Zvicra në vitin 2014 fatkeqësisht nuk e mori titullin Kampion Bote, shembulli tregon se bashkëqytetarët shqiptarë në Zvicër po konsiderohen gjithmonë e më tepër si fqinjë, e jo më si të huaj. Fakti që bëhet fjalë për bashkëjetesë fqinjësh e jo të huajsh, vërtetohet edhe në rastin e emigrimit mbrapsht, kjo lidhet veçanërisht me minoritetet fetare dhe etnike në Evropën Juglindore, respektivisht në zonën shqipfolëse.

Megjithatë, të rinjtë shqiptarë në Zvicër përballen me epitete nga më të ndryshmet, që ndonjëherë nuk është e lehtë t'i hedhësh poshtë. Këtë e demonstrojnë edhe bisedat tona me fëmijë e të rinj nga Programi Kombëtar Hulumtues NFP 58. Donim të mësonim më shumë rreth rolit të ndryshimeve kulturore dhe fetare në jetën e tyre të përditshme: Çfarë strategjish kanë zhvilluar ata për t'u ndier në Zvicër si në shtëpi? Çfarë roli luajnë shkolla, koha e lirë, familja dhe marrëdhëniet me bashkëmoshatarët e tyre? Si e jetojnë ata përkatësinë e larmishme që kanë?

Çështjet që lidhen me identitetin kulturor janë mjaft të rëndësishme edhe për vetë të rinjtë, pasi si zviceranët ashtu edhe brezi i parë i emigrantëve theksojnë ndryshimet kulturore midis dy grupeve. Por backgroundi emigrant është vetëm njëri aspekt në jetën e të rinjve shqiptarë në Zvicër. Pyetur lidhur me dëshirën (apo problemin) e tyre më të madh, të rinjtë shqiptarë shprehen në përgjithësi për një përfundim të suksesshëm të shkollës dhe të arsimimit të tyre. Mundësitë e arsimimit të fëmijëve të tyre në Zvicër kanë shërbyer shpesh si një motiv i rëndësishëm për tërheqjen e familjes, sidomos pas shpërbërjes së Jugosllavisë në vitet '90. Edhe baballarët e nënat që vetë janë të pashkolluar ose me një arsimim shumë të ulët, e njohin rëndësinë qendrore të arsimit për një të ardhme të mirë dhe për promovim social. Ky përfundim ndryshon dukshëm nga «diskurset e mjeruara», të cilat ua refuzojnë prindërve emigrantë apriori aftësinë për t'i mbështetur si duhet fëmijët e tyre lidhur me shkollën dhe arsimimin.

Koncepti «kulturë e ndërmjetme» tregon se identitetet ndërkombëtare në shtetet multikulturore të Evropës janë kthyer në normalitet. Kështu, fokusi i fëmijëve të emigrantëve shqiptarë në Zvicër është: Ata jetojnë këtu dhe tani. Por kjo nuk përjashton aspak rëndësinë e rrjeteve shqiptare në jetën e tyre të përditshme. Do të ishte e dëshirueshme që përkatësia e ndryshme e emigrantëve shqiptarë në Zvicër, situatë e ngjashme si tek emigrantët italianë, të njihen si potencial e jo si mangësi.

Pyetja 2

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI nën këndvështrimin e metodikës së planifikimit dhe organizimit të takimeve dhe çfarë mund të përmirësohej (dhe si)?

Konferencat ishin të organizuara shumë mirë:

- Inpute të shumta e interesante nga ekspertë.
- Një kombinim i mirë i mundësive për biseda formale dhe joformale.
- Me mjaft gjallëri u paraqit prezantimi «live» i një serie leksionesh në lëndën e Edukimit për demokraci.

Çfarë ndoshta mund të përmirësohej: Diskutime të thella e të përqendruara tek rezultatet lidhur me çështjet qëndrore.

Pyetja 3

Çfarë përfitova tjetër nga bashkëpunimi tek NEZI dhe çfarë më mungoi?

Shkëmbimi me pjesëmarrësit e rrjetit ishte mjaft pasurues, pasi grupi kishte përbërje shumë të larmishme. Kjo nuk lidhet vetëm me kombësitë e ndryshme të pjesëmarrësve, por para së gjithash, edhe me disiplinat e ndryshme shkencore p.sh. psikologjia, shkencat e edukimit, gjuhësia, sociologjia, etnologjia. Veçanërisht interesant për mua ishte diskutimi që kishte të bënte jo vetëm me ndryshimet, por edhe me të përbashkëtat e vendeve pjesëmarrëse gjë që u referohet edhe pasojave të transnacionalitetit në sistemin e arsimit. Këtu duhet vënë në fokus shtrirja e veçantë gjeografike e Evropës Juglindore si rajon kufitar midis lindjes dhe perëndimit. Duhet tematizuar më tepër fakti se Evropa Juglindore dhe veçanërisht shtetet e dala nga Jugosllavia sjellin shumë përvoja dhe Know-how me vete. Do të doja të mësoja më shumë rreth mënyrës se si shfaqet përgjithësisht kompetenca e ndryshimit në sistemin arsimor. Veçanërisht lidhur me temën e «demokracisë» ekziston pak rreziku se kushtet zvicerane idealizohen. Kjo është e disfavorshme për shkak se, siç del dukshëm edhe nga bashkëpunimi për zhvillim, modeli zviceran ka një histori të gjatë dhe ky proces historik nuk mund të eksportohet si një mall i çfarëdoshëm. Nga ana tjetër, në diskutimin krahasues harrohen shpesh deficitet e demokracisë zvicerane, pikërisht përjashtimi i popullsisë së huaj nga sistemi politik, në rastin e Zvicrës ata përbëjnë gati çerekun e popullsisë rezidente.

Pyetja 4

Nëse NEZI do të vazhdonte, cilat do të ishin dëshirat e mia lidhur me drejtimin e këtij vazhdimi?

Dëshira ime është që të krijohet një shkëmbim i vazhdueshëm me institucionet dhe organizatat e formimit e kualifikimit të mësuesve në vendet pjesëmarrëse.

Pyetja 5

Nëse NEZI do të vazhdonte, cilat janë propozimet e mia konkrete dhe cila do të ishte ndihmesa ime për këto projekte?

Studentë nga vendet pjesëmarrëse mund të marrin pjesë në një modul nën kujdestarinë e bashkëpunëtorëve që vijnë nga përkatësisht dy vende. Në Shkollën Pedagogjike të Cyrihut kjo mund të organizohet eventalisht në kuadrin e një projekti FE. Një projekt FE përfshin pjesëmarrjen aktive të studentëve për hulumtim e zhvillim dhe kryhet në semestrin e 3-të e respektivisht të 5-të. Shembuj:

- Studentët mund të hartojnë një sërë leksionesh për temën e edukimit për demokraci, nën këndvështrimin e vendeve të tyre të prejardhjes e respektivisht të lidhjeve të tyre ndërkombëtare.
- Studentët mund të kryejnë së bashku një studim të vogël në terren, p.sh. lidhur me temën «shkolla dhe familja».
- etj.

Përveç dhe në vijim të kësaj, mund të zhvillohen edhe studime të vogla në terren në një nga shtetet pjesëmarrëse si bazë për temat e diplomave të Bachelorit e veçanërisht të masterit.

Kai Felkendorff, Shkolla e Lartë Pedagogjike Cyrih

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndihmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspektet që mund të thelloheshin më tej.

NEZI është një projekt brenda të cilit dhe me të cilin nuk u kapërcyen thjesht kufijtë e disiplinave të ndryshme dhe ata kombëtare, por edhe kufijtë midis sferave të shkencës, politikës, administratës, letërsisë dhe gazetarisë.

Përjetimi i bashkimit të një larmie të tillë perspektivash dhe mundësia për të qenë pjesë aktive e tij, është ajo nga e cila përfitova më shumë. Bisedat dhe takimet informale që u zhvilluan ishin po aq të rëndësishme sa vizitat në mësim dhe diskutimet e përbashkëta apo në grupe. Fokuset tematike formonin një kuadër të përshtatshëm brenda të cilit u arrit të analizohet, prezantohej, shkëmbeheshin përvoja dhe madje edhe të debatohej me pasion pikërisht për pyetje të tilla si më poshtë:

- «Çfarë kuptojmë me termin «kulturë»? A mund të flitet për një kulturë shqiptaro-zvicerane? A është ende i lejueshëm përdorimi i termave të tilla dhe koncepteve që fshihen pas tyre apo në këtë mënyrë bëhesh fajtor për shkak të një esencializmi shkatërrues mbi kulturën?»
- «Si mund të sensibilizohen mësuesit dhe nxënësit lidhur me rreziqet e attributeve etnike? A janë të gjitha atributet me sfond etnik të së njëjtës shkallë rrezikshmërie apo ka edhe përjashtime?»
- «Si dhe ku ndodh në të vërtetë edukimi për demokraci, nëse në mësimin e gjuhës e kulturës së prejardhjes në Zvicër apo në mësimin e një klase shqiptare në Maqedoni flitet për historinë kosovare dhe atë shqiptare?»
- «A duhet përmendur UÇK-ja në një material mësimor në mësimin e gjuhës e kulturës së prejardhjes? Nëse po, si?»
- «Si mund të didaktizohen të drejtat e minoriteteve? Po e drejta për rezistencë a bën pjesë tek të drejtat e minoriteteve që duhen tematizuar gjatë kohës së shkollimit të detyruar?»

Është mjaft e qartë që pyetjet e renditura këtu shpesh nuk u përgjigjen atyre që janë listuar në program. Ato mundën të lindnin vetëm falë dinamikës së një situatë, që mundi të krijohej falë bashkimit të perspektivave të ndryshme.

Gjithashtu u bë e qartë se, për disa nga këto çështje, nuk mund të arrihej në një konsensus. Dhe kështu duhet të jetë. Në shkëmbimin që kap sferat e ndryshme ndërdisiplin-

ore, ndërkombëtare dhe shoqërore mbi koncepte që bartin norma e vlera të një shkalle të lartë, diskutimi i hapur, i informuar dhe kontrovers mbi këto koncepte është diçka që mbart në vetvete në mënyrë të vetkuptueshme vlera e dobi të mëdha. Nuk mund e nuk duhet pritur që gjithë pjesëmarrësit të bien dakord mundësisht shpejt për një mënyrë konceptimi të njëjtë e pothuajse të gatshme për nënshkrim të koncepteve të «kulturës» apo «edukimit për demokraci», nga i cili më pas mund të nxirren edhe rekomandime të qarta për veprim.

Nëse projekti do kishte një vazhdim, atëherë dëshira ime do ishte të thelloheshin në përmbajtje temat e «etnizimit», «Dinamikat përfshirëse dhe përjashtuese në sistemet tona arsimore», «Formimi mbi të Drejtat e Njeriut» dhe «(Didaktika e) Të drejtat e minoriteteve».

Pyetja 2

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI nën këndvështrimin e metodikës së planifikimit dhe organizimit të takimeve dhe çfarë mund të përmirësohet (dhe si)?

Planifikimi dhe organizimi i takimeve ishte mbresëlënës. Siç e përmenda më sipër, drejtuesit e takimeve bënë të mundur një shkëmbim tepër pasurues gjatë, midis dhe pas referimeve dhe ekskursioneve.

Do ta kisha vlerësuar nëse diskutimeve të detajuara si dhe kontroverse t'u ishte lënë më tepër hapësirë në programin zyrtar. Kështu p.sh. diskutimi që prekte thelbin e projektit mbi konceptin e kulturës që u trajtua në takimin e parë nuk mundi të ndiqej mjaftueshëm.

Pyetja 3

Çfarë përfitova tjetër nga bashkëpunimi tek NEZI dhe çfarë më mungoi?

Bashkëpunimi më mundësoi kontakte me njerëz shumë simpatikë dhe interesantë. Ajo që më mungoi ishte, nga njëra anë, vijimi i përballjeve interesante të prekura në projekt dhe, nga ana tjetër një diskutim më i detajuar lidhur me çështjen se si duhet organizuar një bashkëpunim ndërkombëtar ballë për ballë gjatë zhvillimit të mëtejshëm konceptual të edukimit për demokraci.

Pyetja 4

Nëse NEZI do të vazhdonte, cilat do të ishin dëshirat e mia lidhur me drejtimin e këtij vazhdimi?

Nga pikëpamja organizative më duket me vend formimi i grupeve më të vogla të punës që do të punojnë në mënyrë të thelluar për temat specifike që janë ende për t'u përkufizuar. Njëri nga dy takimet vjetore mund t'u kushtohet këtyre takimeve të grupeve të punës. Më pas në takimet e përbashkëta të projektit mund të prezantohen e diskutohen përfundimet e grupeve të punës.

Dëshirat e mia lidhur me përmbajtjet i kam shprehur më sipër. Unë personalisht do të dëshiroja pikësëpari një thellim të temave «Përfshirja/përfshirja», «Të drejtat e Njeriut» dhe «Të drejtat e minoriteteve», por jam e hapur dhe për tema të tjera.

Pyetja 5

Nëse NEZI do të vazhdonte: Cilat janë propozimet e mia konkrete dhe cili do të ishte ndihmesa im për këto projekte?

Do të më pëlqente të punoja në një grup pune për temën «Formimi i të Drejtave të Njeriut». Ndër të tjera më duket interesante dhe produktive analiza e planeve dhe materialeve mësimore, koncepteve ekzistuese dhe/ose leksioneve nën këndvështrimin e çështjeve që janë ende për t'u përcaktuar.

Nëse do të ketë një vazhdim për temën «Përfshirja/Përfshirja», atëherë do të isha e gatshme dhe e aftë të ofroja njohuritë e mia specifike mbi sociologjinë dhe pedagogjinë.

**Rolf Gollob,
IPE/Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut,
anëtar i stafit drejtues**

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndihmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspektet që mund të thelloheshin më tej.

NEZI si projekt bazohet mbi rrjetet tashmë ekzistente dhe ka për qëllim jo vetëm përforcimin e tyre, por edhe formimin e rrjeteve të reja. NEZI fokusohet njëkohësisht tek disa tematika specifike përmbajtjesore, të cilat plotësojnë por edhe mund ta konkurrojnë njëra-tjetrën. Qëllimi im personal ishte të lidhja tematikën mbi demokracinë me çështjet qendrore të zhvillimit të identitetit dhe të emigracionit. Me NEZI-n ia vlejti përpjekja që së bashku me pjesëmarrësit të lidhnim shume shpesh çështjet e kompetencës gjuhësore, suksesit shkollor dhe integritetit profesional me çështjet themelore të një shoqërie të organizuar në mënyrë demokratike. A ofron një shoqëri civile e hapur, e organizuar në mënyrë demokratike, kushtet bazë për kërkesat e një shoqërie emigrante dhe a do të jetë e mundur që çështje të tilla të diskutohen jo vetëm në kuadrin e këtyre takimeve por edhe si shkëmbime shkencore dhe të përpunohen zgjidhje?

Forca e projektit gjendej tek qëndrueshmëria e pjesëmarrësve e cila na mundësoi të krijonim një kuadër të përgjithshëm që lejonte procese të kujdesshme të të menduarit dhe diskutime kritike.

Nëpërmjet principit të përzgjedhur të organizimit në vend, të gjithë pjesëmarrësit mundën të ishin njëkohësisht mikpritës dhe mysafirë. Sfidat e projekteve të tilla është që në grup të kemi persona mundësisht sa më të angazhuar dhe të profilizuar me ndikim mbi proceset e ndryshimit dhe njëkohësisht kompetentë të mirë në fushën profesionale. Këtë e arritëm. Rrjeti shqiptar NEZI u vlerësua dhe synimi duhet të jetë lidhja me të dhe gjenerimi i projekteve dhe i bashkëpunimeve të vogla e të mëdha prej tij.

Pyetja 2

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI nën këndvështrimin e metodikës së planifikimit dhe organizimit të takimeve dhe çfarë mund të përmirësohet (dhe si)?

Lidhur me qëllimin e bashkimit të kolegëve të profilizuar dhe të angazhuar nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Zvicra u gjendëm përpara një detyre komplekse, si nga ana organizative ashtu edhe përmbajtjesore. Si mund të bashkohen më njëra-tjetrën dëshirat e ndryshme dhe mundësitë kohore? Si mund të arrihet që kompetencat e pjesëmarrësve jo vetëm të merren parasysh por edhe të shfrytëzohen? Si mund të organizohen takimet e shkurtra në mënyrë të tillë që të realizohen si specifika vendore ashtu edhe nevoja e grupit të projektit për një shkëmbim të thelluar dhe diskurs profesional?

Pikërisht pika e fundit përbënte për ne një sfidë të madhe dhe një qëllim të rëndësishëm. Shkëmbimi shkencor ka nevojë për hapësira që lidhen me nxitjet e përmbajtjeve. Në grup mësuam që t'i besonim gjithmonë e më tepër dinamikës së simpoziumeve të veçanta dhe së bashku me përfaqësuesit lokalë, në Prishtinë, Shkup dhe Tiranë, të gjejmë një balancë midis momenteve të paplanifikuara dhe elementeve të ngjeshur të programit, të planifikonim vizitat e institucioneve, shkollave dhe autoriteteve dhe të gjykonim në mënyrë realiste afatet, por edhe të nxisnim dhe mbështesnim. Komuniteti i pretenduar homogjen shqipfolës dhe specifik arsimor u shpalos në larminë e vet, në pozicionet dhe këndvështrime të ndryshme.

Nëse elementë të tillë gjejnë hapësirë dhe arrijnë të manifestohen, përbën gjithashtu një shenjë të një planifikimi të suksesshëm seminari. Sa më homogjen të duket një grup nga jashtë, aq më e rëndësishme është që të gjejnë vend apo që vetëm të mund të manifestohen temat e vështira dhe pozicionet e ndryshme, falë planifikimit të seminarit.

Pyetja 3

Çfarë përfitova tjetër nga bashkëpunimi tek NEZI dhe çfarë më mungoi?

Shumë nga pjesëmarrësit i njihja paraprakisht. Ka qenë gjithmonë një kënaqësi për mua t'i takoj sërish ata në kuadrin e takimeve të NEZI-t apo edhe me rastin e takimeve të tjera. Ajo që më ka rënë në sy gjatë këtyre takimeve ka qenë: Kolegët e mi i janë referuar shpesh rrjetit tonë, e kanë përdorur dhe e kanë quajtur atë një shembull të suksesshëm për shkëmbim e zhvillim, e janë të mendimit se forma të ngjashme duhen planifikuar më shpesh.

Unë personalisht kam pasur rastin të njihesha në mënyrë intensive me tematika specifike që lidhen me identitetin shqiptar dhe të mësoja se sa shumë ndryshon imazhi mbi vetveten në situatën e minoritetit maqedonas apo në situatën e zhvillimit të shtetit kosovar. Ishte pikërisht stabiliteti politik ende mjaft i brishtë i Kosovës dhe njëkohësisht statusi i fituar si «shumicë etnike», të cilat në ndryshim me situatat e shqiptarëve në Shqipëri, Maqedoni apo Zvicër përbënin shpesh rast për shumë bisedime, njohuri të reja dhe thellim të mëtejshëm. Falë strukturës së projektit (pesë takime, grup i njëjtë pjesëmarrësish, axhenda e qartë e temave, përqendrimi tek një grup etnik), u arrit të hidhej vështrim në brendësi të tematikës dhe nuk ishte e nevojshme të mbroheshe, justifikohesh apo pozicionohesh kundrejt një grupimi tjetër. Unë përjetova hapjen e diskutimit dhe për mua kjo përvojë ishte një zgjerim i madh i njohurive dhe interesit tim.

Do të dëshiroja të kishte më tepër diskutime që i vendosin këto tematika në kuadrin e teorisë së demokracisë dhe shoqërisë civile.

U arrit të trajtohej niveli shkollor i formimit të demokracisë, e njëjta gjë vlen edhe për elementet e zhvillimit të materialeve mësimore. Diskursi rreth lidhjes së përfytyrimeve mbi demokracinë dhe emigrimin, u zhvillua shumë shkurt. Ky diskurs nuk është zhvilluar ende. Ai është shumë specifik e politik dhe kërkon njohuri bazë teorike politike paraprake, që i kapërcejnë qasjet pedagogjike apo psikologjike

Pyetja 4

Nëse NEZI do të vazhdonte, cilat do të ishin dëshirat e mia lidhur me drejtimin e këtij vazhdimi?

Për vazhdimin e tij shoh dy qasje të mundshme që e plotësojnë mirë njëra-tjetrën. Nga njëra anë, unë personalisht jam e interesuar për thellimin e çështjeve të kuptimit të demokracisë të përmendura më sipër. Çfarë ndikimi kanë emigrimi dhe kontakti me vendin e prejardhjes mbi përfytyrimin e organizimit politik shoqëror? Çfarë do të thotë për të rinjtë përballja me një përfytyrim të ndryshëm mbi përfshirjen dhe kërkesat shoqërore në demokracitë e «vjetra» dhe «të reja»? Cilat diskurse zhvillohen midis brezave, por dhe midis shteteve të ndryshme me traditën e tyre të ndryshme politike? Kështu p.sh. çështjet e Shqipërisë si shtet postkomunist janë krejt të ndryshme nga ato të shtetit të ri të Kosovës, ku minoriteti i dikurshëm brenda Serbisë është kthyer në një maxhorancë me një minoritet serb. Si i trajtojnë të rinjtë e të rejt shqiptarë në Zvicër, çështjet e dyshtetësisë apo të shtetësisë së mohuar? A ekzistojnë mundësi për institucionalizimin dhe bërjen publike të këtij diskursi?

Një mundësi e dytë do të ishte që të mos përcaktohej tema, por që rrjeti të përdorej si bazë për diskutime të tjera dhe shkëmbim shkencor dhe që iniciativa t'i lihej pjesëmarrësve në dorë. Gjithsesi për momentin nuk janë përcaktuar as financimi e as drejtuesit.

Pyetja 5

Nëse NEZI do të vazhdonte, cilat janë propozimet e mia konkrete dhe cili do të ishte ndihmesa ime për këto projekte?

Siç e përmenda, unë personalisht jam i interesuar për çështjet e kuptimit të demokracisë, sidomos në kontekstin shkollor. Do të më pëlqente që këtë temë ta trajtonim e zgjeronim më tej së bashku me anëtarët e interesuar të rrjetit. Në fokus të interesit mund të vendosej shkolla si nënsistem shoqëror, që në vetvete nuk mund të jetë demokratik por, që nga njëra anë, vepron në kuadrin e një misioni demokratik arsimor e, nga ana tjetër, duhet të karakterizohet nga një kulturë e demokracisë e të dallohet nga pjesëmarrja dhe transparenca. Pyetjet që shtrohen këtu janë: Si mund të mbështeten e të kualifikohen më tej mësuesit, nxënësit, drejtuesit e shkollave dhe prindërit? Çfarë shkëmbimi mund të synohet dhe realizohet midis katër shteteve pjesëmarrëse? Kush është i interesuar dhe zë një rol mbështetës në këtë diskurs?

NEZI ka potencial që në të ardhmen të përqendrohet mbi çështje shumë specifike, edhe pse atëherë ndoshta jo patjetër të gjithë pjesëmarrësit do kenë të njëjtin interes e nivel pjesëmarrjeje.

Andrea Haenni Hoti, Shkolla e Lartë Pedagogjike e Lucernit

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndhmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspektet që mund të thelloheshin më tej.

Ishte mjaft përfituese të mund të diskutoje me specialistë nga vende të ndryshme mbi demokracinë, trajtimin e minoriteteve dhe larminë kulturore. Mjaft interesante m'u dukën edhe vizitat në shkolla. Vizita që bëmë në një shkollë kosovare dhe mundësia që patëm për të diskutuar me drejtorinë e shkollës dhe stafin e mësuesve mbi temën e, përfshirjes, përfshirë edhe integrimin e të kthyerve, nxënësve invalidë dhe fëmijëve romë në shkollat kosovare, m'u duk mjaft me vlerë. Mjaft informuese për veprimtarinë time si pedagogje dhe kërkuese shkencore, ishin edhe vizita e mësimit të gjuhës e kulturës së prejardhjes shqiptare në Zvicër e veçanërisht bisedat me mësuesin e gjuhës e kulturës së prejardhjes shqiptare dhe nxënësit me sfond emigrant shqiptar. Ata më treguan edhe një herë tjetër se sa i rëndësishëm është promovimi i gjuhëve të para tek fëmijët me sfond emigrant nën këndvështrimin e zhvillimit të një identiteti dykulturore. Gjithsesi, vetë përshkrimi i nxënësve si «të huaj» shtrën për mua si humlues të akulturimit edhe pyetje si: Cilat procese të etnizimit zhvillohen brenda shkollës? Si mund të konceptohet një shkollë gjithëpërfshirëse në të cilën të gjithë nxënësit (me apo pa sfond emigrant) ndihen pjesë e saj?

Pyetja 2

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI nën këndvështrimin e metodikës së planifikimit dhe organizimit të takimeve dhe çfarë mund të përmirësohet (dhe si)?

Bashkëpunimi në rrjet m'u duk mjaft konstruktiv. Takimet, ku mund të merrja pjesë ishin të organizuara me profesionalizëm dhe mundësonin kontakte të larmishme me specialistë dhe këndvështrime interesante në politikën arsimore dhe shkollore. Barrierat gjuhësore mundën të kapërceheshin falë angazhimit të palodhur të përkthyesve. Gjithsesi, çështjet që u shtruan gjatë takimeve mund të ishin formuluar në mënyrë më precize dhe të ishin fokusuar më intensivisht. Do të ishte gjithashtu me interes të mësonim se sa kanë kontribuar takimet e rrjetit për projektet konkrete brenda politikës arsimore, praktikës shkollore, arsimimit, kualifikimit apo kërkimit shkencor.

Pyetja 3

Çfarë përfitova tjetër nga bashkëpunimi në NEZI dhe çfarë më mungoi?

Do të ishte bukur që në kuadrin e takimeve të rrjetit të mund të inicioheshin edhe publikime shkencore dhe projekte kërkimore.

Pyetja 4

Nëse NEZI do të vazhdonte, cilat do të ishin dëshirat e mia lidhur me drejtimin e këtij vazhdimi?

Do të sugjeroja që diskursin shkencor brenda rrjetit mbi kulturën e parë, të dytë dhe ndërkulturën, diskurs ky që i ka rrënjët tek tradita e formimit ndërkulturor, të zgjerohej më tej në drejtimin e pedagogjisë së diversitetit dhe pedagogjisë së gjithëpërfshirjes dhe në këtë mënyrë të trajtohen qasje teorike aktuale dhe çështje të politikave arsimore.

Pyetja 5

Nëse NEZI do të vazhdonte, cilat do të ishin propozimet e mia konkrete dhe cila do të ishte ndihmesa ime për këto projekte?

Çështjet e mëposhtme mund të përpunohen mbi bazën e prioritetin që kanë:

- Si trajtohet diversiteti në shtete të ndryshme? Si trajtohet veçanërisht larmia kulturore? Si konceptohet kombi (anglisht: ethnic vs. civic) brenda shteteve të ndryshme dhe si e ndikon ky konceptim trajtimin e larmisë kulturore? Çfarë roli luan shkolla këtu?
- Si trajtohen azilkërkuesit në shtete të ndryshme ose çfarë politikash për azil ndjekin shtetet e ndryshme? Si reagon shkolla ndaj nevojave të fëmijëve të refugjatëve dhe familjeve të tyre apo si integrohen fëmijët e refugjatëve?

**Basil Schader,
IPE Shkolla e Lartë Pedagogjike Cyrih,
anëtar i stafit drejtues të projektit**

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndhmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspektet që mund të thelloheshin më tej.

Lidhur me fokusin tematik «Edukimi për demokraci», të pestë takimet (sidomos takimet I deri III) kontribuan në mënyrë precize për thellimin e njohurive të mia. Krahas inputeve dhe fazave të diskutimeve e të shkëmbimeve lidhur me këtë, më lanë mjaft mbresa sidomos «Leksioni model» i Rolf Gollob dhe prezantimi i materialeve mësimore të EDC-së. Fokusi «Orientimi midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës», i cili u tematizua në mënyrë eksplicite sidomos gjatë takimit të parë, u mënjanua disi në sfond. Gjithsesi, duhet thënë gjithashtu se këtu bëhet fjalë për një temë tejet komplekse, për përpunimin e thelluar të së cilës ka gjasa që ky kuadër (dy konferenca-vit) nuk përshtatet optimalisht. Për të do ishin ndoshta më të përshtatshme takime disaditore me përfshirjen intensive të të rinjve të prekur nga kjo tematikë nga shtete të ndryshme (p.sh. të rinj shqiptarë në Zvicër, apo të rinj nga Zvicra në shkolla të një natyre ekstreme multikulturore në Zvicër), romët në Shqipëri, Maqedoni, anëtarë të minoritetit sllav apo minoriteteve të tjera në Kosovë).

Më intensivisht sesa fokusin «Orientimi midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës», përjetova përfitim të njohurive e informacioneve lidhur me temën e shkollës, MGJP-së dhe formimin e mësuesve. Inputet e lidhura me këto, prezantimet, fazat e shkëmbimeve dhe sidomos, edhe vizitat shkollore në Kosovë, Maqedoni dhe Zvicër (të mbështetura e strukturuara me detyra dhe instrumente vëzhguese), përçuan impulse mjaft me vlerë dhe krijuan raste për pikëpamje autentike dhe diskutime të frytshme. Një thellim dhe vijim i këtyre vizitave, mundësisht edhe me më tepër diskutime me mësuesit dhe nxënësit, do të ishte një projekt tërheqës.

Pjesëmarrja në rrjet dha natyrisht një ndihmesë mjaft të vlefshme edhe në lidhje me njohuritë e thelluara të vendeve pjesëmarrëse dhe sistemeve të tyre shkollore, problematikave etj. Shpërndarja e konferencave në katër vendet pjesëmarrëse dhe inputet, prezantimet specifike të shteteve, ishin jashtëzakonisht informuese dhe të zgjerorin horizontin.

Pyetja 2

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI nën këndvështrimin e metodikës së planifikimit dhe organizimit të takimeve dhe çfarë mund të përmirësohet (dhe si)?

Organizimi dhe planifikimi i pesë konferencave ishte i komplikuar dhe kërkonte punë intensive, por rezultatet që solli ishin mjaft positive. (Këtë gjë po e formuloj nga pikëpamja e bashkëpjesëmarrësit.). Të gjitha çështjet organizative mundën të zgjidheshin në mënyrë optimale nëpërmjet takimeve paraprake të punës me grupet përkatëse të shteteve dhe falë bashkëpunimit të tyre të angazhuar, nuk pati pengesa të mëdha. Me shumë vlerë ishte edhe mbështetja e punonjësve të IPE-s në Cyrih për porositjen e biletave, përgatitjet e detajeve në Cyrih etj. Vështirësi krijuan edhe mungesat në grupin drejtues, të cilat vetëkuptohet ishin të gjitha të justifikuara (sëmundje, shtatzëni, bursat semestrale për hulumtim), por prapëseprapë krijuan një ngarkesë pune të pabarabartë gjatë organizimit.

Një konceptim formal tërheqës dhe një rrjedhë stimuluese e takimeve të veçanta u konceptuan që në fillim si pika me mjaft rëndësi. Pesë takimet e rrjetit duhet të paraqisnin në mënyrë të vetëdijshme një kundërtënie me konceptimet e deritanishme të konferencave mjaft të ngjeshura me referime dhe me karakter konsumator. Ato duhet të përçonin, si të thuash, në një nivel të dytë stimuluj dhe impulse të transferueshme për një organizim bashkëkohor takimesh, që mund të përdoret edhe në kontekste të tjera. Tek elementet inovativë të përdorur për konceptimin dhe rrjedhën e takimeve, përfshihen ndër të tjera tryezat e rrumbullakëta, prezantimet dhe diskutimet e përgatitura paraprakisht nga grupet e shteteve të veçanta, vizitat në shkolla, vëzhgimet e strukturuar të mësimit, një model leksioni, inpute të shkurtra nga ekspertë, sekuenca kohore të shpeshta e të bollshme për shkëmbime në grupet e ndryshme të krijuara dhe pa harruar një program për pushimet që krijoj rast për biseda të thelluara. Referimet për ndërtimin e detajuar të takimeve të veçanta gjenden në programet I deri V të këtij volumni.

Reagimet lidhur me këtë formë konceptimi ishin mjaft positive, në veçanti u vlerësuan mundësitë e shkëmbimit në fazat e diskutimeve me konstelacione të ndryshme. U sugjerua që atyre t'u lihej më tepër kohë në dispozicion, gjë që ka të ngjarë se kërkon zgjatjen e konferencave të veçanta me të paktën dy ditë.

Mjaft efektive ishin detyrat që iu shpërndanë pjesëmarrësve përpara takimeve të veçanta dhe që në shumicën e rasteve duheshin kryer brenda grupeve të shteteve (ALB, KOS, MAK, CH ch dhe CH alb) dhe që në fund demonstroheshin p.sh. me një prezantim të vogël. Këto detyra garantonin që pjesëmarrësit ishin të përgatitur lidhur me përmbajtjet dhe të aktualizuar me temën përkatëse të takimit.

Arkivi elektronik i rrjetit (<http://www.phzh.ch/de/ipe/Projekte-und-Mandate/Europaweite-Projekte/Netzwerk-Albanischer-Sprachraum/>) nuk u përdor ndoshta shumë intensivisht, por ai e përmbush misionin e vet si bazë të dhënash dhe vendndodhje dokumentacioni.

Pyetja 3

Çfarë përfitova tjetër nga bashkëpunimi në NEZI dhe çfarë më mungoi?

Krahas njohurive të përmendura mbi përmbajtjet dhe përvojat didaktike të konferencave, veçanërisht pozitive m'u dukën sidomos kontaktet e mira personale dhe diskutimet e angazhuara që i kapërcenin kufijtë e grupeve të vendeve e gjuhëve të ndryshme. Si anëtar i stafit drejtues pata rastin që në kuadër të takimeve përgatitore në Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri, të krijoja kontakte të ngushta dhe miqësore dhe të shkëmbeja përvoja me grupet përgjegjëse për konferencat e atjeshme. Gjatë takimeve gëzohesha shumë të shihja se sa shpejt vendoseshin kontakte që i kapërcenin kufijtë e shteteve dhe grupeve dhe, se si anëtarët e grupeve të ndryshme shkëmbenin mendimet me njëri-tjetrin në situata komunikimi të hapura, intensive dhe të përzemërta. Një rol vendimtar luajtën këtu edhe programet e mbrëmjeve dhe programet kornizë. Fakti që për darkat u zgjodhën restorante të përshtatshme, me atmosfere të këndshme dhe tradicionale për vendin dhe fakti që në çdo shtet u ofruan edhe ture qytetesh dhe një pjesë kulturore kontribuoi për ndërtimin e marrëdhënieve joformale, gjë që luan një rol të padiskutueshëm për bashkëpunimin e ardhshëm dhe ishte pa dyshim mjaft i vlefshëm.

Ajo që më mungonte herë pas here ishte një kohë dhe hapësirë më e bollshme për vijimin e diskutimeve interesante, për të njohur më mirë karakteristikat lokale ose për të kryer vizita shtesë në shkolla etj. Për këtë qëllim do të nevojitej një planifikim tjetër kohor i konferencave të veçanta (p.sh. një shtrirje kohore nga 2–4 ditë), gjë që ishte e pamundur brenda kuadrit të dhënë. (Një përjashtim përbënte takimi i pestë, i cili në përfundim të projektit u shtua me një «ditë kulturore».)

Përbërja disi heterogjene e profesioneve të pjesëmarrësve (studiues dhe pedagogë nga disiplina të ndryshme sociale, pedagogë të fushës pedagogjike, pjesëmarrës të niveleve ministeriale dhe nga fusha e shkollës), solli shumë përparësi dhe mjaft diskutime tërheqëse me shumë perspektiva. Për thellimin dhe fokusimin e aspekteve të caktuara do të kishte qenë ndoshta më mirë një përbërje më homogjene e grupit, pasi në këtë mënyrë mund të niseshe në mënyrë më efektive nga parakushte të ngjashme e respektivisht të bazohesh tek to. Besoj se kjo përvojë e këtij projekti pionier, mund të shfrytëzohet mjaft mirë në aktivitete të mundshme vijuese dhe mund të merret fort në konsideratë për formimin e rrjeteve të ngjashme në të ardhmen.

Pyetja 4

Nëse NEZI do të vazhdonte, cilat do të ishin dëshirat e mia lidhur me drejtimin e këtij vazhdimi?

Nga përvojat mjaft produktive gati trevjeçare me rrjetin e kulturës së parë, të dytë dhe të ndërkulturës, rezultojnë dëshira dhe nxitje në tri këndvështrime:

- a** Lidhur me përmbajtjet: Ndoshta një fokusim më intensiv tek një (apo dy deri në tri) tema të pjesshme të përkufizuara saktësisht, të cilat përpunohen në mënyrë të thelluar. Kjo duhet parë së bashku me ngritjen e grupit të pjesëmarrësve (shih më poshtë) dhe sipas rastit edhe së bashku me aspektet organizative (lloji i projekteve / fokuset, kohëzgjatja e takimeve).
- b** Lidhur me ngritjen e grupit të pjesëmarrësve: Medoemos duhet ruajtur përbërja shumëkombëtare. Ajo lejon diskutime dhe përvoja interesante mbi kufijtë e vetëkulturore dhe brenda kulturave. Por sipas rastit (lidhur me fokuset e përmbajtjeve) duhet një kompozim më homogjen i pjesëmarrësve (p.sh. përqendrimi tek specialistë nga shkollat e larta pedagogjike apo mjedisi i tyre ose tek sociologët etj.). Një mundësi tjetër do të ishte që, duke ruajtur strukturën heterogjene, të formoheshin nën-grupe të cilat do të merreshin me aspekte të veçanta të një teme të përbashkët, që i përgjigjen profilit të kualifikimit të tyre.
- c** Nga pikëpamja organizative: Patjetër sërish takime në vendet e ndryshme me hapësira të mjaftueshme për të njohur karakteristikat lokale, arritjet dhe problemet. Patjetër duhet të ketë gjithashtu kohë të mjaftueshme për shkëmbim e diskutime. Ndoshta duhen planifikuar takime apo ditë pune më të gjata (në rastin e zhvillimit në kuadrin e projekteve të pjesshme), p.sh. 2–3 ditë. Ndoshta një përdorim më i gjerë i mundësive të shkëmbimeve në rrugë elektronike, përfshirë videokonferencat, skype etj.

Pyetja 5

Nëse NEZI do të vazhdonte, cilat do të ishin propozimet e mia konkrete dhe cila do të ishte ndihmesa ime për këto projekte?

Kompetencat e larmishme të pjesëmarrësve lejojnë zhvillime të mëtejshme dhe thellime në këndvështrime të ndryshme. Kjo lidhet nga njëra anë me mënyrën e qasjes dhe metodologjinë: a) Temat duhet të jenë më të orientuara ndaj teorisë dhe të lidhura me kërkimet (p.sh. për çështjet e identitetit apo për aspektet gjuhësore). b) Më tepër projekte që lidhen me zbatimin (p.sh. lidhur me implementimin e EDC-së apo MGJP-së së shqipes). c) Puna me çështjet që lidhen me një qasje të fortë empirike (p.sh. anketime, intervista etj. dhe vlerësimi i tyre). Nga ana tjetër, kjo larmi e vijimeve të mundshme ka të bëjë natyrisht edhe me një gamë të gjerë përmbajtjesh të mundshme, siç u bë e qartë më sipër me anë të disa shembujve.

Sidoqoftë, për projektet vijuese është i rëndësishëm përkufizimi i një kornize të qartë e të përbashkët, ku sqarohen kuadri kohor (p.sh. kufizimi tek projektet që mund të mbyllet brenda një viti), ku deklarohen qartë mjetet financiare që i vendosen në dispozicion çdo projekti të pjesshëm dhe që i vendos të gjithë projektet e pjesshme të iniciuar nga pjesëmarrësit nën një perspektivë të përbashkët, të realizueshme dhe të aprovuar edhe nga donatori.

Po tërhiqem këtu nga formulimi i ideve personale konkrete për vazhdimin e projektit, pasi në qendër të aktiviteteve të mia për vitin 2016 do të jetë pikësëpari redaktimi final i këtij vëllimi të plotë.

Grupi shqiptar i Zvicrës (Pjesëmarrësit/et nga Zvicra me origjinë shqiptare)

**Shqipe Bajrami-Grohs,
Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut,
anëtare e stafit drejtues të projektit**

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndihmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspektet që mund të thelloheshin më tej.

Unë kam përfituar shumë sidomos nga tematika «Edukimi për demokracinë». Për sa u përket përmbajtjeve u lidhën me njëra-tjetrën teoria dhe praktika. Kjo mund të ilustrohet mirë me shembullin e takimit të Shkupit. Gjatë prezantimeve u tematizuan aspekte të ndryshme të formimit demokratik, gjatë vizitave të mësimit u pa se formimi demokratik nuk mund të jetë thjesht një formim shkollor, por edhe një shkollë jete, nëse bashkojnë format dhe përmbajtjet e duhura. Gjithashtu u bë e qartë se kjo nuk është diçka e vetëkuptueshme. Kështu kemi arritur tek tema «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura»:

Këtu u bë e qartë se të mësuarit demokratik është i mundur edhe midis gjuhëve. Nxënësit i dëgjuan çështjet në anglisht, morën një përkthim në gjuhën standarde shqipe dhe i diskutuan ato në dialekt apo sociolekt, megjithatë ishte e qartë se në këtë mënyrë realizohet të nxënit. U çudita se sa efektiv mund të jetë mësimi në një klasë të tretë. Gjatë temës së një bime u arrit t'u tregohej nxënësve se si funksionojnë rregullat bazë demokratike dhe respekti ndaj të tjerëve.

Vëzhgimi i mësimit në Shkup na dha mundësinë të shohim se si zhvillohet mësimi atje dhe se si është infrastruktura shkollore. U zhvillua një mësim interaktiv dhe nga ana metodike dhe didaktike mësimi ishte i ngjashëm si në Zvicër apo në një vend tjetër të Evropës Perëndimore, gjë që i çuditi pozitivisht mjaft nga pjesëmarrësit.

Përveç vizitave shkollore ishin edhe referimet nga disiplinat e ndryshme të cilat më mundësuan një depërtim të thelluar në sistemin arsimor, konceptimet pedagogjike dhe reformat e procesit në shtetet anëtare. Falë përvojës sime shumëvjeçare si përçuese e gjuhës dhe kulturës në Zvicër, para takimeve të NEZI-t u mora me temën «Dinamika e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash», por NEZI më mundësoi thellimin e këtij kompleksi tematik duke i kapërcyer kufijtë e vendeve dhe disiplinave.

Pyetja 2

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI nën këndvështrimin e metodikës së planifikimit dhe organizimit të takimeve dhe çfarë mund të përmirësohet (dhe si)?

Mjaft të rëndësishme m'u dukën plotësimet e referateve nëpërmjet punës në grupe dhe diskutimeve të përbashkëta, dhe veçanërisht vizitat shkollore të cilat sollën një depërtim të thellë në kulturat përkatëse të mësimdhënies e mësimnxënies. Fjalët përshëndetëse bënë të qartë për të ftuarit rëndësinë e projektit dhe gjithashtu demonstuan ndryshimet gjatë vetëprezantimeve të institucioneve. Ndonjëherë mungonte ndoshta hapësira për diskutime e biseda të thelluara, kështu që në këtë pikë programi i ngjeshur, ndoshta duhej përshtatur pak.

Pyetja 3

Çfarë përfitova tjetër nga bashkëpunimi në NEZI dhe çfarë më mungoi?

Kontaktet e larmishme dhe kontakti i rregullt janë aspekte nga të cilat mund të përfitosh më tej dhe horizonti im u zgjerua jashtëzakonisht. Mora shumë informacione mbi institucionet dhe veçanërisht mbi sistemet shkollore të shteteve të veçanta dhe mësova të kuptoj gjithashtu më mirë edhe dinamikën e secilit shtet. Vetëm kështu arrita të kuptoj që këtu po lind një fushë kërkimore interesante dhe pak e përpunuar. Falë bashkëpunimit mësova të kuptoj më mirë situatën e minoriteteve në Kosovë.

Pyetja 4

Nëse NEZI do të vazhdonte, cilat do të ishin dëshirat e mia lidhur me drejtimin e këtij vazhdimi?

Duhen formuar grupe të cilat do të përqendrohen në mënyrë më të fokusuar tek temat e veçanta, e jo grupe të rastësishme të hedhura me short, pasi në këtë mënyrë diskutimet do të mbeten sipërfaqësore. Shkëmbimi midis vendeve pjesëmarrëse duhet vazhduar e përforcuar, për këtë qëllim do të ishte mjaft me vend një fokusim. Ndoshta mund të integroheshin intensivisht institucione arsimore për të përforcuar shkëmbimin midis akademisë dhe praktikës, për të fituar akses të reja dhe për të siguruar transferimin e rezultateve të projektit në praktikën arsimore. Do të ishte e dëshirueshme përfshirja më

intensive e minoriteteve, veçanërisht në Kosovë dhe Maqedoni, në mënyrë që të përmbushet pretendimi i projektit. Gjithashtu është e domosdoshme edhe përfshirja më intensive e komuniteteve të gjuhës shqipe dhe e «Dytësorit» (Secondo/as) në Zvicër.

Pyetja 5

Nëse NEZI do të vazhdonte, cilat janë propozimet e mia konkrete dhe cila do të ishte ndihmesa ime për këto projekte?

Siç e kuptova në kuadrin e takimeve nga mendimet e një numri të madh të pjesëmarrësve ekziston dëshira e përbashkët që NEZI të vazhdojë në një lloj forme. Falë njohjeve të krijuara u formua një bazë besimi dhe një identifikim me temat e përpunuara së bashku. Në këtë mënyrë mund të punohej në mënyrë cilësore, ndoshta në grupe të vogla të preken tema konkrete dhe të planifikohen projekte.

Si pjesë e drejtimit të NEZI-t do të isha e gatshme të vija në dispozicion përvojat e mia të punës dhe do t'i përkushtohesha një teme të rrjetit.

Ylfete Fanaj, përgjegjëse për çështje të integritetit të kantonit të Nidwaldenit

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndhimë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspektet që mund të thelloheshin më tej.

Në fillim isha e pasigurt nëse mund të jepja edhe unë një ndihmesë në rrjet në rolin e «Seconda-s». Unë nuk kam një formim pedagogjik, por kam studiuar punë sociale dhe jam e angazhuar politikisht. Shpejt vura re se këto përvoja profesionale dhe politike dhe biografia ime si dhe përvojat e të rriturit midis përfytyrimeve të ndryshme kulturore dhe mbi vlerat, lidhen ngushtë me NEZI-n. Besoj se ne, «Secondas» e pranishëm, arritëm të japim një ndihmesë dhe përfshirja e përvojave tona të larmishme ishin me rëndësi sidomos për ekspertët nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria.

Shkëmbimi intensiv gjatë takimeve tematike ishte mjaft pasurues. Puna përgatitore ishte e rëndësishme dhe thelloi bashkëpunimin brenda pjesëmarrësve nga Zvicra. Bash-

këpunimi në NEZI për një kohë mbi dy vjet kishte përparësinë e njohjes së pjesëmarrësve dhe shkëmbimi ishte i lirshëm. Grupi me pjesëmarrës nga disiplina e katër shtete të ndryshme, si dhe sfondet e ndryshme profesionale më mundësuan një vështrim të gjerë mbi situatën. Të gjithë partnerët nga të gjitha shtetet shtojnë çështje të ngjashme, por ndodhen në vende të ndryshme të realizimit. Vizitat mësimore nëpër shkolla ishin të shkurtra, por kjo përvojë si dhe kontakti i drejtpërdrejtë me stafin mësimdhënës, më treguan shumë lidhur me cilësinë e mësimi dhe mbi sfidat shoqërore dhe politike.

Pyetja 2

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI nën këndvështrimin e metodikës së planifikimit dhe organizimit të takimeve dhe çfarë mund të përmirësohet (dhe si)?

E vlerësova faktin që organizuam paraprakisht punë përgatitore dhe që në këtë mënyrë u zhvillua një bashkëpunim edhe jashtë kuadrit të takimeve. Gjithashtu me mjaft vlerë për mua ishin edhe vizitat mësimore. Më erdhi keq që duhet të udhëtonim menjëherë pas takimeve dhe që sidomos shkëmbimi me pjesëmarrësit nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia u kufizua vetëm gjatë kohës së konferencave.

Përzierja e metodave të referimeve, prezantimeve, punës në grupe, referateve të shkurtra gjetën një balancë të mirë me njëra-tjetrën. Por gjithsesi programi ishte shumë i ngjeshur, vetëkuptohet që organizatorët kanë dashur ta shfrytëzojnë mirë kohën. Më pak mund të jetë edhe më shumë.

Loja me role e Rolf Gollob lidhur me edukimin për demokracinë, m'u duk mjaft mbresëlënëse. Mendoj se lojërat e simulimit dhe ato me role si dhe elementët e rinj surprizues e çlirojnë atmosferën dhe nxisin krijueshmërinë.

I vlerësoj përshëndetjet e mikpritësve, por disa prej tyre edhe mund të ishin shmangur.

Pyetja 3

Çfarë përfitova tjetër nga bashkëpunimi në NEZI dhe çfarë më mungoi?

Arrita të lidh miqësi dhe kontaktet me ta i kam ende dhe mund ti aktivizoj. Nga NEZI u zhvillua diçka konkrete: Më 19 shtator 2014, pjesëmarrësit e NEZI-t nga Zvicra organizuan një koncert me muzikantë nga Prishtina.

Pyetja 4

Nëse NEZI do të vazhdonte: Cilat do të ishin dëshirat e mia lidhur me drejtimin e këtij vazhdimi?

Besoj se duhet menduar sërish nëse takimet duhet të zgjasin më tepër dhe nëse duhen tematizuar më shumë tema konkrete. Gjithashtu mund të mendohet se si të përfshihen në projekt studentë nga shkollat e larta pedagogjike nga Zvicra dhe shtetet e tjera.

Lidhur me drejtimin, mendoj se duhet investuar për kualifikimin e mëtijshëm të mësuesve dhe kjo iniciativë të mbështetet konkretisht në Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë me formimin e një rrjeti.

Pyetja 5

Nëse NEZI do të vazhdonte, cilat janë propozimet e mia konkrete dhe cila do të ishte ndihmesa ime për këto projekte?

Do të isha e gatshme të sillja përvojat e mia nëse nevojitet diçka e tillë.

Rifat Haxhijaj, Universitetin e Genfit dhe të Prishtinës

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndhmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspektet që mund të thelloheshin më tej.

Bashkëpunimi në rrjetin NEZI është shumë me vend dhe ka dobi shumëdimensionale. Në njërin anë, fakti që gjatë konferencave ka takime në tematika konkrete dhe shkëmbime idesh në mes të specialistëve të shteteve të ndryshme e me përvoja që mund të ndërlihen, konkluzionet që rrjedhin nga takimet mund të kenë fuqi të veçantë, qoftë në aspektin shkencor, qoftë në aspektin praktik.

Së dyti, rëndësia është edhe më e theksuar për shtetin Zvicëran, sepse shkëmbimet në mes të specialistëve të këtij domeni mund të nxjerrin në evidencë pista dhe sugjerime, e të cilat ndër të tjera, mund të jenë të frytshme në rritjen e komunikimit dhe përafrimin e individëve dhe grupeve me sfond kulturor të ndryshëm, e gjithë kjo me qëllim rritjen e kohezionit të përgjithëshëm të shoqërisë multikulturore zvicerane. Gjithashtu, një dobi të veçantë nga ky rrjet mund të kenë edhe shtetet e Ballkanit, të cilat kishin një përvojë të ndryshme të edukimit në të kaluarën e afërt, në dallim nga ajo që është prezente dhe në zhvillim e sipër me dekada të tëra në demokracitë e Evropës Perëndimore.

Rrjeti NEZI dhe objektivi i tij në orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës si dhe të edukimit për qytetari demokratike

Të jesh i ri dhe me origjinë shqiptare në Zvicër, ndër të tjerat do të thotë të ndeshesh me problematika specifike ndërkulturore brenda- dhe jashtëfamiljare, qoftë në sferën private dhe atë publike, e të cilat nëse nuk trajtohen në kohën dhe formën e duhur, mund të reflektohen negativisht jo vetëm në shëndetin shpirtëror, por edhe në projektimet e ardhme socio-profesionale të të rinjëve. Kjo do të thotë, të rinjtë me origjinë të huaj, përpos alternativave të cilat u shfaqen në momente vendimtare të jetës, mund të ndodhen edhe përballë dilemave dhe ambivalencave të mëdha, të identifikohen më shumë me kulturën (urbane) të vendit ku jetojnë, apo me atë (kryesisht rurale) të prindërve dhe të kulturës së tyre të origjinës. Gjithashtu, të rinjtë duke jetuar në një shtet siç është Zvicra, me një shkallë të lartë stabiliteti politik dhe ekonomik, ndër të tjera me sigurime sociale të përsosura, as që mendojnë për t'u kthyer në vendin origjinë të prindërve. Në anën tjetër, prindërit e po këtyre të rinjve, kryesisht të orientuar rreth aktiviteteve profesionale, fizike dhe të sigurimit të bazës financiare për një jetë më të qëndrueshme ekonomike, janë në pamundësi të perceptojnë tërësinë e jetës sociale në vendin ku jetojnë. Këta të

fundit, duke mos braktisur asnjëherë idenë e kthimit në vendin e tyre origjinë, qëndrojnë shpirtërisht të lidhur me projektimet afatshkrurtëra dhe afatgjata e që kanë të bëjnë me vendlindjen. Në këtë mënyrë dhe duke pasur perceptime të ndryshme për realitetin që i rrethon të rinjtë dhe prindërit e tyre, por edhe duke pasur projekte konceptualisht diametrale rreth të ardhmes së tyre, konfliktet mund të jenë prezente sidomos në periudhat e jetës ku merren vendime të rëndësishme siç janë: Rrethi shoqëror, projekti profesional, martesë, solidariteti brenda- dhe jashtëfamiljar, si dhe investimet financiare.

Kompleksiteti mund të rritet nga fakti se të rinjtë kalojnë proporcionalisht kohë të përafërt në shtëpi dhe në shkollë (aspekti pedagogjik i ndryshëm dhe kundërtësues me atë familjar), bën që ata të ndeshen vazhdimisht dhe paralelisht me kulturën kryesisht tradicionale të prindërve të tyre, por edhe me kulturën institucionale e, kjo e fundit reflektohet nëpërmjet institucioneve të vendit ku ata jetojnë. Pra, në këtë trekëndësh kulturash, është më se e rëndësishme të ketë një shpjegim shkencor të këtij fenomeni, por edhe pista në përafrimin e këtyre kulturave, me qëllim të mundësimin të bashkëjetesës dhe harmonisë së tyre sa më të qëndrueshme. Në këtë mënyrë mund të zvogëlohen ndieshëm problemet shoqërore. Këtu nuk duhet harruar roli i veçantë që mund të luajë nëna e emigruar shqiptare, kryesisht e preokupuar rreth punëve të shtëpisë dhe me fare pak kontakte me sferën publike jashtështëpiake. Në këtë aspekt, ajo jo vetëm që ka njohuri shumë të reduktuara për gjërat që e rrethojnë, por edhe ato pak njohuri që zotëron, mund të jenë shumë sipërfaqësore dhe joreale, sepse janë të bazuara në interpretimet e të tjerëve.

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe e realizimit/zbatimit të konferencave, dhe çfarë mund (si) të përmirësohet?

Nga arsyet e lartpërmendura dhe pikërisht duke u bazuar në strukturën dhe bagazhin profesional të anëtarëve të rrjetit NEZI, rëndësia e këtij rrjeti si për shtetin Zvicran, si për të emigruarit me origjinë shqiptare, por edhe për shtetin e tyre origjinë, është shumë e evidente. Në mënyrë që rezultati i kësaj nisme të jetë teorikisht edhe më i kapshëm, shkencërisht i pranueshëm dhe i lexueshëm, por edhe realisht i dukshëm në publikime konkrete, ka hapësirë që disa gjëra të korrigjohen eventalisht. Zhivillimi i konceptve në lidhje me fenomenet e bashkëzotësisë së disa kulturave si dhe ndikimet e tyre eventuale në dinamikën shoqërore në Zvicër, do të ishte e dobishme si për autoktonët aq edhe për të emigruarit. Në njërin anë, Zvicra si një vend me një shumëllojshmëri kulturore, duke njohur aspektet specifike të kulturës shqiptare, si edhe të kulturave tjera të grupeve të emigruara, do të kishte mundësi të nxirrte projekte politikash për prandalim të konflikteve

të mundëshme brendafamiljare, gjë që do të ndikonte në mënyrë direkte edhe në ngjitjen e nivelit të kohezionit social dhe të paqes sociale në përgjithësi. Ne anën tjetër, do të mund të propozohej alternativa për gjetjen e pistave të përafrimit të prindërve shqiptarë, fillimisht me kuturën e fëmijëve të tyre (bazë e cila do të shërbente për kontakte direkte, ndërveprime sociale) dhe me vonë, njohje sa më të mirë edhe të rrethit në të cilin ata praktikisht jetojnë.

Pra, për t'u arritur rezultate edhe më të prekshme në këtë drejtim, disa pista reflektimi janë të mundshme:

a Fillimisht, do të ishte e rëndësishme të qartësohet principi pjesëmarrës dhe baza e këtyre reflektimeve gjatë komunikimeve dhe konferencave të NEZI-t.

Në të vërtetë, fakti që në Zvicër prezenca e shqiptarëve të Kosovës është numerikisht më e madhja (pasojnë ata nga Maqedonia dhe Kosova lindore), fokusi i këtij grupi do të duhej të kishte për bazë këtë realitet. Gjithashtu, duke u nisur nga ajo që emigracioni nga Shqipëria është kryesisht i orientuar drejt Greqisë, Italisë dhe Anglisë, do ishte mirë të rishikohet rëndësia praktike e qëndrimit të grupit nga Shqipëria në rrjetin NEZI në formën aktuale. Kjo do të rezultonte jo vetëm me zvoglimin e numrit të pjesëmarrësve, por duke pasur një numër të reduktuar të personave, konferencat do të ishin më dinamike edhe produktiviteti i pjesëmarrësve do të ishte më i madh. Eventualisht, pjesëmarrja e grupit nga Shqipëria do të ishte e mirseardhur vetëm në konferencat ku do të flitej për «Edukimin për demokraci ...». Në këtë rrafsh, grupi nga Zvicra (autoktonët dhe ata me origjinë shqiptarë) duke u bazuar në njohuritë teorike por edhe në ato praktike nga përditshmëria e jetës së tyre në Zvicër, do ta kishin më lehtë të kontribuojnë më konkretisht në sferën e edukimit në demokraci.

b Në radhë të dytë, do të duhej të përkufizohej më qartë objektivi i rrjetit NEZI.

Fakti që rrjeti ka dy objektiva kryesorë «Orientimin në mes të kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci (në lidhje me bashkëvendosje, pjesëmarrje, sjellje demokratike, me rolet e dy gjinive, me zakonet, me kohën e lirë etj ...)» sipas mendimit tim, pamundëson trajtimin paralel dhe të thukët të këtyre dy objektivave. Për këtë arsye, ose këta objektivë duhet të trajtohen si të ndarë në grupe të ndryshme pune, ose njeri nga ta duhet të mos trajtohet fare në formën aktuale dhe në kuadër të rrjetit NEZI. Në të vërtetë, objektivi që do të duhej të ishte prioritar në Zvicër, është ai që merret me aspektin e ndërkulturës. Në këtë rrafsh, ekipi i ekspertëve nga Zvicra, do të mund të bazohej jo vetëm në njohuritë teorike në lidhje me shoqëritë tradicionale dhe ndërveprimet në mes të tradicionales dhe bashkëkohores, por në të gjitha elementet dhe njohuritë konkrete të furnizuara nga ekipet shqipfolëse të Ballkanit. Gjithë kjo do të jepte një dinamikë shumë më konkrete reflektionit dhe konkluzioneve initiale apo atyre finale, dhe duke u nisur në impaktin e drejtpërdrejtë që mund të këtë kjo përzierje kulturash në jetën e përditshme të emigraci-

oneve në Zvicër, rrjeti do ta kishte edhe më të lehtë të propozonte pista apo sygjerie më të thukta. Në këtë drejtim, pjesëmarrësit nga Kosova dhe Maqedonia do të ishte më mirë të ishin ekspertë në rrafshin e etnologjisë, sociologjisë dhe pedagogjisë sociale. Me një ekip të tillë dhe me një bashkëpunim të ndërsjellë me ekspertët zviceranë, do të mund të krijohej një bazë solide për hulumtime të nivelit shkencor të përmasave ndërkombëtare të cilat të bazuara në njohuritë e dëshmuara, do përfilleshin edhe më shumë nga të gjitha institucionet relevante, si në vendet e Ballkanit po ashtu edhe në Zvicër.

- c Ne radhë të tretë, do të duhej të qartësohej finaliteti i rrjetit NEZI.** Në të vërtetë, mendoj se do të duhej të përkufizohej sa më thukët cili është objektivi final dhe cilët mund të jenë nën objektivat e mundshëm, si edhe etapat në realizimin e tyre, që do të kishin për qëllim realizimin sa më të qartë të objektivit final. Pra, në se mbahet si qëllim thelbësor ngritja e nivelit të kontakteve të të emigruarve me institucionet zvicerane, apo të të emigruarve me kultura të ndryshme (midis tyre) dhe të tyre me institucione zvicerane, gjithë kjo me qëllim të rritjes së kohezionit social dhe bashkëjetesës, duke zvogëluar kështu paragjykimet dhe klishtë të ndërsjella, fokusi i reflektimit do të duhej të orientohej në atë drejtim. Në të kundërtën, nëse nga ky reflektim pritet të nxirren vetëm konkluzione të dobishme dhe të pranueshme shkencore edhe në rrafshin ndërkombëtar, fokusi do të orientohej në drejtim tjetër. Ose, nëse qëllimi final është "Edukimi për demokraci..." reflektimi i këtij grupi do të duhej të ishte vetëm njëkahësh, nga Zvicra në drejtim të shteteve të Ballkanit. Siç e përmenda edhe më lart, në këtë rast, objektivi parimor do të ishte ndihma drejt trojeve shqipfolëse të Ballkanit, me qëllim të përsheptimit të integritimit sa më të shpejtë të të gjitha njohurive që kanë të bëjnë me edukimin dhe demokracinë.

Pyetja 3+4

-

Pyetja 5

Nëse projekti NEZI do ta kishte një vazhdimësi: Cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dhe çfarë mund të kontribuoj unë personalisht për këto projekte?

Me shpresë se rrjeti NEZI do të ketë vazhdimësi dhe qëndrueshmëri, duke u bazuar në rëndësinë e bashkëpunimit në mes të ekspertëve të tematikave të rëndësishme e të lidhura në mënyrë direkte me ndërkulturën, mendoj se në të ardhmen e afërt do të ishte e arsyeshme të formohen grupe pune në tematikat në vijim:

- Identiteti dhe ndërkultura.
- Marrëdhëniet ndërinstytucionale/ndërshtetërore.
- Raportet femijë, prind, shkollë.
- Besimi dhe ndikimi i tij në raportet ndërkulturore.
- Riatdhesimi dhe roli i shtetit origjinë.

Në rast se një gjë e tillë realizohet, unë propozoj të jem bartës i njërit nga këto grupe, për të koordinuar reflektimin, për të rishikuar konkluzionet dhe bërë finalizimin e shkri-meve apo publikimeve eventuale. Duke u nisur nga fakti që në nivelin profesional kam arritur të krijoj njohuri teorike dhe praktike në rrafshin e Identitetit dhe ndërkulturës, dëshirë të veçantë do të kisha të merresha me këtë tematikë. Vlen të shtoj se njohuritë në këtë tematikë mund të ketë përmasa edhe më të gjëra në rast të bashkëpunimit me hulumtues të tjerë të këtij domeni. Këto njohuri, do të ishin të ndër lidhura ngushtë edhe me zbatueshmërinë e tyre praktike në domenin e të emigruarve me origjinë nga vendet shqipfolëse nga Ballkani. Megjithatë, duke u nisur nga rëndësia e secilës nga tematikat që propozova, jam i hapur të koordinoj edhe ndonjë nga tematikat tjera, por duke mos garantuar produktivitetin e nivelit të njëjtë si në rastin e parë.

Shpresa Jashari, Universiteti Neuchâtel

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndihmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Menjëherë më entuziasmoi idea e një rrjeti ndërkombëtar që do të merrej me çështje të integritit dhe izolimit social dhe demokratik, si dhe në mënyrë indirekte dukej sikur do të përfshinte në të një nga përvojat më dominuese të të nxëniet të kohës së rinisë sime: Përvojën e trajtimit në mënyrë të pabarabartë dhe atë që buronte nga maksima e «drejtësisë së krahastuar». Në një kohë kur unë, si shqiptare në Zvicër, përjetoja atë që mësuesi im zviceran në shkollën e mesme «nuk mund ta shihte», ishte e qartë se fjalja e xhaxhait tim në Maqedoni rreth nxënësve romë me natyrë të supozuar «dembelë në të mësuar», nuk mund të qëndronte. Kjo qasje krahasuese rreth çështjeve të pjesëmarrjes së minoriteteve është aplikuar tek NEZI, gjë që ofron mundësinë e vënies në fokus të karakterit strukturor të diskriminimit, në vend që të humbasim në diskutime sipërfaqësore rreth diçkaje «tjetër kulturore». Këtë do të mund ta kishim përdorur si pjesë të rrjetit, por për fat të keq mbe-
ti diçka abstrakte.

Përsa u përket dy temave kryesore, asaj të «përkrahjes në orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «edukimit për qytetari demokratike», mund të them se veçanërisht për çështjen e dytë kam mësuar shumë gjëra të reja, duke përmendur këtu prezantimet interesante, demonstrimet e mjeteve të mësimdhënies, vizitën në shkollë gjatë Konferencës në Shkup, gjithashtu dhe diskutimet jozyrtare në kampusin universitar në Prishtinë rreth mjeteve që ndikojnë në marrëdhëniet e studentëve dhe afërsitë e tyre me partitë politike (qofshin këto të supozuara ose të faktura).

Në mënyrë të përgjithshme mund të them personalisht se pjesa e bazuar në përvoja, pa vizitat nëpër klasa etj., por edhe fakti që çdo konferencë u mbajt në një vend tjetër relevant me temën, ishte një fitore e madhe. Kjo qasje që një ndihmesë për informacionet e mbledhura në ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe të dimensioneve të shumta.

Falë kumtesave të pjesëmarrësve nga disiplina të ndryshme relevane rreth dy temave kryesore, kam marrë njohuri më të thelluara në punën politiko-arsimor, sistemin arsimor dhe të institucioneve përkatëse dhe proceseve të zhvillimit të vendeve të ndryshme, që pa ndihmën e NEZI-t, nuk do të mund të kisha kurrësi qasje.

Sa i dobishëm është caktimi i një konteksti të qartë, kombëtar dhe të kufizuar si kua-
dër orientues për trajtimin e çështjeve të pjesëmarrjes (pra çfarë Zvicrës i përket, pjesë-
risht edhe kantoneve), ku bëhet fjalë për strukturat formuese shtetërore, institucionet
dhe diskurset zotëruese, aq edhe problematike, është nga pikëpamja sociale dhe shken-

core lidhja me një koncept të orientuar kulturor të një korresponduesi, shpesh variable të tilla si «komb», «popull» ose «përkatësi etnike». Konceptet e kulturës nuk hasen vetëm në temën e parë kryesore dhe në emrin e rrjetit tonë, por qenë të pranishme edhe gjatë konferencave dhe diskutimeve të ndryshme, sidomos kur bëhej fjalë rreth trajtimit të konflikteve dhe vështirësive të «Secondoas», madje edhe në gjëra si edukimi demokratik në përditshmërinë e jetës së tyre zvicerane. Pak a shumë, në mënyrë indirekte, u kërkua rreth identifikimit të shkaqeve të konflikteve përkatëse në rrafshin e kulturave, ku rrezi-kohej mbivlerësimi ose nënvlerësimi i rëndësisë së faktorëve strukturorë.

Nga ana tjetër, ndarja e tipareve, zakoneve dhe preferencave të emigrantëve në një kulturë të parë, të dytë dhe në një të ndërmjetme, nuk merr parasysh faktin se jeta e tyre e përditshme nuk rrjedh më përgjatë kufijve kombëtar të vendit të prejardhjes dhe atij mbërritës. Kultura e tyre është ndërkombëtare, heterogjene por edhe e pavarur, nuk është një përzierje ndërmjet dy kulturave, pa përmendur faktin se këto ndahen në mënyrë hierarkike në kohë dhe proporcion në një kulturë të parë dhe të dytë. Këta «kontenierë idesh» të kulturës si diçka me vlerë të ruajtur që i përkasin një shteti, nuk i përshtaten realitetit të një shoqërie postemigrante si Zvicra. Përkundrazi, ajo detyron pjesëtarët e saj «emigrantë» dhe vetë pasardhësit e tyre të brezit të dytë dhe të tretë të maten vazhdimisht me kategori ndërkombëtare të ruajtura.

Një ballafaqim më i thelluar rreth nocioneve kulturore të përdorura në kuadër të konferencës, sipas mendimit tim, do të ishte diçka me vlerë, e megjithatë përpjekjet për të arritur diçka të tillë dështuan, nga njëra anë ishte presioni i kohës dhe nga ana tjetër një gjë e tillë sipas perspektivës së praktikuesve, dukej të ishte disi jo shumë e rëndësishme dhe tërheqëse.

Si hulumtuese në fushën e emigrimit dhe e ndërkombëtarizmit dhe si «Seconda» kisha mjaft njohuri rreth temës «Dinamika e të rriturit në dhe ndërmjet sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash» dhe rëndësinë e tyre për shoqërinë zvicerane edhe para serisë së konferencave të NEZI-t. Megjithatë, NEZI ia doli të paraqesë dhe të pasqyrojë kompleksitetin e këtyre temave në mënyrë të përgjithshme rreth «Orientimit ndërmjet kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës», duke përfshirë kështu vende dhe disiplina, prej të cilave mora mjaft ide në sajë të prezantimeve dhe tipareve të huaja me vlerë nga jeta si emigrante në Zvicër, sidomos në rastin e pjesëmarrësve nga Kosova, Maqedonia, Shqipëria dhe Zvicra. Ndërlidhja e perspektivave të personave të riemigruar, pati për mua një zgjerim të njohurive në këtë fushë me sfidat dhe mundësitë e tyre. Fakti që këto zgjerime njohurish rreth sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash u aplikuan në sasi të paktë, pra se çfarë përjetojnë personat minoritarë që rriten në Kosovë, Shqipëri ose Maqedoni, që një mundësi e humbur, si dhe dëshmoi gjithashtu për situatën aktuale të vendeve në fjalë. Nga ana tjetër, tema e integritetit dhe pjesëmarrjes së komunitetit rom, ishte pjesë (e shkruar) e programit politik, por përballja me vetë botën e përjetimeve të këtyre fëmijëve dhe të rinjve, që diçka shumë pak e pranishme në bisedat e hapura. Do të kishte qenë diçka vërtetë interesante, nëse kjo hallkë e munguar do të ishte plotësuar fortë në një nga konferencat e mbajtura.

Diskutimet gjithëpërfshirëse dhe ndërdisiplinore si të përmbajtjeve praktike, teoriko-referuese dhe të përjetimeve, njohja me këndvështrimet e ndryshme ashtu edhe të qëndrimeve të rëndësishme dhe pozicionimeve të pjesëmarrësve të ndryshëm, ishin për mua si një nga personat më të rinj në këtë fushë një përvojë veçanërisht pasuruese.

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe të realizimit të konferencave, çfarë (dhe si) mund të përmirësohet?

Aftësia e gjetjes dhe e grumbullimit rregullisht së bashku e kaq shumë ekspertëve të ndryshëm shqipfolës dhe gjermanishtfolës nga hulumtimi dhe arsimi në fushat e emigrimit dhe pjesëmarrjes, si dhe mundësia e ndërveprimit me ta, është një mundësi vërtet e madhe për hulumtuesit dhe aktivistët e rinj që punojnë në këto rrethe (gjuhësore), për të mos lënë pas edhe mundësinë e lidhjes së kontakteve dhe mësimi të gjërave të reja. Lidhja e ballafaqimeve të teorisë dhe pjesëmarrësve me temat e konferencës, pra siç e përmenda dhe më lart, ndryshimi i vendeve nga konferenca në konferencë, ishte diçka e shkëlqyer. Kjo qasje «shumë dimensionale dhe përjetuese» e objekteve në fokus, mundësoi që si grup të krijonim përvoja të përbashkëta, të ndanim përshtypje si dhe sjelljen dhe diskutimet e interpretimeve përkatësisht të ndryshme. Tërësia e këtyre gjërave ndihmoi në arritjen e qëllimit të të gjithë radhës së aktiviteteve, atij të krijimit të një rrjeti. Se sa e qëndrueshme do të jetë diçka e tillë, do të tregohet në bashkëpunimet e mëtejshme. Përsa i përket tejkalimit të kufijve kombëtar, do të doja që ndonjëherë këto të ishin arrirë jo vetëm në pjesën e hapësirës, por të ishte më e theksuar në ndarjen e grupeve të punës. Ndarja sipas kategorive «Zvicër-Zvicër», «Shqipëri-Zvicër», «Shqipëri» etj., nuk u përshtatet të gjithëve dhe qëllimi përmbushet pjesërisht.

Pyetja 3

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI dhe çfarë më ka munguar?

NEZI ofroi gjatë gjithë kohës mundësinë e diskutimit rreth hulumtimeve aktuale, por edhe rreth çështjeve të ndryshme ndërkombëtare dhe ndërdisiplinore, kjo dhe jashtë kuadrit formal: A perceptohen shqiptarët në Zvicër kryesisht si myslimanë? Çfarë e ndryshon një traditë nga tjetra? Si duhet të vishet një akademik? A është normale të mërzhitesh rreth faktit se fëmijët që shkojnë në shkollë e që i përkasin brezit të tretë në Zvicër, të etiketohen si të huaj? A mundet që një kosovar kundrejt një zvicerani të trembet më pak në rast të një alarmi për zjarr? Janë këto dhe biseda të tjera jozyrtare që të vënë në mendime dhe prej të cilave kanë lindur miqësi, përfshirë këtu edhe takimet në baze e lokale. Si p.sh. ato në Prishtinë, ku u angazhua një numër i madh pjesëmarrës të NEZI-t për një shfaqje në Cyrih.

Për të ardhur keq ishte fakti se nga vendet si Maqedonia, Kosova dhe Shqipëria nuk kishte përfaqësues minoritar, pasi sigurisht që ka persona shqipfolës në fjalë të kualifikuar.

Pyetja 4

Nëse projekti NEZI do të kishte vazhdimësi, cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dhe çfarë mund të ndihmoj unë personalisht për këto projekte?

Përveç pikave të lartpërmendura rreth përfshirjes së grupeve të tjera të pakicave etnike, fokusimit më të theksuar në elementët strukturor sesa ato kulturor dhe ballafaqimit më të thelluar të nocionit të kulturës si të tillë, interesant do të ishte organizimi konkret dhe i përqendruar në praktikë i një projekti pasues. Kjo mund të ishte realizuar me përfshirjen më të fortë të institucioneve arsimore, përkatësisht me nxënësit dhe studentët. Ndoshta një mundësi tjetër e frytshme në kontekstin tonë, do të ishte tek hulumtimi. «Përftimi i njohurive të reja, të thelluara shkencore rreth temës së të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme normash dhe referimesh dhe rezultatet e dala prej tyre për formimin politik», ashtu siç edhe është theksuar në objektivat e projektit, deri tani u realizua nëpërmjet shkëmbimeve të hulumtuesve dhe jo nëpërmjet një output-i vetjak shkencor.

Pyetja 5

Nëse projekti NEZI do të kishte një vazhdimësi: Cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dhe cili do të ishte ndihmesa ime për to?

NEZI do të përfaqësonte një bazë ideale për lidhjen e një projekti pasues të fokusuar në hulumtim dhe të një publikimi përkatës hulumtimi. Si një specialist socialo-gjuhësor do të ishte mjaft interesante për mua të përfshihesha në dizejnimin dhe zbatimin e një projekti të tillë. Po ashtu, përsa i përket këshillës së parë do të ishte i mundshëm realizimi i një projekti shkëmbimi për nxënësit rreth temave të rrjetit, si p.sh. organizimi i një workshop-i.

Driton Kajtazi, Drejtore i Institutit Suisse des études albanaises (ISEAL)

Nga cila kulturë apo i kultivuar?

Vështrim me qasje prologu në vend të epilogut të rrjetit NEZI

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndihmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Rrjeti NEZI më ka përforcuar mendimin tim se për një nxënës, një mësuesdhënës, një qytetar dhe secilin nga ne më mirë do të ishte të shtrohej pyetja se «Sa jemi të kultivuar?» dhe se «Cilës kulturë i përkasim?». «Kultura dhe mendja janë si parashuta, nëse qëndrojnë të mbyllura, përplasja me tjetrin, me tokën, është e madhe». «Sa më i thellë të jetë lumi, aq më i qetë është...», thoshte dhe gjyshi im. Kështu mendoj edhe unë.

Në kuadër të NEZI-t ndihem i përkrahur në idenë se sa më shumë njohuritë tona të ndërsjella të zgjerohen, të thellohen, aq më tepër shpirtërat tanë qetësohen dhe përplasja është më e vogël. Dhe në shkollë të punojmë në drejtim që të mos kemi «përplasje kulturore» por «përplasje të kultivuar».

Kultura është një koncept aq i gjerë sa askush nuk mund të pretendojë të ketë tërësinë e vështrimeve intelektuale dhe artistike, pra të ketë tërësisht një kulturë.

Atëherë kush mund të jetë bikulturore, multikulturore, ndërkulturore, plurikulturore apo polikulturore dhe kështu të pretendojë të zotërojë disa kultura, shumë kultura ?

Modeli multikulturore e ka bërë rrugëtimin e tij, shpesh duke u zbrapsur, dhe është koha e të ndjellurit të kulturintegritimit në mënyrë që të mënjanohet getoizimi në dëm të kompaktësisë shoqërore.

Kultura është një shprehje metafizike dhe e gjithanshme, njohuritë janë lënda e saj. Kultura nuk është një pronë, as individuale, as kolektive. Kultura nuk trashëgohet as individualisht dhe as kolektivisht, ajo është çështje individuale dhe kolektive të së njëjtës kohë.

Fatmirësisht që nuk e trashëgojmë kulturën, përndryshe edhe marrëzia do ta kishte kërkuar hisen e saj të trashëgimisë.

«Nuk ka njeri të kultivuar. Ka vetëm njerëz që kultivohen», thoshte Maréchal Foch. Pyetjes se «Nga e cila kulturë është? », unë e parapëlqej atë se «A është i kultivuar?». Nisur nga ajo se kultura është një shprehje metafizike dhe e gjithanshme, njohuritë janë lënda e saj, në NEZI mendoj se njohuritë përbëjnë një lëndë të mirë për t'u kultivuar. Dhe edukata qytetare e ka shumë më të lehtë të gjejë rrugëtimin e vet nga momenti kur kultivimi i asaj që e ne e quajmë kulturë e parë, e dytë apo ndërkulturë, merr kuptim dhe thellohet.

Edukata qytetare nuk mund të trajtohet ndaras nga kultura e përgjithshme, e njohjes së ndërsjellë fillimisht me vetveten, pastaj me vendin ku jetojmë dhe me botën që na rrethon.

Mendoj se këta tre rrathë pedagogjikë do të mund të përfshiheshin edhe më tej e të thelloheshin.

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe e realizimit/zbatimit të konferencave, dhe çfarë mund (si) të përmirësohet?

NEZI më ka sjellë të dhëna të cilat përbëjnë burim për referencat dhe për kontaktet që në rrethana tjera, nuk do të kisha pasur rastin t'i njihja.

Ajo që do të mund të përmirësohej është që pjesëmarrësit e rrjetit të kenë mundësi të shkëmbejnë apo paraqesin më shumë përvoja të tyre konkrete në raport me NEZI-n dhe synimet e NEZI-t.

Pyetja 3

Çfarë tjetër më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI dhe çfarë më ka munguar?

NEZI më ka sjellë njohje dhe mundësi shkëmbimi me persona të ndryshëm, me rrethana të ndryshme shoqërore, pedagogjike, politike dhe ekonomike.

Ajo që më ka munguar është mundësia që të mund të shoh në se kemi një aplikim apo rrezatim konkret nga pjesëmarrësit në vendet dhe institucionet ku punojnë.

Më ka munguar edhe pjesëmarrja e vendimmarrësve politikë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia, të paktën në hapje apo në mbyllje të takimeve.

Pyetja 4

Nëse projekti NEZI do të kishte një vazhdimësi: Cilat do të ishin dëshirat e mia në lidhje me drejtimin e këtij vazhdimi?

Nëse NEZI do të kishte vazhdimësi, do të dëshiroja të ndërroheshin vendet e takimeve, jo vetëm në kryeqytete por edhe në qytete të tjera në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni ku realitetet nuk përkojnë me ato të kryeqyteteve.

Po ashtu do të dëshiroja që të ketë qasje më shumë në drejtim të aplikimit të temave dhe të synimeve të NEZI-it.

Pyetja 5

Nëse projekti NEZI do ta kishte një vazhdimësi: Cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dhe çfarë mund të kontribuoj unë personalisht për këto projekte?

Në cilësinë e anëtarit të Dhomës Kantonale Konsultative për të Emigrantë në Kantonin Vaud, përfaqësues i vendeve ballkanike, para ca vjetësh bëra një propozim në kuadër të Dhomës Kantonale që gjuha amtare të përfshihet në shkolla publike të Zvicrës, si lëndë me zgjedhje, me nota si edhe në lëndët e tjera. Kjo nismë, nuk ishte edhe aq e lehtë, meqë duhej bindur jo vetëm kryesia e dhomës, por edhe disa përfaqësues të komuniteteve të ndryshme që ngurronin të përkrahnin këtë nismë. Megjithatë, Dhoma Kantonale e miratoi me shumicë këtë propozim timin dhe projekti iu dorëzua autoriteteve kompetente të Kantonit Vaud.

Në cilësinë e Kryetarit të Jurisë së Çmimit Kantonal të Integritit: Mesi i Botës (Le Milieu du Monde), pata kënaqësinë që së bashku me 7 anëtarët e jurisë të ndanim mendimin për strukturën AVESAC (Shoqata e Mësimdhënësve të Kantonit Vaud në strukturat e integritit të nxënësve emigrantë). Mendoj se mund të vazhdoj të përkrah strukturat që kanë qasje pozitive të integritit ku vend e hapsirë i lihet më shumë refleksioneve se sa reflekseve si edhe kjo Dhomë.

Sa u përket rrethanave në vendin mikpritës, shumë është bërë por ka edhe shumë për t'u bërë. Kontributet shkencore të konferencës: Shumëgjuhësia në shkolla, një potencial i rëndësishëm (24 janar 2004 në Cyrih), tregojnë shumë qartë se «shkolla si institucion nuk mund të jetë tjetër, veçse fitimtare nëse e mundëson zhvillimin e shumëgjuhësisë. Megjithatë, në mënyrë që shkolla në tërësinë e saj të mund të angazhohet në këtë rrugëtim, vendimet e strukturave janë të domosdoshme. U përket administratave kompetente që të përgatisin këto vendime që do të merren nga politikanët.» (<http://www.vpod-bildungspolitik.ch/pdf/138vpodBild.pdf>)

«Shkolla një kohë të gjatë ka bërë sikur nxënësi emigrant nuk kishte gjuhë para se të arrinte në shkollë. Në realitet, secili fëmijë është ekspert», shkruan Jean-François de Pietro, Bashkëpunëtor Shkencor në Institutin e Kërkimeve dhe Dokumenteve Pedagogjike në Neuchatel (24 heures, 30 prill 2003, f. 9).

Ashtu sikur në Dhomën Kantonale, mendoj se do të mund të shkëmbeja këtë përvojë edhe në kuadër të ISEAL-it (Institut i Zvicëran i Studimeve Shqiptare – www.iseal.ch) edhe me kantone të tjera dhe jemi të gatshëm që të bashkëpunojmë edhe më shumë me Konferencën Ndërkantonale të Mësimi Publik, organin koordinator të mësimi në Konfederatën Zvicerane, (EDK-CDIP-CDPE-CDEP) dhe me shkollat e larta pedagogjike dhe fakultetet e edukimit sidomos të Cyrihut dhe të Kantonit Vaud për të thelluar dhe konkretizuar idenë që gjuha amtare të jetë lëndë me zgjedhje në shkolla publike. Me Institutin ISEAL ne kemi organizuar module formimi mbi komunikimin ndërkulturor dhe shkollat publike në Zvicër ku kemi pasur mësimdhënës nga EDK-CDIP (Konferencën Ndërkantonale të Mësimi Publik) por edhe me mësimdhënës nga Institut i Kërkimeve dhe Dokumenteve Pedagogjike në Neuchatel si dhe nga Forumi Zviceran për Studime të Emigrimeve dhe Popullatave pranë Universitetit të Neuchatel.

Ne mendojmë dhe punojmë t'i bëjmë të rregullta këto module të formimeve të komunikimit ndërkulturor në shkolla në Zvicër.

Janë katër shtylla ato që e mbajnë gjallë strukturimin dhe komunikimin e diasporës me vendet e prejardhjes:

- Krijimi i një programi të formimit të vazhdueshëm të mësimdhënësve në diasporë.
- Kristalizimi i një programi mësimor i cili merr parasysh përbajtjen e teksteve dhe kontekstin e vendeve ku jetojnë njerëz nga diaspora jonë.
- Harmonizimi i veprimeve me autoritetet e vendeve ku mërgata jonë punon dhe jeton.
- Informimi sa më i mirë i prindërve dhe nxënësve mbi mësimin e gjuhës amtare.

Edhe në këtë drejtim ISEAL ka gatishmëri që të punojë me partnerë si në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni ashtu edhe në vendin mikpritës në Zvicër. NEZI përbën një synim dhe platformë të punës së përbashkët në të ardhmen.

Nexhat Maloku,
President i Lidhjes së Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë (LAPSH)
në Zvicër «Naim Frashëri»

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndihmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Bashkëpunimi në kuadër të një grupi ekspertësh siç ishte ky i «Rrjetit» për mua ishte një pasurim plotësues në fushën e thellimit të mëtejshëm të njohurive të reja në temën e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash, në njërën anë, dhe në anën tjetër, në shkëmbimin e njohurive, përvojave dhe koncepteve për temën e gjerë arsimimi demokratik, e cila në shikim të parë duket pakëz e thjeshtë, por është edhe shumëdimensionale dhe pjesë e domosdoshme e jetës sonë.

Përbërja e «Rrjetit» me profesionistë të vjetër e të rinj të kësaj fushe nga Kosova, Maqedonia, Shqipëria dhe grupi shqiptaro-zviceran nga Zvicra, ishte një bërthamë shumë e vlefshme për të marrë informacione nga këto vende, për t'U njohur me hulumtimet shkencore të bëra në fushat e trajtuara gjatë konferencave, për të zhvilluar debate mbi pikëpamje të ndryshme, herë-herë kundërthënëse, por shumë të frytshme. Trajtimi i temës për mësimin plotësues në Zvicër ishte jo vetëm për mua por edhe për kolegët e mi me të cilët punoj, e një rëndësie të veçantë, sepse kjo temë është pjesë përbërëse e punës në mësimin plotësues në Zvicër. Njohja me kolegë nga vendet e mia më mundësoi që gjatë këtyre konferencave, por edhe jashtë tyre, të krijojë kontakte autentike, të përfitoj nga to jo vetëm në fushën intelektuale por edhe njëkohësisht të nxitem se si të veprojmë në kontekstin e marrëdhënieve të mia gjatë punës me nxënës, të rinj e të reja dhe të rriturit.

Pikërisht në këtë drejtim mund të bëhet një thellim në këtë fushë, pra çështja është se si të zbatohen konkretisht në punën me të rinjtë e të rejat këto norma të demokracisë dhe se si të trajtohet tema e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash. Në fushën e mësimin plotësues në Zvicër, nxënësit shqiptarë mund të përfitojnë shumë nga një trajtim i drejtpërdrejtë në mësimin plotësues të këtyre temave, sepse mjaft të rinj dhe të reja kanë vështirësi nga më të ndryshmet e sidomos në rrjed-

hën e formimit të identitetit të tyre, të kontaktit me pjesëtarë të nacionaliteteve të tjera, të sjelljes së tyre në shoqërinë shumëkulturore.

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe e realizimit/zbatimit të konferencave, dhe çfarë mund (si) të përmirësohet?

Grupi udhëheqës i «Rrjetit» në bashkëpunim me ekspertët e vendeve përkatëse, ka bërë një planifikim shumë të mirë të konferencave, duke zgjedhur për trajtim tema të rëndësishme të cilat i përgjigjeshin qëllimit të vënë të konferencave. Zgjedhja e ekspertëve nga fushat përkatëse, informimi në kohë lidhur me detyrat në kuadër të konferencave, dërgimi i materialeve, udhëheqja e konferencave, bashkëpjesëmarrja e mysafirëve, vendet e ndryshme të mbajtjes së konferencave, hyrjet tematike, debatet, puna në grupe, përkthimet, shfrytëzimi shumë racional i kohës, kanë bërë që unë të jem me kënaqësi pjesë e vogël e këtij bashkëpunimi, nga i cili kam fituar përvoja të reja sa i përket kësaj fushe.

Një ide për një ndryshim në këtë drejtim, në rast të një vazhdimësie të projektit, do të ishte ndoshta që të ketë më shumë kohë në shfrytëzim për debate shterruese, sepse edhe këtu ka dinamika të ndryshme, dallime kulturore midis grupesh, të cilat ndikojnë në rrjedhën e konferencave (dëshira për të folur më gjatë për tema tëaktuara).

Pyetja 3

Çfarë tjetër më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI dhe çfarë më ka munguar?

Bashkëpunimi në «Rrjet» më ka nxitur që të lexoj e hulumtoj më shumë në këtë fushë dhe në anën tjetër të angazhohem që në kuadër të punës që bëj, para së gjithash, me nxënësit në shkollë të trajtoj edhe më tepër, në mënyrë të qëllimshme temën për demokracinë si normë të jetës. Të rinjtë shqiptarë në Zvicër kanë nevojë për përkushtim, njohje, ngushëllim e dashuri, në mënyrë që më vonë të marrin përgjegjësinë për vete dhe për të tjerët. Të përkrahen nxënësit për të jetuar mes kulturave të ndryshme, për të zhvilluar edhe më tej aftësitë e tyre në fusha të ndryshme të jetës, për të krijuar një individualitet të fortë, është një prej detyrave primare të fushës në të cilën punoj dhe ky bashkëpunim në kuadër të «Rrjetit» më ka dhënë nxitje të reja.

Mendoj se konferencat do të ishin edhe më të suksesshme nëse do të kishin marrë pjesë edhe njerëzit të cilët janë në sferat e pushtetit në vendet përkatëse e që kanë të bëjnë me këto tema. Veçanërisht do të ishte me rëndësi të merren informacione se si e shohin këtë fushë ata të cilët, në kuadër të funksionit të tyre, ndikojnë drejtpërdrejt në politikat për një shtet demokratik. E kaluara e largët dhe fatkeqësisht edhe e afërt e shteteve ku jeton populli shqiptar, ka treguar se në kushtet e demokracisë njerëz të caktuar në bashkëpunim me «institucione demokratike të pushtetit» e turma dhunënxitëse të njerëzve dalin lehtë, në anën e shkatërruesve të demokracisë. Pra, demokracia pa ligje dhe strukturë të fortë shtetërore e cila ndonëse vërtet i zbaton me përpikmëri ato ligje, mund të bëhet lehtë një surrogat i demokracisë e edhe më keq.

Pyetja 4

Nëse projekti NEZI do të kishte një vazhdimësi: Cilat do të ishin dëshirat e mia në lidhje me drejtimin e këtij vazhdimi?

Në rast të një vazhdimësie për mua do të ishte me rëndësi që krahas ekspertëve të marrin pjesë edhe figura politike të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me zbatimin e normave demokratike në sferat e pushtetit e të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në «kulturën e demokracisë».

Pyetja 5

Nëse projekti NEZI do ta kishte një vazhdimësi: Cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dhe çfarë mund të kontribuoj unë personalisht për këto projekte?

Do të ishte me shumë dobi që kjo punë e bërë deri tani të mos mbetet vetëm në mendjet e ekspertëve por edhe të vazhdohet më tutje në mënyrë që të sjellë edhe suksese konkrete. Do të ishte mirë të shihet se çfarë materialesh ekzistuese ka në këtë fushë, ose çfarë duhet të përgatitet dhe në bashkëpunim me mësuesit e shkollës shqipe të mësimi plotësues në Zvicër të punohet drejtpërdrejt me nxënësit shqiptarë të cilët vijojnë këtë mësim. Natyrisht do të ishte me rëndësi që paraprakisht mësuesit e mësimi plotësues të kenë një seminar disaditor për këto përmbajtje në mënyrë që të mund t'i trajtojnë pastaj me profesionalizëm në orët mësimore. Pikërisht mësimi plotësues është një vend shumë i qëlluar për t'i trajtuar këto tema të cilat ishin pjesë e konferencave të deritanishme. Duke qenë në cilësinë e udhëheqësit të Lidhjes së Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë «N. Frashëri» në Zvicër, jam i gatshëm të kontribuoj në realizimin e një vazhdimësie të tillë.

Do të ishte me rëndësi të krijohet një Website e veçantë në të cilën ekspertët e «Rrjetit», por edhe profesionistë të tjerë të mund të publikojnë punimet e tyre, të debatojnë, të jenë një urë lidhëse me publikun e para së gjithash me njerëzit e fushës arsimore. Kjo faqe e veçantë do të ishte me rëndësi të jetë si lidhës në Website-t zyrtare të ministrive të arsmit të Kosovës, Maqedonisë e Shqipërisë.

Shukrije Ramadani, Drejtoreshë e Qendrës Kulturore Shqiptare në Zvicër

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndhmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Për mua bashkëpunimi me grupin nuk më ndihmoi vetëm për një thellim në sferën time, ku unë dhashë ndihmesën time njezetvjeçare me fëmijët që rriten në mes të dy kulturave, por më bëri të reflektoj thellë në vete emocionet që ngrinin këto pyetje të cilat shpesh mbeteshin pa përgjigje dhe ndikojnin në zhvillimin dhe ndikimin e shoqërisë njerëzore. Në veçanti përkrahja në orientimin midis kulturës së parë dhe të dytë ka një rëndësi të madhe ngaqë realiteti të cilin ne kishim jetuar dhe vepruar me fëmijët tanë, nga të cilët pjesa më e madhe kishin lindur në Zvicër, i bindnim se jeta dhe ardhmëria e tyre ishte në Kosovë, vetpërcaktimi i ynë që fëmijët tanë të jetonin aty ku dëshironim ne, nuk ishte demokratik, dhe ne si shoqëri vepronim jo në dobi dhe interes të fëmijeve tanë për orientimin dhe përkrahjen e tyre në kulturën dhe vendin ku ata jetonin por në kulturën dhe vendin ku ne i kishim ëndrrat dhe bindjet tona se edhe ata duhet të bëheshin pjesë e atyre ëndrrave dhe asaj kulture.

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe e realizimit/zbatimit të konferencave, dhe çfarë mund (si) të përmirësohet?

Shumëlarmshëria e vetëmbajtjes së konferencave, puna efektive në grupe dhe komunikimi interaktiv tejet i vlefshëm i pjesëmarrësve jashtë konference, njohja me metodologji të reja të punës dhe efikasiteti, cilësia e lartë e mbajtjes së konferencave.

Është e rëndësishme të thuhet se fillimi ishte shumë më i vështirë se konferenca e parafundit dhe e fundit në Shkup kur pjesëmarrësit veç u njoftuan më shumë midis njëri-tjetrit, dhe njëkohësisht kuptuan metodën e punës me Basilin dhe Rolfin dhe përfituan jo vetëm nga përvoja e tyre por edhe nga cilësia dhe menaxhimi i kohës, si dhe kërkesa e vazhdueshme për lidhshmërinë e temave me konceptin.

Dendësia e materialeve ka qenë tejet e lartë dhe nuk na është ofruar koha e duhur për t'u thelluar dhe bashkëbiseduar temat të cilat kishin një rëndësi tejet të lartë dhe kërkonin kohë më të gjatë për studim.

Diçka që duhet cekur është edhe metodologjia e planifikimit, ngaqë nuk është e lehtë të arrihet që në çdo vend mikpritës të gjendet koha e duhur kur nxënësit nuk kanë pushime apo ndonjë festë dhe njëkohësisht të arrihet që të gjithë pjesëmarrësit t'i përshtaten kohës së kërkuar për konferencë, por vërtet kjo mund të arrihet vetëm me një menaxhim dhe planifikim të sukseshëm i cili duhej lavdëruar.

Pyetja 3

Çfarë tjetër më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI dhe çfarë më ka munguar?

Shoqëri të re me njerëz të profileve të ndryshme dhe mundësi për pranim të botëkuptimeve të ndryshme si pjesë realiteti dhe hapje të reja horizonti si mundësi reflektimi mbi botëkuptimet e brendshme të cilat nganjëherë na krijojnë mure të padukshme që na pengojnë të shohim jashtë vetes.

Na është ofruar mundësia për t'u informuar nga dora e parë lidhur me metodat dhe sistemet e shumëllojshme të edukimit dhe arsimimit në shtete të ndryshme, të cilat përdoren nga njëra shkollë te tjetra në mënyrë të pavarur.

Ajo që më ka munguar mua ishte koha për të qenë e pranishme nga fillimi deri në fund në të gjitha konferencat dhe ligjëratat, prandaj me vjen shumë keq dhe shpresoj që Nezi të vazhdojë në mënyrë që të kemë mundësi të marr përgjigje në shumë pyetje të cilat më kanë mbetur peng gjatë punës sime si mësuesë si dhe gjatë përpunimit të materialit të konferencave.

Pyetja 4

Nëse projekti NEZI do të kishte një vazhdimësi: cilat do të ishin dëshirat e mia në lidhje me drejtimin e këtij vazhdimi?

Unë do të kisha dëshiruar që përveç temave të shumëllojshme duhet më shumë t'i përkushtohemi temës së integritimit dhe riintegritimit dhe t'i qasemi më seriozisht ngaqë riintegrimi është njësoj i vështirë si integrimi. Të përgatisim nga ekspertët tanë një anketë me pyetje për prindërit të cilët është dashur t'i përshtaten jetës në shtete të ndryshme dhe pastaj janë kthyer në shtetin e tyre, dhe pas një etape është dashur ta braktisin vendin amë dhe të kthehen në ato shtete ku kanë jetuar me vite.

Do të ishte mirë të kërkojmë shifra sa nga ata kanë pasur sukses të qëndrojnë në vendin e lindjes dhe se sa është dashur të kthehen prapë aty ku fëmijët e ndjejnë veten në shtëpi. Sa ka ndikuar kjo në arsimimin dhe edukimin e fëmijëve dhe në botën e tyre sociale dhe emocionale.

Kush merret me përkrahjen sociale dhe emocionale të fëmijëve të cilët pa dëshirën e tyre përplasen mes dy a më shumë kulturash?

A e shohin fëmijet këtë si përparësi apo mangësi, pengesë në zhvillimin social dhe emocional të tyre? A mund të riintegrohen më lehtë fëmijët apo të rriturit?

Janë shume pyetje, për të cialt shpresoj të marr përgjigje në vazhdueshmërinë e projektit NEZI.

Pyetja 5

Nëse projekti NEZI do ta kishte një vazhdimësi: Cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dheçfarë mund të kontribuoj unë personalisht për këto projekte?

Përvojën time profesionale për temën e emigrimit dhe riemigrimit do ta kisha ofruar me dëshirën më të madhe dhe angazhimin e vazhdueshëm edhe për tema që kanë të bëjnë me edukimin dhe arsimimin e gjeneratave të reja.

Mirë do të ishte nëse do të formohej një grup pune me profile të ndryshme i cili do t'i përkushtohet kësaj teme dhe do të kisha ofruar edhe anketat e bëra me fëmijë dhe të rritur të cilat të mahnisin me emocionalitetin me të cilin i përshkruajnë ecejaket e veta nëpër shtete dhe kultura.

Naxhi Selimi, Shkolla e Lartë Pedagogjike e kantonit të Shvicit (Schwyz)

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndihmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Si i deleguar nga Drejtoria Arsimore për shkollat e sistemit para arsimit të mesëm (Volksschule) të kantonit të Zyrihut dhe më vonë për Shkollën e Lartë Pedagogjike të Shvycit, përfitova në mënyrë të dyfishtë nga rrjeti NEZI «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura». Së pari arrita të integroja në mënyrë të drejtpërdrejtë në punën time të përditshme materialet tematike dhe njohuritë e grumbulluara. Lidhur me këtë u mundësua vazhdimi dhe përforcimi i një bashkëpunimi të mirë institucional midis dy institucioneve të sipërpërmendura dhe Shkollës së Lartë Pedagogjike të Zyrihut, e cila është drejtuese e projektit. Shkëmbimi profesional me ekspertët pjesëmarrës në projektin NEZI të ardhur nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Zvicra më ofruan mundësinë të hidhja vështrimin përtej kufirit të kopshtit tim dhe të fitoja njohuri të reja lidhur me proceset e demokratizimit në fushën e arsimit të këtyre vendeve.

Nga diskursi i suksesshëm profesional, gjatë takimeve të NEZI-t u bë e qartë ndër të tjera se procesi i intensifikuar i demokratizimit në vendet e Rajonit të Evropës Juglindore po e përfshin me një intensitet gjithmonë e më të shpejtë fushën e arsimit. Gjithashtu u bë e qartë se këto procese, të ndikuara edhe nga mediat e reja dhe komunikimi, çojnë në heqjen e kufijve brenda gjithë zonës evropiane dhe përshpejtojnë shndërrimet në fushën e arsimit dhe të edukimit në nivel lokal e global. Për mendimin tim NEZI është një shembull konkret që tregon se nëpërmjet rrjeteve krijohen energji të reja, të cilat japin pa dyshim një ndihmesë të nevojshme në fushën e arsimit në institucionet dhe shoqëritë përkatëse. Ky projekt tregoi se larmia kulturore e cila çon drejt sfidave të reja në fushën e arsimit, mund të trajtohet në mënyrë konstruktive. Një nga pikat e forta të NEZI-t e përbënte ndër të tjera socializimi i fëmijëve e të rinjve në ambientin e tyre të larmishme kulturore e gjuhësore si një temë e gjerë e gjithëpërfshirëse e diskutuar në këndvështrim të ndryshme.

Përveç këtyre, prononcimet e shumta lidhur me këtë, dëshmuuan se koncepti i «kulturës» nuk duhet kufizuar në asnjë mënyrë vetëm brenda një territori. Ai paraqet më tepër një paketë formash të larmishme kulturore dhe nëpërmjet shndërrimeve shoqërore të çon drejt formave të reja subjektive apo kolektive të njohurive dhe reflektimeve.

Nga gjithë sa u skicua më sipër del se NEZI paraqet një platformë të mirë për thellimin e iniciativës për një marrëdhënie konstruktive me larmi kulturore e gjuhësore në shkolla dhe shoqëri.

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe të realizimit të konferencave, çfarë (dhe si) mund të përmirësohet?

Takimet e NEZI-t në vende të ndryshme i përjetova mjaft pozitivisht nga pikëpamja organizative dhe metodike. Në mënyrë të veçantë më pëlqeu larmia metodike: Referate informuese, puna në grupe, diskutime në grup etj. Vizitat në shkolla m'u dukën mjaft edukative. Më bëri shumë përshtypje dhe më frymëzuan p.sh. produktet e nxënësve prej materiali riciklimi, të cilat na u prezantuan gjatë vizitës së një shkolle të arsimit të detyrueshëm në Prishtinë. Do t'i kujtoj me kënaqësi punimet e shumta të projektit dhe shkëmbimin interesant profesional me mësuesit e shkollave pritëse. Gjithsesi, pas vizitave të tilla shkollore i drejtoja vetes pyetjen, dhe këtë gjë edhe e raportova, nëse duhej çliruar programi i ngjeshur i takimeve për të pasur më tepër kohë për shkëmbimin praktik me profesionistët.

Pyetja 3

–

Pyetja 4

Nëse projekti NEZI do të kishte vazhdimësi, cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dhe çfarë mund të ndihmoj unë personalisht për këto projekte?

Çështja e trajtimit të larmisë gjuhësore, kulturore si dhe socializimit të fëmijëve dhe të rinjve në kontekstin shkollor, zë një rol qendror dhe ka interes të veçantë në formimin e mësuesve të ardhshëm. Unë po e shfrytëzoj hapësirën që më është lënë në dispozicion në këtë material dhe në vijim po e përshkruaj më nga afër socializimin kulturor të fëmijëve dhe të rinjve në Zvicër.

Në Zvicrën heterogjene përsa u përket kulturave, vendwsit dhe të ardhurit janë të sfiduar më tepër se kudo tjetër që të përballen me veçantitë e socializimit dhe integritetit të të gjithë fëmijëve dhe të rinjve. Vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet që çdo individ të shpalosë personalitetin e vet brenda shoqërisë. Gjithsesi socializimi në dy kultura paraqet një proces afatgjatë i cili [përfshin] edhe «shkëmbimin si me ambjentin social ashtu edhe me atë material» (Nohl, 2006, f. 170).

Çdo ditë fëmijët dhe të rinjtë përjetojnë dhe praktikojnë elemente të ndryshme kulturore: Në familje, në zonën ku banojnë, në institucionet arsimore, në të përditshmen profesionale etj. Shumë nga këto elemente individët i bëjnë në mënyrë eksplicite si pjesë përbërëse të përditshme të veprimeve të tyre, të tjerat përjetojnë dhe shpjegohen nëpërmjet kontekstit. Çdo individ vendos vetë se cilave rregulla duhet t'u përmbahet në mënyrë strikte dhe cilat prej tyre duhet t'i vërë në diskutim.

Nohl thekson tri fusha të procesit të socializimit të një fëmije ose të rrituri në shoqëri: a) Krijimi i habitusit personal, b) ushtrimi i rregullave të caktuara sociale si dhe, c) rritja e njeriut në një ambient të caktuar. Këto të fundit janë struktura heterogjene sociale dhe disponojnë dimensione të ndryshme si brezi, gjinia, emigracioni, arsimimi etj. Në procesin e socializimit në ambientet me karakter heterogjen fëmijët dhe të rinjtë janë të sfiduar «në një mënyrë të dyfishtë»: «Socializimi i tyre karakterizohet nga fakti se ata nuk janë të fiksuar habitualisht në asnjërën nga dy praktikat» (Nohl, 2006, f. 172)

Duke iu referuar fëmijëve dhe të rinjve me origjinë shqiptare që janë edhe në fokus të këtij materiali, ky citat do të thotë se këta fëmijë e të rinj i përjetojnë «zvicëranen» dhe «shqiptaren» si dy botë, në të cilat ata nuk ndihen plotësisht si në shtëpi.

Në varësi të realitetit të socializimit, kjo gjë mund të shkaktojë sidomos në periudhën e fundit të adoleshencës, që këtyre të rinjve pikë së pari t'u duhet të zotërojnë ndryshimet e zakonshme tipike të brezit dhe gjinisë së tyre në ambientin ku jetojnë. Nga ana tjetër, ata në këtë përballje me sferat e ndryshme të përkufizuara nga etnia, nuk kanë modele të njohura dhe nuk mund të identifikohen realisht me asnjërën nga sferat. Lidhja e praktikës së jetës familjare me detyrat e socializimit në shoqërinë pritëse, mund të përbëjë një sfidë për fëmijët e të rinjtë e prekur.

Institucionet e arsimit, sidomos shkollat mund t'ua sjellin më afër fëmijëve dhe të rinjve kulturën që për ta është «e re» si dhe përfytyrimet shoqërore të lidhura me të mbi vlerat dhe t'i mbështesë ata që t'i lidhin vlerat dhe normat e këtushme me ato të vendit të tyre të origjinës dhe, në këtë mënyrë të kenë një marrëdhënie konstruktive dhe të natyrshme me të dy kulturat dhe sfidat e lidhura me to (Adam/Inal, 2013, f. 60).

Për disa prindër, procesi i socializimit të tyre në Zvicër, përbën një sfidë. Ndërkohë që shumica e prindërve e konsiderojnë Zvicrën si vendlindjen e fëmijëve të tyre dhe janë të hapur me rregullat kulturore të këtushme, ata prapë se prapë mbahen fort tek përfytyrimet e vlerave të kulturës së tyre të origjinës, pasi nuk mund ta parashikojnë se çfarë çmimi duhet të paguajnë nëse zhyten në kulturën e vendlindjes së re. Në këtë kontekst, Hoffmann tërheq vëmendjen që tipare të rëndësishme si socializimi, vullneti për të mësuar ose gatishmëria për t'u përshtatur nuk duhen perceptuar dhe tematizuar vetëm si tipare të emigrantëve, por edhe si të shoqërisë pritëse (Hoffmann, 1996, f. 241). Në këtë kontekst, Auernheimer konstaton «se kultura e emigrantëve nuk duhet ngatërruar me kulturën e vendit të prejardhjes». (...). Njohuria mbi kulturën e prejardhjes ndihmon sigurisht për të kuptuar kulturën e emigrantëve e cila është një rezultat i përballjes me kushtet e reja të jetesës dhe ndikimet kulturore mbi bazën e traditës (Auernheimer 1990, f. 102).

Në mënyrë që të realizohet me sukses socializimi në një kontekst ndërkulturor dhe që fëmijët të rriten në një ambient të qëndrueshëm jetese, specialistët si Westphal kërkojnë më tepër dialog, mundësim takimesh, shkëmbim mbi përfytyrimin rreth vlerave midis botëve të strukturuar ndryshe si dhe një ndarje të barabartë të burimeve sociale.

Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se NEZI ka mundësuar takimet dhe ka përforcuar dialogun profesional dhe institucional. Shkëmbimi mjaft i vlefshëm i përvojave si dhe bashkëpunimet që lindën midis specialistëve japin sigurisht një ndihmesë të nevojshme arsimore, e cila duhet ruajtur me vazhdimin e kësaj iniciative. Përvojat e deritanishme tregojnë se sa i rëndësishëm është vijimi i këtij dialogu ndërkombëtar midis specialistëve në fushën e arsimit dhe garantimi i tij me anë të bashkëpunimeve të mëtejshme dhe projekteve të përbashkëta. Kush investon në projekte të këtij lloji pasuron fushën e arsimit e cila përbën një nga shtyllat qendrore shoqërore.

Pyetja 5

–

Bibliografi

- Adam, H./Inal, S. (2013). Pädagogische Arbeit mit Migranten- und Flüchtlingskindern. Unterrichtsmodule und psychologische Grundlagen. Weinheim/Basel: Beltz Verlag.
- Auernheimer, G. (1990). Einführung in die interkulturelle Erziehung. Darmstadt: Wissenschaftliche Buchgesellschaft.
- Hoffmann, L. (1996). Der Einfluss völkischer Integrationsvorstellungen auf die Identitätswürfe von Zuwanderern. In: Heitmeyer, W./Dollase, R. (Hrsg.): Die bedrängte Toleranz. Frankfurt am Main: Suhrkamp Verlag, S. 241-260.
- Nohl, A.-M. (2006). Konzepte interkultureller Pädagogik. Eine systematische Einführung. Bad Heilbrunn: Klinkhardt.

Grupi i Shqipërisë (Pjesëmarrësit/et nga Shqipëria)

Astrit Dautaj,
Bashkëpunëtor në Institutin for Development of Education në Tiranë

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndhimë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Ideja e marrëdhënieve ndërmjet kulturave në shoqërinë e sotme vjen në mënyrë sinjifikative në një botë që, gjithnjë e më shumë, e sheh veten të përfshirë në marrëdhëniet të ndërlikuara të kulturave e në kultura të larmishme që bashkëjetojnë e duhet të bashkëjetojnë në shoqëri. Kjo bashkëjetesë nuk është gjithmonë dhe kudo pjesë e trashëgimisë historike e jetuar, e përjetuar, e pranuar, e kundërshtuar etj. Edhe kur është e tillë, në kohën e sotme ajo ka marrë dhe vazhdon të marrë tipare e karakteristika të reja, zhvillohet në ritme e intensitete të ndryshme në kohë dhe në hapësira të ndryshme.

Përveç ligjësive të brendshme të zhvillimit të kulturës, në këto procese ndikojnë, deri në kushtëzim, edhe faktorë ekonomikë, shoqërorë, politikë, historikë etj., që jo vetëm i bëjnë më komplekse marrëdhëniet ndërmjet kulturave në shoqëri, por vështirësojnë edhe të kuptuarit e problemeve, të shkaqeve të tyre dhe, për rrjedhojë, edhe identifikimin e politikave që synojnë dhe ofrojnë zgjidhje të qëndrueshme e paqësore, dhe nga pikëpamja praktike ndihmojnë përfasuesit e kulturave të ndryshme të orientohen e «të lundrojnë» më të sigurtë ndërmjet kulturave të para, të dyta etj, për një jetë më të qetë e harmonike.

Aftësimi i individit për t'u orientuar në larminë e botës së sotme gjithnjë e më globale e të larmishme, dhe për të marrë vendime gjithnjë e më të mirëmenduara, është një ndër synimet kryesore të edukimit për qytetari demokratike. Për këtë arsye, këto çështje nuk mund të shihen të shkëputura, por të ndërlidhura: Marrëdhëniet ndërkulturore përbëjnë ushqimin e përmbajtjes dhe të kontekstit të edukimit për qytetari demokratike, ndërkohë që ky i fundit, mundëson ndërtimin e kompetencave të individit për të marrë vendimet e duhura në komunitetin shumëkulturësh.

Në këtë këndvështrim, projekti NEZI ka pasuruar njohuritë e mia për marrëdhëniet ndërmjet kulturave në vendet e ngjashme dhe jo të ngjashme, në disa pikëpamje, me Shqipërinë, më ka ndihmuar të konfirmoj bindjet e mia për disa prej çështjeve që lidhen me politikat e vendeve në studim. Në të njëjtën kohë, ky projekt, më hapi një dritare të re të shikimit të problemeve që lidhen me kulturën në vendin tim, në mënyrë të veçantë, me

atë që mund të shihet si kulturë e dytë në të. Kështu, në këtë këndvështrim, mund të vlerësohet si kulturë e dytë, kultura e emigrantëve të riatdhesuar pasi kanë jetuar për një kohë të gjatë në një vend evropian. Të ndryshuar «kulturalisht» nga jeta në vendin e huaj (kultura e punës, individualizmi, raporti me punën, me pushtetet, me kulturën e fisit etj., shumë të riatdhesuar ndihen si refugjatë në vendin e tyre të origjinës. Madje, pas një farë kohe ndjejnë nevojën të rikthehen, dhe jo vetëm për arsye ekonomike, përsëri në Evropë.

Shumë prej të rinjve shqiptarëqë kanë studjuar dhe patën rastin të punojnë për disa vite në të, kthehen në Shqipëri me idenë të kontribuojnë në vendin e tyre. Jo rrallë, në Shqipëri, ata ndeshen me një kulturë pune të ndryshme me atë që fituan në Evropë. Ata ndihen të zhgënjyer, shesh herë të revoltuar me neglizhencën dhe mungesën e përgjegjësisë për punën ose kur vënë re që shpeshherë, interesi dhe përgjegjësia e tyre për të punuar me cilësi, vlerësohen si modele të papranueshme, madje shqetësuese.

E përsëri, dëshira për t'u kthyer në Evropë, tashmë vendi ku ndihen mirë («vendi i tyre») shfaqet përsëri. Kjo ndodh pasi mjedisi i ri ku ata kanë jetuar për disa kohë, Evropa, prodhoi ndryshime të qëndrueshme, të cilat me sa duket, janë edhe të dëshiruara prej tyre.

Në thelb, tiparet e sjelljes njerëzore që lidhen me këto ndryshime si, respekti për tjetrin, për punën, për vlerat pozitive, përgjegjësia për tjetrin, për komunitetin etj., janë ato që kërkohen për një shoqëri demokratike.

Këto ide dhe të tjera të ngjashme, u nxitën, u konfirmuan ose u pasuruan si rrjedhojë e këtij projekti dhe e shanseve që ai ofroi, pavarësisht nga koha e kufizuar në dispozicion.

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe realizimit/zbatimit të konferencave, dhe çfarë mund (si) të përmirësohet?

Në këtë drejtim më është dukur gjithçka.

Pyetja 3

Çfarë tjetër më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI dhe çfarë më ka munguar?

NEZI ofroi mundësinë për të ndarë me të tjerët përvoja dhe ide. Personalisht, më ka ndihmuar t'u jap përgjigje disa hamendësimeve të mia në lidhje me çështje të caktuara të fushës së kulturës, të arsimit, të politikave etj. Po përmend këtu, për shembull, çështjen e programeve dhe teksteve në gjuhën shqipe për fëmijët në diasporë. Zhvillohen takime

të rregullta vjetore, në Shqipëri dhe në Kosovë, në lidhje me atë që mund t'i ofrohet diasporës në këtë fushë. Por, nga specialistë ose politikbërës vendorë, që nuk e njohin gjendjen, kërkesat dhe mundësitë e diasporës, nuk mund të pritët shumë në këtë drejtim. Të paktën në planin e ideve dhe zgjidhjeve. Kjo ide e imja u konfirmua nga vizita në një klasë të mësimi shqip në diasporë, nga kërkesat e fëmijëve, nga arsyet përse ata kërkojnë të mësojnë gjuhën shqipe, çfarë librash, për çfarë përmbajtje mësimore kanë nevojë, cila është mënyra më e mirë, më e përshtatshme dhe më e efektshme për të realizuar mësimdhënien në mjedise të ndryshme, me kërkesa e prioritete të ndryshme arsimore.

Pyetja 4

Nëse projekti NEZI do të kishte një vazhdimësi: Cilat do të ishin dëshirat e mia në lidhje me drejtimin e këtij vazhdimi?

Çdo mjedis mësimor, megjithë ngjashmëritë, është i veçantë në përparësitë e tij edukative, si në fushën e kurrikulës, të përmbajtjes së saj dhe, në mënyrë të veçantë, në atë të kërkesave për trajnimin e mësuesve.

Pikërisht, në këtë drejtim, unë e shoh drejtimin e vazhdimi të projektit.

5

E thënë shkurt

Trajnimi i mësuesve për edukimin ndërkulturor, me fokus të veçantë, të marrëdhëniet ndërmjet kulturës së parë dhe të dytë.

Admir Kraja, bashkëpunëtor në Ministrinë e Arsimit dhe të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndhimë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Pjesëmarrja ime dhe bashkëpunimi me kolegët dhe ekspertët pjesëmarrës në këtë rrjet NEZI (nga Zvicra, Ballkani dhe diaspora), gjatë pesë konferencave me tematika të veçanta më ka shërbyer në disa aspekte dhe kryesisht më ka ndihmuar në përforcimin e lidhjes së teorisë me përvojën, pra të të kuptuarit më mirë të dinamikës e së rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash.

Në debatet dhe diskutimet e ndryshme kam hasur një mori aspektesh të temës së ndërkulturalitetit, arsimimit, gjetjes së identitetit apo orientimit në sisteme të ndryshme normash e kulturash. Dua ta shpreh që tematika me ka prekur, pasi personalisht kam jetuar e jam shkolluar shume vite jashtë vendlindjes time, gjë që më ka detyruar ta vëzhgoj veten dhe t'i bëj pyetje vetes mbi zhvillimin personal, konceptet e qëndrimit në lidhje me temat e lartpërmendura.

Gjatë konferencave në Cyrih dhe Prishtinë kam vënë re iniciativat e bashkëpunimit për të ndihmuar në nxitjen e mësimin të gjuhës shqipe si gjuhë plotësuese për gjeneratën e dytë dhe të tretë të shqiptarëve të Kosovës në Zvicër. Në Cyrih jam njohur me legjislacionin dhe kushtet reale të ofruara për një mësim në gjuhën shqipe. Përveç kësaj jam njohur me studimet mbi rezultatet e nxënësve shqiptarë/kosovarë, të cilat ndryshe nga stereotipet dhe paragjykimet rezultojnë në nivele konkurruese me ato të pakicave të tjera evropiane. Shumë interesante ishin edhe prezantimet studimore dhe diskutimet mbi temën e ndërkulturalitetit dhe kërkimit të identitetit tek brezi i parë, i dytë dhe i tretë i emigrantëve në Zvicër.

Shumë me vlerë ishte edhe njohja me histori suksesi të ish-emigrantëve nga Kosova, përveç vështirësive të ndryshme që kanë hasur në jetë. Është më se e qartë se dyzimi i njeriut, pra «të lundruarit» apo «të ngecurit» mes dy apo më shumë botërave/kulturave kërkon një energji dhe sipërmarrje të madhe vetjake. Kjo ia vlen gjithmonë nëse ajo shihet si pasuri dhe jo si pengesë. Për këtë vlerësoj aspiratat dhe shembujt e suksesit të zhvillimit të brezit të ri tashmë, të rritur në Zvicër. Takimet dhe njohja nga afër e disa prej këtyre shembujve gjatë punimeve të rrjetit NEZI ishte një veprim i duhur për të parë nga afër rezultatin e modeleve tashmë të provuara.

Përveç kësaj gjatë Konferencës në Prishtinë dhe Shkup jam njohur me problemet dhe sfidat e reja të gjithëpërfshirjes dhe bashkëjetesës ndëretnike e ndërfetare. Kështu kam

parë nga afër disa shembuj të përparimit në këtë drejtim të prezantuar në disa shkolla. Gjithashtu jam njohur edhe me iniciativa arsimore kombëtare dhe politikbërëse të push-tetit lokal duke pasur në fokus përcjelljen e vlerave e të Drejtave të Njeriut dhe të edukimit demokratik. Modelet e qeverisjes demokratike në shkolla nxisin jo vetëm komunikimin dhe bashkëpunimin mes mësuesve dhe prindërve por ndikonte edhe në vetëpërgjegjësimin dhe disiplinimin e nxënësve.

Përveç arritjeve të vogla por të konsiderueshme, mund të them se në përgjithësi në Ballkan edukimi qytetar dhe edukativ duhet të jetë më në fokus të politikave të arsimit në të ardhmen, meqë të gjithë aspirojnë për bashkimin në KE. Sistemi shkollor duhet të jetë më i konsoliduar, që të ofrojë më shumë hapësira lidhur me përcjelljen e vlerave demokratike dhe orientimeve të sistemeve të vlerave apo normave. Brezi i ri i përballur sot me «bishën» e medias duhet të edukohet që herët jo vetëm mbi të përbashkëtat apo dallimet me grupet ose kulturat e tjera por edhe mbi qasjet dhe të përbashkëtat, që çojnë në bashkëkomunikim, -punim dhe -jetesë. Këto i shoh si elemente të demokracisë dhe pjesëmarrjes aktive në komunitet.

Në lidhje me këto koncepte unë u njoha edhe gjatë prezantimeve të grupeve të vendeve përkatëse, të cilët treguan për legjislacionin dhe rregullimet normative në sistemin arsimor (rasti i Shqipërisë) dhe dhanë shembuj nga modelet e punës organizative dhe edukative të disa shkollave (rasti i Kosovës). Në diskutimet e ndryshme u shpalosën mendime dhe gjykime mbi edukimin për qytetari duke pasur parasysh dimensionet e ndryshme të kësaj çështje, si p.sh. ai politiko-ekonomik, arsimor, edukativ, etik, social-kulturor, etj.

Duhet përmendur se një theks i veçantë iu vu edhe edukimit përkatësisht formimit të mësuesve, të cilët mbartin një pjesë të konsiderueshme të përgjegjësisë së përcjelljes së vlerave shoqërore tek brezi i ri. Prandaj u fol dhe u diskutua mbi programet arsimore dhe sistemin arsimor për formimin e mësuesve në vendet pjesëmarrëse. Gjatë prezantimeve Shqipëria spikat me modelin e saj më të ndërlikuar dhe të shtrirë të gjithëpërfshirjes dhe edukimit pedagogjik, ku shteti me institucionet pedagogjike dhe nismat e shoqatave të huaja kanë kontribuar në rritjen e këtij procesi edukativ, si p.sh. me qasjen e re «Shkolla si qendër komunitare», me kurrikula të veçanta për nxënësit e minoriteteve, apo me shtimin e partneriteteve shkollore dhe aktiviteteve social-kulturore.

Në kuadër të punimeve krahasuese dhe të bashkëpunimit me ekspertët në konferencat, lidhur me zhvillimet social-kulturore dhe politiko-arsimore, kam fituar në rrjetin NEZI edhe një vështrim të përgjithshëm të tematikave të lartpërmendura në vendet pjesëmarrëse, ku shqiptarët gjenden para katër situatave/kushteve të ndryshme që kërkojnë kushte, strategji dhe zgjidhje të ndryshme: Në Zvicër shqiptarët shikohen si minoritet i emigruar por në etablim dhe integrim në shoqërinë zvicerane. Shqipëria tradicionalisht me shoqëri homogjene shqiptare dhe me një histori të veçantë diktature por edhe zhvillim të konsiderueshëm në fushën e arsimit gjendet sërish përpara reformave të mëdha. Kosova si shtet i ri multietnik me shumicë dërrmuese shqiptare përballlet me detyra dhe

përgjegjësi të reja. Së fundmi rasti i veçantë i shqiptarëve të Maqedonisë, të cilët si grupimi më i madh minoritar përballët me sfidat e një situatë të komplikuar të shteti pothuajse dyetnësh.

Megjithatë mendoj se Zvicra me historinë, strategjitë, politikat e ndërgjegjësimi dhe standardet e saj, jep një shembull mjaft të mirë të ndikimit dhe të zhvillimit të bashkëjetesës së komuniteteve me prejardhje të ndryshme etnike, të edukimit qytetar e demokratik sikurse participimit duke i parë si sfidë dhe njëkohësisht pasurim në lidhje me formimin e identitetit, rritjen dhe përshtatjen në një kulturë të re apo përfshirjen në një sistem normash dhe vlerash.

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe realizimit/zbatimit të konferencave, dhe çfarë mund (si) të përmirësohet?

Prandaj jam i kënaqur që ky rrjet bashkoi specialistë të katër vendeve, të cilët jo vetëm që shkëmbyen pikëpamjet dhe përvojat e tyre, por panë dhe përjetuan nga afër disa situata dhe modele nga çdo vend të integritimit ndërkulturor dhe edukimit demokratik në sisteme të ndryshme normash dhe referimesh. Si pasojë janë shkëmbyer kontaktet, janë krijuar miqësi dhe janë shpalosur ide të reja për bashkëpunime të ndryshme në të ardhmen. Për këtë është për t'u përgëzuar puna e palodhur e ekipit drejtues të rrjetit dhe të pjesëmarrësve në vendet përkatëse me fitimin e përvojave të organizimit të konferencave ndërkombëtare.

Pyetja 3

Çfarë tjetër më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI dhe çfarë me ka munguar?

Personalisht ky organizim ishte një përvojë tepër e mirë për shkëmbimin e përvojave. Edhe pse realizimi dhe zbatimi ishte korrekt, mendoj se do të ishte më mirë nëse distanca kohore e konferencave të ishte më e shkurtër, ndoshta 3–4 muaj. Gjithashtu mendoj se më shumë kohë ditore në dispozicion do të ishte më e nevojshme përballë programit të ngjeshur dhe plot intensitet apo përballë diskutimeve të shumta me një larmi aspektesh dhe përvojash nga 4 shtete.

Pyetja 4

Nëse projekti NEZI do të kishte një vazhdimësi: Cilat do të ishin dëshirat e mia në lidhje me drejtimin e këtij vazhdimi?

Përveç kësaj unë do të dëshiroja për të ardhmen vazhdimin e projektit duke u përqendruar më shumë në shkëmbimin e specialistëve nga fusha e pedagogjisë, për nxitje të formimit demokratik dhe të komunikimit ndërkulturor (konferenca, studime, trajnime). Mendoj se, përballë ndryshimeve të shpejta globale dhe ndikimit të mediave të reja, standardet dhe programet e reja të formimit pedagogjik të mësuesve, duhet të kenë më shumë vëmendje, pasi janë ato që përcjellin tek brezi i ri njohuritë social-kulturore e normative dhe vlerat demokratike.

Pyetja 5

Nëse projekti NEZI do ta kishte një vazhdimësi: Cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dhe çfarë mund të kontribuoj unë personalisht për këto projekte?

Gjithashtu me interes do të ishte studimi më specifik i aspekteve të riintegritit të shqiptarëve në atdheun e tyre. Qasja e tyre në jetën shoqërore dhe në sistemin e normave, i cili në shoqëritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor po pëson ndryshime të shpejta për shkak të orientimit drejt familjes evropiane. Këto ndryshime mbajnë të tendosur shoqërinë mes traditës dhe së resë, besimit dhe maskimit, transparencës dhe standardeve të dyfishta, etj. Besoj se në Kosovën e pasluftës dhe në Shqipërinë e viteve të fundit ka mjaft shembuj të të kthyerve nga vendet perëndimore me shpresën dhe dëshirën për të ndryshuar vendlindjen duke dhënë dijet dhe përvojat e tyre. Njohja e ndryshimeve kulturore dhe aftësimi për të kuptuar, komunikuar dhe vepruar ndërkulturalisht janë aspekte, ku do të kontribuoj personalisht me shumë dëshirë (projekt, studim, trajnim). Aktualisht një këndvështrim i ndërsjellë do të ishte interesant në lidhje me fenomenin e ditëve të fundit, atij të azilërkuesve shqiptarë dhe kosovarë në Evropë.

Falë multiperspektivës së tij, ky rrjet në këtë nivel të lartë, ku në qendër janë shqiptarët e Ballkanit Perëndimor dhe të Diasporës, mbetet për mua personalisht i vetmi projekt prestigjioz, që bashkoi shumë ekspertë nga katër vende. Përvoja ime përgjatë kontaktit shumëvjeçar me vendet gjermanishtfolëse nuk më ka njohur me projekte të tilla, pasi kur flitet për Ballkanin apo Evropën Juglindore Shqipëria është anashkaluar shumë shpesh, duke përjashtuar programet e shkëmbimit, ku grupi i synuar kanë qenë të rinjtë.

Si përfundim përgëzoj punën e drejtuesve të rrjetit në lidhje me organizimin dhe gjithashtu punën e pjesëmarrësve dhe ekspertëve për shkëmbimin e përvojave dhe gjallërimin e debateve e diskutimeve lidhur me tematikat e rrjetit. Me shumë kënaqësi do të merrja pjesë përsëri duke dhënë patjetër ndihmesën time.

Nikoleta Mita, Universiteti i Tiranës

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndihmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Projekti i parë i rrjetit NEZI ishte një përvojë e shkëlqyer për mua në disa drejtime.

Dy temat kryesore rreth të cilave u orientua dhe u realizua projekti janë objekt i mësimdhënies, i kërkimit dhe i botimeve të mia, kështu që ato u përputhën plotësisht me interes të mia, e pasuruan njohjen dhe përvojën time, nxitën lindjen e ideve të reja për kërkime dhe veprime konkrete dhe më ndihmuan të reflektoj për veprimtarinë e kryer në Shqipëri në këto dy aspekte.

Shkëmbimi i rezultateve të kërkimeve shkencore, të prezantuara nga kolegët në konferencat e organizuara, ishte një përfitim i dobishëm dhe i vlefshëm për mua pasi jo vetëm që e pasuroi njohjen time me teori dhe gjetje të reja, me këndvështrime të ndryshme, më dha mundësinë të njoh metodologjitë e përdorura nga ekspertët e fushës, por gjetjet dhe përfundimet e paraqitura në konferencat e organizuara mund t'i përdor në funksion të temave të ndryshme të programeve të edukimit në Universitetin e Tiranës. Projekti mundësoi një dialog shkencor ndërkombëtar, mundësoi paraqitjen e këndvështrimeve, njohjen e natyrës së problemeve të orientimit, përfshirjes dhe integritit të fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë në shoqërinë zvicerane. Dialogu ndërkombëtar më ndihmoi të identifikoj të përbashkëtat dhe dallimet që lidhen me ndërkulturën dhe edukimin qytetar në Shqipëri, Zvicër, Kosovë e Maqedoni. Shkëmbimi i perceptimeve, besimeve, fakteve, përfundimeve më mundësoi krijimin e një tabloje më të plotë për ndërkulturën dhe edukimin qytetar. Dialogu krijoi një mjedis të nxëni dhe bashkëpunimi.

Takimet me persona dhe vizita në institucione të përfshirë në tematikën e rrjetit mundësuan njohjen me problemet aktuale, me sfidat për përballimin e tyre dhe me historitë e suksesit.

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe realizimit/zbatimit të konferencave, dhe çfarë mund (si) të përmirësohet?

Në aspektin metodologjik, projekti prezantoi një shumëllojshmëri veprimtarish, si: Konferenca, tavolina të rrumbullakta, rrahje mendimesh, paraqitje modelesh, praktikash, takime me personalitete të shkencës, politikës, mësues, nxënës, të cilat ishin organizuar mjaft mirë. Shumëllojshmëria, planifikimi dhe menaxhimi, ishin dimensionet më të spikatura në aspektin metodologjik. Ndërlidhja e veprimtarive praktike në projekt, të demonstruara në Zvicër dhe Maqedoni, ishte një përvojë nga e cila unë përfitova mjaft. Jo vetëm dimensionin real, praktik i veprimtarive, por edhe përvoja konkrete e mësuesve, nxënësve dhe specialistëve për realizimin e edukimit ndërkulturor, për përballimin e sfidave të ndërveprimit të kulturës së parë dhe të dytë, ishte një vlerë e shtuar.

Mbase relacionet përmbledhëse për çdo fazë dhe veprimtari do të ishin një praktikë e mirë që do të ndihmonte pjesëmarrësit e rrjetit, por edhe persona të tjerë të interesuar.

Pyetja 3

Çfarë tjetër më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI dhe çfarë më ka munguar?

Bashkëpunimi me rrjetin NEZI pati për mua një sërë përfitimesh të tjera që do t'i rendis si më poshtë:

- Unë u bëra pjesë e një rrjeti të ri, e një nisme të re.
- Unë njoha kolegë të rinj, përvojat e tyre, arritjet dhe sfidat e tyre.
- Pjesa sociale e projektit më mundësoi njohjen e kulturave të ndryshme, lidhjen e miqësisë dhe forcimin e saj.
- Projekti ishte një mundësi për bashkëpunime të mëtejshme.

Pyetja 4

Nëse projekti NEZI do të kishte një vazhdimësi: Cilat do të ishin dëshirat e mia në lidhje me drejtimin e këtij vazhdimi?

Sipas meje, sukcesi i projektit të përfunduar është garanci për vijimësinë e kësaj nisme dhe unë do të dëshiroja që kjo nismë të zgjerohej. Propozimet e mia janë si më poshtë:

Së pari, unë do të dëshiroja që NEZI të institucionalizohej si një «rrjet që jeton», me një mision të përcaktuar qartë dhe me një strukturë organizative që të përfshinte një ekip menaxhues që të koordinonte dhe të promovonte bashkëpunimin e degëve në vendet pjesëmarrëse.

Së dyti, do të ishte e dobishme që të përcaktoheshin fushat e veprimtarisë që mund të ishin: Kërkimi, trajnimi, konsulenca, promovimi i praktikave më të mira, publikimi i materialeve burimore. Por rrjeti mund edhe të merrte përsipër fushata ndërgjegjësimi, zhvillim ekspertize.

Së treti, përcaktimi i një axhende afatshkurtër dhe afatmesme të veprimtarisë së NEZI-t do të mundësonte një veprimtari më të efektshme dhe me ndikim më të gjerë. Se katërti, zgjerimi i rrjetit do të mundësonte qarkullimin e ideve, përvojave, praktikave në më shumë njerëz dhe institucione.

Pyetja 5

Nëse projekti NEZI do ta kishte një vazhdimësi: Cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dhe çfarë mund të kontribuoj unë personalisht për këto projekte?

Për të realizuar dëshirat e mia të prezantuara më lart, unë paraqes këto propozime:

Të hartohet një platformë për institucionalizimin e rrjetit si një organizëm i cili bashkërendon veprimtarinë e profesionistëve që janë të interesuar dhe aktivë në çështje të interkulturalizmit dhe të edukimit qytetar në Zvicër, Kosovë, Maqedoni, Shqipëri. Mund të shikohet mundësia e përfshirjes edhe të Malit të Zi dhe vendeve të tjera, por edhe të ekspertëve nga vende të tjera.

Të ngrihen degët e rrjetit në vendet pjesëmarrëse. Të ngrihet një ekip menaxhimi me përfaqësues nga vendet pjesëmarrëse. Të hartohet axhenda afatshkurtër dhe afatmesme e veprimtarive. Aktivitetet tipike të rrjetit të jenë:

- Konferenca periodike (çdo vit ose çdo dy vjet) ku të prezantohen rezultate të kërkimeve në fushën e edukimit ndërkulturor, qytetarisë.
- Trajnime për edukimin ndërkulturor, për gjithëpërfshirjen, për qytetarinë.
- Workshope për çështje praktike të fushës.
- Promovime të përvojave dhe praktikave më të mira.
- Konsulenca për qeveritë.
- Krijimi i një portali me materiale për edukimin ndërkulturor në ndihmë të mësuesve dhe studentëve që përgatiten si mësues.

Rrjeti mund të bëhet pjesë e projekteve të përbashkëta në kuadrin e programeve të mbështetura nga BE. Për një periudhë tranzitore deri në institucionalizimin më formal të rrjetit, unë do të bëja këto propozime:

Rrjeti mund të ndërmarrë veprimtari për disa nga këto tema:

- Zhvillimi i kompetencave ndërkulturore.
- Vlerësimi i kompetencave ndërkulturore.
- Të nxënit ndërkulturor.
- Komunikimi ndërkulturor.
- Zgjerimi i horizonteve ndërkulturore.
- Lidhshipi ndërkulturor.
- Zgjidhjet ndërkulturore për sfidat e kohës që jetojmë.
- Të jetosh dhe punosh në një botë shumëkulturore.
- Zhvillimi i komuniteteve ndërkulturore.
- Krijimi i kulturës gjithëpërfshirëse të shkollës.
- Përgjegjësitë e qytetarëve në kontekstin shumëkulturore.
- Çdo mësues ka një rol në edukimin ndërkulturor.
- Barrierat për edukimin ndërkulturor.

Si dhe:

- Bazuar në rezultatet e projektit të parë të rrjetit NEZI, të përgatiten rekomandime që do të ndihmonin qeveritë e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, për mbështetjen e diasporës shqiptare në Zvicër.
- Rrjeti mund të organizojë një workshop për çështje të edukimit ndërkulturor me studentët që përgatiten si mësues.

Unë mund të kontribuoj në ideimin dhe realizimin e veprimtarive të rrjetit. Unë mund të jap ndihmesë kryesore në ideimin dhe realizimin e veprimtarive që lidhen me zhvillimin e kompetencave ndërkulturore, vlerësimin e kompetencave ndërkulturore, përgatitjen e mësuesve për edukimin ndërkulturore, krijimin e kulturës gjithëpërfshirëse të shkollës, rolin e mësuesit në edukimin ndërkulturore, përgjegjësitë e qytetarëve në kontekstin shumëkulturore.

Merita (Vaso) Xhumari, Universiteti i Tiranës

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndhmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Pjesëmarrja në rrjetin «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura» ka qenë një përvojë e vyer si nga këndvështrimi profesional, si profesor i politikës sociale, ashtu edhe personal për të kuptuar dhe trajtuar drejt dinamikën e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash. Shqipëria që deri në vitet 1990 nuk i ka njohur këto problematika, sot përballat përditë me problemet e emigracionit legal dhe ilegal, problemet e trajtimit të pakicave etnike si minoriteti grek në Jug, apo grupet vulnerable si romët dhe egjiptianët.

Pjesëmarrja në Konferencën I në Cyrih me temë «Ç'do të thotë të rriturit dhe zhvillimi i identitetit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash' për vendin ose kontekstin tonë, cilat grupe janë më së shumti në fokusin e kësaj teme?» u përqëndruam për të mbledhur dhe sistemuar të dhëna nga dokumente të ndryshme që nga CENSUS 2011, i cili jep pasqyrën e përbërjes demografike të popullsisë në realitetin bashkëkohor të Shqipërisë, deri në strategjitë dhe politikat sociale dhe arsimore në mbështetje të integritetit të grupeve sociale me probleme përshtatjeje.

Nga hulumtimi qartësua problematikat shumëdimensionale që përjetojnë në proceset e integritetit, si emigrantët e kthyer, ashtu dhe emigrantët shqiptarë në vendet ku kanë emigruar, ku tipike sot është emigrimi familjar.

Prandaj të kuptuarit e dallimeve dhe ngjashmërive midis dy brezave që bashkëjetojnë, por që ndajnë përvoja të ndryshme integriteti, ka qenë shumë interesant si duke u njohur me përvojën e vyer të shoqërisë zviceriane në zhvillimin e identitetit kulturor të emigrantëve shqiptarë në Zvicër, ashtu dhe me problematikat e integritetit të etnive të

ndryshme në Maqedoni dhe Kosovë. Kësaj i ka shërbyer veçanërisht konferenca me temën «Ndihmesa e mësimit plotësues shqip në përmirësimin e orientimit midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës».

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe e realizimit/zbatimit të konferencave, dhe çfarë mund (si) të përmirësohet?

Aktivitetet e rrjetit janë planifikuar që të përfitohet më e mira në të gjitha planet dhe nga të gjithë pjesëmarrësit. Nga ana metodologjike janë ndërthurur referimet teorike mbi temat e zhvillimit të identitetit kulturor, të integritetit dhe përfshirjes sociale, me konkretizime të rasteve të gjalla që dëshmuar se si vetë personat e ftuar kishin kaluar përvoja të integritetit të shqiptarëve në shoqërinë zviceriale, apo të emigrantëve të kthyer në shoqërinë maqedonase dhe kosovare.

Krahas tyre, me shume interes kanë qenë punët në grupe, qoftë me pjesëmarrësit e një shteti, qoftë në grupe mikse me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga shtete të ndryshme, ku debatet ishin frytdhënëse sepse këmbëheshin ide nga përvoja të ndryshme. Po me aq interes kanë qenë fjalimet e përfaqësuesve të diplomacisë shqiptare në Zvicër të cilët qartësuan politikat shtetërore në kuadrin e mbështetjes së emigrantëve për integritetin në vendet ku ata jetojnë. Tipike ishin vizitat në shkolla, diskutimet në klasa me mësues dhe nxënës që përjetonin problematikat e integritetit të tyre dhe familjeve që kishin emigruar apo të rikthyer në rastin e Kosovës dhe të Maqedonisë. Mësimi në dy gjuhë, me tematika për ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar dhe me veprimtari që mbështesnin realisht integritetin, na bëri të prekim nga afër procesin e bashkëveprimit mes kulturave.

Në këndvështrimin tim ky rrjet ka sjellë risi në mënyrën e bashkëpunimit mes shqiptarëve të të tri vendeve duke shkëmbyer jo vetëm ide për bashkëpunime, por edhe duke parë nga afër se si realizohet qoftë mësimi i gjuhës shqipe në secilin vend. Njohja e teksteve, qarkullimi i tyre mes shteteve do të lehtësonte qoftë edhe unifikimin e terminologjisë së gjuhës shqipe, veçanërisht për lëndët e edukatës qytetare dhe demokratike që pasqyrojnë parime të të drejtave universale të shpalluara në dokumente ndërkombëtare të OKB-së.

Pyetja 3

Çfarë tjetër më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI dhe çfarë më ka munguar?

Unë si profesor i përcjell secilën nga këto ide tek studentët e mi, duke u dhënë modelin e trajtimit të diversitetit të kulturave, mundësi të njëjta për të zhvilluar idetë dhe perceptimet në varësi të identiteteve të ndryshme kulturore. Po ashtu metodologjitë e ndërveprimit në auditor, punës në grupe të ndryshme dhe gjetja e rasteve tipike për të sjellë konkretizime reale të koncepteve të integritit dhe gjithëpërfshirjes sociale.

Ishte një bashkëpunim i mbarë dhe unë gjeta në rrjetin NEZI kolegë, profesorë jo vetëm nga Zvicra, por edhe nga Maqedoni dhe Kosova, me të cilët mund të bashkëpunojmë edhe në të ardhmen. Mundësimi i bashkëpunimeve mes profesorëve të universiteteve të Rajonit ishte një përfitim që unë kam marrë nga rrjeti NEZI dhe që shumë pak mundësi kemi në Rajon për shkëmbime eksperiencash të tilla, pa mundësimin e projekteve me mbështetje nga jashtë.

Pyetja 4

Nëse projekti NEZI do të kishte një vazhdimësi: Cilat do të ishin dëshirat e mia në lidhje me drejtimin e këtij vazhdimi?

Do të dëshiroja që ky rrjet të vazhdonte bashkëpunimin për ta shtrirë më tej shkëmbimin e përvojave në kushtet që problemet e emigrimit të shqiptarëve në Evropë kanë marrë përsëri një vëmendje të veçantë për shkak të rritjes së emigrimit masiv të familjeve nga trojet e Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë.

Vazhdimi i shkëmbimit të përvojave në politikat arsimore, mua më është dukur mjaft me interes, përderisa arsimi, gjuha kultura janë treguesit kryesorë të identitetit kulturor. Do të më interesonte vazhdimi i aktiviteteve të rrjetit duke u shtrirë në gjithë larminë e ndërhyrjeve dhe politikave të shoqërive bashkëkohore në drejtim të përkrahjes në orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës. Nëse mund të angazhoheshim në projekte të përbashkëta edhe përtej politikave arsimore, çfarë veprimtarish sociale e kulturore do ta lehtësonin edukimin qytetar demokratik? Përvoja e pasur e Zvicrës me sistemin arsimor të zhvilluar në drejtim të edukimit qytetar demokratik do të sillte, një ndihmesë, nëse ne do të ndikonim në vendet tona për të prezantuar dhe pilotuar këto përvoja.

Pyetja 5

Nëse projekti NEZI do ta kishte një vazhdimësi: Cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dhe çfarë mund të kontribuoj unë personalisht për këto projekte?

Së pari, do të dëshiroja të realizonim një studim rajonal mbi format e përdorura në vendet tona për të realizuar edukimin qytetar, sa ato përcjellin parimet demokratike të shoqërive përparimtare. Studimi të konsistonte në evidentimin e rasteve më të mira të edukimit qytetar në të gjitha ciklet e edukimit, që nga sistemi parashkollor, arsimi i detyrueshëm dhe arsimi i mesëm për t'i sjellë në një botim të përbashkët të të tri vendeve.

Së dyti, të bëhej një vlerësim i teksteve të edukatës qytetare, pasi pluraliteti i teksteve ka sjellë edhe tekste që mund të kenë koncepte jo të konkretizuara qartë. Mbi të gjitha, për mësuesit e edukatës qytetare të ketë edhe tekste mbi metodologjinë që duhet të përdorin në realizimin e kësaj lënde, jo thjesht vetëm me mësim në klasa, por edhe jashtë klase.

Së treti, të organizohen trajnime të mësueve të lëndëve të edukatës qytetare dhe unë mund të kontribuoj me përvojën si pedagoge në këtë drejtim.

Së katërti, krahas aspekteve të edukimit, me interes do ishte që rrjeti të kontribuonte në shkëmbimin e përvojave edhe në lidhje me ndërhyrjet e tjera që realizohen konkretisht nga qeveria dhe shoqëria zviceriane për bashkëjetesën mes kulturave në një plan më të gjerë, për punësimin, sepse sfera e arsimit ka në vëmendje vetëm një kategori, kryesisht të rinjtë dhe fëmijët, por jo të gjitha moshat dhe interesat.

Grupi i Kosovës (Pjesëmarrësit/et nga Kosova)

Arif Demolli,
Ministria e Arsimit të Republikës së Kosovës (pensionist):
Shiko tek Nuhi Gashi.

Lulzim Dragidella,
Universiteti i Prishtinës

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndihmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Bashkëpunimi në një rrjet në të cilin marrin pjesë mbi njëzet e pesë ekspertë të fushave të ndryshme të kulturës së parë, të dytë dhe të ndërkulturës nga Kosova, Zvicra, Maqedonia dhe Shqipëria është një mundësi e rrallë ku bashkërisht punohet në mënyrë tematike. Në kuadër të rrjetit ne kishim mundësinë që të diskutim për sistemet e ndryshme të vlerave dhe normave me qëllim të të kuptuarit të këtyre sistemeve referuese.

Edukimi për demokraci është një tematikë tjetër shumë e rëndësishme që është tematizuar në kuadër të rrjetit e që ka një rëndësi të veçantë për sistemin referues të kulturës së parë.

Qëllimi i rrjetit NEZI ishte që të zhvillohet një shkëmbim i njohurive shkencore dhe i modeleve të provuara në praktikë, të cilat kanë të bëjnë me kulturën e parë, me kulturën e dytë dhe ndërkulturën. Ky shkëmbim, do duhej të na jepte njohuri të reja se si mund të rritesh dhe edukohesh në këto sisteme të ndryshme referimesh.

Për t'i kuptuar këto gjëra, sipas mendimit tim, duhet të sqarohet edhe nocioni i kulturës. Të rritesh në kulturën e parë, që do të thotë në një sistem të caktuar të vlerave dhe normave shoqërore, që në shkencë quhet socializimi i parë dhe socializimi i dytë (shoqëria, shkolla, etj.). Pra, kjo do të thotë se/që në këtë internalizim vlerash (të individit), rol shumë të rëndësishëm luajnë gjuha, besimi, morali, e drejta, ekonomia etj.

Kur flasim për kulturën e parë, unë mendoj se në kuadër të NEZ-it, kemi kuptuar se nuk bëhet fjalë vetëm për ata individë që janë rritur në shtetet e origjinës por edhe për

gjeneratat e reja, që janë lindur dhe rritur në kulturën e dytë (Zvicër). Mirëpo, në një anë ata janë pjesë e familjeve të tyre që vijnë dhe janë rritur në kulturën e parë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë janë pjesë e socializimit të parë, ku atyre u transmetohen vlera dhe norma të caktuara. Ndërsa, në anën tjetër ata janë pjesë e sistemit të kulturës së dytë ku tani ndodh edhe socializimi i dytë (shkolla, shoqëria, puna, etj), dhe është rast ku kemi një sistem tjetër vlerash dhe normash. Të rinjtë shqiptarë duhet rregullisht të lëvizin në këto dy sisteme referimesh, gjë që shpesh herë e bën të vështirë njohjen dhe pranimin e vlerave të caktuara.

Në fillim të ardhjes së emigrantëve të parë shqiptarë në Evropën Perëndimore (edhe në Zvicër), shpesh herë shtetet mikpritëse edhe qëllimisht kanë ndjekur modele të caktuara mbi kulturën si model i një sfere, ku kultura e parë është trajtuar diçka e izoluar nga kultura e dytë dhe vetë kohë pas kohe ka pasur pika takuese.

Pikërisht nga ky model, lind nocioni i një shoqërie multi-etnike. Kjo do të thotë, se në një shoqëri të caktuar kemi edhe kultura të ndryshme por që jetojnë të izoluar nga njëra tjetra, të cilat trajtohen si model i një sfere. Cdo gjë ndodh brenda një kulture dhe në raste të rralla kemi disa pika takuese ose kontakti me kulturën tjetër. Mendoj, se kjo qasje ndryshoi më vonë në Evropën Perëndimore por edhe në Zvicër. Tani, kur ne flasim për kulturat e ndryshme në Zvicër i referohemi konceptit të ndërkulturës. Kjo do të thotë se tani kultura e parë dhe kultura e dytë hapen ndaj njëra-tjetres dhe fillojnë kontaktet. Këtu ndeshen tani sistemet e ndryshme të vlerave. Kur flasim për konceptin e ndërkulturës ekziston sërisht rreziku i dallimeve kulturore.

Unë them/supoj, se tani për t'iu larguar këtij rreziku të dallimit të kulturave, duhet të mendojmë për forma tjera të bashkëjetesës. Një ndër format tjera është ndërkulturaliteti. Këtë nocion për herë të parë e përdori filozofi i njohur Welsch. Kur flasim për koncept të bashkëjetesës, atëherë mendojmë se nuk krijohet një kulturë e re globale, por çdo herë duke e theksuar se ne tani flasim për individ dhe shoqëri të cilat lëvizin në mes të kulturave të ndryshme dhe që bartin në vete elemente transkulturore.

Në këtë kuptim, secili prej nesh edhe, në rastin konkret, tek të rinjtë shqiptarë në Zvicër bart elemente «të huaja» në brendinë e vet. Kjo mund të bëhet pjesë e identitetit të secilit të ri shqiptar, kur ajo pjesë «e huaj» bëhet e vetëdijshme.

Siç e përmenda edhe më lart, unë mendoj se në këtë drejtim, që «e huaja» të bëhet pjesë e vetëdijshme e identitetit të të rinjve shqiptarë në Zvicër, një rol të rëndësishëm mund të luajë edhe edukimi për demokraci. Në lidhje me rolin e edukimit për demokraci në kemi pasur mundësinë që këtë rol/ndikim ta shohim edhe në praktikë gjatë takimeve tona.

Roli i edukimit për demokraci mund të jetë i pashmangshëm kur kemi të bëjmë me çështjet e lirisë së shprehjes, të Drejtat e Njeriut, etj.

Këto vlera do duhej të ishin bazë e panegocueshme e secilës kulturë apo e një transkulture.

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe e realizimit/zbatimit të konferencave, dhe çfarë mund (si) të përmirësohet?

Rrjeti NEZI, ka dhënë një ndihmesë shumë të frytshme për mua përsa i përket aspektit metodik të organizimit të takimit. Në rend të parë, e theksoj si pozitive, planifikimin e saktë të aktiviteteve në kuadër të takimeve tona fizike, në konferencat e caktuara por edhe në kuadër të punës sonë parapërgatitore dhe paspërgatitore. Personalisht them se ishte një përvojë shumë e mirë dhe organizimi praktik i një ore mbi mësimin për demokraci në një shkollë në Shkup. Shpesh herë në vendet e kulturës së parë mungon ndërlidhshmëria në mes të teorisë dhe praktikës. Gjithashtu, vlerësoj se kjo ka qenë/ishte për mua reflektim i teorisë. Ndër të tjera, si anë pozitive ishte shumëllojshmëria e pjesëmarrësve, por në raste të caktuara kjo shumëllojshmëri profesionale, ekspertizash ka qenë edhe sfiduese.

Pyetja 3

Çfarë tjetër më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI dhe çfarë me ka munguar?

Rrjeti NEZI, për mua ka dhënë një ndihmesë të vecantë përsa i përket edhe mbledhjes së individëve nga vendet e ndryshme në një vend të përbashkët, për të diskutuar rreth tematikës së caktuar. Përveç kësaj ne jemi njohur mbi aktivitetet e tjera të pjesëmarrësve dhe mundësitë e tjera të bashkëpunimit mes nesh në kuadër të ndonjë projekti tjetër grupor apo individual.

Pyetja 4

Nëse projekti NEZI do të kishte një vazhdimësi: Cilat do të ishin dëshirat e mia në lidhje me drejtimin e këtij vazhdimi?

Duke marrë për bazë rëndësinë dhe kompleksitetin e tematikës, unë mendoj se duhet të ketë plotësime në kuadër të aspektit metodik. Trajtimi i tematikave të tilla kërkon një hapësirë dhe mundësi kohore më të mëdha. Sipas meje, trajtimit të këtyre çështjeve i duhet dhënë më shumë kohë. Takimet njëditore në konferenca dhe një program i ngjeshur, duke marrë parasysh edhe udhëtimin e pjesëmarrësve nga vendet e ndryshme,

them se përbëjnë një presion shumë të madh. Mendimi im në këtë aspekt është se duhet të jepet më shumë kohë si dhe të bëhen disa ndryshime si vijon. Konferencat të jenë së paku dy ditë punë dhe të rishikohet madhësia e grupit. Këtu theksoj, se numri i madh i grupit ndonjëherë ka paraqitur vështirësi për punën në formën e caktuar. Në këtë kontekst, duhet rishikuar edhe fushat e ekspertizës së pjesëmarrësve. Ndonjëherë, fushat e ndryshme të ekspertizës kanë dërguar në kahje jo të duhur punën në grupe gjatë konferencës.

Pyetja 5

Nëse projekti NEZI do ta kishte një vazhdimësi: Cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dhe çfarë mund të kontribuoj unë personalisht për këto projekte?

Në rast të vazhimit të projektit, ndihmesa ime do ishte në sferën e integritetit të të huajve nga aspekti teorik dhe praktik, duke u bazuar në përvojën time disavjecare në punën me emigrantët dhe në integrimin e tyre në shoqërinë gjermane.

Nuhi Gashi,
Ministria e Arsimit të Republikës së Kosovës,
dhe
Arif Demolli,
Ministria e Arsimit të Republikës së Kosovës (pensionist).

Pyetja 1

Çfarë përfituam nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndhimë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Bota jonë «e madhe», e njohur si planeti Tokë, falë zhvillimeve marramendëse të shekujve të fundit, në veçanti në sferën e komunikimit, realisht po bëhet gjithnjë e «më e vogël», respektivisht e përthekueshme apo edhe e arritshme, si fizikisht po ashtu edhe kulturalisht. Sigurisht brenda kësaj lëvizjeje, këtij komunikimi apo ndërkomunikimi, zhvillohet e perceptohet më drejt e më qartë edhe koncepti i globalizmit apo edhe i globalizimit, i cili së paku në premisat themelore dhe në deklaratat e promovimit publik i referohet ruajtjes, respektimit, kultivimit e zhvillimit të veçantive, specifike, diversitetit kulturor. Dhe, të gjitha këto, në një perceptim human e qytetar modern, i përkasin trashëgimisë kulturore njerëzore, pra janë globale. Edhe projekti i SHLP-së të Cyrihut, respektivisht i Institutit IPE, tashmë i njohur në qarqet shqiptaro-zvicerane si NEZI, përpiket të hulumtojë, të konstatojë, të krahasojë, të zbërthejë, kategori, veprime, koncepte, dukuri, kode, konventa brenda temave komplekse, si: a) Përkrahje e orientimit midis kulturës së parë, të dytë-ndërkulturës, dhe b) të pafundshmes e të pashtershmes temë për gjithë njerëzimin e të gjitha kohërave Edukimi për qytetari demokratike etj.

Elemente të universit kulturor shqiptar, respektivisht modele të hapësirave gjeografike e politike, pashmangshëm me konsekuenca të ndryshme të rrafshit kohor, historiko-politike, ballafaqohen e krahasohen ndërmjet tyre, për të vënë më në fund në pah ekzistencën e konsistencën kulturore shqiptare unike, integralitetin e saj, në njërën anë, dhe si e tillë, në kompaktësinë e saj, në anën tjetër vihet në raporte me kulturën tjetër (të vendit të ri, të atdheut të ri, të Zvicrës si model shumëkulturor shembullor). Është e ditur që rreth 40% e shqiptarëve jetojnë jashtë hapësirave etnike shqiptare, kështu që brenda një komunikimi ndërkulturore dinamik me atdheun dhe me vendet e tyre pritëse, ata paraqesin një faktor me forcë ndikimi. Pra, realisht ata, duke qenë formalisht qytetarë dypatrëdhë, në të dy rrafshet krahasuese janë edhe qytetarë dygjuhësorë e dykulturorë.

Nga perspektiva vërtet kompetente dhe, duke iu referuar edhe rezultateve shkencore të fushave përkatëse (psiko- e sociolinguistikë, sociologji kulturore e familjare, antropologji e etnologji, pedagogji ndërkulturore e didaktikë), Konferenca afirmoi interesin

shumëpalësh kulturor të mësimit të gjuhës dhe të kulturës së origjinës (lexo: Gjuhës shqipe e kulturës shqiptare) nga ana e fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë në Zvicër.

Njësi e mjedise kulturore e ndërkulturore shqiptare (Prishtinë, Shkup, Cyrih e Tiranë) u vunë në raporte krahasuese, fillimisht ndërmjet vetive e më pas edhe me kulturat e tjera, për të parë ndërveprimet dhe ndikimet e ndërsjella në fushën e arsimit parauniversitar dhe të qëllimeve e ndikimeve për edukimin qytetar, për krijimin e baraspeshës së nevojshme të rritjes midis kulturash etj.

Në këtë kompleksitet konceptesh, kategorish e temash, edhe në këtë komplementaritete veprimesh, ndikimesh e komunikimesh, hyrja e qasja ishin plot kureshtje, të motivuara mjaft mirë për të parë interesin personal dhe u duk se, ndër të tjera, u arrit në përfundime:

Përkundër veprimeve e ndikimeve në kohë e hapësira të ndryshme, kultura shqiptare është e integruar më vete dhe kompakte por, në këtë plan, në qarqe, rrethe a shtresa të caktuara, për arsye të ndikimeve të ndryshme kulturore e politike, jo rrallë vërehet një mëdyshje perceptimi duke e identifikuar atë (profilin kulturor të shqiptarit) ndryshe (një perceptim evident në Zvicër për shqiptarët i cili evoluon prej identifikimit apo «shkrirjes» së tyre në jugosllavë, deri në vitin 1989, e më pas në shqiptarë, shembulli më i dhimbshëm i viktimave të represionit e segregacionit të vazhdueshëm të shtetit serb (1990-2001) deri te i fundit në muslimanë, 2001 e këndej, është vërtet shqetësues dhe i shëmtuar nga qarqe e grupe politike ksenofobe apo edhe albanofobe.

Në Kosovë arsimi dhe sistemi arsimor synojnë t'u afrohen sistemeve simotra të shteteve perëndimore duke synuar edhe rol të veçantë në edukimin për qytetari demokratike, por ballafaqohet me inercione e reminishenca të sistemit të kaluar, me konsekuenca edhe më tej të ndieshme të luftës së fundit, me refuzimin e minoritetit serb për t'u integruar në sistemin arsimor etj. Përndryshe në Kosovë, në përgjithësi, në raport me temat e fokusit të Konferencës, tashmë është ndërtuar një infrastrukturë ligjore e profilit evropian dhe pritjet janë optimiste. Po ashtu edhe reforma kurrikulare pretendon të identifikohet me trendet evropiane.

Edicioni i Shkupit vuri në vëmendje përpjekjet e shqiptarëve për zhvillim të barabartë me maqedonasit dhe brenda një partneriteti shtetbërës, në njërën anë, dhe, në anën tjetër, vullnetin e pamjaftueshëm politik të palës maqedonase për këtë dhe tendencën e saj për hegjemoni e diskriminim. Caktimi i orareve të mësimit nëpër shkolla sipas përkatësive etnike, diskriminimet gjuhësore e kulturore, diskriminimet hapësinore në shkollë, shpifja e falsifikimi i historisë deri te glorifikimi primitiv i saj (qendra e re e Shkupit si provokim kulturor, ai akt kulturor përjashtues dhe albanofobia e vërejtur kudo), janë shënja jo të mira dhe nuk ofrojnë ambient qytetar për demokraci të mirëfilltë.

Çfarë duhet thelluar?

Posaçërisht te brezi i parë dhe i dytë i emigrantëve vërehet një fortifikim kulturor në kode, zakone e konvenca që, duke qenë jo tipike e jopërfaqësuese shqiptare, tashmë në atdheun e origjinës janë kapërcyer dhe nuk paraqesin vlera as identitare, as kulturore, as qytetare. Së këndejmi, të hulumtohen modele (e mjedise) të tilla dhe të mundësohet hapja kulturore, respektivisht komunikimi dinamik kulturor, si në raport me vendin e origjinës, ashtu edhe në raport me vendin e ri. Në mënyrë të veçantë të hulumtohet roli dhe pozita e gruas shqiptare (në familje, në shkollë, në edukim për demokraci etj.).

Po ashtu me interes është edhe hulumtimi i statusit social, ekonomik, kulturor e psikologjik etj. si dhe i perceptimit kulturor të emigrantit apo qytetarit me sfond emigrues; të kapen e afishohen arsyet e ndjesisë personale (është naive) të të qenit zakonisht «i dytë» apo edhe i «margjinalizimit» në të dy vendet.

Të hulumtohet më thellë ekujlibrimi i mirëfilltë ndërkulturor dhe të afirmohet si një favor, përparësi e mundësi e integritit të plotë në shoqëri?

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe e realizimit/zbatimit të konferencave dhe çfarë (si) mund të përmirësohet?

Duke qenë një shembull i mirë i organizimit në rrafshe të ndryshme, nga pikëpamja metodologjike, konferenca na njohu më tej me përvojat e të tjerëve në organizime të këtilla komplekse, ku komunikime e bashkëpunime, që i shquan saktësia, përgjegjësia e planifikimit dhe e realizimit, respektimi i tjetrit dhe i të ndryshmes, para së gjithash përbëjnë edhe vlera themelore qytetarie demokratike.

Modelimi i qartë teorik dhe planifikimi në kohë, përgjegjësia e vazhdueshme e organizimit (apo afishimi i kësaj te të gjithë) dhe e realizimit të zbatimit në të gjithë zërat, përfshirja në role vepruese, dëshmuuese, hulumtuese etj. e të gjithë subjekteve, duke i respektuar në masë të pranueshme (pa paragjykime favorizuese apo përjashtuese) po ashtu të gjithë, u hap rrugë shumësisë së qasjeve dhe konstatimeve të miradresuara e kompetente.

Natyra lëvizëse e konferencës nëpër disa qendra shqiptare (kryesoret) e vë atë në lidhje më të ngushtë e të përgjegjshme me vetë lëndën, temën, qëllimin, përfshirjen e insitucioneve përkatëse dhe të subjekteve.

Ndoshta duhet menduar në krijimin e kushteve për analiza me të thella, më shterruese dhe me bazë më kompetente hulumtuese e krahasimtare brenda njësive shqiptare dhe të njësive shqiptare me të tjerat.

Pyetja 3

Çfarë tjetër më ka sjellë bashkëpunimi në rrjetin NEZI dhe çfarë më ka munguar?

Këtë rrjet tashmë të identifikuar me gjuhë pune si NEZI dhe bashkëpunimin brenda e tij, duhet përjetuar si komunikim dinamik, ku çmohet mendimi i lirë dhe ndryshe. Njohja me qarqe shqiptare dhe të tjera përbëjnë edhe një vlerë të re të kësaj Konference.

Ndoshta, për të thelluar më tej diskutimin e debatin, konferenca do të duhet të zgjatej edhe për një gjysmë dite pune.

Pyetja 4

Nëse projekti NEZI do të kishte një vazhdimësi: Cilat do të ishin dëshirat tona në lidhje me drejtimin e këtij vazhdimi?

Konferenca do të duhej të hapej edhe më tej për tema të reja, drejt njerëze e profileve të ndryshme të fushës së kulturës, të gjuhës, psikologjisë, antropologjisë, didaktikës, pedagogjisë ndërkulturore, etnologjisë, arteve, besimeve etj.

Pyetja 5

Nëse projekti NEZI do ta kishte një vazhdimësi: Cilat janë propozimet tona konkrete për këtë vazhdim dhe çfarë mund të kontribuojmë ne personalisht për këto projekte?

Të nxiten debate, hulumtime të ndryshme nga mjedisi kulturor-arsimor i shqiptarëve në diasporë (40 % e shqiptarëve) dhe marrëdhëniet e tyre me kulturat e ndryshme, ndikimi i tyre në vetë profilin kulturor shqiptar.

Një edicion t'i kushtohet fenomenit kulturor shqiptar të «Shacit» ose të «Shacave» (prej ngjyrimit pezhorativ e deri ironik), që i referohet shqiptarit me sfond migrator duke e kapur në të gjitha përmasat e tij (psikologjike, sociale, ekonomike etj.).

Është me shumë interes studimi i jetës shoqërore e publike të gruas shqiptare, rolit e të ndikimit të saj në familje, rolit të saj në mbështetjen e shkollës etj.

Shqipe Gashi-Ramadani, Ministria e Arsimit të Republikës së Kosovës

Hyrje

Projekti NEZI i filluar më 2013, është projekt që na ka ndihmuar të begatojmë edhe mëtej njohuritë për kulturalizmin, interkulturalizmin, konceptet kultura e parë, kultura e dytë dhe për edukimin qytetar. Përmes këtij projekti së pari krijuam miq nga trojet shqiptare, nga diaspora shqiptare por edhe nga Zvicra dhe në këtë vazhde shkëmbyem përvoja për çështjet e lartshënuara.

Vizitat e zhvilluara në Zvicër, Kosovë dhe Maqedoni, na mundësuan që për së afërmi të shohim integrimin dhe bashkëjetesën apo vështirësitë për t'u integruar dhe jetuar bashkë, qytetarë të kombeve të ndryshme, të besimeve të ndryshme fetare dhe të komuniteteve të ndryshme shoqërore.

1

Praktika të ndërkulturalizmit dhe qytetarisë demokratike, nevojat për thellim

Qasja zvicerane për t'i integruar të huajt në jetën zvicerane, në këtë rast edhe të shqiptarëve, është shembull i mirë për vendet që përballen me të huaj por edhe për vendet që kanë vështirësi në integrimin e etniteteve të ndryshme në jetën e tyre të përbashkët shoqërore. Mundësia që të huajt në vendin pritës të organizojnë mësim plotësues në gjuhën amtare dhe të mësojnë për kulturën e vendit të origjinës por nën kornizën e një kurrikule të përcaktuar nga shteti pritës, konsideroheshin si bazament i integrimit të çdo qytetari në mjedise të reja shoqërore. Hulumtimet e zhvilluara për mësimin e gjuhës amtare krahas mësimin të gjuhës së vendit pritës, tregonin përparësitë e integrimit të qytetarëve të huaj në gjitha sferat e jetës në vendin pritës. Po ashtu njohja me historinë, gjeografinë, kulturën dhe traditën e vendit të origjinës, në anën tjetër trajtoheshin si mundësi që gjenerata e dytë dhe e tretë të integrohen më lehtë në vendlindjen e prindërve apo gjyshërve të tyre në rast vizite por edhe kthimi.

Segregacionet në kurrikulë për popullatën e dytë të një shteti, si rasti i shqiptarëve në Maqedoni, për mësimin e historisë dhe kulturës së tyre, mund të konsiderohen si faktorë që do të nxisnin konflikte dhe do të pengonin bashkëveprimin për ndërtimin një shteti demokratik. Pastaj segregacioni fizik duke i ndarë lagjet, shkollat dhe qendrat tregtare dhe shtrembërimi i historisë duke përvetësuar idhujt e kombeve të tjera apo duke ekspozuar në çdo cep vetëm heronjtë e një kombi dhe çështje të tjera si këto, i kontribuojnë ndasive, urrejtjes dhe nxitjes së tensioneve e jo bashkëjetesës si vlerë e sho-

qërisë së sotme demokratike. Një mënyrë e tillë e jetesës reflektohet edhe në përcaktin e përmbajtjeve kurrikulare në favor të njërës palë nga shteti dhe në anën tjetër përzgjedhjen e tyre nga vetë mësuesit, të paparashikuara në kurrikulën zyrtare, si revansh ndaj palës tjetër. Në këtë drejtim nxënësit çdo herë ngarkohen me gjuhën e urrejtjes dhe jo të paqes, gjithashtu pengohet mësimdhënia efektive dhe të nxënit e sukseshëm, sepse në kësi rastesh mbretërojnë emocionet e jo arsytet.

Integrimi i sukseshëm në jetën e përbashkët brenda një shteti është rezultat edhe i gatishmërisë së secilës palë, sepse përpjekjet e njëanshme, përkatësisht vetëm të njërës palë, shpesh janë jo frytëdhënëse. Në rastin e Kosovës përsa i përket integritetit të etniteteve në shoqërinë saj vërehet se pjesa më e madhe e tyre janë integruar, përjashtuar komunitetin serb. Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme të palës shqiptare që komuniteti serb të integrohet në jetën shkollore të Kosovës, ai ende punon me plane dhe programe të Serbisë dhe nuk u përgjigjet kërkesave të Qeverisë së Kosovës e së fundmi as pilotimit të kurrikulës së re. Çështje të tilla si në rastin e Maqedonisë dhe të Kosovës mendoj se mund të trajtohen në projektin NEZI përmes temave të edukimit për qytetari demokratike në nivelin e zgjidhjes së konflikteve, ndërmjetësimit e temave të tjera të ngjashme të përditshmërisë shkollore.

Zhvillimet kurrikulare duke përcjellë trendet në arsim për Kosovën, duke parë vështirësitë me të cilat përballen shkollat e saj, mund të konsiderohen ende si sfidë për t'u realizuar. Krahës sigurimit të kushteve fizike për t'u mundësuar shkollave që të punojnë më një ndërresë shumë të rëndësishme është parë edhe investimi i mëtijshëm në kapacitetet njerëzore, respektivisht në stafin menagjerial dhe profesional, përfshirë mësimdhënësit që të bëhen të hapur dhe më shumë bashkëpunues përbrenda shkollës dhe jashtë saj, dhe kjo frymë më pas vetvetiu të reflektohet tek nxënësit. Projekti NEZI me përvojat e shkollave zvicerane do të na ndihmonte që më shumë të kemi mundësi që praktikisht të shohim funksionimin e një shkolle demokratike duke filluar nga udhëheqja e shkollës e deri te zhvillimi i procesit mësimor nga mësuesit.

Pra, projekti NEZI na mundësoi që të shohim ballafaqimin e shqiptarëve të Zvicrës, Maqedonisë dhe Kosovës me aspektet e integritetit, ndërkulturalizmit dhe diversitetit në kontekst të vlerës dhe antivlerës përbrenda shteteve ku jetojnë dhe diversitetit pozitiv brenda tyre si komb.

2

Praktika organizative, përfitime dhe propozime

Organizimet e konferencave në shtete prej nga vinin pjesëmarrësit, të kombinuara me vizita në shkolla, orët model (kujtojmë orën e mbajtur nga Prof. Rolf Golob) dhe me vizita në qytete ku organizoheshin ato, mundësuan përqëndrim të madh të pjesëmarrësve në temat e përcaktuara dhe po ashtu trajtimin e tyre nga disa perspektiva, nga pozita e nxënësit, e mësuesit, e drejtorit, e zyrtarit të shtetit për profesione të caktuara, e shoqërisë civile, nga pozita e përfaqësuesit të etnisë dhe grupeve të ndryshme shoqërore. Qasja e organizimit të konferencave në vende të ndryshme i mundësoi secilit pjesëmarrës që të bëhet aktor aktiv, kujtojmë ndërrimin e roleve varësisht nga detyrat, si të organizatorit, vizitorit, moderatorit dhe ligjëruesit. Metodologjia e tillë e trajtimit të çështjeve të ndryshme mund të përdoret si shembull i mirë në punën tonë të përditshme profesionale.

Përsa i përket kohëzgjatjes së konferencave mendoj se ishin të shkurtra në ditë por të ngjeshura shumë brenda ditës. Pjesëmarrësve nuk u dha mundësia që më mirë të eksploronin vendet, përkatësisht qytetet ku u organizuan konferencat, bile as për eksplorim individual, prandaj në rast se vazhdon ky projekt, duhet menduar për këtë aspekt.

3

Rekomandime

Ky projekt më tutje është mire të fokusohet në hulumtime, respektivisht në gjetjen e mundësive legislative e kurrikulare të vendeve pjesëmarrëse që ndërkulturalizmi dhe respektimi i diversiteve në kontekste të ndryshme të bëhet pjesë e frymës së institucioneve edukativo-arsimore të të gjitha niveleve formale, e jo vetëm e përmbajtjeve mësimore. Meqenëse fusha ime profesionale i përket kësaj linje, përkatësish kurrikulës, përsa i përket hulumtimit dhe shkëmbimit të përvojës mendoj se mund të jap një ndihmesë. Gjithashtu mendoj se ndihmesa do të ishte e mundshme në këtë lëm nga gjithë pjesëmarrësit në projektin NEZI sepse ata vijnë nga fusha e edukimit, vijnë nga shkollat, fakultetet institucionet qeverisëse por edhe OJQ-të që merren me edukim.

Melinda Mula,
Universiteti i Prishtinës, Kosova Education Center (KEC)

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore
 a) «Ndhimë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe
 b) «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

a) Gjendja e vështirë socio-ekonomike ka bërë që shumë qytetarë të Kosovës të emigrojnë në vende të ndryshme të Bashkimit Evropian për të kërkuar një jetë më të mirë. Një gjë të tillë e konfirmojnë dhe raportet e progresit për Kosovën të Komisionit Evropian. Ata të cilët kanë fituar të drejtën e qëndrimit në vende të ndryshme, janë përballur me sfida për t'u integruar në një kulturë e cila dallon nga kultura e origjinës, ndërsa ata që kthehen, ballafaqohen me problemet e riintegrit të tyre ose të fëmijëve të tyre, për të cilët vendi i origjinës së prindërve dallon nga kultura e vendit ku kanë lindur.

Projekti «Orientimi midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës», më ka ofruar mundësi të njohjes së problematikës së orientimit të qytetarëve midis kulturës së parë (të origjinës) dhe kulturave të tjera të vendeve ku ata kanë emigruar, me theks të veçantë të shqiptarëve që janë shumicë absolute në Shqipëri, të shqiptarëve që janë shumicë në Kosovën multietnike, të shqiptarëve që janë nacionalitetet shetformues në Maqedoni, si dhe të shqiptarëve që janë pakicë e kosniderueshme në Zvicër.

Prezantimi i disa publikimeve lidhur me termin «kultura» nga Janine Dahinen, si dhe pjesëmarrja në workshope në të cilat është diskutuar lidhur me aspektet e ndryshme të akulturimit, adaptimit psiko-social dhe suksesit të të rinjve nga familje të emigruara shqiptare më ka ndihmuar të kuptoj dilemat psiko-sociale, emocionale dhe kulturore me të cilat ballafaqohen të rinjtë gjatë të rriturit të tyre në sisteme të ndryshme referimesh dhe normash. Shembujt e prezantuar më kanë ndihmuar të reflektoj në mënyrë kritike lidhur me angazhimin e gjeneratave të reja të familjeve të emigruara shqiptare për t'u shkolluar dhe profesionalizuar, si mundësia më e mirë për integrim dhe mirënjohje shoqërore në vendin ju jetojnë.

Projekti më ka ofruar mundësinë e vizitave studimore në të gjitha vendet e përmendura më sipër për të parë nga afër sfidat me të cilat ballafaqohen emigrantët për t'u integruar në vendet që jetojnë, si dhe të qasjeve institucionale të atyre vendeve për të krijuar kushte sa më të përshtatshme për integrim. Prezantimi i publikimeve, filmave të shkurtër, fakteve, shifrave dhe shembujve të integritimeve të suksesshme gjatë të rriturit në dhe midis dy kulturave kanë qenë aspektet më interesante të këtij projekti. Informacionet e prezantuara, si dhe vizitat në institucione dhe shkolla të ndryshme kanë bërë që problematika e orientimit të individëve në dhe midis kulturave të ndryshme të kuptohet thellësisht, në mënyrë që përvojat e mira të jenë motiv jo vetëm për të përmirësuar situ-

atën në vendin ku punojmë dhe jetojmë, por edhe të evokojmë aty ku kemi mundësi për të ndërtuar një shoqëri të hapur dhe demokratike për të gjithë qytetarët e saj.

b) Njohja e koncepteve të ndryshme të demokracisë dhe formave më efikase të pjesëmarrjes aktive në ndërtimin e saj, ishin temat që u shtjelluan me shumë kujdes nga ekspertët e EDC/EHR. Në veçanti u theksua roli i shkollës si vend i mundshëm i socializimit demokratik dhe i praktikimit të demokracisë që në fillim të arsimit të gjeneratave të reja.

Njohja e parimeve të edukimit për qytetari demokratike, si dhe mënyra e përfshirjes së tyre gjatë shtjellimit të temave të caktuara mësimore kanë qenë me interes të jashtëzakonshëm për mua. Gjatë vizitave në shkolla është kuptuar se përfshirja e parimeve të EDC/EHR gjatë zbatimit të metodologjive bashkëkohore në klasa dhe aktivitete të ndryshme mundëson gjithëpërfshirjen e nxënësve, ofron shance të barabarta për të gjithë, si dhe e lehtëson integrimin e nxënësve të cilët rriten në dhe midis kulturave të ndryshme.

Në të ardhmen shpresoj që projekti të fokusohet në njohjen dhe shpërndarjen e përvojave të suksesshme të përgatitjes së mësimdhënësve para shërbimit dhe në shërbim lidhur me temat e EDC/HRE, ndër dhe multikulturalizimit, si dhe të komunikimit efektiv në dhe midis kulturave të ndryshme. Në veçanti krijimin e kushteve dhe trajnimin e mësimdhënësve për të ndihmuar integrimin e suksesshmë të komunitetit RAE dhe të nxënësve me nevoja të veçanta, problematikë kjo e theksuar në çdo raport të progresit për Kosovën nga zyra e BE-së.

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe e realizimit/zbatimit të konferencave, dhe çfarë mund (si) të përmirësohet?

Që në fillim më ka bërë përshtypje identifikimi i problematikës që ka trajtuar ky projekt dhe mënyra se si është shtjelluar gjatë konferencave të ndryshme dhe vizitave studimore.

Çdo konferencë ka shtjelluar një aspekt të problematikës së orientimit të qytetarëve midis kulturës së parë, kulturës së dytë dhe ndërkulturës, si dhe të rriturit në dhe midis kulturave të ndryshme. Në çdo konferencë, pas prezantimeve nga ekspertët, ka vazhduar diskutimi në workshope të ndryshme për të reflektuar mbi situatat që ekzistojnë në vende të ndryshme, si dhe për të shkëmbyer shembjute të praktikave të suksesshme. Më pas janë realizuar vizitat në shkolla për të vëzhguar situatën nga afër, si dhe për të biseduar me mësimdhënës dhe nxënës të vendeve të caktuara.

Pjesëmarrja në rrjetin NEZI më ka ofruar mundësinë e njohjes me ekspertë të ndryshëm në Rajon dhe më gjerë, të cilat shpresoj në të ardhmen të thellohen me forma të ndryshme të bashkëpunimit. Po ashtu, ky projekt më ka ndihmuar të thelloj njohuritë e mia në fushën e EDC/HRE, të problematikës së integritit të komuniteteve pakicë, si dhe problematikës së integritit të atyre që emigrojnë dhe riemigrojnë për të jetuar në kultura të ndryshme nga vendi i origjinës së tyre ose të prindërve të tyre.

Në të ardhmen është e parapëlqyer që konferencat të shoqërohen dhe me publikimin e prezantimeve të ekspertëve, si dhe të punimeve të ndryshme që shfrytëzohen gjatë konferencave.

Pyetja 3

Çfarë tjetër më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI dhe çfarë më ka munguar?

Gjatë këtij projekti kam njohur shumë ekspertë të fushave të ndryshme, si dhe kam forcuar bashkëpunimin me disa prej tyre. Bashkëpunimi me Prof. Rolf Gollob në këtë projekt më ka ndihmuar që ne së bashku me dy trajnerë të tjerë të organizojmë për herë të parë në Kosovë Akademinë për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut. Kjo akademi do të mbahet në Kosovë më 2–6 dhjetor 2015 dhe do të financohet nga Këshilli i Evropës, the Wergeland European Center dhe Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë.

Gjatë Konferencës kam njohur edhe ekspertë të tjerë, disa prej të cilëve kam arritur t'i angazhoj si trajnerë në udhëheqjen e seminareve të ndryshme.

Pyetja 4

Nëse projekti NEZI do të kishte një vazhdimësi: Cilat do të ishin dëshirat e mia në lidhje me drejtimin e këtij vazhdimi?

Propozoj që projekti NEZI të vazhdojë me shtjellimin e problematikës së EDC/HRE, të ndër- dhe multikulturalizimit, duke ngritur çështjen e përgatitjes së mësimdhënësve para dhe në shërbim lidhur me këto tema.

Përgatitja e udhëzuesve të ndryshëm të cilët mund të jenë pjesë e literaturës së përgatitjes së mësimdhënësve para dhe në shërbim, si dhe publikimi i materialeve të ndryshme të përgatitura me studime dhe analiza të hollësishme për temat e mësipërme, do të ishte me interes për institucionet e Arsimit të Lartë që merren me përgatitjen e mësimdhënësve, si dhe për OJQ-të që ofrojnë programe për zhvillimin profesional të

mësimdhënësve në shërbim. Mendoj se publikimet i ndihmojnë qëndrueshmërisë së këtij rrjeti dhe forcimit të bashkëpunimit të ekspertëve në të ardhmen.

Pyetja 5

Nëse projekti NEZI do ta kishte një vazhdimësi: Cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dhe çfarë mund të kontribuoj unë personalisht për këto projekte?

Me kënaqësi do të kontribuoja në realizimin e ndonjë studimi të ndërmarrë nga Projekti, i cili është në pajtim me kualifikimin dhe shkathtësitë e mia në fushën e EDC/HRE, si dhe të ndërmultikulturalizimit.

Arbër Salihu, Ministria e Arsimit të Republikës së Kosovës

Hyrje

Ngjitja e rrjetit KPDI (NEZI) me ekspertë, specialistë nga katër vende (Zvicra, Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia), që ishte dhe një nga objektivat e projektit, para së gjithash mendoj se ka qenë ide shumë e qëlluar.

Krijimi i një forumi ku mund të diskutohen dhe trajtohen çështjet e kulturës së parë, kulturës së dytë, ndërkulturës dhe edukimit për qytetari demokratike, ka sjellë një mundësi të shkëlqyer për të gjithë pjesëmarrësit. Të jetuarit në një botë ku diversiteti, ndërvarësia dhe të jetuarit së bashku me të tjerët, janë bërë pjesë e përditshmërisë demokratike, ka ndikuar që shoqëritë tona të kërkojnë forma të ndryshme të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të ideve dhe përvojave. Në këtë drejtim rrejt ka arritur të realizoj qëllimin e vet.

Pyetja 1

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin KPDI (NEZI) përsa u përket temave kryesore?

Personalisht, mua, rrieti më ka ndihmuar për të kuptuar nga afër ndëreveprimin e kulturës së parë (kulturës familjare, gjuhësore, etnike, të vendlindjes, të origjinës) me kulturën e dytë (shtetërore, shumëgjuhësore, multitetare, multikulturore të vendit tjetër mikpritës) dhe si ndërlihen e manifestohen ato. Njëherazi, kemi përjetuar dhe bashkëndierë veprimin e ndërkulturës te emigrantët, riemigrantët, te të rikthyerit në vendin e origjinës, por dhe me anëtarët e pakicave etnike, në viset ku jetojnë shqiptarët.

Rasti i emigrantëve shqiptarë në Zvicër, më ka qartësuar më së miri se çfarë do të thotë të rritësh dhe të zhvillosh identitetin në dhe midis sistemeve të ndryshme normash dhe kulture. Sa i vështirë dhe njëherazi sa domethënës është adaptimi psikosocial në mjediset multikulturore dhe multiidentitare që ndërlihen dhe reflektohen pastaj si në suksesin në mësim (shkollë) ashtu dhe në jetën e mëtejshme.

Kam mësuar dhe për sfidën me të cilën thuajse çdo emigrant në mënyrë universale ballafaqohet, adaptimi me «kulturën e re» të vendit mikpritës dhe rrezikun e «akulturimit» nga kultura e parë, e origjinës. Kam mësuar për brengosjen e gjeneratës së parë të emigrantëve «për asimilim» dhe për sfidat e «Sekonda-ve» (brezit të dytë) për integrim.

Gjithashtu, rrjeti KPDI (NEZI) më ka dhënë mundësi të thelloj njohuritë praktike për edukimin për qytetari demokratike. Duke qenë për shumë vite përfaqësues, koordinator

i Republikës së Kosovës në rrjetin e koordinatorëve të Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe të Drejta të Njeriut, kam pasur rast të dëgjoj, të mësoj, por dhe të jap ndihmesën time në hartimin e politikave evropiane në këtë lëm. Por, përmes projektit KPDI (NEZI) kemi parë se si ato praktikohen, jetësohen drejtpërdrejt në shkolla, në shoqëri. Kemi parë edhe vështirësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohen shkollat, mësimdhënësit, drejtorët, nxënësit për të ndërtuar një shoqëri më të mirë, më të hapur, më tolerante, më demokratike.

Shkëmbimi i përvojave, e sidomos mundësia që nga kolegët, ekspertë, të shohim modele të suksesit në zbatimin e të mësuarit dhe të jetuarit të demokracisë në jetën e përditshme, në shkollë, por dhe jashtë saj, ka qenë një vlerë e veçantë e projektit.

Mendoj se aspektet që mund dhe duhet thelluar janë anët praktike që ka sjellë projekti. Prezantimi i modeleve të sukseshme, është mënyra më e mirë për të kuptuar dhe rritur besimin në vlerat e demokracisë, të tolerancës, diversitetit, si pasuri personale dhe shoqërore, por dhe si mënyrë e të menduarit dhe të jetuarit.

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin KPDI (NEZI) nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe e realizimit/zbatimit të konferencave, dhe çfarë mund (si) të përmirësohet?

Nga ana e metodologjisë së planifikimit dhe realizimit/zbatimit të Projektit, bashkëpunimi në rrjetin KPDI (NEZI) ka qenë edhe një përvojë e re, e rëndësishme për mua. Përcaktimi i qartë i platformës që përmes konferencave të shkëmbehen njohuritë shkencore, të zhvillohet dialogu në mes të anëtarëve të rrjetit, por, dhe të takohen dhe vizitohen drejtpërdrejt persona dhe institucione të veçanta, që janë të përfshirë në tematikën e rrjetit, ka qenë me vend në aspektin metodologjik. Si pjesë të suksesshme të metodologjisë e konsiderojmë po ashtu edhe planifikimin e hollësishëm të secilit aktivitet, paraprakisht, shumë më herët se sa të realizohen konferencat . Përcaktimi i qartë i bartësve të secilit veprim dhe respektimi në përpikëri i agjendës kohore, si veçori tipike zvicerane, është model që duhet kultivuar në të gjitha vendet tona.

Sugjerimi im ndoshta do të ishte vetëm për hapësirën kohore të dedikuar për konferencë. Për mendimin tim boshti i funksionimit të rrjetit ka qenë kontakti i drejtpërdrejtë i anëtarëve të tij. Takimet në mes të pjesëmarrësve, njohja me njëri-tjetrin, shkëmbimet e drejtpërdrejtë të ideve dhe përvojave nuk mund të zëvendësohen nga ndërveprimet virtuale. Temat e konferencave, që kanë pasur të bëjnë me kulturën, me ndërkulturën, kërkojnë familjarizim, përjetim, zhvillim të ndjesive, e kjo kërkon kontaktim të drejtpërdrejtë, kërkon kohë për të qenë të efektshme. Dy ditë kohë, sa kanë qenë të parapara për një,

mendoj se nuk janë të mjaftueshme për të parë dhe për të përjetuar më në thellësi secilin nga qytetet, vendet ku janë organizuar konferencat qoftë si raste të diversiteti, të traditës por dhe si socikultura.

Pyetja 3

Çfarë tjetër më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI dhe çfarë me ka munguar?

Veç të tjerash bashkëpunimi me rrjetin na ka sjellë mundësinë që të vështrojmë e të krahasojmë edhe diversitetin brenda shoqërisë shqiptare. Duke jetuar në disa shtete Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, por dhe në vendet të tjera mikpritëse si Zvicra etj., shoqëria shqiptare ka krijuar një profil të shumëfishtë kulturor edhe përbrenda vetë saj. Ndërsa në Kosovë ballafaqimi me lirinë, me të kaluarën e afërt, por dhe me sfidat e shtetndërtimit janë preokupimet kryesore, në Shqipëri konsolidimi i demokracisë është synim parësor, ndërsa në Maqedoni aspiratat për barazi kombëtare dhe për zhvillim të demokracisë, mbasin shqetësime kryesore. Kjo reflektohet gjithsesi dhe në fushën e arsimit, në shkollë, në preokupimet e jetës së përditshme por dhe në strukturën kulturore. Dimensi- oni apo profili tjetër janë shqiptarët e diasporës që përveç «dallimeve» që ata bartin me vete nga vendi i origjinës, krijojnë dhe një «dallim» tjetër me përvetësimin e kulturës së dytë, të vendit mikpritës. E tërë kjo larmi ka kompleksitetin e vet që reflektohet dhe në marrëdhënit ndërshqiptare.

Ajo që mua personalisht më ka munguar e që do të kisha pasur dëshirë ta trajtonim në këtë Projekt, ka qenë puna më e fokusuar hulumtuese në çështje apo tema të caktuara. Krahas diskutimeve dhe vizitave e takimeve të frytshme, përqendrimi në çështje të caktuara duke realizuar ndonjë minihulumtim, për mendimin tim, do t'i kishtë dhënë vlerë të shtuar projektit.

Pyetja 4

Nëse projekti NEZI do të kishte një vazhdimësi: Cilat do të ishin dëshirat e mia në lidhje me drejtimin e këtij vazhdimi?

Po qe se Projekti NEZI do të kishte vazhdimësi, unë do të kisha pasur shumë dëshirë që projekti të përqendrohet në disa nga aspektet që janë trajtuar deri më tani. Si shembull do të kishte mundur të ishte ndikimi ndërkulturor tek përfaqësuesit e diasporës shqiptare në Zvicër dhe si reflektohen ato në familjet shqiptare qoftë në Zvicër qoftë në Kosovë dhe vendet tjera ku jetojnë shqiptarët. Aspekt tjetër do të kishte mundur të ishte

analizimi dhe vlerësimi i rasteve të veçanta të «rrëfimeve/historive të suksesit» të përfaqësuesve të diasporës shqiptare. Raste këto që do të kishin shërbyer qoftë për krijimin e modeleve për integrimin në shoqërinë mikpritëse, qoftë në krijimin e urave të komunikimeve ndërkulturore në mes popujve dhe vendeve tona.

Pyetja 5

Nëse projekti KPDI (NEZI) do ta kishte një vazhdimësi: Cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dhe çfarë mund të kontribuoj unë personalisht për këto projekte?

Për mendimin tim Projekti do të mund të funksiononte në formatin përafërsisht të njëjtë sikurse deri më tani. Projekti do të ishte dashur të bazohet në ruajtjen e vazhdimësisë së rrjetit dhe në funksionimin e bashkëveprimit, me detyra konkrete. Hulumtimi do të mund të jetë një nga detyrat dhe metodologjitë që do të përdreshin në të ardhmen. E kjo do të mund të realizohej duke caktuar tema të posaçme për grupe të vogla, me përbërje të përzier nga anëtarët e vendeve përkatëse. Me këtë, do të ishte fuqizuar bashkëpunimi dhe do të ishte thelluar njohuria për problemet dhe sfidat e veçanta. Për këto çështje pastaj do të mund të bëheshin hulumtime dhe të dilej me sugjerime konkrete. Këto grupe do të mund të trajtojnë tema për disa dimensionë si për fushën e arsimit, për aspektet sociokulturore, për ndërkulturën, për qytetarinë demokratike, për integrimin etj.

Ndihmesa ime do të kishte mundur të ndërlihet me fusha të caktuara, duke siguruar (gjetur) materiale të nevojshme, duke përcjellë përvojën personale, duke bashkëvepruar me të tjerët. E tërë kjo pastaj do të mund të bartej në punën tonë të përditshme qoftë duke ndihmuar në orientimin e politikave, qoftë duke praktikuar mësimet e fituara në mjediset arsimore, ku veprojmë ne.

Grupi i Maqedonisë (Pjesëmarrësit/et nga Maqedonia)

Jonuz Abdullai,
Universiteti i Evropës Juglindore Tetovë, Shkup,
Universiteti i Prishtinës

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndhimë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Inkuadrimi dhe bashkëpunimi në rrjetin NEZI mua personalisht më ka sjellë dobi të shumëfishtë. Së pari fuqizova zgjerimin e rrjetit të personaliteteve profesionale të angazhuara në Projekt si dhe njohja me institucionet të cilat i mbështesin proceset edukativo-arsimore si dhe përpjektet tona për hulumtime shkencore dhe zgjerimin e njohurive dhe përvojave të mira nga kolegët në Rajon, në veçanti ato zvicerane. Së dyti, njohja dhe sqarimi i dukurive të kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës në aspektin shkencor si dhe praktik dhe problemet me të cilat ballafaqohen fëmijët ose gjenerata e dytë e të rinjë jo zviceranë, në veçanti ata shqiptarë që janë ballafaquar me integrimin e tyre në shoqërinë zvicerane.

Për nga aspekti i edukimit për qytetari demokratike, duhen theksuar njohuritë e përfituara gjatë vizitave të mia në Cyrih, si dhe ato në Prishtinë dhe Shkup, ku pata rastin të vizitoj shumë institucione të arsimit fillor dhe të lartë ku për së afërmi u njoha me kushtet e punës të mësimdhënësve dhe të ekipeve menaxheriale, si dhe me participimin e tyre në vendimmarrje gjatë procesit të punës. Gjithashtu kisha mundësi për së afërmi të dëgjoja prezantime nga njohës profesionistë të lëmeve të caktuara që kanë të bëjnë me respektimin e rregullave të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Mënyra e trajtimit të nxënësve dhe kujdesi i shtuar me anë të mësimit plotësues për nxënësit që i takojnë kulturës së dytë, ishte interesimi im i veçantë, sepse në një farë mënyre tregon përkushtimin institucional për integrimin më të lehtë të kësaj grupmoshe në shoqërinë zvicerane.

Aspektet që duhet thelluar janë puna me nxënësit shqiptarë me mësim plotësues, vëzhgimi i integritit të këtyre në paralelet e përziera, puna me mësimdhënësit dhe prindërit si dhe organizimi dhe realizimi i takimeve me përfaqësues të institucioneve mbështetëse të arsimit në Zvicër. Gjithashtu i duhet kushtuar rëndësi të veçantë hulumtimit të zhvillimit dhe mangësive në sistemin e arsimit në vendin e prejardhjes së këtij grupi shoqëror.

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe e realizimit/zbatimit të konferencave, dhe çfarë mund (si) të përmirësohet?

Përsa i përket pikëpamjes së metodologjisë së planifikimit dhe e realizimit/zbatimit të konferencave mund të them hapur se bëhet fjalë për një planifikim të detajuar në kohë dhe në vend të duhur, ku çdo gjë funksiononte si ora zvicerane. Duhet veçuar organizimi i grupit të ekspertëve dhe atyre përcjellës të cilët ishin në nivel të detyrës. E gjithë kjo ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në suksesin e konferencave të deritashme, e në veçanti të Projektit të kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës.

Për më tepër, raportimi, evaluimi nga konferencat e mëparshme si dhe plotësimi ose përmirësimi i mangësive që paraqiteshin në të kaluarën, bënë që puna jonë të jetë më cilësore dhe më efektive për nga aspekti i menaxhimit të kohës dhe burimeve që i kishim në dispozicion.

Problem të vogël përbën axhenda e ngarkuar e Konferencës, prandaj jam i mendimit që në të ardhmen të organizohen workshope që do t'i paraprijnë konferencave, me këtë rast do të fitojmë në kohë dhe në cilësi të debatit si dhe të rezultateve nga impakti i organizimit të tillë.

Shkëmbimi i materialit përgatitor duhet të bëhet më herët dhe të jepet mundësia e mendimit ose feedback-ut nga ana e çdo pjesëmarrësi dhe përzgjedhja e materialeve më të mira të bëhet nga një këshill redaktues i Konferencës dhe të njëjtat të publikohen.

Pyetja 3

Çfarë tjetër më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI dhe çfarë me ka munguar?

Bashkëpunimi im me institucionet e mësimi fillor dhe Institucioni i Lartë Pedagogjik i Cyrihut janë një përvojë e re për mua, sepse në të kaluarën time profesionale nuk kam pasur mundësi të bashkëpunoj me institucione të tilla arsimore. Për më tepër duhet veçuar njohja me ekspertët dhe kolegët nga Rajoni dhe Zvicra, gjë e cila zgjeron njohuritë por edhe interesimin për vazhdimin e hulumtimit në këtë lëm.

Për nga aspekti i metodologjisë së punës, kisha mundësi të njihem për së afërmi me mënyrën zvicerane të punës e cila dallon ndieshëm nga ajo ballkanike, në veçanti në aspektin e menaxhimit të kohës dhe ai organizativ. Gjithashtu praktikën e mirë që kisha mundësi ta shoh gjatë punës në klasë në Shkup me nxënësit shqiptarë nga eksperti zviceran, për mua la mbresa të jashtëzakonshme dhe ishte e mirëpritur edhe nga punonjësit e arsimit të shkollës fillore që e kishim si pilot.

Përsa u përket mungesave që na janë paraqitur, personalisht kisha kapur kohën, e cila na ka munguar për përgatitje sa më cilësore në kuadër të këtij Projekti si dhe mungesa e asistentëve të rinj të cilët do të na jepnin një përkrahje teknike dhe profesionale. Gjithashtu ndihej edhe mungesa e hulumtimit të mjaftueshëm paraprak të çështjeve që i preokupojnë të rinjtë dhe prindërit e tyre, të cilët kanë probleme me integrimin në shoqërinë zvicerane. Mendoj se këto të dhëna do të mundësonin tejkalimin e disa vështërsive si dhe integritet të tërësishëm në shoqërinë zvicerane, duke e mbajtur njëkohësisht edhe lidhjen me vendlindjen e tyre.

Në fund duhet veçuar se mosnjohja e gjuhës gjermane përbënte një ndër mungesat e mia më të mëdha në kuadër të këtij Projekti, por përkthimi në gjuhën shqipe nga organizatorët më mundësoi të jem i integruar tërësisht në realizimin e këtij Projekti.

Pyetja 4

Nëse projekti NEZI do të kishte një vazhdimësi: Cilat do të ishin dëshirat e mia në lidhje me drejtimin e këtij vazhdimi?

Projektet e tilla janë gjithnjë të mirëseardhura dhe të nevojshme, veçanërisht në mjediset ku gërshetohen kultura e parë dhe e dytë dhe ndërkultura. Duhet theksuar këtu edhe nevoja e projekteve të tilla për shtetet në tranzicion siç janë shtetet e Ballkanit Perëndimor, të cilët ballafaqohen me krizë ekonomike dhe politike, ku është i theksuar emigrimi i popullatës në vendet e Evropës Perëndimore. Prandaj mendoj se zgjerimi i rrjetit NEZI duhet të përfshijë edhe sektorin e OJQ-ve, përkrahësit administrativ nga universitetet dhe pushteti vendor si dhe studiues të dalluar në lëmin e multikulturalizmit.

Gjithashtu në kuadër të Projektit të kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës, duhet të shihet edhe mundësia e organizimit të shkëmbimit të nxënësve dhe mësimeve të përzier (të etniteteve dhe kulturave të ndryshme) duke vizituar institucionet arsimore, si dhe pranimit të tyre në familjet e vendit pritës.

Jam i mendimit se është mirë të bëhet organizimi i kampeve verore ku fëmijët shqiptarë që jetojnë në Zvicër do të kishin mundësinë që së bashku me mësimeve të tyre të njihen me kulturën dhe zakonet e të parëve të tyre duke vizituar monumentet më të rëndësishme historike dhe kulturore në vend.

Pyetja 5

Nëse projekti NEZI do ta kishte një vazhdimësi: Cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dhe çfarë mund të kontribuoj unë personalisht për këto projekte?

Propozimi im konkret është të bëhet një hulumtim në të katër vendet e inkuadruara në Projekt (Maqedoni, Shqipëri, Kosovë dhe Zvicër) dhe të shihet se cili është impakti i projekteve të deritanishme dhe cilat janë nevojat për zgjerimin e rrjetit dhe të hulumtimit të këtyre dukurive.

Për më tepër duhet shikuar cilat shkathtësi u nevojiten pjesëtarëve të kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës për integrim e tyre sa më të sukseshëm në shoqërinë zvicerane si dhe tejkalimi i problemeve socio-devijante tek të rinjtë shqiptar përmes trajnimeve dhe ligjëratave të ndryshme. Kjo me siguri se do të kishte impakt në shoqërinë zvicerane në largimin e stereotipeve për këtë grup shoqëror i cili nëpër mediate shpesh cilësohet si problematik dhe i vështirë për t'u integruar. Gjithashtu nëpërmjet këtyre ligjëratave dhe prezantimeve do të promovoheshin vlerat dhe praktikat e mira që i zotërojnë shqiptarët në Zvicër gjatë angazhimit të tyre në punë dhe në jetën e përditshme.

Nga ana tjetër, mendoj se një aspekt i rëndësishëm i integritit të gjeneratës së dytë, është puna me prindërit e tyre, në veçanti me atë grup prindërisht të cilët kanë arsim të ulët dhe të cilët nuk janë të angazhuar në punë. Kycja e tyre nëpër organizata joqeveritare si dhe lidhja e tyre me organizatat nga vendi i të parëve të tyre, është i domosdoshëm.

Trajnimi i vullnetarëve për organizimin e aktiviteteve me komunitetin rinor, organizimin e manifestimeve të përbashkëta kulturore dhe sportive, formimi i klubeve rinore janë një aset i dobishëm ku si model duhet të merren sportistët e suksesshëm shqiptar në klubet zvicerane.

Ndihmesën time në këtë Projekt në të ardhmen do ta kisha ndarë në disa aspekte. Fillimisht do ta kisha prekur përvojën time profesionale në mësimdhënie dhe njohjen institucionale e cila do të jetë një aset për të kontribuar në përpilimin dhe mbarëvajtjen e Projektit. Për më tepër përvoja ime në hartimin e programeve studimore dhe në akreditimin e tyre institucional besoj se do ta lehtësojë punën e ekipit profesional si dhe do të sigurojë mbështetje nga ekspertë dhe administratorë vendorë në lëmet e nevojshme me të vetmin qëllim, që projekti të fitojë në cilësi dhe të ketë sukses në realizimin e tij.

Gjithashtu angazhimi im do të jetë i fokusuar edhe në gjetjen e përkrahjes institucionale për sigurimin e mjeteve financiare dhe burimeve të nevojshme për realizimin e aktiviteteve përcjellëse të ndryshme që do të lindin si nevojë e përgatitjes dhe realizimit të projekteve në të ardhmen.

**Adelina Marku,
Drejtoreshë në Akademinë Diplomatike në Ministrinë e Punëve të
Jashtme të Republikës së Maqedonisë**

a) Hyrje

Shtetet në tranzicion, pra ato që kanë jetuar sistemin monist e që transformohen në sistemin pluralist, të mirënjohur si shoqëri e hapur e sistem demokratik, përballen me shqetësimet e sistemeve nga e panjohura e sistemit që nevojitet të rirenditet ose riven-doset.

Këto kode të panjohura janë të lidhura kryesisht me botëkuptimet e reja të individit / qytetarit mbi:

1. Vlerat e standartet e reja ligjore, pra sistemin e reformuar të gjyqësorit (mbi të gjitha këtu, mbi konceptin e të Drejtave të Njeriut sipas Konventave Ndërkombëtare dhe mbrojtja e lirisë së të shprehurit).
2. Parimet e edukimit të gjeneratave të reja në një shoqëri të hapur, pra sistemin edukativo-arsimor.
3. Ndërgjegjien progresive të institucioneve shtetërore, pra transparencën e tyre.

Në kontekstin e të jetuarit në një sistem monist, ndërgjegjia civile është kryesisht e uzurpuar nga e ashtuquajtura ideologji moniste, madje e diktuar sistematikisht nga aparatura udhëheqëse shtetërore, e cila gjatë gjithë jetesës së vet ka vepruar në kundërshtim me vlerat e shoqërisë së hapur duke i refuzuar ato me kokëfortësi.

Si rezultat i këtij modeli të të jetuarit, koncepti i qytetarisë paraqitet si fenomen i vonuar në shoqëritë e sotme në transformim. Ky dimension vonese, mbetet ende i patrajtuar besnikërisht dhe objektivisht nga aktorët e kontekstit të ri shoqëror, prandaj ky kapërcim ka krijuar boshllëk intrakulturor në shoqëri.

Këto shkallëzime, të përcjella në këtë punim me dozë skematizmi e me përsiatje sipërfaqësore, kanë kontribuar që në Maqedoni dhe në të tri nivelet/kodet e lartëpërmendura, të veprohet e të «krijohet» përmes së ashtuquajturës ndërgjegjje falso institucionale dhe si pasojë shoqërore.

Sipas vrojtimeve të mia, fenomeni i ndërgjegjies institucionale falso buron nga inhibimet strukturore që kanë ndërvepruar në sistemin e vjetër e që trashëgoohen nga sistemi i ri e që për pasojë kanë: mosnjohjen e kulturës së tjetrit. Kjo gjendje e gjatë dhe aktuale krijon mosaftësimin e institucioneve që të veprohet ndryshe nga kjo formë subkulturale e të vepruarit e që si pasojë spikat paragjykimet kuturore këtu. Prandaj, ky fenomen rrigjid në shoqërinë e Maqedonisë, u vihet në kundërshtim thelbësor parimeve e mësimëve të edukimit për demokraci.

Rivendosja e vlerave dhe e parimeve të reja të edukimit për demokraci, është një doemosdoshmëri institucionale për të funksionalizuar sistemin edukativo-arsimor këtu.

Ndërgjegjia falso institucionale në ndërtimin e ri shoqëror në Maqedoni le shumë për t'u dëshiruar dhe përveç të tjerash hap debatin ose dilemën e madhe se sa i shëndoshë në të vërtetë është sistemi edukativo-arsimor në ditët e sotme, por edhe sa progresivitet mbjell në ideologjinë e vet vepruese për të avansuar demokracinë.

b) Mësime të mësuara dhe ide për si mëtej

Bashkëpunimi në rrjetin NEZI hap një perspektivë të re në synimin drejt një qëllimi të mirë i cili do ta mbindërtonte hap pas hapi mënyrën e deritanishme të edukimit demokratik dhe të komunikimit ndërkulturor të gjeneratave të reja në Maqedoni, ndërshtqiptare dhe midis tyre e të tjerëve. Një konstatim të këtillë e shoh si të duhur e madje të përdorshëm, sepse për shoqërinë në Maqedoni, modeli i orientimit (institucional zviceran) midis kulturës së parë, të dytë dhe të ndërkulturës si dhe modeli i edukimit demokratik, mund të tregohet si mjaft i dobishëm dhe madje i lehtë për implementim në strukturën e sistemit edukativo-arsimor të Maqedonisë.

Ndryshimi i mentalitetit dhe se ndërtimi i psikologjisë masive në këtë drejtim, është i bëshëm në rast se modelet e sprovuara derimëtani nuk ndryshohen sipas rrethanave me tendenca të etno- politizuara e si pasojë e veprimeve add –hoc, por përkundrazi, nëse ato përvetësohen, praktikohen, implementohen në një sistem të qëndrueshëm e gjithëpërfshirës arsimor edukativ. Një qëndrueshmëri e këtij lloji, do të nxiste gjenerimin e prurjeve mjaft progresiste për shoqërinë multietnike të Maqedonisë, e si rezultat do të fuqizonin shtyllën e bashkëjetesës .

Në rast se një përshtatje e këtillë do të shtresohet mirë, atëherë edhe komunikimi mes emigrantëve dhe rimigrantëve do të mund të zhvillohet më intensivisht dhe madje me rezultate praktike, sidomos në lëminë e ekonomisë dhe të investimeve.

Konferencat e organizuara derimëtani nga ana e rrjetit NEZI, na shërbyen për të përafuar modelin zviceran të këtij dimension/modeli të edukimit demokratik që përcjell vlera të shtuara progresit shoqëror në përgjithësi. Jam e mendimit, se ky varg konferencash nevojitet të mos shpëputet, por të vazhdojë duke shtuar nivelin e studimit dhe kërkimit shkencor, por edhe të shkëmbimit të përvojave mes shteteve në Rajon (Ballkan) dhe Zvicrës, përse jo përmes Ministrive të Arsimit dhe Shkencës si dhe institucioneve të tjera kërkimoro-shkencore.

Një ndër risitë e mëdha nga bashkëpunimi me rrjetin NEZI është njohja me jetën e diasporës shqiptare në Zvicër. Për mua ky ishte edhe dimension i dytë më i rëndësishëm i këtij bashkëpunimi menjëherë pas informacionit që fitova për format e edukimit qytetar në shoqërinë zvicerane. Mësova shumë mbi organizimin e jetës së diasporës shqiptare, gjë që nuk e kisha ditur më parë, mësova për format dhe rrugën e integritetit të kësaj diaspore në shoqërinë zvicerane, mësova për mënyrat e mbrojtjes dhe kujdesit të identi-

tetit kulturor të shqiptarëve në Zvicër, mësova për format e integritit dhe përfaqësimit të shqiptarëve në politikat shoqërore të Zvicrës, mësova për integritin e gruas shqiptare në shoqërinë zvicerane, për mënyrën e zhvillimit të familjes tradicionale shqiptare atje por edhe për transformimet që kjo familje përjeton përmes zhvillimeve të reja të teknologjisë së të jetuarit dhe menduarit, mësova më shumë për konceptin e integritit vizavi asimilimit etj. Të gjitha këto i vlerësoj si mësim me rëndësi të jashtëzakonshme jetësore dhe profesionale dhe sfidoj veten që edhe më shumë të preokupohem me këto forma organizmi të diasporës shqiptare dhe komunikimin e së njëjtës me shtetet amë.

Për vazhdimësisë e projektit NEZI do të propozoja nevojën për përpilimin e një kurrikule mësimore ose madje edhe programi studimor në nivel universitar mbi diasporën shqiptare, duke marrë për bazë analize dhe studimi jetën e diasporës shqiptare në Zvicër dhe zhvillimin progresiv të këtij komuniteti kulturor e ekonomik atje.

Ndihmesën time e shoh si të vazhdueshme prandaj edhe propozoj që konferencat e derimëtanishme të na shërbejnë jo vetëm për rrjetizmin por edhe për kalimin në një nivel më të zhvilluar e praktik, pra përpilimin e një programi të akredituar studimo, studime të diasporës shqiptare.

Ali Pajaziti, Universiteti i Evropës Juglindore Tetovë dhe Shkup

Kultura, dykulturësia dhe identitetet postmoderne

Përkufizimin më klasik të kulturës e ka bërë E.B. Taylor-i, i cili thotë se kultura është një tërësi komplekse që përfshin njohuritë, artin, moralin, doket e zakonet, si dhe të gjitha aftësitë të cilat i fiton njeriu si pjesë e shoqërisë. C. Wisler thotë se kultura paraqet mënyrën e jetesës së një populli. Claude Lèvi Strauss, njëri prej mbrojtësve kryesorë të strukturalizmit francez, e përkufizon kulturën si një tërësi të formuar nga strukturat mendore të ndikuara si nga historia ashtu edhe nga mjedisi psikologjik e social i grupit. Antropologjia me termin kulturë nënkupton mënyrën e përgjithshme të jetesës së një populli, trashëgiminë shoqërore që individi e mëson nga grupi i vet. Për antropologët të jesh njerëzor do të thotë të jesh i kulturuar.

Të jetosh në një vend në të cilin nuk ke lindur ka qenë problemi i emigrantëve të dikhurshëm në vendet e Evropës Perëndimore. Brezi i parë shqiptarëve të viteve '60 të shekullit të kaluar (XX) që për shkaqe të ndryshme morën rrugën e arratisjes nga «liria», të kërkimit të litarit të mbijetesës për shkak të desidencës apo ishkomunikimit, të jetesës më të mirë. Brezi i dytë dhe në veçanti i tretë i shqiptarit që jeton në vendet evropiane ka dilema të shumta, por ama një gjë e ka të qartë, ai është qytetar si gjithë të tjerët i vendit

pranues. Megjithatë, probleme ka, me prindërit që janë më konservatorë, që duan vatanin, që duan ta kultivojnë gjuhën amtare, që preferojnë ushqime tradicionale shqiptare dhe preferencave të tyre rinore vendore që janë shumë të ndryshme nga ato të «mëmë-dheut» të prindërve. Kultura është termi kyç që diskutohet kur flitet për emigrantët apo Gastarbeiter e dikurshëm që sot kanë mbetur mes dy kulturave, mes dy shteteve, mes dy nënshtetësive.

Rrjeti NEZI që ka të bëjë me përkrahjen në orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe të ndërkulturës dhe me edukimin për qytetari demokratike, përbën një platformë shumë të rëndësishme për të kuptuar sociologjikisht dhe antropologjikisht rrugën e zhvillimit të trendeve kulturore të emigrantëve. Në këtë drejtim në fokus është vënë diaspora shqiptare, Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Zvicra.

Në këtë projekt jam përfshirë nga takimi i Shkupit, kur bëra elaborimin in vivo në sheshin e Shkupit, gjegjësisht kur shpalosa qëndrimet e mia lidhur me projektin antiurban dhe kundërkulturor «Shkupi 2014», i nisur në vitin 2006, një vit pas decentralizimit administrativ, kur partia e posazgjedhur populiste dhe konservatore VMRO DPMNE filloi t'i ngjallë frustracionet pas konfliktit në lidhje me identitetin dhe presionin e evropianizimit, deri në atë masë që kjo qasje mori forma vizuale urbane. Shkupi përmes këtij delirium tremens dalëngadalë po shndërrohet në qytetin më të shëmtuar të Evropës, shembëlltyrë e fundit dhe e pashijës. Shkupi është shndërruar në Luna Park të përmendoreve, në një histori në miniaturë, në një legoland, në një neverland, pak antikë, pak Romë, pak Paris, pak Vjenë. «Expo 2014» është shndërruar në metaforë të diznifikimit, në hapësirë totale dhe historicizëm, në sintaksë postmoderne, në buffer zonë, në hapësirë të krimit të identitetit të ri.

Pas shpjegimeve të bëra, në stilin peripatetik, ec e diskuto, polemizo, u zhvillua një debat shumë i frytshëm lidhur me realitetin e dy Shkupeve, të atij në anën e djathtë të Vardarit (maqedonas), ultraurban dhe të tjetrit, në anën e majtë (shqiptar), shkatërinë, slum. Pjesëmarrësit nga vendet e ndryshme vërenin pamjet e artit neobarok XXI, ndërkohë që mendonin rreth përplasjeve kulturore për të cilat flet Huntingtoni me të tjerë. Berlinizim, qytet i ndarë. Urë në mes, urë klasike, e gurit, e bastarduar me shkresë cirilike mbi një monument osman. Biseda lidhur me një kulturë qytetare e jokombëtare vazhdoi në darkën e organizuar në restorant, ku ishim më të relaksuar.

Përsa i përket takimit në Cyrih, qe një Konferencë me peshë në të cilën të rëndësishme ishin edhe komunikimet që patëm në seancat e ndryshme, perspektiva e kulturës së parë dhe të ndërkulturës, ajo ndërkulturore e kulturës së dytë, perspektiva «e jashtme» nga vendi i prejardhjes/originës etj.

Një temë që u diskutua ishte edhe ajo për mësimin plotësues në gjuhën shqipe që organizohet me vetëndihmesën e prindërve. Shumëmbresëlënës ishte takimi me fëmijët e emigrantëve shqiptarë nga Valliseleni, të cilët reflektonin kulturën e parë, të dytë dhe ndërkulturën. Të cilët komunikonin me mësuesen e vet në gjuhën shqipe por me theks të veçantë, të një shqipeje me nuanca të gjermanishtes dhe që shpesh mbeteshin në boshllëk për shkak të mungesës së fjalëve nga gjuha shqipe. Interesante ishin edhe

këngët që ata i kënduan para nesh, rrëfimet e tyre personale për «atdheun» dhe Zvicrën, për përkatësinë, identitetin etj. Vërtet ishte një vëzhgim me pjesëmarrje të jashtëzakonshme, një laborator i vërtetë i dykulturësisë, i matjes së ndjesisë së këtyre krijesave të njoma që jetojnë me një diadë kulturore, shqiptare dhe zvicerane, albanofonë dhe gjermanofonë. Sa interesante ishin fjalët e Agnesës së vogël, e lindur në Zvicër, shprehur në takimin e 7 majit: «Këtu ku jemi jashtë», apo e një nxënësi tjetër që ka nuanca kontradiktore me këto fjalë: «E mësojmë shqipen sepse është gjuha e nanës, kurse në shpi flasim gjermanisht!» Këto janë identitetet polimorfëshe, postmoderne, përkundër atyre klasike, njëtrajtëshe, njëvijëshe. Bota e globalizimit ka prodhuar më tepër qarkullim, më tepër kontakte kulturore dhe më tepër mpleksje dhe ngjizje të reja kulturore.

Nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe e realizimit/zbatimit të konferencave kam përfituar shumë, në veçanti përsa i përket ndërlidhjes së dijes teorike me atë praktike. Dalja në terren ka qenë jashtëzakonisht frytdhënëse për mua, në veçanti kontaktet me fëmijët dhe figura të rëndësishme të diasporës që janë veprimtarë të kauzës në një vend ku kulturat e «Sekondove» janë ishuj që mundohen të përballojnë furtunën e ujërave të oqeanit të kulturës vendëse. Si mungesë e vetme më duket mbyllja e vonuar në këtë platformë, në NEZI. Nëse do të kishte vazhduar ky Projekt do të kisha sugjeruar realizimin e një studimi shkencor, me pyetësor dhe intervista që do të ofronin të dhëna sasiore, ekzakte për gjendjen në terren.

Afrim Rexhepi, Universiteti i Shkupit

Hyrje; paradigma teorike

Njeriu është krijuar në bazë të dallimit (Difference), nuk është qenie e plotë, nuk është qenie perfekte. Në diskursin teorik, Platoni e ka parashikuar një gjë tillë, duke e eksploruar nocioni «dallim» ose «ndarje». Midis qenies dhe të qenurit, midis esencës dhe ekzistencës, ka një dallim vendi (locus). Le ta kujtojmë vendin e zanafillës, sugjeron Platoni, «Vendi i zanafillës është aty ku ndodhet Qenia. Po ne nuk ndodhemi aty. Ne ndodhemi diku tjetër. Kjo diku tjetër, është mosqenia që na nxit për informacion». Platoni, i pari në diskursin teorik, e shtroi problemin e komunikimit që realizohet përmes kundërvënies. Pra, objekt i mendimit, është diferenca si e tillë, është identiteti, dallimi. Martin Hajdegeri përmes logjikës sistematike «Shkatërrimi ontologjik i strukturës», përkufizoi Qenien si dallim, që përmes kundërvënies, realizohet në ekzistencë si Da- sein (Të qenët). «Qenia njerëzore, është ç'farëdo që don ajo. Qenia është lëshuar në botë (ekzistencë), për tu qenëzuar» (Michael Inwood, Martin Heidegger – A very short introduction, Oxford University Press, London, 1997).

Kategoria dallim (Difference), ishte ajo që ne evoluimin e vet, solli kategorinë e Zhak Deridasë «dallim që lidh – Difference». Në Universitetin Princeton është thënë: «... mendja e njeriut nuk është monologjike, por dialogjike». (Stephen Priest, «Theories of the Mind», London, 1991) Në kontekst, nëse në diskurset teorike të kulturës, merret për paradigmë teorike kategoria dallim, atëherë imponohet përkufizimi i Zhak Deridasë «Nuk ka kulturë, e as identitet kulturor, pa dallimin në vete» apo «Secila kulturë, në esencë, është interkulturë». Kategoria dallim e lidh (Differance), e bën të mundshme bashkekzistencën e kulturave të ndryshme, sepse i vë ato në komunikim aktiv. Dhe ja Poenta: Të zbulosh Tjetrin përmes komunikimit aktiv, do të thotë, të zbulosh dallimet dhe ngjashmëritë. Koegzistimi i kulturave të ndryshme, është proces që mësohet, duke lëvizur nga multikulturalizmi, kah interkulturalizmi aktiv. Dhe ja vlera e Projektit «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura», që vë në sprovë interkulturalizmin aktiv, është një sfidë e re në studimet kulturologjike sot.

Pyetja1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndhimë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Projekti NEZI më mundësoi të lexoj librin e Rolfit «Të jetosh në demokraci, për arsyen e Pragmatizmit, një logjikë tejte sfiduese në filozofinë moderne». Libri i Rolfit sugjeron një lloj demokracie progresive, një demokraci pragmatike, e cila funksionalizohet përmes një thënijeje të Xhon Djujt: «Më mirë një gram përvojë, se sa shumë teori». Për pragmatistët, e vërteta është ideja e cila mund të shfrytëzohet. Nëse idetë përputhen me pragmen, praktikën, ato më mirë realizohen. Koncepti për demokraci krijuese, është në thelb të librit të Rolfit, e që realizohet përmes edukimit dhe arsimimit praktik. Kjo realizohet, nëse shkolla përkufizohet si njëra nga format pragmatike të jetës në shoqëri. Për t'u realizuar një koncept i tillë, është i nevojshëm edukimi për qytetari demokratike, veçanërisht, edukimi demokratik i mësimitdhënësve dhe nxënësve, apo hartimi i kurrikulave ndërkulturore, që duke i zhdukur paragjykimet ndaj Tjetrit, përgatit gjeneratat e reja për jetë të përbashkët në shoqëritë demokratike. Në kuadër të projektit NEZI, në një shkollë fillore në Shkup, në lëndën e Gjuhës dhe letërsisë shqipe, ku ligjërohej poezia «Shpella e Dragobisë», mësimitdhënësi zotëronte kompetenca pedagogjike, profesionale dhe komunikative, por nuk zotëronte kompetencë ndërkulturore. Nuk duhet harruar që letërsia është njëra nga disiplinat më të prirura, e cila përveç mesazheve kombëtare, përcjell edhe mesazhe universale. Ajo që për mua është intriguese, është përkufizimi i kulturës si strukturë postmoderne. Secila kulturë, në thelb, është ndërkulturore. Themeluesi i komunikimit ndërkulturore Edward Hall, përkufizon: «Kultura është proces, që krijohet përmes kontaktit dhe lidhjes me Tjetrin». (Edward Hall, Keio Communication Review No. 24, 2002, Edward T. Hall and The History of Intercultural Communication: The United States and Japan, p.9) Mbase, struktura e hapur, shpreh modelin e «kulturës së tretë»: Secili njeri është dallim (difference) në kuptimin «unë jam unë», dhe secila kulturë është «dallim që lidh» (differance), në kuptimin «unë jam ti, dhe ti je unë». Në kontekst, rrjeti NEZI, më ka sjellë bindjen për ndërkulturalizmin aktiv, bindjen për modelin e kulturës së tretë, me elemente edhe të kulturës së parë (kultura shqiptare p. sh. mësimi i gjuhës shqipe në shkolla), edhe të kulturës së dytë (gjuha e vendit emigrant, kultura e vendit), që është funksional ndër shqiptarët e Zvicrës. Më ka sjellë bindjen e mësimnxënies ndërkulturore, që realizohet kur nxënësit vihen në kontakt me njëri-tjetrin, e jo mësimnxënie abstrakte në mësimnxënien për Tjetrin, që në përmasa të konsiderueshme, është ende funksional në sistemin arsimor në Maqedoni, i karakterizuar përmes ndërkulturalizmit pasiv, me elemente të theksuara etnocentrike. Shembull pragmatik është botimi i librave shkollore (të historisë, të kulturës qytetare, teste eksterne etj.), me elemente fyese për Tjetrin.

Pyetja 2

Ç'farë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI, nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe realizimit të konferencave, dhe çfarë mund të përmirësohet?

Sensibiliteti ndërkulturor është efekti shumë domethënës që praktikon metodologjia e planifikimit dhe e realizimit të konferencave të rrjetit NEZI. Të punojmë së bashku, të punojmë përmes dallimeve, bilingualizmi ndërkulturor, respektimi i Tjetrit dhe puna interaktive, janë referenca thelbësore që nuk e ndërtojnë vetëdijen kolektive të punës në rrjetin NEZI.

Pyetja 3

Çfarë tjetër më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI, dhe ç'farë më ka munguar?

Rrjeti NEZI, ka edhe një efekt domethënës, pragmatizmin. Përmes rrjetit NEZI, na është mundësuar që të njihemi më shumë për nivelin e pragmatizmit, në sistemit arsimor në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Pragmatizmi duhet të bëhet çështje thelbësore, një paradigmë e re, jo vetëm për arsimin, por edhe për logjikën e të menduarit shkencor shqiptar. Pragmatizmi do të përforconte bindjet për shkollat eksperimentale, që shkollat janë vende ku nxënësit mësojnë të bëhen qytetarë përmes praktikës. Arsimi shqip duhet të gjejë veten në paradigmat ndërkulturore të politikave arsimore dhe kalimin e tyre, duke filluar që nga arsimimi ndërkulturor dhe të drejtat e pakicave, e deri tek arsimimi ndërkulturor që mëson si të jetohet bashkë në demokraci.

Pyetja 4

Nëse projekti NEZI, do të kishte një vazhdimësi, cilat do të ishin dëshirat e mia në lidhje me drejtimin e këtij vazhdimi?

Uroj që projekti NEZI të funksionojë përmes logjikës eksperimentale, duke e kuptuar shkollën si njëra nga format determinante në demokratizimin e shoqërive në tranzicion. Pragmatizmi i Djuit, shkollën e mendonte si bazë për evoluimin e shoqërisë, «... unë kërkoj vëmendjen tuaj, përpjekje për të krijuar atë që quhet «Edukimi i ri» në dritën e ndryshimeve të mëdha në shoqëri. A mund ta lidhë këtë «Edukimi i ri», me lëvizjen e përgjithshme të ngjarjeve? Nëse ne mund ta bëjmë atë, ajo do të humbasë karakterin e saj

të izoluar, dhe do të pushojë të jetë një çështje që del vetëm nga mendjet e pedagogëve që merren me nxënës të veçantë. Ajo do të duket si pjesë përbërëse e të gjithë evolucionit shoqëror, dhe, në karakteristikat e tij më të përgjithshme të paktën, si e pashmangshme». (Dewey, John, 1859–1952: *The School and Society* (based on 1907 and 1915 editions) (HTML at Brock). Pranimi i pragmatizmit dhe përforcimi i logjikës eksperimentale, do të ndihmonte arsimin shqip në tranzicion (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni), dhe padyshim vetëdijen kombëtare, në intergrimet demokratike evropiane.

Pyetja 5

Nëse projekti NEZI, do të kishte një vazhdimësi: cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dhe çfarë mund të kontribuoj unë personalisht për këto projekte?

Duke e pasur parasysh faktin që arsimi shqip në Maqedoni, është në fazën kalimtare të tij, mendoj që projekte hulumtuese të tipit «Transferet dhe modelet e ndërkulturalizmit» apo «Kurrikula për arsim bilingual-ndërkulturore», do të nxiste progresin e koegzistencës pasive të kulturave.

Nadire Rexhepi, Mësuese, Bashkëpunëtoreshë në Ministrinë e Ambjentit dhe të Planifikimit të Hapësirës në Republikën e Maqedonisë

Pyetja 2

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndhimë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Bashkëpunimi në rrjetin Nezi për mua ka qenë një përvojë e mrekullueshme dhe një sfidë e këndshme, sidomos temat kryesore «Përkrahja në orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për qytetari ...», tema të cilat më kanë preokupuar përgjatë jetës sime dhe akoma më preokupojnë.

Përgjatë qëndrimit tim në Zvicër kam vënë re tek emigrantët shqiptarë që janë rritur në Zvicër se pak e njohin kulturën dhe gjuhën e vendeve nga e kanë prejardhjen. Në të shumtën e rasteve këta persona edhe keqinterpretojnë kulturën, traditat dhe doket e vendeve nga të cilët vijnë, dhe japin një pasqyrë të gabuar tek të tjerët. Për këtë arsye me gëzon fakti që ka iniciativa të tilla, sepse në këtë mënyrë ngrihet sadopak vetëdija e emigrantëve shqiptarë në Zvicër. Kjo mundëson gjithashtu që ata të njohin më mirë identitetin e tyre dhe njëkohësisht ndihmon integrimin e tyre në një shtet multi-etnik, multikulturor dhe multigjuhësor siç është Zvicra.

Unë mendoj që fëmijët shqiptarë përmes mësimit plotësues të gjuhës shqipe arrijnë të njohin më mirë gjuhën, kulturën, traditat dhe ligjet e vendit nga ato vijnë dhe kjo ndihmon që ata të jenë më të suksesshëm gjatë procesit të integritimit në Zvicër dhe do të kuptojnë më mirë faktin që në çdo vend ekzistojnë rregulla dhe ligje, por gjithçka varet nga vetë populli se sa i respekton ato. Njëkohësisht këta fëmijë do të jenë të përgatitur në rastet e riemigrimit apo qoftë kur vijnë vetëm për pushime në vendlindje të adaptohen dhe të integrohen më lehtë dhe më mirë.

Si e re në ushtrimin e profesionit të mësueses ky bashkëpunim më ka sjellë shumë dobi si në anën profesionale, ku kam pasur rastin të jem midis shumë ekspertëve të fushave të ndryshme, të dëgjoj ligjëratat dhe përvojat e tyre shkencore, por edhe nga ana private që me shumicën e pjesëmarrësve kam lidhje shoqërore dhe kemi rastin të diskutojmë hapur për tematika të ndryshme.

Përsa i përket temës së dytë «Edukimi për qytetari demokratike» ka qenë një temë më tërheqëse për mua dhe më fitimprurëse nga ana profesionale. Unë si mësime ndihmëse në gjimnazin e Tetovës çdo ditë ballafaqohem me këtë problematikë dhe më preokupon fakti se si shkolat tona akoma funksionojnë në formën diktatoriale, ku nxënësi respekton rregullat vetëm nga ana e frikës dhe në të shumtën e rasteve janë vetëm pjesë e problemit dhe jo të marrin pjesë në zgjidhjen e problemit. Për këtë arsye mendoj se në

lidhje me këtë temë duhet të organizohen më shumë konferenca dhe seminare të tilla por edhe workshope nëpër shkolla, ku mund të trajnojmë mësues se si të zhvillojnë mësimin në forma më demokratike ashtu si e zhvilloi zoti Rolf Gollob një orë mësimore në Konferencën e tretë që u mbajt në Shkup.

Të edukosh një shoqëri demokratike duhet që të mbjellësh tek ajo së pari ndjenjën e përgjegjësisë individuale dhe kolektive që të mundemi të krijojmë shkolla demokratike dhe jo shkolla kaotike. Po e perifrazoj një citat te zonjës Angela Merkel në një fjalim që e kishte mbajtur në një kishë në Gjermani: «Zoti na lindi te gjithëve të lirë dhe në demokraci, mirëpo ne nga mospërgjegjësia jonë ndaj rrethit dhe të tjerëve detyrohemi të vendosim ligje dhe rregulla ...» pikërisht kjo ide përshtatet me temën «Edukimi për qytetari demokratike», pra nëse ne nuk mbajmë përgjegjësi për veprimet tona ndaj vetes dhe të tjerëve, atëherë gjithçka do të ishte një kaos i vërtet dhe patjetër do funksionojë më së miri diktatura.

Të krijosh shkolla demokratike do të thotë të edukosh qytetare të denjë, individë të cilët marrin përgjegjësinë për zgjidhjen e problemeve e jo individë që janë vetëm pjesë e konstatimit të problemit ose pjesë e vetë problemit. Sa u përket shkollave tona sistemi është i tillë që në të shumtën e rasteve nxënësit janë pjesë e problemit dhe jo të marrin përgjegjësinë ta zgjidhin problemin. Vallë, pse ndodh kjo? Ndodh sepse ne i edukojmë në mënyrë që ata duhet t'u nënshtrohen vetëm urdhrave tanë dhe nuk u lëmë hapësirë që edhe ato te marrin vendime në çështjet që diskutohen.

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe e realizimit/zbatimit të konferencave, dhe çfarë mund (si) të përmirësohet?

Nga ky bashkëpunim në pikëpamje të metodologjisë së planifikimit dhe realizimit të konferencave, kam përfituar përvoja të reja dhe shumë pozitive. Më ka pëlqyer organizimi i pesë konferencave të njëpasnjëshme që si tematikë kishin edukimin e emigrantëve dhe të rimigrantëve, mirëpo çdo konferencë në veçanti kishte tematika që mundësojnë që të arrihet qëllimi më me sukses, që konkluzionet dhe rezultatet e këtyre diskutimeve të vendosen në praktikë.

Gjithashtu e kam parë si pozitive intervalin kohor ndërmjet konferencave që na mundësonte përpunimin e informacioneve dhe tematikave deri ne konferencën e radhës dhe njëkohësisht kisha mundësi që gjatë jetës së përditshme profesionale të mendoja në lidhje me këto tematika dhe çdo herë duke u orvatur që njohuritë që kemi diskutuar në konferenca t'i praktikoj në shkollën ku jap mësim.

Gjithashtu më ka pëlqyer organizimi i konferencave në vende të ndryshme, ku

njëkohësisht na mundësonte të njiheshim së afërmi me problematikat që diskutoheshin, sepse në çdo konferencë kemi pasur rastin të vizitojmë shkolla të vendit dhe të ndjekim zhvillimin e mësimi.

Diçka që mund të përmirësohet do ishte mundësia që të kemi më shumë kohë për diskutime në grupe të vogla apo edhe një diskutim me gjithë pjesëmarrësit. Unë mendoj se shumë tema na ngelshin pa diskutuar për shkak të kohës së limituar, sepse jo çdo kush mund të shprehte atë që mendonte me dy tri fjalë, kështu që ato që e merrnin fjalën për të folur stërzgjateshin në sqarime dhe nuk na linin kohë në të tjerëve që të shpreheshim.

Pyetja 3

Çfarë tjetër më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI dhe çfarë me ka munguar?

Ky bashkëpunim më ka sjellë krijimin e kontakteve me ekspertë të fushave të ndryshme që së bashku të punojmë për të mirën e gjeneratave të ardhshme dhe për krijimin e marrëdhënieve midis shteteve shqipfolëse dhe me diasporën shqiptare në Zvicër. Gjithashtu bashkëpunimi i tillë më ka motivuar që të mendoj në të ardhmen si të kontribuoj më shumë për diasporën shqiptare të Maqedonisë në Zvicër, sepse mendoj se për këtë grup emigrantësh Maqedonia nuk jep haraçin e duhur, sa emigrantët japin për vendlindjen.

Më ka munguar mospjesëmarrja ime në dy konferencat e para, dhe futja ime në konferencën e tretë me vonesë, gjë që më pengoi në ndihmesën tim ndaj rrjetit Nezi, sepse nuk kisha informata të mjaftueshme paraprake rreth qëllimit të rrjetit. Mirëpo koha ndërmjet konferencës së radhës ishte boll e mjaftueshme që unë të përgatitem për konferencën e katërt që u mbajt në Cyrih.

Kam pasur fatin të jem pjesë e këtij rrjeti, sepse këto tematika vërtet janë në favorin tim personal dhe profesional. Mendoj që në të ardhmen kam shumë ambicie të kontribuoj në këtë drejtim për të mirën e emigrantëve dhe të rimigrantëve shqiptarë dhe gjithashtu për formimin e gjeneratave të reja në vendet tona si Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë.

Pyetja 4

Nëse projekti NEZI do të kishte një vazhdimësi: Cilat do të ishin dëshirat e mia në lidhje me drejtimin e këtij vazhdimi?

Nga një herë është e pamundur t'i ndajmë dëshirat nga idetë, mirëpo unë si dëshirë do të prek vetëm një mundësi që rrjeti Nezi të bëjë organizimin e mësuesve shqiptarë që kanë kryer studimet në Zvicër, të vinë në vendet e tyre të prejardhjes dhe të zhvillojnë ca orë mësimore me qëllim të shpërndarjes së përvojave të tyre dhe në këtë mënyrë të kontribuohet në vendet e tyre të prejardhjes.

Pyetja 5

Nëse projekti NEZI do ta kishte një vazhdimësi: Cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dheçfarë mund të kontribuoj unë personalisht për këto projekte?

Propozimet e mia për këtë bashkëpunim do ishin këto:

Thellimi i bashkëpunimit në lidhje me temën e parë «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura». Më konkretisht dua që ky lloj bashkëpunimi të vendoset në praktikë. Unë mendoj që do ishte fitimprurëse nëse organizohen p.sh. javë të këmbimit të nxënësve të cilët jetojnë në Zvicër, të kenë mundësinë të ndjekin mësim disaditor ose javor në vendet e tyre të lindjes. Gjithashtu nxënësit e vendeve shqipfolëse të kenë mundësi të ndjekin disa ditë mësim në shkollat e tyre nga mësues të trajnuar në forma më demokratike, ashtu si ora që zhvilloi zoti Gollob.

Një tjetër pikë bashkëpunimi do ishte ripërpilimi i planit mësimor kornizë për gjuhën dhe kulturën e atdheut si dhe rishqyrtimi i teksteve shkollore. Gjatë vizitave që bëmë në klasat ku mësohej gjuha shqipe në Zvicër hasa në një realitet vetëm të shqiptarëve të Kosovës. Aty flitej dialekti i Kosovës dhe tekstet shkollore kishin ca aspekte nacionalizmi si p.sh. UÇK-ja, lufta dhe të tjera, aspekte të cilat mendoj se janë të gabuara t'i mësojnë fëmijët e kësaj kohe, sepse UÇK-ja nuk ekziston më dhe mënyra se si përmendej në tekst ndjellte një masë dhune tek fëmijët. Mendoj që tekstet shkollore duhet të rishikohen dhe të shkruhen në një gjuhë të unifikuar ku do mundeshin të gjithë fëmijët e trojeve shqiptare të mësonin gjuhën e pastër shqipe.

Deri tani Maqedonia nuk ka bërë asnjë përpjekje që të ndihmojë diasporës shqiptare në Zvicër, këtë informatë e dëgjova nga shefi kabinetit të Ministrisë së Diasporës. Unë mendoj se grupi i ekspertëve të rrjetit nga Maqedonia të bëjë kërkesë në Ministrinë e Arsimit të Maqedonisë që të japë ndihmesën e saj në këtë sferë sikurse japin Kosova dhe

Shqipëria. Për sa i përket idesë së këmbimit të nxënësve që përmenda më lart, personalisht mund të kontribuoj që të bëjë organizimin e vendosjes dhe shpërndarjes së tyre nëpër shkolla dhe vendqëndrime.

Për sa i përket temës së dytë «Edukimi për qytetari demokratike» mendoj se do të ishte shumë fitimprurëse sidomos këtu në Maqedoni ku kemi një shtet multi-etnik dhe ku marrëdhëniet ndëretnike janë të përkeqësuar, nëse organizohen orë të përziera që nënkupton bashkimin e nxënësve të etnive të ndryshme në një orë të përbashkët p.sh. orën e edukatës fizike ta bëjnë së bashku, që ato të kenë rastin e njoftimit dhe bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe njëkohësisht do të mësohen të pranojnë dhe të duan të tjerët që kanë kulturë dhe gjuhë të ndryshme nga ato.

Myqereme Rusi, Universiteti i Tetovës

Pyetja 1

Çfarë përfitova nga bashkëpunimi në NEZI, duke pasur parasysh tematikat kryesore «Ndihmë për orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës» dhe «Edukimi për demokraci»? Aspekte që mund të thelloheshin më tej.

Së pari kam pasur kënaqësinë të jem në rrjetin NEZI, ngaqë ishte një përvojë unike për mua, besoj edhe për pjesëmarrësit e tjerë. Sa u përket temave që u përpunuan si përkrahja midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës, mendoj se në një shoqëri që përpigjet të ndërtojë institucionet e veta në të gjitha nivelet, duhet të synojë kompletimin teorik e profesional për implementimin e suksesshëm të strategjisë kombëtare dhe binacionale për jetësimin e standardeve evropiane dhe të përgjithshme ndërkombëtare në fushën e studimit të kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës, studimin e ligjit dhe respektimin e të Drejtave të Njeriut.

Por, jo vetëm kaq, të bërit politikë tashmë gradualisht duhet kaluar te profesionistët, ndërsa vendi gjithashtu ka nevojë për promovimin dhe respektimin e kulturës së parë, të dytë dhe të ndërkulturës, pasi që vendi im karakterizohet me multinacionalitetin e tij si shtet.

Në projektin e edukimit për qytetari demokratike, vendi im duhet të ketë një program unik që do të vlejë për gjithë shoqërinë multi-etnike ku implementimi i tij mund të jetë një sfidë serioze për të gjithë qytetarët, e veçmas, për të rinjtë ambiciozë që janë rritur në një shoqëri shumëpartiake.

Këto dy tema të përmendura janë shumë të rëndësishme në harmonizimin e jetës, tejkalimin e frustracioneve dhe konflikteve, ku individi është në fokus të shoqërisë, ku bëhet edhe humanizimi i qytetarëve, sidomos i brezave të rinj.

Programet ngërthejnë në vete edukimin e fëmijëve të moshave të reja, orientimin dhe përcjelljen e tyre në zhvillimin psiko-social si edhe socio-kulturor.

Për vendin tim ende flitet se është në tranzicion, ndërhyrja e programeve të përmendura është e domosdoshme, për ta kaluar sa më lehtë dhe me sa më pak dhimbje procesin e transformimit shoqëror (ku fëmija është pasuria më e çmueshme dhe më e lëndueshme njëkohësisht).

Pyetja 2

Çfarë më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI nga pikëpamja e metodologjisë së planifikimit dhe e realizimit/zbatimit të konferencave, dhe çfarë mund (si) të përmirësohet?

Çdo aktivitet shkencor e ka metodologjinë e vet të punës. Edhe ky Projekt mendoj se i integroi rregullat relevante akademike, plotësoi standardet shkencore analitike dhe hulumtuese, përdori shkathtësi kritike, për të ardhur deri në sintezë të të gjithë asaj që punohej për të ardhur në përfundime relevante.

Do të më interesonte mënyra e implementimit të këtij Projekti në praktikë në vendin ku jetoj. Përveç që duhet përkrahje financiare për praktikimin e Projektit, do të duhet edhe përgatitje për tejkalimin e paragjykimëve (që do të jetë vështirë).

Edhe pse çdo fillim është i vështirë, vlen të provohet me hapa të vegjël.

Pyetja 3

Çfarë tjetër më ka sjellë mua bashkëpunimi në rrjetin NEZI dhe çfarë më ka munguar?

Rrjeti NEZI më ka ofruar një formësim të qëndrueshëm të profilit teoriko-shkencor të avansuar dhe një performancë cilësore pragmatike, origjinale të avancuar që ka qasje të formësuar mbi trendet dhe zhvillimet në vend dhe Rajon.

Programi ka ndikuar në zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive kritike, analitike dhe hulumtuese, që mund të aplikohen në vendet prej nga jemi.

Ky Projekt na ka përgatitur për ta vlerësuar në mënyrë kritike rëndësinë e diversitetit të kulturave të ndryshme. Projekti ka patur rëndësi hulumtuese dhe investiguese që ka

të bëjë me aktorë të ndryshëm komunikues, që secili në mënyrën e vet dhe jep ndihmesë në këtë Projekt duke u bazuar nga njohuritë dhe praktika e vendeve prej nga jemi.

Komponent tjetër i përfitimit nga rrjeti NEZI është përfshirja e komunikimit ndërkulturor dhe ndërfetar, komunikimet me opinionet e jashtme dhe të matjes së efekteve të mesazhit që ndihmon dhe projektin e kulturës së parë, së dytë dhe ndërkulturës.

Pyetja 4+5

Nëse projekti NEZI do të kishte një vazhdimësi: Cilat do të ishin dëshirat e mia në lidhje me drejtimin e këtij vazhdimi? Nëse projekti NEZI do ta kishte një vazhdimësi: Cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dheçfarë mund të kontribuoj unë personalisht për këto projekte?

Nëse projekti NEZI do të ketë vazhdimësi, do të sygjeroja që secili prej nesh të bëjë një introspektion, ta njohim vetveten pastaj, si na njohin të tjerët, sa kemi mundësi ti njohim kulturat e tjera, çfarë kemi të përbashkëta dhe dallimet në kulturat tona dhe në kulturat e dyta si dhe në ndërkulturat.

Ndihmesa ime personale mund të ishte një hulumtim në lidhje me vetëbesimin dhe marrëdhëniet ndërpersonale në mes kulturës së parë, së dytë dhe ndërkulturës.

Kushtëzuar nga rezultatet që do të dalin, të mund të ndikoj dhe të ndihmoj në rrethin ku jetoj.

Pjesa III

Përfitimet dhe pasojat e rrjetit

Referime të
koordinuara të
të pesë grupeve

Grupi i Zvicrës (Pjesëmarrësit/et nga Zvicra pa origjinë shqiptare)

**Miriam Aegerter-Jossen,
Brigit Allenbach,
Regina B. Bühlmann,
Kai Felkendorff,
Andrea Hänni Hoti**

Për pyetjen 1

Cilat aspekte të punës së NEZI-t ishin për grupin tonë/vendin tonë veçanërisht produktive dhe me rëndësi?

Larmia nën pjesëmarrësit e rrjetit na u duk si shumë e frytshme. Kjo larmi në perspektiva lejonte një diskurs mbi disiplinat e ndryshme shkencore dhe përtej kufijve kombëtarë. Rrjeti përfshinte ekspertë nga domenë shoqërorë të ndryshëm si të shkencës, politikës, administrimit dhe praktikës shkollore, nëpërmjet të cilave mund të nixtej shkëmbimi midis hulumtimit, planifikimit arsimor dhe praktikës profesionale. Veçanërisht për t'u theksuar është bashkëpunimi i investuar në shumë vite. Qëndrueshmëria e bashkëpunimit mundësoi ngritjen dhe ruajtjen e një rrjeti marrëdhëniesh. Krahas pjesëve zyrtare me rëndësi nga këndvështrimi i grupit tonë ishin edhe pjesët jozyrtare të konferencave. Veç kësaj u krijuan si brenda grupit tonë ashtu edhe brenda rrethit të të gjithë pjesëmarrësve të Projektit nga Zvicra shumë kontakte dhe mundësi shkëmbimi, që anëtarët të takoheshin personalisht në konferencat brenda dhe, para së gjithash, jashtë vendit dhe të gjenin kohë për të ruajtur diskursin profesional. Në kuadrin e këtij shkëmbimi falë rrjetit, morëm një perspektivë të re për punën tonë.

Si shembull për një prej shumë temave interesante, me të cilat ne jemi marrë, dëshirojmë të përmendim mësimin shqip të kulturës së gjuhës së prejardhur (gjuha dhe kultura e atdheut), vizitë e cila na u mundësua në Zyrih në kuadrin e Konferencës.

Vizita e mësimi të kulturës së gjuhës së prejardhjes paraqiste, për këndvështrimin tonë, një Highlight dhe krijonte një element lidhës, meqë të gjithë pjesëmarrësit nga Zvicra tashmë ishin marrë në një formë apo në një tjetër me këtë tematikë. Mësimi në gjuhët e prejardhjes (MGJP) në Zvicër i njohur edhe me emrin mësimi në gjuhën dhe kulturën e vendlindjes (MGJK), organizohet në Zvicër nëpërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe/apo nëpërmjet shteteve të prejardhjes.

Ai është në dispozicion, si rregull, si një ofertë arsimore fakultative shtesë për mësimin në shkollën publike për fëmijët nga përkatësisht këto vende të prejardhjes apo me përkatësisht gjuhën e prejardhjes në moshën e detyruar të shkollës.

Në mësimin e gjuhës së prejardhjes transmetohen, së bashku me thellimin e kompetencave të gjuhës së prejardhjes, kryesisht edhe njohuritë e kulturës së prejardhjes.

Kantoni i Cyrihut do që me kornizën e kurrikulës për gjuhën dhe kulturën amtare (HSK), të ndërtojë një urë midis programit në shkollat publike zvicerane dhe përmbajtjeve në MGJP. Krahas transmetimit të kompetencave të gjuhës së parë, futet këtu edhe transmetimi i përmbajtjeve dhe kompetencave transkulturore si edhe të pedagogjisë demokratike. Se si transmetohen konkretisht këto kompetenca në MGJP, pjesëmarrësit e NEZI-t mundën ta vëzhgonin gjatë mësimit të tyre.

Në bisedë me mësimdhënësit e MGJP-së u bënë edhe të qarta kufijtë e transmetimit të këtyre përmbajtjeve të sofistikuara.

Si rregull mësimi i MGJP-së ka në dispozicion vetëm dyleksione në javë, klasat e MGJP-së janë shumë heterogjene (veçanërisht në funksion të moshës dhe të nivelit të arritjeve), mësimdhënësit e MGJP-së sjellin me vete kushte të ndryshme profesionale, bashkëpunimi konkret midis MGJP-së dhe shkollës publike shfaqet pjesërisht i vështirë. Shpesh mungojnë edhe mjetet përkatëse dhe materialet didaktike për mësimin e MGJP-së. Këtu Projekti me bazë të gjerë vë «themelet për mësimin e MGJP-së» të Shkollës së Lartë Pedagogjike Cyrih. Ai ofron një mbledhje materialesh me një vëllim hyrës për bazat dhe arsyet si edhe 6 broshura me sugjerime didaktike për mbështetjen e të lexuarit, të të shkruarit dhe të folurit në gjuhën e parë si edhe mbështetjen e kompetencës ndërkulturore dhe transmetimin e strategjive dhe teknikave të të mësuarit në MGJP (krahaso në bibliografi tek Schader (Hg.) 2016).

Tema i MGJK-së ka hyrë edhe në arsimimin e mëtejshëm dhe në trajnimin e mësimdhënësve. Në kursin për certifikatën gjermanishtja si gjuhë e dytë dhe ndërkulturaliteti (CAS DaZIK), e cila ofrohet nga Shkolla e Lartë Pedagogjike Zug në bashkëpunim me Shkollën e lartë Pedagogjike Lucern, munda të fiksohej tematika e MGJP-së në përshkrimin aktual. Kështu zhvillohet një takim midis pjesëmarrësve dhe një mësimdhënësi të GJK-së, çfarë krahas ngritjes dhe zgjerimit të dijes për pjesëmarrësit e kursit, duhet të kontribuojë për një bashkëpunim më produktiv midis mësimdhënësve të MGJK-së dhe mësimdhënësve të shkollës publike.

Për pyetjen 2

Çfarë dhe si mund të thellohet apo zgjerohet?

Ne dëshirojmë në përgjithësi një diskutim të thelluar me debate shkencore aktuale, pak a shumë me perspektivë transkombëtare, e cila vështrohet në mënyrë kritike proceset e të bërit ndryshe («odhëring») dhe e kalon në kulturë perspektivën etno-kombëtare të kontejnerit. Diaspora shqiptare në Zvicër si edhe grupet e popullësisë shqiptare në shtetet e

ndryshme të Evropës Juglindore janë shembuj parade për heterogjenitetin e «kulturave» apo «minoriteteve». «Rrënjët» shqiptare janë pikënisja për atë që Steven Vertovec (2007) e ka përkufizuar me konceptin e superdiversitetit: vende të ndryshme nga origjina, kombësi dhe statuse qëndrimi, biografi dhe motive të ndryshme emigracioni, ndryshime lidhur me moshën, brezin dhe gjininë, rrugë të ndryshme formimi dhe karriera profesionale, situata banimi si edhe pozicione krejtësisht të ndryshme në funksion të vlerave dhe të normave, besimit, rendit familiar dhe gjinor. Në projektet pasuese duhet që të kalohet më me forcë në problematikën e të menduarit në kategori kombëtare-etnike dhe duhet të zhvillohen perspektiva të reja, të cilat e drejtojnë fokusin nga fqinjësia dhe interesat e përbashkëta të qytetarëve në një shtet, të cilat si rregull nuk janë të kushtëzuara etnikisht apo nga besimi, por që varen nga faktorë të tjerë si për shembull mosha, gjinia dhe shtesa (krahaso artikullin e Allenbach në pjesën II të këtij vëllimi).

Fatkeqësisht konstatojmë në të përditshmen tonë profesionale si docentë të shkollave të larta dhe ekspertë për arsimin në Zvicër, që dija mbi vendet e prejardhjes të familjeve shqiptare në Zvicër është shumë e kufizuar tek mësimdhënësit që fillojnë punën edhe tek ata të trajnuarit. Mungojnë njohuri si për historinë dhe politikën në shtetet multikulturore të Evropës Juglindore si edhe të tilla mbi të përditshmen e grave, burrave dhe të fëmijëve në mjediset e ndryshme socio-kulturore. Kjo gjysëmdije favorizon qëndrimet e ngarkuara me paragjykimet ndaj familjeve shqiptare dhe fëmijëve të tyre në Zvicër.

Së bashku me debatet socialo-shkencore dhe kulturoro-shkencore të transnacionalizmit, tema interesante do të ishin edhe konceptet aktuale të diversitetit pedagogjik, me të cilat mund të merret në të ardhmen rrjeti apo një rrjet i ri i formuar. Veçanërisht për t'u menduar është për vendosjen nga pedagogjia e diversitetit dhe e inkluzionit, të cilat kanë zëvendësuar koncepte ekzistuese të pedagogjikës ndërkulturore, dhe me këtë edhe kuptime thelbësore të kulturës (krahaso artikullin e Haenni Hoti në pjesën II të këtij vëllimi).

Për pyetjen 3

Si mund të ndodhë konkretisht kjo gjë?

Ne jemi menduar, që mund të inicohen forma të ndryshme të partneriteteve me shkollat e larta, programe shkëmbimi apo udhëtime studimore midis institucioneve dhe organizatave të formimit dhe kualifikimit të mësimdhënësve në vendet pjesëmarrëse, meqë programet e mobilitetit në formimin e mësuesve po marrin shumë rëndësi. Veçanërisht në letërsi jepet një potencial i rëndësishëm për mbështetjen e kompetencave dhe pozicioneve relevante profesionale. Për pyetjen, se deri në çfarë mase pjesëmarrja në programet e mobilitetit ndryshon me të vërtetë qëndrimet dhe pozicionimet për mësim-

dhënësit apo mbështet kompetenca përkatëse, shumë studime të cilat i ka kryer Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Çështjet e Arsimit në Shkollën e Lartë Pedagogjike Zug, kanë dhënë disa përgjigjigje (krahajo Leutöyler & Meierhans, 2011). Për kontekstin tonë janë interesante njohuritë e mëposhtme: Qëndrimet e mobilitetit nuk i shërbejnë thjesht një zhvillimi të personalitetit jospecifik, ato përmbajnë dukshëm një potencial të madh, faceta mjaft specifike për të mbështetur kompetencën profesionale të mësimeve (që janë për t'u futur në punë). Nisur nga kjo, këto faceta të kompetencave specifike do të zhvilloheshin në qëndrimet e mobilitetit pothuaj në mënyrë automatike, vetëm se duhet të shënohen si një mit i thjeshtë.

Gjendja e hulumtimit përshkruan një potencial, zor se përshkruan në mënyrë empirike të qëndrueshme efekte faktike. Me qëllim që të realizohet ky potencial, nevojitet një drejtim dhe mbështetje e qëllimshme si edhe nevojiten kushte të përcaktuara tek studentët e mobilitetit. Nuk përfitojnë të gjithë në të njëjtën përmasë, jo të gjithë kalojnë zhvillime produktive. Përveç kësaj ka edhe udhëzime për forcimin dhe ngurtësimin e paragjyqimeve, n.q.s për shembull kjo për shkak të një shoku kulturor apo të mbingarkesës nuk është e mundur për studentët të mobilitetit për t'i besuar hapësirës së mundshme stimuluese të të mësuarit dhe të përvojës. Prandaj është e rëndësishme që në shkollat e larta pedagogjike të gjenden dhe të shfrytëzohen konvejerë të përshtatshëm me qëllim që të ndodhë para- dhe paspërgatitja e qëllimshme e programeve të mobilitetit (në mënyrë ideale e individualizuar). Njohuritë e përmendura mësipër për këtë arsye janë me rëndësi për ngritjen e partneriteteve të shkollave të larta potencialisht të reja, programet e shkëmbimit apo udhëtimet studimore.

Bibliografi

- Leutwyler, B. & Meierhans, C. (2011). Mobilitätsaufenthalte in der Lehrerinnen- und Lehrerbildung. Aktivitäten und Lernerfahrungen von Mobilitätsstudierenden. Beiträge zur Lehrerbildung 29 (1), 100–108.
- Schader, Basil (Hg.; 2016): Materialien für den herkunftssprachlichen Unterricht. Band «Grundlagen und Hintergründe» sowie 5 Hefte mit didaktischen Anregungen zur Förderung des Schreibens / des Lesens / der Mündlichkeit in der Erstsprache / zur Förderung der interkulturellen Kompetenz / zur Vermittlung von Lernstrategien und -techniken. Zürich: Orell Füssli. Zu den Übersetzungen auf Englisch, Albanisch, Türkisch etc. vgl. <http://www.phzh.ch/ipe>.
- Vertovec, S. (2007). Super-diversity and its implications. *Ethnic and Racial Studies* 30, 1024–1054.

Grupi shqiptar i Zvicrës (Pjesëmarrësit/et nga Zvicra me origjinë shqiptare)

**Shqipe Bajrami,
Ylfete Fanaj,
Shpresa Jashari,
Rifat Haxhijaj,
Driton Kajtazi,
Nexhat Maloku,
Shukrije Ramadani,
Naxhi Selimi**

Rrjeti NEZI, aspektet tematike dhe perspektivat

Ndërkultura, multikultura dhe transkultura duhet të tematizohen më qartë dhe të gjejnë vend të rregullt në planet mësimore të shumë shteteve me emigracion të shtuar, ngaqë identiteti është çështje komplekse, e larmishme, dhe nuk merr parasysh vetëm perspektivat e vendit të prejardhjes, por para së gjithash edhe të atij ku jetohet. Thjesht, në çështjen e identitetit, në veçanti në kohën e mobilitetit të shtuar të Evropës Perëndimore, parametrat që ndikojnë në formimin e tij janë po aq zyrtar, formalë dhe të planifikuar, sa edhe jozyrtar, joformal dhe të lidhur direkt me kontekstet sociale. Për këtë arsye, reflektimi ndërprofesional në kuadër të rrjetit NEZI është si impuls fillestar shumë i dobishëm, me shpresë se kjo gjë mund të zhvillohet dhe të marrë përmasa edhe më globale

Për pyetjet 1 dhe 2:

Aspektet tematike të rrjetit Nezi

Korpusi i temave të zgjedhura për t'u trajtuar ishte tejet pozitiv dhe ajo që i bënte interesante ato ishin zhvillimet e reja në trojet shqiptare. Ndërsa, edhe pse temat ishin pjesërisht inovative, ngaqë shumica tashmë ishin të praktikuara në kuadër të profesioneve të pjesëmarrësve, risia nuk mungonte dhe ishte pikërisht tek kuptimi mbi terminologjinë e shumësisë së kulturave, gjë e cila nuk është e njëjtë në kontekstin kulturor për të gjithë fëmijët. Gjithashtu, nga përshtypja se ndikimi i politikës dhe i ligjeve ndikojnë thellë në politikat arsimore, jo vetëm në Ballkan por edhe në Zvicër, bëri që kompleksiteti i këtij domeni të jetë në rritje dhe se trajtimi i minoriteteve varet edhe nga vetë faktorët politikë.

Temat e trajtuara nga ekipi zviceran kanë ndihmuar për të pasur një pasqyrë më të qartë të zhvillimeve në fushën e ndërkulturës. Veçanërisht çështja e mësimit në gjuhën e prejardhjes ishte me interes të dyanshëm dhe idetë e shkëmbyera për këtë fushë ishin të rëndësishme për rrjetin në përgjithësi.

Aspekti i konfrontimit me temën të rrites mes kulturave të ndryshme, të integrohesh mirë në shoqëri dhe njëkohësisht të zgjerosh njohuritë në gjuhën e prejardhjes dhe në fushën e kulturës ishte shumë i dobishëm, ngaqë jo rrallë ndodh që integrimi dhe ruajtja e identitetit të shihen si dyfusha që e përjashtojnë njëra-tjetrën.

Duke u nisur nga ajo se çdo i treti fëmijë që rritet e jeton në kantonet me qytete të mëdha të Zvicrës, socializohet në dy apo më tepër gjuhë, aspektet e trajtuara në rrjetin NEZI marrin vlerë të pakontestueshme. Në qytetin e Cyrihut, për shembull, janë më tepër se gjysma e fëmijëve shumëgjuhësor, të cilët rriten në dy e më tepër kultura. Shumë gjuhë, ndër to edhe gjuha shqipe, janë pjesë e mësimit vullnetar plotësues. Tashmë është konstatuar shkencërisht se njohuritë e përfituara gjatë këtyre orëve të vijua në gjuhën e tyre të prejardhjes i ndihmojnë fëmijët dhe të rinjtë edhe në mësimin e rregullt, pastaj në kontaktet me farefisën në vendlindje dhe më vonë edhe në fushën e profesionit.

Duke u nisur nga fakti që sot jetojmë në kohën e globalizimit, gati të gjithë flasin mbi vlerat kulturore, madje edhe mbi vlerat ekonomike të shumëgjuhësisë. Konsiderohet si tepër e vlefshme, kur fëmijët paralelisht me gjuhën e dytë (gjermanisht, frëngjisht, italisht etj.) e përvetësojnë gjuhën shqipe. Fjala është për një potencial kulturor të gjuhësor, që duhet përkrahur dhe inkurajuar.

Në këtë kontekst, ligji mbi gjuhët (shih EDK) mundëson që të përkrahet të mësuarit e gjuhës së parë (pra, në rastin konkret të gjuhës shqipe). Në këtë drejtim ekziston edhe strategjia e aprovuar e Konferencës e Drejtorive të Arsimit (EDK) në kuadër zviceran e vitit 2004. Në të, përpos gjuhëve të vendit dhe anglishtes, parashihet edhe të mësuarit e gjuhëve të prejardhjes së emigrantëve. Nga kjo, në kuadër të harmonizimit të sistemit shkollor, kantonet anëtare janë të obliguara që t'a përkrahin në mënyrë organizative mësimin plotësues në gjuhët e prejardhjes. Dhe fakti se gjuha dhe vlerat kulturore qëndrojnë në raport të ngushtë me njëra-tjetrën, nënkupton edhe ruajtjen e vlerave kulturore, të cilat i trashëgojnë fëmijët shqiptarë, të cilët rriten në diasporë.

Ky zhvillim formal ligjor padyshim se na gëzon dhe mirëpritet edhe nga bartësit e mësimit plotësues në gjuhën e prejardhjes. Megjithatë, pozitat reale të mësimit plotësues në shkollë nuk zhvillohen aq shpejt, fjala vjen, ashtu siç ndodh me retorikat përkrahëse të përfaqësuesve të arsimit zviceran. Mësimi plotësues nuk ka arritur ende të përfshihet në orarin e mësimit të rregullt në shkollën fillore. Mirëpo, falë përkrahjes dhe angazhimit të grupeve përkatëse gjuhësore apo shoqatave, siç është për komunitetin tonë LAPSh «Naim Frashëri», fëmijët e mësojnë dhe i zgjerojnë njohuritë në gjuhën dhe kulturën shqipe. Financimi është padyshim në mënyrë kronike i dobët ose nuk ekziston fare, kështu që prindërit detyrohen të marrin përsipër mbështetjen financiare të këtij mësimi plotësues.

Shembuj nga kantoni i Cyrihut

Për t'i përkrahur sa më mirë fëmijët me sfond emigrimi, Drejtoria e Arsimit e Kantonit të Cyrihut ka aprovuar dokumente të ndryshme, nëpërmjet të të cilave u dilet në ndihmë mësimdhënësve me këshilla përkatëse. Në këtë drejtim vlen të përmendet dokumenti i aprovuar i 14 janarit 2008 "Arsimimi dhe integrimi", kurse në kuadër të arsimimit për mësues në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Cyrihut, në mjaft module trajtohet çështja e përkrahjes së fëmijëve me sfond emigrimi si dhe bashkëpunimi mes mësuesve të klasave të rregullta dhe atyre të mësimit në gjuhën e prejardhjes.

Një grup ekspertësh në bashkëpunim me Komisionin Pedagogjik të Drejtorisë së Arsimit të Kantonit të Cyrihut, ka hartuar «Planin mësimor kornizë» për mësimin në gjuhën e prejardhjes, i cili synon përafrimin e mësimit plotësues me mësimin e rregullt. Ky plan shërben si linjë orientuese për të gjitha grupet gjuhësore dhe tashmë është në përdorim edhe në kantonet tjera gjermanishtfolëse.

Në vitet e fundit janë publikuar mjaft dokumente e tekste të cilat synojnë që të forcojnë gjithnjë e më shumë kompetencën ndërkulturore të mësimdhënësve zviceranë dhe të atyre të mësimit plotësues, e të cilat konkretizohen edhe me projekte të përbashkëta në shkolla dhe institucione të tjera arsimore.

Shembull nga kantoni i Gjenevës

Në Gjenevë kemi një realitet tjetër. Aty përpos përkrahjes financiare nga organet relevante shtetërore e të cilat mbulojnë më shumë se gjysmën e shpenzimeve vjetore, ka një bashkëpunim zyrtar në mes të mësuesit të mësimit plotësues me «Éducation et ouverture aux langues à l'école» (EOLE). Qëllimi i këtij bashkëpunimi është sensibilizimi dhe motivimi i të gjithë fëmijëve për shumëgjuhësinë dhe pasurinë kulturore.

Shembuj të këtyre që praktikohen në disa qytete të mëdha zvicerane, tregojnë se me kushte të mira dhe bashkëpunim të ngushtë shtohet edhe ndikimi i mësimit plotësues. Kënaqësia e prindërve, mësuesve dhe autoriteteve shkollore me modelin e këtij lloji është e lartë.

Arsimimi për demokraci

Lëmi i arsimimit për demokraci është veçanërisht i rëndësishëm sidomos për kontaktet dhe mënyrat e reja se si hyjnë idetë në praktikë. Përderisa në praktikë flitet për ndërkulturë, në shkencë është diçka e tejkualuar, ngaqë në fushën shkencore përdoret termi transkulturë. Diçka që mund të përmirësohet është edhe koncepteti i të punuarit. Do të ishte mirë të gjendet gjuha që shkenca të lidhet me praktikën, por edhe formën e transferimit nga shkenca te praktika.

Është mendim i përgjithshëm se shkolla duhet të bëjë më shumë në zbatimin e mjaft dokumenteve të shkruara, në mënyrë që të ketë një qëndrim të përbashkët përse i përket marrëdhënies që mban shkolla në përgjithësi në fushën e EDC-së dhe të përkrahjes së fëmijëve me sfond emigrimi dhe të pakicave në orientimin e tyre midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës. Është me shumë rëndësi që të punohet në drejtimin që fëmijët me prejardhje tjetër të mos etiketohen si «fëmijë me sfond emigrimi», por si pjesëtarë të barabartë të shoqërisë dhe në punën e mësuesve të mos ketë dallime mes fëmijëve «vendës» dhe atyre «me sfond emigrimi».

Kompetenca ndërkulturore duhet të jetë pjesë e domosdoshme e arsimit jo vetëm për mësues, por edhe në kuadër të seminareve për mësimdhënës që tashmë janë në procesin mësimor, ngaqë shoqëria zvicerane është një shoqëri multikulturore dhe kjo shumëllojshmëri duhet të shikohet si një pasuri e përbashkët e jo si një pengesë. Sot flitet për inteligjencën kulturore, pra për aftësinë e të jetuarit me sukses mes kulturave të ndryshme dhe qëllimi i arsimit të mësuesve duhet të jetë të formojë mësimdhënës të cilët i përkrahin nxënësit që të mund të përballen me sfidat e reja të jetës në një ambient ku gërshetohen kultura të ndryshme.

Kompetenca ndërkulturore duhet të jetë pjesë përbërëse edhe e punës së mësimdhënësve të mësimin në gjuhën e prejardhjes ngase të dy palët duhet të kenë të njëjtin qëllim, të përgatisin nxënësit për një jetë në një shoqëri multikulturore.

Në këtë drejtim udhëtimet studimore qoftë të studentëve, qoftë të mësuesve zviceranë, të cilët tashmë janë në procesin mësimor, janë shumë të dobishme. Njohja dhe ballafaqimi i drejtpërdrejtë me kulturat e tjera i ndihmon ata për t'i zbatuar në mësimdhënien e tyre çështjet e lartpërmendura.

Politika të reja arsimore

Sipas mendimit tonë, në rrethanat aktuale, është e domosdoshme të ndiqet një politikë e re arsimore, e cila u krijon mundësinë edhe nxënësve nga shtresat e ulta sociale që të studiojnë për mësimdhënës të ardhshëm. Shkolla duhet të bëjë më shumë në fushën e bashkëpunimit me mësuesit e mësimin në gjuhën e prejardhjes, sepse ata janë një burim shumë pak i shfrytëzuar në fushën ndërkulturore. Shembull, në këto vitet e fundit LAPSH «N. Frashëri» në Zvicër, një nga objektivat kryesorë ka pasur përkrahjen e nxënësve, të cilët e vijnë mësimin në gjuhën shqipe, në fushën e kompetencës ndërkulturore. Për këtë arsye janë krijuar edhe materiale mësimore të cilat i shkojnë për shtat realizimit të këtij objekti.

Mësuesit zviceranë, në bashkëpunim me mësuesit e mësimin plotësues të gjuhëve të prejardhjes, duhet të punojnë në mënyrë të koordinuar që të ndihmojnë prindërit për të qenë më të lidhur me realitetin shkollor, qoftë nëpërmjet seminareve, kontakteve të drejtpërdrejta, apo edhe materialeve përkrahëse me shkrim etj.

Për pyetjet 2 dhe 3:**Perspektiva e NEZI-t**

Në rast të vazhdimësisë së punës të NEZI-t, do të ishte e frytshme që të formohen grupe të reja duke u nisur nga profesionet që ushtrojnë, ngaqë gjatë konferencave, duke u identifikuar me etni, produktiviteti dhe kredibiliteti i rezultatit ishte i ndryshëm. Në këtë rast, kemi të bëjmë me modele të reja hibride, dhe me një lidhshmëri initiale në mes gjuhëve dhe kulturave. Këtë shumëllojshmëri të elementeve duhet ta konsiderojmë si element të natyrshëm.

NEZI ka mundësi të ketë një perspektivë të mirë në rast të krijimit të grupeve të vogla të afta të punës, të cilat do të angazhoheshin në zbatimin konkret të fryteve të arritura në kuadër të konferencave të rrjetit. Dobia e këtij rrjeti do të dëshmohej nëse do të punohet në ato fusha dhe me ato grupe të cilat kanë nevojë për t'i përjetuar nëpërmjet aktiviteteve konkrete.

Grupi i Shqipërisë (Pjesëmarrësit/et nga Shqipëria)

**Astrit Dautaj,
Admir Kraja,
Nikoleta Mita,
Merita Xhumari**

Rrjeti NEZI, kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura e zhvilloi veprimtarinë në harkun kohor të dy viteve 2013-2015. Veprimtaria e tij u përqendrua në dy çështje kryesore që lidhen me diasporën shqiptare në Zvicër dhe vendet e prejardhjes së saj Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria: a) Orientimi midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës (në lidhje me emigrantët dhe të riatdhesuarit, por edhe me anëtarë të pakicave etnike e të tjera në trojet shqiptare), b) edukimi për demokraci. Shqipëria u përfaqësua në këtë rrjet me katër ekspertë të fushës së edukimit, sociologjisë, filozofisë dhe linguistikës.

Këtë raport po e paraqesim sipas disa pikave kryesore.

Për pyetjen 1:

Vlera e shtuar për grupin dhe vendin tonë nga pjesëmarrja në rrjetin NEZI

Pasurim i njohjes

Veprimtaritë e shumta të projektit na dhanë mundësi të fitojmë njohuri të reja për tematikën e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash; të njohim teori, rezultate të kërkimeve bashkëkohore dhe modele nga Evropa Perëndimore, veçanërisht nga Zvicra, përsa i përket edukimit për demokraci dhe integritet të fëmijëve që rriten në dhe midis dy kulturave, të kuptojmë më mirë dinamikën e të rriturit në shoqëri me larmi kulturore, të njohim më mirë çështje aktuale që lidhen me praninë e shumë kulturave dhe me edukimin shumëkulturore, të njohim historitë e suksesit, veçanërisht, të të emigruarve në Zvicër nga Kosova dhe Maqedonia.

Pasurimi i njohjes u realizua nëpërmjet një shumëllojshmërie veprimtarish, si konferenca, tavolina të rrumbullakta, rrahje mendimesh, paraqitje modelesh, mësim tregues në shkollë të Zvicrës, Kosovës e Maqedonisë, takime me personalitete të shkencës, politikës, mësim, nxënës, prezantime botimesh.

Dialogu ndërkombëtar dhe kontaktet autentike

Rrjeti NEZI bashkoi specialistë të katër vendeve (Zvicër, Kosovë, Maqedoni, Shqipëri), të cilët nëpërmjet një dialogu profesional shkëmbyen pikëpamjet dhe përvojat e tyre, diskutuan modele të integritimit ndërkulturor dhe të edukimit demokratik, prezantuan ide të reja për bashkëpunime të ndryshme në të ardhmen. Rrjeti mundësoi njohjen e kulturave të ndryshme, shkëmbimin e kontakteve, krijimin dhe forcimin e miqësive.

Projekti mundësoi një dialog shkencor ndërkombëtar, mundësoi paraqitjen e këndvështrimeve, njohjen e natyrës së problemeve të orientimit, përfshirjes dhe integritimit të fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë në shoqërinë zvicerane. Dialogu ndërkombëtar na ndihmoi të identifikojmë të përbashkëtat dhe dallimet që lidhen me marrëdhëniet ndërkulturore dhe edukimin qytetar në Shqipëri, Zvicër, Kosovë e Maqedoni. Shkëmbimi i perceptimeve, besimeve, fakteve, përfundimeve na mundësoi krijimin e një tabloje më të plotë për marrëdhëniet ndërkulturore dhe edukimin qytetar. Dialogu krijoi një mjedis të nxëni dhe bashkëpunimi.

Për ne ishin shumë interesante diskutimi i problematikave të përshtatjes, të integritimit, diskutimet mbi temën e marrëdhënieve ndërkulturore dhe rezultatet e kërkimeve për identitetin te brezi i parë, i dytë dhe i tretë i emigrantëve në Zvicër, iniciativat e bashkëpunimit për të ndihmuar në nxitjen e mësimit të gjuhës shqipe si gjuhë plotësuese për gjeneratën e dytë dhe të tretë të shqiptarëve në Zvicër.

Me shume interes kanë qenë punët në grupe, qoftë me pjesëmarrësit e një shteti, qoftë në grupe të përziera me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga shtete të ndryshme, ku debatet ishin frytdhënëse sepse këmbëheshin ide nga përvoja të ndryshme. Po me aq interes kanë qenë fjalimet e përfaqësuesve të diplomacisë shqiptare në Zvicër të cilët qartësuan politikat shtetërore në kuadrin e mbështetjes së emigrantëve për integrimin në vendet ku ata jetojnë.

Takimet dhe vizitat në institucione të përfshirë në tematikën e rrjetit, mundësuan njohjen me problemet aktuale, me sfidat për përballimin e tyre dhe me historitë e suksesit. Jo vetëm dimensionin real, praktik i veprimtarive, por edhe përvoja konkrete e mësuesve, nxënësve dhe specialistëve për realizimin e edukimit ndërkulturor, për përballimin e sfidave të ndërveprimit të kulturës së parë dhe të dytë, ishin një vlerë e shtuar për ne.

Shembujt e suksesit dhe takimet e drejtpërdrejta me përfaqësues të brezit të ri të shqiptarëve të rritur në Zvicër, ishte një nga pikat e forta të Projektit, sepse nëpërmjet modeleve tashmë të provuara ne njohëm sfidat e gjithëpërfshirjes, të bashkëjetesës ndëretnike e ndërjetare, sfidat kulturore me të cilat ata ishin ndeshur dhe mënyrat se si i kishin përballuar ato sfida. Modeli i bashkëpunimit të qeverisë qendrore me qeveritë vendore në Zvicër për përmblidhjen e të drejtave gjuhësore, përcjelljen e vlerave e të Drejtave të Njeriut dhe të edukimit demokratik, ishte i efektshëm. Modelet e qeverisjes demokratike në shkollë dëshmonin se si garantohej dhe nixtej komunikimi dhe bashkëpunimi mes mësuesve dhe prindërve, se si ndërgjegjësoheshin nxënësit për statusin dhe rolin e tyre në një shoqëri demokratike.

Në këndvështrimin tonë ky rrjet ka sjellë risi në mënyrën e bashkëpunimit mes shqiptarëve të të tri vendeve duke vendosur një dialog të frytshëm, duke ndarë ide për bashkëpunime, duke shkëmbyer përvoja të mësimit plotësues të secilit vend. Mundësimi i bashkëpunimeve mes profesorëve të universiteteve të Rajonit, ishte një përfitim nga rrjeti NEZI, pasi ne kemi pak bashkëpunime rajonale në fushën e edukimit.

Reflektimi i përfundimeve përkatëse në fokusin e edukimit ndërkulturor dhe demokratik

Veprimtaria e rrjetit na ka hapur një dritare të re të shikimit të problemeve që lidhen me kulturën në Shqipëri, me kulturën e emigrantëve, të të riatdhesuarve pasi kanë jetuar për një kohë të gjatë në një vend evropian, na ka ndihmuar t'u japin përgjigje disa prej pyetjeve që lidhen me edukimin ndërkulturor, integrimin, gjithëpërfshirjen, edukimin qytetar; na ka ndihmuar të reflektojmë për programet e përgatitjes dhe kualifikimit të mësuesve dhe për programet në ndihmë të nxënësve të riatdhesuar.

Një reflektim tjetër i yni lidhet me përdorimin e qasjes ndërkulturore në programet e mësuesisë. Me qenë se Shqipëria nuk është një vend shumë i ndryshëm nga përbërja etnike, edukimit ndërkulturor nuk i është kushtuar vëmendje dhe ai nuk është mjaftueshëm i pranishëm në kurrikula. Problemet me emigracionin në 25 vitet e tranzicionit e kanë shtruar si një nevojë të ditës qasjen ndërkulturore. Nga ana tjetër, sistemi arsimor, shkolla dhe mësuesit janë përgjegjës për të forcuar identitetin kulturor dhe vlerat e nxënësit, duke nxitur respekt dhe të kuptuarin e kulturës së të tjerëve. Kështu që zhvillimi i qasjes ndërkulturore do të mundësonte që mësuesit të merrnin një formim të mirë për edukimin ndërkulturor, do të mundësonte një dialog ndërkulturor me dhe te nxënësit, do të rrëzonte stereotipat e ekzagjeruar për kultura të caktuara, do të mundësonte zhvillimin e kompetencave ndërkulturore. Zbatimi i kësaj qasjeje do të kërkonte dhe do të krijonte mjedisin e përshtatshëm për të nxënësit ndërkulturor.

Për pyetjen 2:

Zbatimi i përvojës së fituar në kontekstin e Shqipërisë

Përvoja e fituar nga pjesëmarrja në këtë Projekt mund të përdoret me sukses në auditoret e universiteteve, në trajnimet e mësuesve, në rekomandimet për Ministrinë e Arsimit, për Institutin e Zhvillimit të Arsimit dhe në komunikimin publik.

Duke e vlerësuar ndihmesën e Kosovës për hartimin e strategjisë për mësimin plotësues në diasporë dhe përgatitjen e serisë së librave për mësimin plotësues, ne e gjejmë me bashkëpunimin për të arritur energji.

Për pyetjen 3:**Propozime për vijimin e projektit**

Suksesi i projektit të përfunduar është një garanci që rrjeti NEZI të vijojë veprimtarinë e tij duke ndërmarrë kërkime, duke zhvilluar trajnime, duke ofruar konsulencë, duke promovuar praktikat më të mira, duke publikuar materiale burimore, por edhe duke marrë përsipër fushata ndërgjegjësimi dhe zhvillim ekspertize.

Ne besojmë se rrjeti i ka kapacitetet njerëzore dhe mundësitë për të siguruar qëndrueshmëri, për ta thelluar veprimtarinë e nisur dhe për ta zgjeruar atë në dimensione të reja.

Propozimet tona konkrete lidhen me ndërmarrjen e projekteve:

- Për transferimin e modeleve të edukimit qytetar bashkëkohor,
- për partneritetin në edukim,
- për ngritjen e një shkolle vere në edukim,
- për trajnimin e mësuesve për edukimin shumëkulturore,
- për përgatitjen e paketës së kompetencave për edukimin ndërkulturore,
- për kërkime të përbashkëta për integrimin e emigrantëve dhe të të riatdhesuarve në shoqëritë e vendeve ku shkojnë e kthehen;
- për publikime për mësimin plotësues në diasporë.

Grupi i Kosovës (Pjesëmarrësit/et nga Kosova)

**Arif Demolli,
Lulzim Dragidella,
Nuhi Gashi,
Shqipe Gashi,
Melinda Mula,
Arbër Salihu**

Për pyetjen 1:

Cilat aspekte të punës në rrjetin NEZI ishin posaçërisht interesante dhe relevante për vendin/grupin tonë?

Rrjeti NEZI ishte një ndihmesë e çmuar për të kuptuar nga afër ndërveprimin e kulturës së parë (kulturës familjare, gjuhësore, etnike, të vendlindjes, të origjinës) me kulturën e dytë (shtetërore, multigjuhësore, multifetare, multikulturore të vendit tjetër mikpritës) dhe ndërlidhjet e manifestimet e tyre në mjedise të ndryshme; prej atij në Zvicër e më tutje në shtetet Kosovë, Shqipëri e Maqedoni. NEZI ofroi një mundësi për të kapur më shkoqitur raportet kulturore ndërsqiptare në mjedise a shtete të ndryshme, për të përjetuar dhe bashkëndjerë veprimin e ndërkulturës te emigrantët, riemigrantët, te të rikthyerit në vendin e origjinës, raportin me anëtarët e pakicave etnike në viset ku jetojnë shqiptarët etj.

Rasti i emigrantëve shqiptarë në Zvicër, i parë si shembull i rritjes e zhvillimit (kulturor) në dhe midis sistemeve të ndryshme kulturore dhe normash, na mundësoi të kapim në fusha thelbësore se sa është i vështirë dhe njëherazi sa domethënëse është përshtatja psiko-sociale në mjediset shumëkulturore dhe shumëidentitare, realitete këto që ndërlidhen dhe reflektohen pastaj si në suksesin në mësim (shkollë), ashtu dhe në jetën e mëtejshme.

Në rrafshin kurrikular krahasimtar ndërmjet njësive gjeografike dhe sistemeve shkollore po ashtu diverse shqiptare (3 modelet e shteteve ku jetojnë shqiptarët) dhe Zvicrës, rrjeti bëri të ditura vështirësitë me të cilat përballen shkollat e sistemet arsimore në këtë hapësirë, sfidat evidente dhe vullnetin (Kosovë e Shqipëri) apo mungesën e vullnetit të mjaftueshëm (Maqedoni) për kapërcimin e tyre. Projekti NEZI, duke prezantuar përvojat e shkollave zvicerane, do të ndihmojë më shumë në kapjen e funksionimit praktik të shembullit të shkollës demokratike, duke filluar nga udhëheqja e shkollës e deri te zhvillimi i procesit mësimor nga mësuesit. Shkëmbimi i përvojave e sidomos mundësia që

nga kolegët, ekspertët etj. të prezantohen modele të suksesit në zbatimin e të mësuarit dhe të të jetuarit në demokraci në jetën e përditshme, në shkollë dhe jashtë saj, ka qenë një vlerë e veçantë e projektit.

Po ashtu, parë nga perspektiva e shumësisë së pjesëmarrësve dhe e ndërtuesve të rrjetit, rrjeti ofroi një mozaik rezultatesh edhe shkencore e njohëse të fushave të ndryshme (sociolinguistikë, sociologji kulturore e familjare, antropologji e etnologji, pedagogji ndërkulturore e didaktikë), që iu referohen kompetencave vërtet solide të autorëve e ligjëruesve përkatës.

Në veçanti ai (rrjeti) afirmoi interesin shumëpalësh kulturor të mësimit të gjuhës dhe të kulturës së origjinës (lexo: gjuhës shqipe e kulturës shqiptare) nga ana e fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë në Zvicër.

Për pyetjen 2:

Cilat aspekte/tema do të duhet thelloheshin ose zgjeroheshin?

Në plan të parë do duheshin thelluar shembujt dhe anët praktike të projektit. Mbase, prezantimi i sa më shumë modeleve të suksesshme do të ishte mënyra më e mirë për të kuptuar dhe rritur besimin në vlerat e demokracisë, të tolerancës, të diversitetit kulturor etj., si pasuri personale dhe shoqërore, në një anë, por dhe si mënyrë e të menduarit dhe të jetuarit, në anën tjetër.

Do të duhej një fokusim më i përqendruar në njohjen dhe shpërndarjen e përvojave të suksesshme të përgatitjes së mësuesve para shërbimit dhe në shërbim lidhur me temën e këtij Projekti dhe kategoritë e konceptet e lidhura me të (ndër- dhe multikultura, komunikimi e bashkëpunimi dinamik) duke krijuar, në këtë mënyrë, premisa paraprake për kushte optimale të trajnimit të mësuesve, natyrisht në funksione mbështetëse integruese të të gjithëve dhe në të gjitha mjediset, me një kujdes të veçantë ndaj pakicave dhe komunitetit RAE.

Në rastin e shqiptarëve në Zvicër, do të duhej të hidhej dritë më shumë te brezi i parë dhe i dytë i emigrantëve, ku vërehet një fortifikim kulturor në kode, zakone e konvenca që, duke qenë jo tipike e jo përfaqësuese shqiptare, tashmë në atdheun e origjinës janë kapërcyer dhe nuk paraqesin vlera as identitare, as kulturore, as qytetare. Së këndejmi, duke u hulumtuar e konstatuar modele (e mjedise) të tilla edhe mundësohet hapja kulturore, respektivisht komunikimi dinamik kulturor, si në raport me vendin e origjinës si në raport me vendin e ri. Një fushë gati e paprekur, por me shumë interes kulturor dhe didaktik, na shfaqet roli dhe pozita e gruas shqiptare (në familje, në shkollë, në edukim për demokraci etj.). E gjithë kjo lidhet edhe me hulumtimin e statusit social, ekonomik, kultu-

ror e psikologjik etj. si dhe me perceptimin kulturor të emigrantit apo qytetarit me sfond emigrues; të kapen e afishohen arsyet e ndjesisë personale (është naive) të qenit zakonisht «i dytë» apo edhe i «margjinalizimit» në të dy vendet.

Të hulumtohet më thellë realiteti i një «udhëkryqi kulturor» në funksion të një rekomandimi për një ekuilibrim e vetërealizim të mirëfilltë kulturor e ndërkulturor dhe të afirmohet si një favor, përparësi e mundësi e integritetit të plotë në shoqëri.

Pra, në rrethanat aktuale kulturore, në raportet dinamike mes kulturash, edukimi për demokraci duhet thelluar më tej duke e kuptuar kulturën në natyrën e vetë dinamike dhe të hapur, në atë që sot, në zhvillimet globale është emërtuar si transkulturë e që nënkupton bartje, hapje, marrje të së huajës, dhënie e «tëndes», perceptim i së huajës si e jotja etj., raporte këto ku vlerat kulturore çmohen në rrafsh global dhe trajtohen si pasuri globale. Sigurisht që në rastin shqiptar, në veçanti te ata 40 % që jetojnë edhe fizikisht midis kulturash (edhe këta në Zvicër), barten elemente «të huaja». Dhe, kjo e huaj vepron dhe sigurisht mund të bëhet pjesë e identitetit të secilit të ri shqiptar kur bëhet e vetëdijshme.

Për pyetjen 3:

Pyetja 3: Si do të mund të bëhej ky thellim/zgjerim konkretisht?

Projekti duhet të rrahë në shkëmbimin e përvojave (e atë sidomos mes kolegësh, ekspertësh) të modeleve të suksesit në zbatimin e të mësuarit dhe të jetuarit të demokracisë në jetën e përditshme, në shkollë, por dhe jashtë saj.

Zgjerimi e thellimi duhet shoqëruar me një këmbëngulje të vazhdueshme në hulumtimin, respektivisht në gjetjen e mundësive legjislative e kurrikulare të vendeve pjesëmarrëse. Në jetën e përditshme dhe në shkollë ndërkultura dhe respektimi i diversiteve në kontekste të ndryshme të bëhet pjesë e frymës së institucioneve edukativo-arsimore të të gjitha niveleve formale, e jo vetëm e përmbajtjeve mësimore. Kjo kërkon një ndihmesë me shtrirje e përfshirje të gjerë, në veçanti të atyre të vijnë nga fusha e edukimit, nga shkollat, fakultetet, institucionet qeverisëse, OJQ-të etj.

Si një mundësi tjetër për rezultate më të thelluara shihet ruajtja e vazhdimësisë së rrjetit dhe e funksionimit e bashkëveprimit në projekte konkrete (edhe më të vogla), por me detyra konkrete. Në këtë rrafsh, hulumtimi do të mund të ishte një nga detyrat dhe metodologjitë që do të përdoreshin në të ardhmen. E kjo do të mund të realizohej duke caktuar tema të posaçme për grupe të vogla, me përbërje të përzier nga anëtarët e vendeve përkatëse. Organizimi i akademive të edukimit për qytetari demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, në të cilat do të prezantonin ekspertët e rrjetit NEZI, do të thellonte dhe më tutje promovimin dhe zbatimin e koncepteve demokratike në sistemin shkollor dhe në jetën e përditshme. Në këtë mënyrë, do të fuqizohej bashkëpunimi dhe do të thello-

heshin kompetencat për problemet dhe sfidat e veçanta. Për këto çështje, më pas, do të mund të bëheshin hulumtime dhe do të bëheshin sugjerime konkrete. Këto grupe do të trajtonin tema me interes për edukim demokratik nga fusha e arsimit, sociologjisë së kulturës e të familjes, pedagogjisë ndërkulturore, kompetencës ndërkulturore, integritetit etj., duke e specifikuar e shtrirë veprimtarinë edhe deri në përgatitjen e udhëzimeve për mësues para dhe në shërbim, përgatitjen dhe publikimin e materialeve të ndryshme analitike e studimore deri në hollësi didaktike etj.

Shkurt, ky zgjerim e thellim do të duhej të hapej edhe më tej në drejtim të temave të reja, në drejtim të njerëzve e profileve të ndryshme (por gjithnjë me kompetenca të duhura) të fushës së kulturës, gjuhës, psikologjisë, antropologjisë, didaktikës, pedagogjisë ndërkulturore, etnologjisë, arteve, besimeve etj.

Grupi i Maqedonisë (Pjesëmarrësit/et nga Maqedonia)

**Jonuz Abdullai,
Adelina Marku,
Myqereme Rusi,
Ali Pajaziti,
Afrim Rexhepi,
Nadire Rexhepi**

NEZI: Një përvojë e fluiditetit kulturor konstruktiv

Për pyetjen 1:

Cilat aspekte të punës në rrjetin NEZI ishin posaçërisht interesante dhe relevante për vendin/grupin tonë?

Gjatë punës në rrjetin NEZI veçanërisht interesante kanë qenë hulumtimet e prezantuara të Shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut, njohja dhe përthellimi të problemet e kulturës së parë, të dytë dhe të ndërkulturës të fëmijëve shqiptarë të mërgatës-emigracionit, përgatitja e tyre për përshtatje optimale në një gjuhë dhe mjedis kulturor, bikulturaliteti zviceran-shqiptar, struktura dhe funksionimi i mësimi plotësues, matja e kënaqësisë nga mësimi, përvoja e një studenteje, fëmijë i një martese të përzier dhe të ngjashme, narracionet e mësimdhënësve shqiptarë në Zvicër për zanafillën e këtij organizimi të shkollimit alternativ-plotësues, baticat dhe zbaticat, vështirësitë e përjetuara në drejtim të vënies së gjërave në binar, konform kontekstit zviceran, ndërkohë duke targetuar apologjinë kulturore të komunitetit shqiptar në këtë vend (mik)pritisë (pranues).

Një përjetim i mirë akademik ishte edhe të mësuarit për konceptin e demokracisë qytetare në një shkollë multietnike, organizimi i një mësimdhënësi zviceran për të gjetur «dheun e përbashkët» (common ground) për kategoritë e ndryshme të nxënësve, studentëve që vijnë me sfond të ndryshëm nga vendi i prejardhjes së tyre apo të prindërve të tyre, duke filluar nga Afrika, Ballkani, Azia etj. Element i rëndësishëm i cili duhet shënuar, është edhe vetëdija dhe përgjegjësia për t'u mobilizuar në drejtim të përgatitjes së kuadrove të hapura ndaj shumëkulturësisë e cila është përbërës i pandashëm i epokës së globalizimit, kur duhet të aplikohet ajo që quhet menaxhimi i diversiteteve (diversity management), kur të gjithë duhet të veprojmë në drejtim të jetësimi të demokracisë së gjallë (living democracy). Në këtë drejtim përvoja zvicerane është shumë e rëndësishme

sepse bëhet fjalë për një vend model i demokracisë së drejtpëdrejtë, kur qytetari dhe kërkesat e tij janë në epiqendër të zhvillimeve sociale, ku identitetet shumështrësore janë pjesë integrale e shoqëri-ndërtimit.

Për pyetjen 2:

Cilat aspekte/tema do të duhet thelloheshin ose zgjeroheshin?

Mendojmë se do duhen bërë disa hapa për ta avancuar projektin e demokracisë qytetare, ndryshime në kurikulat shkollore, lënda e demokracisë qytetare duhet të konstruktohet në bazë të Kartës së Këshillit të Europës për Edukim dhe Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut. Duhet organizuar trajnime të mësimdhënësve të profileve të ndryshme (sociologë, pedagogë, psikologë) nga ekspertë të fushës (nga UEJL dhe USHT-Universiteti Shtetëror i Tetovës) në bazë të një teksti të avancuar, të përdorur në vende me traditë demokratike si Zvicra dhe të tjera. Do të ishte shumë produktive që të organizoheshin dy fokusgrupe me nxënës të shkollave fillore në RM që mësojnë për edukimin qytetar dhe një grupi tjetër me nxënës (nga komuniteti shqiptaro-zviceran) për të konstatuar perceptimet e tyre për veten, identitetin, tjetrin, racën, besimin, nënshtetësinë, qytetin, shkollën, shtetin, barazinë, lirinë, drejtësinë, demokracinë, ligjin, pushtetin etj. Në këtë drejtim duhet inkuadruar edhe pala e prindërve për të parë mënyrën e tyre të të menduarit dhe perceptimet e tyre lidhur me mësimin plotësues, për mënyrën dhe metodat e organizimit të këtij procesi të mbindërtimit edukativo-arsimor të këtij brezi që jeton me dilema të identitetit (Kush jam unë? Kuajt i përkas unë? Cili është atdheu im?)

Për pyetjen 3:

Si mund të bëhet konkretisht kjo gjë?

Ky thellim mund të bëhet në bashkëpunim mes projektit NEZI dhe instancave shtetërore, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Kulturës, universitetet, organizatat joqeveritare, duke gjeneruar një doracak për edukimin qytetar, duke e afirmuar këtë koncept përmes fletë-palosjeve, afisheve, bilbordeve, TV video-klipeve etj. Duhet organizuar debate radio-televizive lidhur me këtë subjekt, në kuadër të lëndës «Edukimi qytetar» duhet organizuar vizita të objekteve fetare (tempujve) të kulturës tjetër, duhet shfrytëzuar rrjetet sociale për eliminimin e distancës etnike dhe fetare. Ministria e Arsimit duhet të vërë në përdorim librin «Edukimi qytetar» që favorizon barazinë dhe kohezionin social si prioritet politik i viteve të fundit në nivelin gjithëvropian. Duhet të realizohet një studim

lidhur me lëndët si gjeografia dhe historia, të cilat mendojmë se ngërthejnë në vete shumë teza të pavërtetuara shkencërisht, anime, subjektivizëm, etnocentrizëm dhe kulturo-centrizëm. Përmes metodës së analizës së përmbajtjes ose analizës tekstuale, duhet detektuar njësitë e tilla mësimore të njëanshme, duhet promovuar kritikizmin masovik të palëve të interesuara (stakeholders) që të përpilohen tekste shkollore që do të jenë në përshtatje me frymën e dukimit qytetar. Duhet ngjallur tek nxënësit ndjesinë për mësim të përjetshëm (lifelong learning), për zhvillim të kompetencave qytetare në segmentin e dijes, shkathtësive dhe qëndrimeve gjatë arsimimit shkollor. Ka mundësi që të organizohen ekspozita me piktura të nxënësve lidhur me mënyrën se si ata e shohin botën, kulturën e tyre dhe atë të tjetrit kulturor, duhen organizuar vizita studimore të lagjeve të kulturës tjetër, në veçanti ato unikulturore dhe të «(vetë)getoizuara». Mund të organizohen edhe konkurse për ese, shkrime të fëmijëve që do të pasqyrojnë konceptin e tyre për vlerat bazike të tyre, të familjes, mjedisit dhe shoqërisë në përgjithësi.

Shtesë

Jetëshkrime të shkurtra të pjesëmarrës/eve të rrjetit



Abdullahi, Jonuz; MAK

Jonuz Abdullahi është profesor i rregullt (ordinar) në fushën socio-politike, ligjërues në Fakultetin e Administrimit Publik dhe Shkencave Politike pranë Universitetit të Evropës Juglindore dhe ligjërues në Universitetin AAB në Prishtinë, Fakulteti Ekonomik. Ka marrë pjesë në shumë konferenca vendore dhe ndërkombëtare dhe ka publikuar disa tekste universitare. Gjithashtu ka marrë pjesë në disa projekte ndërkombëtare siç është TEMPUS 4, Projekti për Lidership dhe Punë Rinore në Komunitet, IPA Projektin për vendosjen e partneritetit ndërkombëtar institucional, etj.



Aegerter-Jossen, Miriam; Ch ch

Miriam Aegerter aktualisht është pedagoge në Institutin për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Çështjet e Arsimit dhe drejtuese për studimet e CAS-it, gjermanishtja si gjuhë e dytë dhe ndërkulturaliteti në Shkollën e Lartë Pedagogjike Zug. Arsimin për mësuese filloreje e ka përfunduar në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Cyrih dhe së fundi ka kryer një Master of Arts për Komunikim Ndërkombëtar në Macquarie University në Sydney.



Allenbach, Brigit; CH ch

Brigit Allenbach, Etnologji, Dr. phil. është hulumtuese e asociuar në Universitetin e Freiburgut, Zvicër dhe punon si Bashkëpunëtorë Shkencorë në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Cyrih. Me përqendrim hulumtimi: Emigracioni, gjinia dhe brezi. Aktualisht ajo hulumton për bashkëpunimin e shkollës dhe të familjes. Pikat më të rëndësishme rajonale janë Diaspora e Evropës Juglindore në Zvicër si edhe Afrika Perëndimore.



Bajrami-Grohs, Shqipe; CH alb

Si më e madhja e gjashtë fëmijëve të një drejtori shkolle u arratisa nga Kosova në Zvicër më 1996, në moshën 20-vjeçe. Pasi ndërpreva studimet në Universitetin e Prishtinës, studiova gjermanistikë në Cyrih, të Drejtën Popullore dhe shkenca politike. Pas një veprimtarie të gjatë në administratën e Komunës dhe atë federale, sot punoj si Bashkëpunëtorë Shkencore në Qendrën International Projects in Education IPE të Shkollës së Lartë Pedagogjike Cyrih.



Bühlmann, Regina

Regina B. Bühlmann, me diplomë mësuese filloreje dhe për arsimin e të rriturve, studimet i ka bërë në filozofi, gjermanistikë dhe histori arti. Bashkëpunëtorë Shkencore dhe e ngarkuar për çështjet e emigracionit në Sekretarinë e Përgjithshme të Konferencës Zvicerane të Drejtorëve Kantionalë për edukimin (EDK).



Dahinden, Janine; CH ch

(Mundi të merrte pjesë vetëm në konferencën e parë). Studimet për antropologji shoqërore, komunikimin masiv dhe kriminalistikë, profesoreshtë për studime ndërkombëtare në Universitetin Neuchâtel. Pikat kyçe të punës: Emigracioni, integracioni, bashkëjetesa ndërkulturore etj.



Dautaj, Astrit; ALB

Astrit Dautaj, i lindur në 9 shtator 1959 në Tiranë dhe banoes në Tiranë, Shqipëri. Është diplomuar në Fakultetin e Shkencave Politike (1983) dhe në Fakultetin e Drejtësisë (1999). Punon si përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave në Institutin e Zhvillimit të Arsimit, Tiranë, Shqipëri.



Demolli, Arif; KOS

U lind në fshatin Glllogovicë/Murrizajë afër Prishtinës. Shkollën dhe fakultetin (gjuhë dhe letërsi shqipe) e kreu në Prishtinë, ku jeton edhe sot. Punonte si redaktor në media të ndryshme, pastaj si përgjegjës për tekstet shkollore në Ministrinë e Arsimit e Teknologjisë së Kosovës. Llogaritet ndër autorët më të njohur të Republikës së Kosovës. Ka botuar dhjetra libra për fëmijë dhe të rritur. Ishte bashkëpunëtor në disa projekte të SHLP-së të Cyrihut. Prej vitit 2014 është në pension.



Dragidella, Lulzim; KOS

Kreu akademinë ushtarake në Beograd. Në vitin 1992 emigron në Gjermani. Në Gjermani mbaron studimet për Pedagogji Sociale dhe Punë Sociale, pastaj studimet e Doktoratës në fushën e shkencave sociale. Ka mbaruar specializimin për media. Ai është edhe përkthyes dhe interpret i licencuar nga Gjykata e Qarkut në Heilbronn (Landgericht Heilbronn). Punoi si pedagog dhe punëtor social në disa institucione të fushës sociale në Mynih. Ishte edhe docent në Universitetin e Shkencave Aplikative në Regensburg dhe në Universitetin Protestant të Shkencave Aplikative në Nyrnberg të Gjermanisë.



Fanaj, Ylfete; CH alb

Që prej 1991 (nëntë vjet) në Zvicër, jeton në Lucernë, ka kryer studimet për punë sociale, e ngarkuar për integrimin e Kantonit Nidwalden, Këshilltare e Kantonit dhe Presidente e Fraksionit në Kantonin e Lucernës, punon në shoqata të ndryshme vullnetarisht me fokus: Perspektivat e Secondas shqiptare.



Felkendorff, Kai; CH ch

Kai Felkendorff është pedagog për shkencat e arsimit në Shkollën e Lartë Pedagogjike Cyrih, me përqendrim: Inkluzion, Ekskluzion dhe të pengesave në sistemet arsimore. Aktualisht hulumton në çështjet e dinamikës institucionale dhe të administrimit «Nevojë e veçantë e arsimimit» në Zvicër.



Gashi, Nuhi, KOS

I lindur në katundin Mramuer të Prishtinës. Jeton në Prishtinë dhe Mramuer, punon në Ministrinë e Arsimit të Kosovës si zyrtar për mësimin plotësues në diasporë. Ka studijuar letërsi dhe gjuhë shqipe në Prishtinë. Është magjistër i shkencave filologjike. Ka botuar një mori shkrimesh e studimesh letrare e didaktike në media të ndryshme. Është bashkëkoordinator i Projektit të MASHT-it të Kosovës dhe i SHLP-së të Cyrihut (së bashku me Prof. dr.dr. Basil Schader dhe Arif Demollin), tekste për diasporën (3 libra në 19 fletore tematike).



Gashi-Ramadani, Shqipe; KOS

Jeton në Prishtinë, Kosovë. Është master e pedagogjisë. Nga viti 1993–2000 ka punuar mësuese filloreje dhe mësuese në shkollë fillore. Që nga viti 2000 punon në MASHT, në zyrën e kurrikulave dhe ka marrë pjesë në hartimin dhe zbatimin e dokumenteve kurrikulare. Nga viti 2002-2005 ka koordinuar hartimin e planeve dhe programeve mësimore të lëndës edukatë qytetare. Aktualisht koordinon zbatimin e kurrikulës për asimin fillor.



Gollob, Rolf; CH ch

Prof. Dr. h.c. Rolf Gollob është sot drejtues i Qendrës për Projekte të Arsimit Ndërkombëtar (International Projects in Education) në Shkollën e Lartë Pedagogjike Cyrih. Pas shumë vitesh si mësues fillloreje studioji etnologji dhe publicistikë në Universitetin e Cyrihut. Mbi 20 vjet ishte pedagog në Shkollën e Lartë Pedagogjike Cyrih me përqendrim në didaktikën e specialitetit, edukim politik dhe pedagogji ndërkulturore. Veç kësaj, që prej 1996, është ekspert (për të Drejtat e Njeriut dhe edukimin demokratik) për Këshillin e Evropës në vendet e Evropës Lindore dhe Juglindore. Ai përfaqëson Zvicrën në Këshillin e Evropës për fushat tematike: Edukimi demokratik dhe edukimi për të Drejtat e Njeriut (Education for Democratic Citizenship and Human Rights Education – EDC/HRE).



Haenni Hoti, Andrea; Ch ch

Andrea Haenni Hoti është profesoreshë në Shkollën e Lartë Pedagogjike Lucern për shkencat sociale dhe të edukimit. Ka qenë edhe si profesoreshë e ftuar në Universitetin e Torontos (Kanada) dhe në Augsburg (Gjermani). Aktualisht hulumton dhe jep mësim për temat «Diversiteti gjuhësor dhe kulturor», «Akulturacioni» dhe «Të drejtat për shance në shkollë».



Hauser, Benedikt

Benedikt Hauser është zëvendësdirigjtor i Departamentit për Bashkëpunimin e Arsimit të Sekretarit të Shtetit për Edukim, Hulumtim dhe Inovacion (SBFI). Më parë, gjatë Luftës së dytë Botërore ka punuar, ndër të tjera, për Institutin e të Atëhershëm zvicëran për Kredi dhe për Komisionin e Pavarur të Ekspertëve në Zvicër.



Haxhijaj, Rifat; CH alb

Rifat Haxhijaj është i lindur me 30 tetor 1968 në Banjë të Pejës. Me përfundimin e shkollës fillore ai vijoi gjimnazin dhe fakultetin në Beograd. Pas instalimit të tij në Zvicër në vitin 2000 regjistrohet në Universitetin e Gjenevës, përfundon në 2005 Masterin në sociologji të familjes dhe në 2014 doktoraturën në sociologji të emigracionit. Aktualisht punon në departamentin e punësimit, të çështjeve sociale dhe të shëndetësisë në Gjenevë. Paralelisht, në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm, ligjëron sociologjinë në Universitetin e Prishtinës. Përpos librit «Les jeunes d'origine kosovare à Genève» i botuar në Paris në shtator 2015, ai është autor i dhjetëra artikujve dhe analizave sociale si dhe të romanit «Jetë e ndalur».



Jashari, Shpresa; CH alb

Shpresa Jashari është doktorante në Universitetin Neuchâtel dhe hulumton në lëndët (Analiza e diskurseve gjuhësore & Hulumtimi shoqëror cilësor) për martesën transnacionale në Zvicër. Në qendër të veprimtarisë së saj si autore dhe aktiviste qëndrojnë emigrimi, transnacionaliteti dhe Gender. Shpresa, trevjeçare u morr me vete nga Maqedonia në Zvicër, ku ajo në fillim jetoi si «jugosllave» më pas si shqiptare dhe sot si njeri me sfond emigrimi.



Kajtazi, Driton; CH alb

Driton Kajtazi, drejtor i ISEAL-it (www.iseal.ch) mësimdhënës i frengjishtes, projekteve dhe historisë fetare dhe biblike në kolegjin Léon-Michaud në Yverdon-les-Bains (që prej 2003). Ndër të tjera autor: Hënore e Zvicrës (Antologji e letërsisë së Zvicrës franceze) dhe pjesa teatrale Guri Ura, l'étranger d'ici. I diplomuar në frengjishten moderne (Universiteti i Lozanës) dhe Executive Master of Advanced Studies in Intercultural Communication në Universitetin e Luganos. Kryetar i Jurisë Kantonale për Çmimin e Integrimit Le Milieu du Monde (2013).



Kraja, Admir; ALB

Ka përfunduar studime të gjermanistikës dhe didaktikës së gjuhës gjermane si gjuhë e huaj në Shkodër (ALB), Graz (AUT) dhe Jena (DEU) dhe ka kualifikime të mëtjshme në: Komunikim ndërkulturor, didaktika e translacionit etj. Nga 2010–2014 ai punoi si specialist kurrikule dhe për didaktikën e re të mësimdhënies në Institutin e Zhvillimit e Arsimit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë. Në 2015 ai bashkëpunoi me Kulturkontakt Austria dhe me Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.



Maloku, Nexhat; CH alb

M.A. Studime në Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Universitetin e Prishtinës, i certifikuar në fushën e mediave në Shkollën e Lartë për Punë Sociale në Cyrih, mësues i gjuhës shqipe të mësimi plotësues, udhëheqës i kursit për të rritur në Shkollën e Lartë të Udhëttimeve në Cyrih, udhëheqës i udhëttimeve studimore në vendet e Evropës Juglindore, udhëheqës i projekteve në fushën arsimore në Zvicër e Kosovë, Kryetari i Lidhjes së Arsimtarëve dhe Prindërve Shqiptarë «Naim Frashëri» në Zvicër



Marku, Adelina; MAK

Adelina Marku është lindur në vitin 1971 në Dibër të Republikës së Maqedonisë. Aktualisht punon në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë si Drejtoreshë e Akademisë Diplomatike pranë kësaj ministrie. Është e njohur si opinioniste dhe një ndër kolumnistet e periudhës së tranzicionit shoqëror, para dhe pas shkatërrimit të ish-Jugosllavisë. Është diplomuar në shkencat e mjekësisë, master në shkencat politike në temën e psikologjisë politike të partive politike në Maqedoni dhe ka një sërë specializimesh nga fusha e diplomacisë dhe lidershipit. Jeton dhe punon në Shkup.



Mita, Nikoleta; ALB

Profesor në Departamentin e Pedagogjisë dhe të Psikologjisë të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Ka kryer specializime në fushën e pedagogjisë dhe të psikologjisë brenda dhe jashtë vendit. Që nga viti 2002 mban titullin akademik «Profesor». Ka një përvojë 37-vjeçare në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit, në fushën e shkencave të edukimit dhe të psikologjisë. Aktualisht zhvillon mësim në programet Master në Shkencave të Edukimit, Master në Psikologji dhe në programet e studimeve doktorale në fushën e pedagogjisë dhe të filozofisë. Është bashkëpunëtore në shumë projekte shkencore. Ka botime të shumta në fushën e edukimit.



Mula, Melinda; KOS

Zyrtare programore në Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC) dhe mësimdhënëse në departamentin e matematikës të Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore të Universitetit «Hasan Prishtina» në Prishtinë. Është magistër i shkencave matematikore dhe studente e doktoraturës në Universitetin e Ljubllanës. Ajo menaxhon disa programe për zhvillimin profesional të mësimdhënësve lidhur me zbatimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënësve. Ka marrë pjesë në shumë programe trajnimi, si për EDC/HRE, zhvillim të përmbajtjeve mësimore dhe hartim të testeve, ndër dhe multikulturalizëm, dialog social, edukim kundër korrupsionit, etj.



Pajaziti Ali; MAK

Ali Pajaziti, Ph.D. (1972), sociologist, thinker and researcher, translator from Skopje (Macedonia), lecturer in SEE University on sociology, ethics and anthropology, President of Balkan Sociological Forum, editor of humanities publications at Logos-A Publishers, member of the Council of Max van der Stoep Institute. Author of several books, among others also of the first Albanian sociological dictionary (Dictionary of Sociology, 2009) and author of scientific translations from English and Turkish to Albanian and Macedonian. He is one of three authors of EACME Winner paper (2008), High Performance Award at SEEU (2013)



Ramadani, Shukrije; CH alb

Shukrije Dema Ramadani, Drejtore e Qendrës Kulturore për Zvicrën nga Ministria e Diasporës së Kosovës. Shkollimi dhe arsimimi: Gjuhë dhe letërsi shqipe në Gjiçan. Fakulteti Bachelor drejtimi i edukimit në Prishtinë si dhe Master në degën e edukimit në Fakultetin Filologjik në Prishtinë



Rexhepi, Afrim A.; MAK

Afrim A. Rexhepi (1972, Shkup), profesor ordinar në kulturologji në Universitetin «Shën Cirili dhe Metodij» në Shkup. Është doktoruar në estetikë, pragmatizëm teorik, veprat e Ismail Kadaresë. Është autor i shtatë veprave hulumtuese, shkencore. Jeton dhe punon në Shkup.



Rexhepi, Nadire; MAK

Nadire Rexhepi ka kryer masterin për studime të gjuhës gjermane, punon mësimdhënëse e gjuhës gjermane pranë gjimnazit «Kiril Pejçinoviç» në Tetovë. Ajo është koordinatore e Projektit për Shpalljen e Malit Sharr Zonë e Mbrojtur (park nacional) pranë Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinorë.



Rusi, Myqereme; MAK

Myqereme Rusi ka mbaruar studime për psikologji në Maqedoni dhe në Shqipëri, ajo ka një magjistraturë dhe një doktoraturë në psikologji (tema e doktoraturës: Ankthi dhe ndikimi i tij në shpejtësinë e të menduarit te nxënësit shqiptarë), ka kryer kualifikime të mëtejshme, të ndryshme. Aktualisht punon si profesoreshë në Universitetin Shtetëror të Tetovës; ka përvojë të gjatë humltuese dhe botuese, është anëtare e shumë grupeve pune ndërkombëtare dhe kombëtare.



Salihu, Arbër; KOS

Jeton në Prishtinë, Kosovë. Është magjistër i shkencave historike dhe aktualisht përgatit tezën e doktoraturës për historinë bashkëkohore të Kosovës. Ka punuar si mësimdhënës i historisë në shkolla fillore dhe të mesme. Që nga viti 2000 punon në MASHT, si zyrtar për hartimin e kurrikulave. Gjithashtu është kordinator i Republikës së Kosovës në Projektin e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetarinë Demokratike (EQD).



Schader, Basil; CH ch

Prof. Dr. Dr. phil. Studime për gjermanistikë, pedagogji dhe etnologji evropiane si dhe për gjuhë dhe letërsi shqipe. Pedagog në Shkollën e Lartë Pedagogjike Cyrih (didaktika e gjuhës gjermane dhe e gjermanishtes si gjuhë e dytë), drejtues projekti në Qendrën IPE (International Projects in Education) të Shkollës së Lartë Pedagogjike Cyrih, autor i librave të ndryshëm mësimorë dhe publikimeve shkencore.



Selimi, Naxhi; CH alb

Dr. Naxhi Selimi vjen nga Maqedonia dhe është mësues për shkencat e gjuhësisë dhe të edukimit për shkollat fillore dhe gjimnazet. Që prej shumë vitesh punon në fushën e arsimit. Aktualisht punon si pedagog për didaktikën e gjuhës gjermane në Shkollën e Lartë Pedagogjike Shvyc. Me përqendrim në: përfitimi i leksikut në një mjedis shumëgjuhësh, shkrimi në kontekstin e gjuhës në shkollë, diagnostika semantiko-leksikore dhe kompetenca e gjuhës me shkrim, gjuhësia, zhvillimi i gjuhës në fëmijërinë e hershme



Xhumari, Merita; ALB

Prof. Assoc. Dr. Merita Xhumari, profesore në departamentin e shkencave politike të Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, me përvojë si kërkuese shkencore në projekte kombëtare dhe rajonale të Komisionit Evropian, Këshillit të Evropës, Bankës Botërore, ILO, UNDP, etj. Autore e tekstit universitar «Procesi dhe institucionet e politikës sociale», 2014 dhe e monografisë «Trajektoret e pensioneve në Ballkanin Perëndimor», 2011.

Seria e dokumentacioneve DOK e Qendrës International Projects in Education (IPE, Projekte Ndërkombëtare në Edukim) e Shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut, merret me çështjet e fushës së bashkëpunimit për zhvillimin pedagogjik. Seria DOK prezanton rezultatet e dijeve dhe të hulumtimeve nga projektet ndërkombëtare për arsimin të IPE-së. Pika kyçe janë temat e emigrimit dhe të integritit, të edukimit demokratik dhe të edukimit për të Drejtat e Njeriut, të orientimit për përzgjedhjen e profesionit si edhe Life Skills dhe vetëkompetenca.

Vëllimi I i serisë DOK, përmban përvojat dhe perspektivat e projektit «Rrjeti Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura: Për dinamikën e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme normash dhe referimesh» (NEZI). Raporti për projektin përshkruan bashkëpunimin transnacional midis grupeve ekspertësh nga hapësira shqiptare dhe Zvicra dhe jep një vlerësim të vështirimeve, konsekuencave dhe perspektivave të lidhura me rrjetin.

«Mbetet e pamohueshme që ky projekt ka kontribuar për hapjen dhe për forcimin e sistemit shkollor të Zvicrës: Ai u ka lejuar shkollave të larta të vendit tonë të zgjerojnë e thellojnë shkëmbimin shkencor ndërkombëtar.»

BENEDIKT HAUSER,
SEKRETARIAT SHTETËROR ZVICERAN PËR ARSIM, KËRKIM DHE INOVACION